



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



Komuna e Istog  
Opština Istog  
Istog Municipality

00 Numër: 103/2024  
Data:22.07.2024

<http://kk.rks-gov.net/istog/>  
Tel: 038/200 438 14

**KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG**

Për: Të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës-Istog

Në bazë të nenit 43 neni 45 dhe neni 47 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28/2008) dhe neni 48.3 të Statutit të Komunës së Istogut 01Nr.62/2010, neni 5 i Udhëzimit Administrativ MAPL Nr.02-2015 për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

**T H È R R A S**

Mbledhjen e 29<sup>te</sup> të rregullt të Legjislacionit të VII<sup>te</sup> të Kuvendit të Komunës.

Mbledhja do të mbahet më: **30.07.2024, e Martë**, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, kati III, duke filluar me punë në ora 10:00.



**R E N D   D I T E:**

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Propozim-Vendimi për Shfuqizimin e Vendimit për Ri-alokimin dhe Transferin e mjeteve në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale për arsye të mbetjeve nga projektet kapitale të vitit 2023, për realizimin e projekteve të vitit 2024 nga fondi burimor 21-22,
4. Njoftimi me raportin e punës së Kryetarit të komunës për 6 mujorin e vitit 2024,
5. Njoftimi me raportin e KRM "Ambienti" për 6 mujorin e vitit 2024,
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Veprimit për Energji të Qëndrueshme dhe Klimë,
7. Shqyrtimi i raportit financiar për tre mujorin e dytë të vitit fiskal 2024,
8. Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe miratimi i Planit të Veprimit për Eliminimin e të metave të rekomanduara nga AP,
9. Shqyrtimi dhe miratimi i Listës së projekteve me bashkëfinancim me komunitetin, Korrik 2024,
10. Dhënia në Shfrytëzim e pronës (sipërfaqes prej 3650 m<sup>2</sup>) nga pjesa e përgjithshme e sipërfaqes prej 42060m<sup>2</sup> nga njësi kadastrale me nr.P - 70806016 - 00067 - 1 si dhe pjesës së sipërfaqes prej 350m<sup>2</sup> nga pjesa e përgjithshme prej 17404 m<sup>2</sup> e parcelës 00069 - 1 zona kadastrale Gurrakoc pronë e paluajtshme e Komunës së Istogut përmes negocimit - direkt investitorit Mehmet Imeraj pronar i "Rina Komerc" Sh.P.K,
11. Dhënia në Shfrytëzim e pronës (sipërfaqes prej 16942 m<sup>2</sup>) pjesë e përgjithshme e sipërfaqes nga njësi kadastrale me nr.P - 70806044 - 00896 - 0 Zona kadastrale Sinajë pronë e paluajtshme e Komunës së Istogut përmes negocimit - direkt investitorit Arber Avdijaj, pronar i "Agro Produkt" Sh.P.K,
12. Dhënia në Shfrytëzim e pronës (sipërfaqes prej 4858 m<sup>2</sup>) pjesë e përgjithshme e sipërfaqes nga njësi kadastrale me nr.P - 70806044 - 00213 - 4 Zona kadastrale Sinajë K,Istog pronë e paluajtshme e Komunës së Istogut përmes negocimit - direkt investitorit Abedin Haxhijaj pronar i "Dritoni Plast" Sh.P.K,
13. Dhënia në Shfrytëzim e pronës (sipërfaqes prej 3199 m<sup>2</sup>) pjesë e përgjithshme nga njësi kadastrale me nr.P - 70806016 - 00029 - 21 ,sipërfaqja prej 609 m<sup>2</sup> nga parcela me nr.00034 - 2, parcela 00034 - 3 me sipërfaqe prej 66 m<sup>2</sup> si dhe 00034 - 4,Zona kadastrale Gurrakoc pronë e paluajtshme e Komunës së Istogut përmes negocimit - direkt investitorit Jeton Kabashi pronari B.I "Shija" Gurrakoc Istog.
14. Të ndryshme.

**Vërejtje :**

Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në mbledhje, t'i referoheni dispozitës së nenit 39 paragrafi 39.8 të LVL.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	<b>KRYETARI I KOMUNËS          PRESDENIK OPŠTINE          MUNICIPAL MAYOR</b>		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	01 Nr.574/2024	Datë: 16.07.2024	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 58 pika (h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale publikuar në ( Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008 ) dhe nenin 68, pika 8 e Statutit të Komunës 01 Nr. 62/10 të datës 30.11.2010 i :

### Propozon

Kuvendit të Komunës, që në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2 pika (d), nenit 14 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 11 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr. 06/L-092 ( Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/2019), nenit 23 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 83 të Statutit të Komunës së Istogut 01 Nr.62/2010, nenit 53, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative që në mbledhjen e mbajtur më 30.07.2024 të miratojë këtë:

### VENDIM PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS 00.Nr.66/2024 i datës 30.04.2024

Për Ri-alokimin dhe Transferin e mjeteve në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale, për arsye të mbetjeve të mjeteve nga projektet kapitale të vitit 2023, për realizimin e projekteve të vitit 2024 si më poshtë nga fondi burimor 21-22:

#### **1. Ri-alokimi i mjeteve financiare nga Programet Buxhetore: Kategoria Ekonomike Shpenzime Kapitale nga burimi i financimit 22:**

Në kuadër të nën-programi Buxheti 17517, nga projektet:

- (54000) "Ndërtimi i rrethojave në varrezat e fshatrave Zhakove, Tomoc" shuma prej 4,016.60 € ;
- (54003) "Ndërtimi i rrugëve ne fshatrat Dragolevc, Istog, Istog i Poshtëm" shuma prej 591.00 €;
- (54002) )" Ndërtimi i rrugëve në fshatrat Orroberdë, Dobrushë, Saradran "shuma prej 5,175.80 €;

#### **Të ri- alokohen në projektin:**

(50240) " Projekti me participim te Komunitetetit ,ministrive te linjës,Donatoret e jashtëm" shuma prej: 9.783.40 €

#### **2. Në kuadër të nën-programit Infrastruktura Rrugore 18017, nga projektet:**

- (53271) "Ndërtimi i trotuarit në Dubravë" shuma prej 1,136.70 €,
- (53282) "Ndërtimi i trotuarit koder - poligoni sportiv (Tomoc)"shuma prej 555.50€,
- (53305) "Ndërtimi i trotuareve në Shushicë të Epërme-shkolla" shuma prej 220.56 €,
- (53319) "Ndërtimi i transfer deponisë në Tyçep" shuma prej 2,120.00 €,
- (53335) " Ndërtimi i infrastrukturës së varrezave në Dubovë të Vogël "shuma prej 3,936.80€,
- (53386) " Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Mojstir " shuma prej 5,111.50€,
- (53392) " Ndërtimi i ndriçimit publik ne Banjë "shuma prej 556.00€,
- (53393) " Ndërtimi i kanalizimit në Prekallë-lagjia Hasanaj - Maxharraj"shuma prej 308.00 €,

- (53397) "Ndërtimi i kanalizimit në Lluga - lagja Balaj " shuma prej 2,100.00 €.
- (53402) " Ndërtimi i kanalizimit në Studenicë, lagja Zeqiraj dhe Lipa ""shuma prej 3.735.40€.
- (53403) " Ndërtimi i ndriçimit publik ne Vrellë " shuma prej 154.00 €.
- (53404)" Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Drejë "shuma prej 285.50 €.
- (53406) " Ndërtimi i ndriçimit publik në Istog të Poshtëm " shuma prej 226.50 €.
- (53407)" Ndërtimi i kanalizimit ne fshatin Kosh lagja "Frrokaj" shuma prej 2,616.00€,
- (53409)" Ndërtimi i kanalizimit Prigodë " shuma prej 1.386.70 €;:

Të ri –alokohen në projektin:

(50910) "Ndërtimi i tregut të Ri në Istog" shuma prej: 24,449.16 €.

3. Nga nën-programi Bujqësia 47017, nga projekti: (53239)"Ndërtimi i Rrugës Malore Kaliqan-Shkalla e Kaliqanit", shuma prej 15.00 €.

Të ri- alokohen ne projektin:

Bujqësia 47017, në projektin:

(50940) "Ndërtimi i kanalit të ujitjes Lagja Balaj-Lluga" shuma prej: 15.00 €.

4. Trasferimi i mjeteve financiare nga Programet Buxhetore: Kategoria Ekonomike Shpenzime Kapitale nga burimi i financimit 21:

Nga nen programi Planifikimi Hapësinor dhe Rregullativ 66090, nga projekti:

(50945)"Rregullimi i shtratit të lumit të Istogut, prej burimit te ujit e deri te ura e Hotel Troftes (faza e parë)", shuma prej 75,000.00 €.

Të transferohet në nën-programin dhe ne projektin:

Infrastruktura Rrugore 18017, në projektin:

(50910) "Ndërtimi i tregut të Ri në Istog" shuma prej: 75,000.00 €.

5. Transferimi i mjeteve financiare nga Programet Buxhetore: Kategoria Ekonomike Shpenzime Kapitale nga burimi i financimit 22:

Nga nen programi Planifikimi Hapësinor dhe Rregullativ 66090, nga projekti:

(50945)"Rregullimi i shtratit të lumit të Istogut, prej burimit te ujit e deri te ura e Hotel Troftës ( faza e parë)", shuma prej 30,000.00.

Të transferohet nën-programin dhe ne projektin:

Administrata –16317,në projektin:

(53257) "Ndërtimi i Infrastrukturës për "Smart City" shuma prej: 30,000.00 €.

Nga nën-programi Planifikimi Hapësinor dhe Rregullativ66090, nga projekti:

(50300), "Rregullimi i Trotuareve në Istog (Zonat Urbane)", shuma prej 4,037.26 €.

Të transferohet nën-programin dhe ne projektin:

Infrastruktura Rrugore 18017, në projektin:

(53367) "Ndërtimi i mureve mbrojtëse në Fshatrat e Komunës së Istogut Banjë, Istog, Vrellë, Gurakoc, RakoshStaradran" shuma prej: 4,037.26 €.

Nga nën-programi Shërbimet Kulturore 85017, nga projekti:

(52836)"Ndërtimi i rrethojës në Poligonin Sportiv në Gurrakoc", shuma prej 5,000.00 €.

Të transferohennë nën programin Infrastruktura Rrugore 18017, në projektin:  
(54969) "Ndërtimi i urave në: Vrellë, Gurrakoc, Dubravë, Padalishë, Kerrninë, Kovragë, Kalijan,  
Studenicë dhe Rakosh" shuma prej: 5,000.00€.

**Nga nën programet dhe nga projektet**

-Arsimi i mesëm i lartë, 94680, nga projekti (52746)"Blerja e Pajisjeve për kabinetin e Informatikës", shuma prej 2,680.00 €,

-Arsimi fillor, i mesëm i ulët, 93480, nga projektet(52764)"Ndërtimi i një pjese te rrethojës mbi murin e sh.f.m.u Tre Dëshmoret Uçë dhe rrethojës ne Shfmu "Ndre Mjeda" Rakosh", shuma prej 2,177.00 €,

(52789)"Ndërtimi i infrastrukturës se jashtme ne sh.f. Bajram Curri - Dubravë", shuma prej 981.00.(euro)

Të transferohet në nën programin dhe ne projektin:

-Arsimi parashkollor, 92530 në projektin me kod (52798) "Ndërtimi i këndit te lojërave për para fillor në 5 çerdhet e Komunës së Istogut "Istog, Banjë, Vrellë, Gurrakoc dhe Rakosh" shuma prej: 5,838.00 €

Kryetari i Komunës  
z. Ilir FERATI







Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut  
Opština Istok  
Istog Municipality

## KUVENDI I KOMUNËS / SKUPŠTINA OPŠTINE / MUNICIPAL ASSEMBLY

00Nr.66/2024

Data: 30.04.2024

Kuvendi i Komunës bazuar në Nenin 12 paragrafi 12.2 nenparagrafi d), nenit 40 paragrafi 40.2 pika c, të Ligjit Nr.03/L 040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 33.1 pika 2. Statutit të Komunës së Istogut 01.Nr.62/2010 të datës 30.11.2010 në mbledhjen e mbajtur me datë 30.04.2024 shqyrtoj dhe Propzim Vendimin për Ri-alokimin dhe Transferin e të hyrave vetanake nga fondi burimor 21 dhe 22, për arsye të rialokimit dhe transferim të mbetjeve nga projektet kapitale të vitit 2023 dhe marrë këtë:

### V E N D I M

Për Ri-alokimin dhe Transferin e mjeteve në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale, për arsye të mbetjeve të mjeteve nga projektet kapitale të vitit 2023, për realizimin e projekteve të vitit 2024 si më poshtë nga fondi burimor 21-22:

#### **1. Ri-alokimi i mjeteve financiare nga Programet Buxhetore: Kategoria Ekonomike Shpenzime Kapitale nga burimi i financimit 22:**

Në kuadër të nën-programi Buxheti 17517, nga projektet:

(54000) "Ndërtimi i rrethojave në varrezat e fshatrave Zhakove, Tomoc" shuma prej 4,016.60 €;

(54003) "Ndërtimi i rrugëve ne fshatrat Dragolevc, Istog, Istog i Poshtëm" shuma prej 591.00 €;

(54002) " )" Ndërtimi i rrugëve në fshatrat Orroberdë, Dobrushë, Saradran "shuma prej 5,175.80 €;

Të ri- alokohen në projektin:

(50240) " Projekti me participim te Komunitetetit ,ministrive te linjës,Donatorët e jashtëm" shuma prej: 9,783.40 €

2. Në kuadër të nën-programit Infrastruktura Rrugore 18017, nga projektet:

(53271) "Ndërtimi i trotuarit në Dubravë" shuma prej 1,136.70 €,

(53282) "Ndërtimi i trotuarit koder - poligoni sportiv (Tomoc)" shuma prej 555.50€,

(53305) "Ndërtimi i trotuareve në Shushicë të Epërme-shkolla" shuma prej 220.56 €,

(53319) "Ndërtimi i transfer deponisë në Tyçep" shuma prej 2,120.00 €,

(53335) " Ndërtimi i infrastrukturës së varrezave në Dubovë të Vogël "shuma prej 3,936.80€,

(53386) " Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Mojstir " shuma prej 5,111.50€,

(53392) " Ndërtimi i ndriçimit publik ne Banjë "shuma prej 556.00€,

(53393) " Ndërtimi i kanalizimit në Prekallë-lagjia Hasanaj - Maxharraj" shuma prej 308.00 €,

(53397) "Ndërtimi i kanalizimit në Lluga - lagja Balaj " shuma prej 2,100.00 €,

(53402) "Ndërtimi i kanalizimit në Studenicë, lagja Zeqiraj dhe Liza" shuma prej 3,735,400 €.

(53403) "Ndërtimi i ndriçimit publik në Vrellë" shuma prej 151,000 €.

(53404) "Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Drejë" shuma prej 285,500 €.

(53406) "Ndërtimi i ndriçimit publik në Istog të Poshtëm" shuma prej 226,500 €.

(53407) "Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Kosh lagja "Trokaj" shuma prej 2,616,000 €.

(53409) "Ndërtimi i kanalizimit Prigodë" shuma prej 1,386,700 €.

Të ri -alokohen në projektin:

(50910) "Ndërtimi i tregut të Ri në Istog" shuma prej: 24,449.16 €.

3. Nga nën-programi Bujqësia 47017, nga projekti: (53239) "Ndërtimi i Rrugës Malore Kaliqan-Shkalla e Kaliqanit", shuma prej 15.00 €.

Të ri- alokohen në projektin:

Bujqësia 47017, në projektin:

(50940) "Ndërtimi i kanalit të ujitjes Lagja Balaj-Lluga" shuma prej: 15.00 €.

4. Trasferimi i mjeteve financiare nga Programet Buxhetore: Kategoria Ekonomike Shpenzime Kapitale nga burimi i financimit 21:

Nga nën programi Planifikimi Hapsinor dhe Rregullativ 66090, nga projekti:

(50945) "Rregullimi i shtratit të lumit të Istogut, prej burimit të ujit e deri te ura e Hotel Troftes (faza e parë)", shuma prej 75,000.00 €.

Të transferohet në nën-programin dhe në projektin:

Infrastruktura Rrugore 18017, në projektin:

(50910) "Ndërtimi i tregut të Ri në Istog" shuma prej: 75,000.00 €.

5. Trasferimi i mjeteve financiare nga Programet Buxhetore: Kategoria Ekonomike Shpenzime Kapitale nga burimi i financimit 22:

Nga nën programi Planifikimi Hapsinor dhe Rregullativ 66090, nga projekti:

(50945) "Rregullimi i shtratit të lumit të Istogut, prej burimit të ujit e deri te ura e Hotel Troftes ( faza e parë)", shuma prej 30,000.00.

Të transferohet nën-programin dhe në projektin:

Administrata -16317, në projektin:

(53257) "Ndërtimi i Infrastrukturës për "SmartCity" shuma prej: 30,000.00 €.

Nga nën-programi Planifikimi Hapsinor dhe Rregullativ 66090, nga projekti:

(50300), "Rregullimi i Trotuarëve në Istog (Zonat Urbane)", shuma prej 4,037.26 €.

Të transferohet nën-programin dhe në projektin:

Infrastruktura Rrugore 18017, në projektin:

(53367) "Ndërtimi i mureve mbrojtëse në Fshatrat e Komunës së Istogut Banjë, Istog, Vrellë, Gurakoc, RakoshStaradran" shuma prej: 4,037.26 €.

Nga nën-programi Shërbimet Kulturore 85017, nga projekti:

(52836) "Ndërtimi i rrethojës në Poligonin Sportiv në Gurrakoc", shuma prej 5,000.00 €,

Të transferohennë nën-programin Infrastruktura Rrugore 18017, në projektin: (54969) "Ndërtimi i urave në: Vrellë, Gurrakoc, Dubravë, Padalishtë, Kerninë, Kovragë, Kaliqan, Studenicë dhe Rakosh" shuma prej: 5,000.00€.

**Nga nën programet dhe nga projektet**

-Arsimi i mesëm i lartë, 94680, nga projekti (52746) "Blerja e Pajisjeve për kabinetin e Informatikës", shuma prej 2,680.00 €,

-Arsimi fillor, i mesëm i ulët, 93480, nga projektet (52764) "Ndërtimi i një pjese të rrethojës mbi murin e sh.f.m.u Tre Dëshmoret Uçë dhe rrethojës në Shfmu Ndre Mjeda Rakosh", shuma prej 2,177.00 €,

(52789) "Ndërtimi i infrastrukturës së jashtme në sh.f. Bajram Curri - Dubravë", shuma prej 981.00 € , :

Të transferohet në nën programin dhe në projektin:

-Arsimi parashkollor, 92530 në projektin me kod (52798) "Ndërtimi i këndit të lojërave për para fillor në 5 çerdhet e Komunës së Istogut "Istog, Banjë, Vrellë, Gurrakoc dhe Rakosh" shuma prej: 5,838.00 €

Kryesuesi i Kuvendit  
z. Enver Rugova





REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E ISTOGUT/ OPSTINA ISTOK/ MUNICIPALITY OF ISTOG

KRYETARI/PREDSIEDNIK/MAYOR

---

**RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT PËR PERIUDHËN**  
**JANAR- QERSHOR 2024**

*Korrik 2024*

## PËRMBAJTJA:

1. HYRJE .....	3-8
2. DREJTORIA PËR ADMINISTRATË KOMUNALE.....	8-21
3. DREJTORIA PËR INSPEKSION.....	22-22
4. DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA.....	23-34
5. DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK .....	35-37
6. DREJTORIA PËR KADASTËR DHE GJEODEZI.....	37-38
7. DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MJEDIS.....	39-43
8. DREJTORIA PËR ARSIM.....	43-47
9. DREJTORIA PËR KULTURË RINI DHE SPORT.....	47-50
10. DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE HIDROEKONOMI.....	51-54
11. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI .....	54-56
12. DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPETIM.....	57-62
13. DREJTORIA PER PUNE DHE MIREQENIE SOCIALE.....	63-65
14. DREJTORIA PER SHERBIME PUBLIKE.....	66-67
15. ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE.....	67-69
16. PLANI I VEPRIMIT PËRZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TE DHENA NGA ZYRA KOMBETARE E AUDITIMIT PER PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË ISTOGUT PËR VITIN 2023.....	70-87

## **HYRJE**

### **Udhëheqësi i Komunës**

Komuna si njësi themelore e pushtetit lokal funksionon në bazë të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/08), Statutit të Komunës si akt më i lartë i komunës si dhe Ligjeve të tjera me të cilat janë përcaktuar kompetencat dhe fushëveprimi i saj. Me ligjin e përmendur janë përcaktuar struktura dhe organet e pushtetit lokal dhe Komunave iu është lënë hapësirë për formimin e drejtorive, përkatësisht përcaktimit të numrit të tyre. Në këtë kontekst si organe të Komunës në Ligjin për vetëqeverisjen lokale janë përcaktuar: Kryetari si organ më i lartë ekzekutiv, i zgjedhur drejtpërdrejtë nga qytetarët dhe Kuvendit Komunal si organ më i lartë vendimmarrës

Kryetari i Istog-ut, z. Ilir Ferati (LDK), është zgjedhur në zgjedhjet lokale në vitin 2021. Lidhja Demokratike e Kosovës mbanë 12 nga 27 ulëset në asamblenë komunale. Partia e dytë më e madhe me 6 ulëse është AAK, e përcjellur nga VV me 5 anëtarë të asamblesë, PDK me 3 anëtar dhe GIBI me një ulëse. Në kuadër të kuvendit janë themeluar dy komitete obligative: Komiteti për Politikë dhe Financa, Komitetit për Komunitete, Komiteti për barazi gjinore dhe Komitete tjera siç parashihen me ligj. Komuna e publikon proces verbalin dhe të gjitha aktet e miratuara nga takimi i Asamblesë në ueb-faqen komunale.

Komuna e Istogut është e organizuar në 12 drejtori dhe Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim duke shtuar Zyrën e Kryetarit përgjegjëse për obligimet horizontale të komunës.

### **KRYETARI I KOMUNËS**

Kryetari është organ më i lartë ekzekutiv, i zgjedhur drejtpërdrejtë nga qytetarët i cili e përfaqëson komunën. Gjatë këtij viti, Kryetari i Komunës, në veçanti, krahas punëve dhe obligimeve të tjera ka shqyrtuar dhe realizuar çështje të rëndësishme nga përgjegjësitë komunale dhe atë:

- Realizimi i projekteve me prioritet të përcaktuara nga viti i kaluar dhe realizimi i projekteve të përcaktuara nga ky vit;
- Shqyrtimi i kërkesave të ndryshme të qytetarëve;
- Organizimi dhe funksionimi i organeve komunale të administratës dhe kompletimi i tyre me kuadro profesionale, në këtë drejtim është angazhim permanent në organizimin dhe sistemin e shërbimit civil në atë mënyrë që qytetarët të kenë qasje më të lehtësuara për kryerjen e shërbimeve komunale
- Hartimi dhe propozimi i Rregulloreve dhe Vendimeve të ndryshme nga fushëveprimi dhe kompetencat komunale, të cilat i janë kaluar Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit për miratim
- Si dhe punët dhe detyrat të tjera të rregullta nga fushëveprimi dhe kompetencat e tij.

Kryetari i Komunës në 6 mujorin e punës për vitin 2024 ka nënshkruar gjithsejtë 22 (njëzetedy) Memorandume Bashkëpunimi (MB), ndër to marrëveshje me Ministrinë e Administrimit Të

Pushtetit Lokal, MMPHI-në, MKRS-në, FKEE, CARITAS, Let's do it Peja, Këshillin Evropian, , Organizata joqeveritare(OJQ) etj.

Në kuadër të Zyrës së Kryetarit funksionojnë edhe: zyra e integriteteve evropiane, zyra ligjore, zyra e komunikimit dhe informimit, zyra e menaxherit të personelit, avokati publik dhe auditori i brendshëm.

Në kuadër të zyrës së integriteteve evropiane dhe zyrës ligjore hartohen planet operative për përmbushjen e prioriteteve për integritete evropiane, ofrohen këshillime dhe mendime profesionale juridike, ofrimi i ndihmës dhe hartimi i projekt-rregulloreve komunale, etj. Në kuadër të zyrës së informimit në mënyrë të rregullt ofrohen informata për opinionin dhe media elektronike dhe ato të shkruara për të gjitha aktivitetet e Kryetarit, Drejtorëve dhe punës në përgjithësi të organeve komunale të administratës si dhe bëhet azhurnimi dhe mirëmbajtja e Ueb faqes së komunës. Në kuadër të zyrës për menaxhimin e personelit mbahen dosjet e të gjithë shërbyesve civil dhe bëhet monitorimi i zbatimit të Ligjit mbi shërbimin civil dhe rregulloreve të tjera nga kjo lëmi. Avokati publik, në pajtim me ligjet pozitive në fuqi mbron interesat e Komunës pranë gjykatave kompetente.

Me fillimin e mandatit si Kryetar Komune është bërë një punë mjaft e madhe në aspektet e propozimeve dhe realizimeve të projekteve kapitale të rëndësishme për komunën tonë, identifikimi i prioriteteve të tjera, pastaj vazhdimi i prioriteteve të cilat janë realizuar e që do të paraqiten në vijim në kuadër të raportimeve të drejtorëve përkatës. Krahas këtyre synimeve të cekura më lartë, Kryetari ka kryer edhe punë të tjera: si kontaktimi me organizata të ndryshme qeveritare dhe joqeveritare, përfaqësues të OSBE-së, EULEX-it, ICO-së, KFOR-it dhe vizitave të ndryshme të niveleve ndërkombëtare, qeveritare, Komunale, që i ka bërë Kryetari dhe që i janë bërë komunës sonë në këtë 6 mujor.

## **ZYRA E PERSONELIT**

### **RAPORTI I PUNËS PËR PËRIUDHËN JANAR-QERSHOR 2024**

Zyra e Personelit në komunën e Istogut funksionin në kuadër të Zyrës së Kryetarit, në kuadër të kësaj zyre punon Menaxheri i Personelit, Zyrtarja e Lartë e Personelit si dhe Zyrtarja për Personel. Zyra e Personelit është përgjegjëse për gjithë stafin civil që funksionin në kuadër të komunës, është përgjegjës për sigurimin e mbarëvajtjes së procedurave të rekrutimit të nëpunësve civil, përgatit konkurset, akt emërimet, kontratat për marrëveshjet e punës, procedon pagat dhe bën mirëmbajtjen e dosjeve të personelit.

Udhëheq procesin e planifikimit, vlerësimit dhe rekrutimit të personelit si dhe menaxhon sistemin e informatave për menaxhimin e burimeve njerëzore të komunës, siguron identifikimin e nevojave për trajnimin, arsimimin e burimeve njerëzore, vlerësimi i ndikimit të trajnimeve si dhe sigurimi i trajnimeve adekuate, mbështet punën e komisionit për ankesa dhe parashtrësia dhe komisionit disiplinor, bën vlerësim të rregullt të stafit nën mbikëqyrje të tij dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimeve për të siguruar kryerjen e detyrave të tyre në nivel me standardet e kërkuara.



Gjatë periudhës 6 mujore nga Janari deri në Qershor 2024 Zyra e Personelit ka zhvilluar gjithsejtë 6 procedura deri me tani në Shërbimin Civil ndërsa në Shërbimin Publik janë realizuar 16 procedura.

Zyra e Personelit ka zhvilluar 22 procedura konkurruese në shërbimin civil dhe publik gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2024.

## **SEKTORI LIGJOR**

### **RAPORTI I PUNËS PËR PËRIUDHËN JANAR-QERSHOR 2024**

#### *Për Kryetarin e Komunës-Ekzekutivin:*

Janë nxjerr:

- Vendime-pesëqind (500);
- Kontrata-njëzet e pesë (25);
- Marrëveshje-tri (3);
- Shkresa të ndryshme-njëzet e gjashtë (26);
- Autorizime-shtatë(7);
- Propozim-vendime-tetë (8)
- Njoftime për dëgjime me qytetar (6)
- Lëndë për shqyrtimin e të drejtës banesore: pesë (5),
- Lëndë për legalizime –pesëdhjetë e gjashtë (56),
- Vendime për legalizime-katërdhjetë e tri (43); lëndë për legalizim në listë të pritjes 13,
- Janë shqyrtuar shtatëmbëdhjetë (17) kërkesa për numër të shtëpisë,
- Janë shqyrtuar gjashtë (6) kërkesa për emërimin dhe riemërimin e rrugëve,
- Janë dhënë tri (3) pëlqime për panele solare,
- Komision për dhënie në shfrytëzim të hapësirave publike ka miratuar katër (4) kërkesa,
- Vendimet lidhur me ankesat e Tatimit në Pronë-Drejtoria për Buxhet dhe Financa njëmbëdhjetë (11)

Si dhe janë shqyrtuar dhe përfunduar shumë lëndë të shërbimit pronëso- juridik.

Udhëheqësja e Sektorit Ligjor në bashkëpunim me Zyrtaret Ligjor, kanë punuar në Grupe punuese për hartimin e rregulloreve të ndryshme komunale; për hartimin e Planeve të Veprimit; Puna në Komisione të ndryshme; Puna për mbledhjen e të dhënave në fushën e legjislacionit gjatë vitit 2024 për performances komunale; Përgatitja dhe marrja pjesë në mbledhjet e Kuvendit të Komunës; mbledhjen e Komitetit për Politik dhe Financa; Bashkëpunimi-konsultimi me Drejtoret e Drejtorive si dhe zyrtaret komunal lidhur me zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore; dhënia e mendimeve ligjore; Punimi i raporteve të ndryshme; Futja në sistem elektronik e të gjitha lëndëve të kryera; Pjesëmarrja në trajnime të ndryshme; në tryeza të rumbullakëta; në konferenca; si dhe janë kryer edhe shumë punë tjera të dhënë nga mbikëqyrësi.

## **ZYRA E INTEGRIMEVE EVROPIANE**

### **RAPORTI I PUNËS PËR PËRIUDHËN JANAR-QERSHOR 2024**

Zyra për Integritet Evropian (ZIE) ka zyrtarin përgjegjës i cili kryen punët dhe obligimet në përputhje me Rregulloren 08/2011 për Organizimin dhe Përgjegjësitë e Zyrave Komunale për Integritet Evropian. Zyra në fjalë, mbikëqyr aktivitetet e drejtorive dhe sektorëve që burojnë nga planet e Veprimtimit për Partneritet Evropian, obligimet e komunës që dalin nga Agjenda Evropiane 2024 e që ka të bëjë me Programin Kombëtar për zbatim të Marrëveshjes së Stabilizimit Asociimit (PKMSA), si dhe dokumente tjera strategjike të MAPL-së, respektivisht Qeverisë së Kosovës. Në kuadër të përgjegjësisë së Zyrës për Integritet Evropian, zyrtari përgjegjës në vazhdimësi mbikëqyr hartimin e rregulloreve komunale, për të siguruar se ato janë në përputhje me standardet evropiane si dhe hulumton programe të ndryshme të asistencës së BE-së dhe donatorëve të tjerë për të ofruar mbështetje për qeverisje të mirë dhe zhvillim lokal. Tashmë e kemi dorëzuar raportin 6 mujorësh (Janar-Qershor, 2024), raport që pasqyron përmbushjen e obligimeve të komunës nga fusha e Agjendës Evropiane.

## **ZYRA E AUDITORIT TË BRENDSHËM**

### **RAPORTI I PUNËS PËR PËRIDHËN JANAR-QERSHOR 2024**

Zyra e auditorit të brendshëm në komunën e Istogut është i organizuar si Njësi e Auditimit të Brendshëm (NJAB) që vepron në kuadër të Zyrës së kryetarit komunës me një auditor. Aktivitetin i punës së auditorit përveç auditimit të brendshëm kryen edhe punë të tjera administrative të nevojshme për funksionimin e NJAB . Puna e NJAB bazohet në bazë të Planit vjetor dhe strategjik që aprovohet dhe miratohet nga Kryetari i komunës dhe Komiteti i Auditimit sipas Ligjit nr. 06/L-021 KBFP neni 23 pika 1.2 si dhe neni 25 pika 3.3

Organizimi i Komitetit të Auditimit ,me rend dite;

I. Shqyrtimi dhe Miratimi por jo Detyrim i Planit Vjetor 2024 të Njësisë së Auditimit të Brendshëm-NJAB.

II. Plani Vjetor 2024 i Njësisë së Auditimit të brendshëm-NJAB

III Raporti 6 mujor, Korrik –Dhjetor dhe vjetor Janar-Dhjetor 2023 i NJAB.

IV. Organizimi i Komitetit të Auditimit, me rend dite:

2. Njoftimi për përfaqësuesin e OJQ DEMOS-Helvetias lidhu me gjendjen Aktuale te NJAB.

IV. Organizimi i Komitetit të Auditimit me rend dite:

1.Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Punës së Komitetit të Auditimit.

V. Përditësimi i Planit Strategjik 2023-2025 i NJAB

VI. Përditësimi i Statutit të NJAB

VII. Përditësimi i Statutit të Komitetit të Auditimit.

## **ZYRA PËR KOMUNIKIM DHE INFORMIM**

### **RAPORTI I PUNËS PËR PËRIUDHËN JANAR-QERSHOR 2024**

Gjatë kësaj përudhe , Zyra për Informim dhe Komunikim me Publikun e cila funksion në kuadër të Kabinetit të Kryetarit të Komunës z. Ilir Ferati, ka vazhduar me punën e saj të përditshme, duke pasqyruar në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të gjitha informacionet e duhura që kanë të bëjnë me punën dhe aktivitetet e Komunës së Istogut.

Kjo zyrë ka lëshuar çdo ditë të punës komunikata nga më të ndryshme të cilat kanë pasqyruar punën e cila zhvillohet brenda institucionit të Komunës së Istogut.

Zyra për Informim dhe Komunikim me Publikun (ZIK), ka arritur që të lëshoj mbi 180 komunikata dhe komunikime të ndryshme që përmes ueb-faqes dhe faqes zyrtare të Komunës së Istogut në rrjetet sociale, kanë informuar qytetarët mbi menaxhimin si dhe aktivitetet të përditshme të komunës sonë.

Ueb sajt i komunës sonë pavarësisht problemeve që janë paraqitur pas ridizajnit të ueb faqes komunale nga ana e MAPL-së, çdo ditë është i freskët me plasimin e të gjitha lajmeve dhe ngjarjeve në komunën tonë, përfshirë këtu paralajmërimet e ngjarjeve, përcjelljen e ngjarjeve në komunë, por edhe jashtë komunës.

Në mënyrë që Komuna e Istogut të jetë sa më efikase dhe të ketë një transparencë sa më të madhe karshi shoqërisë civile, medias dhe faktorëve të tjerë relevantë, kemi bërë raportime të rregullta edhe mbledhjet e kuvendit, procesverbalet e kuvendit, po ashtu edhe procesverbalet e mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetit për Komunitete, komitete këto që janë obligative për komunën.

Rregulloret e nxjerra nga Kuvendi i Komunës, të gjitha janë publikuar në ueb faqen e Komunës, por edhe në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Po ashtu vlen të theksohet se në ueb faqe, bëhen publike vazhdimisht të gjitha njoftimet dhe konkurset, ndërkohë që aty pasqyrohen edhe të gjitha vendimet e marra nga Kryetari i Komunës si dhe vendimet e drejtorive komunale. Është punuar mjaft shumë edhe në publikimin e të gjitha kontratave të Zyrës së Prokurimit, por edhe njoftimeve të ndryshme të po kësaj zyreje.

Përparësi e ueb faqes së Komunës së Istogut është edhe ajo se secili lajm, informacion, njoftim dhe konkurs bëhet përveç në gjuhën shqipe, edhe në atë të komunitetit pakicë serb.

Në ueb faqen tonë, qytetarët e interesuar, shoqëria civile dhe mediat po ashtu mund të gjejnë të publikuara edhe të gjitha pasqyrat financiare, projektet e realizuara, projektet që do të realizohen dhe gjithçka tjetër që mund të jetë në interesin e tyre.

Në kuadër të Zyrës për Informim dhe Komunikim me Publikun funksionon edhe zyrtarja për Qasje në Dokumente Publike. Gjatë periudhës Janar-Qershor kemi pasur nëntëmbëdhjetë (19) kërkesë për qasje në Dokumente Publike dhe Informacion.

Poashtu në zyrën për Informim dhe Komunikim me Publikun funksionon edhe zyrtari për konsultime publike. Gjatë kësaj periudhe Janar - Qershor janë mbajtur një (1) Dëgjim Buxhetor dhe shtatë (7) Konsultime Publike që gjithsej i bijnë 8 Takime Publike me Qytetarë.

Avokati publik- Punët-detyrat e punës të caktuara me programin e punës për periudhën raportuese e për të cilat është caktuar mbajtja e shqyrtimit në tërësi janë realizuar.

## ***DREJTORIA PËR ADMINISTRATË KOMUNALE RAPORTI I PUNËS PËR PËRIUDHËN JANAR-QERSHOR 2024***

### **HYRJE**

Drejtoria për Administratë Komunale është drejtoria më e madhe, në kuadër të organeve komunale të administratës, dhe me qëllim të realizimit sa më me sukses të përgjegjësive, në fillim është hartuar plani i punës në të cilin janë paraqitur synimet që do të përmbushën në këtë periudhë.

Administrata komunale është një segment i rëndësishëm i komunës, ku qytetarët në realizimin e të drejtave dhe obligimeve të tyre kanë kontakte të drejtpërdrejta me pushtetin komunal. Gjatë kësaj periudhe kemi bërë përpjekje që administrata të jetë sa më funksionale dhe në pajtim me standardet bashkëkohore, përkatësisht që qytetarët si në aspektin kohor gjithashtu edhe në aspektin cilësor t'i realizojnë të drejtat e tyre nga përgjegjësitë dhe kompetencat e komunës. Në këtë drejtim veprimtaria kryesisht ka qenë e orientuar në realizimin e synimeve programore, respektimin dhe zbatimin e ligjit, si dhe akteve tjera të përgjithshme juridike si parakushte këto për krijimin e një administrate funksionale dhe efikase, në interes të përmbushjes së kërkesave të përgjithshme dhe individuale të qytetarëve pa dallim përkatësie nacionale, fetare, gjinore dhe racore. Orientimet e tilla sipas planit strategjik të punës dukshëm kanë ndikuar në ngritjen e shkallës së përgjegjësisë në punë, disiplinës në punë, avancimit të metodës së punës dhe efikasitetit në punë. Në kontekst të kryerjes së shërbimeve deri tani nuk kemi pasur asnjë vërejtje nga qytetarët tanë, që do të thotë se sipas vlerësimit të përgjithshëm administrata i përmbushë obligimet e saja në mënyrë korrekte dhe cilësore.

Në kuadër të kësaj drejtorie për këtë periudhë raportuese janë realizuar dhe janë në fazën e realizimit dhe në fazën e inicimit projektet si në vijim:

1. "Blerja e pajisjeve të Teknologjisë Informative për nevoja të institucioneve komunale në Istog", vlera 9.000 €, është realizuar në tërësi (pajisjet u janë shpërndarë nëpunësve civil sipas nevojave të paraqitura më herët);
2. "Blerja e materialit higjieniko-sanitar", vlera 25,000.00 euro
3. Janë funksionalizuar 5 (pesë) e-Kioska në komunën e Istogut", në funksion të qytetarëve në Zyrat e vendit Vrellë, Banjë, Rakosh, Gurrakoc dhe në hapësirat e oborrit të objektit të Komunës ku qytetarët mund të tërheqin 5 dokumente të Gjendjes Civile 24/7;
4. Është iniciuar , së shpejti do të bëhet përzgjedhja e operatorit ekonomik: "Mirëmbajtja e e-kioskave", vlera 20,000.00 euro;
5. "Infrastruktura për "smart city"", (kontratë tri vjeçare) vlera për këtë vit 85,070.00 euro;
6. "Mirëmbajtja e higjienik-sanitare objekteve komunale" (kontratë kornizë tri vjeçare), vlera 44,000.00 euro. Nga programi i administratës kanë qenë të planifikuar 25,000.00 euro, koj kontratë, në muajin maj të këtij viti, është ndërprerë për shkak të mos realizimit të punëve në pajtim me kontratën
7. "Mirëmbajtja e automjeteve zyrtare", (kontratë kornizë tri vjeçare), vlera afër 39,000.00 euro
8. Certifikatat të cilat mund të tërhiqen në e-kioske janë:
  - b. Certifikatën e Lindjes
  - c. Ekstraktin e Lindjes
  - d. Certifikatën e Martesës
  - e. Certifikatën e Shtetësisë dhe
  - f. -Certifikatën e Vendbanimit
6. Komuna në bashkëpunim me ASHI (Agresionin e Shoqërisë së Informacionit ) ka plasuar përmes Platformës E-Kosova cila është vendosë edhe në ueb faqen e komunës së Istogut
7. [kk.rks-gov.net/Istog](http://kk.rks-gov.net/Istog) ku qytetari mund të aplikoj dhe të tërheq dokumentet gjendjes civile online e që janë të vlefshme për të gjitha shërbimet brenda Kosovës.
8. Po ashtu përmes Platformës E-Kosova Komuna në bashkëpunim me ASHI ka bërë të mundur aplikimin që qytetari të bëjë pagesën e faturës për takse komunale për regjistrim të automjeteve.
9. Komuna në bashkëpunim me MAPL është duke bërë rifreskimin dhe azhurnimin e Intranetit komunal ku pala përmes Intranetit në 3 faza mund të aplikoj për Leje Ndërtimore.

Duke pasur parasysh synimet e përcaktuara në fillim të këtij viti, mund të përfundojmë se ato deri tani janë realizuar me dinamikën e përcaktuar dhe në pajtim me planin për këtë periudhë.

Drejtoria për Administratë Komunale është e ndarë në:

1. Sektori i gjendjes civile me zyrat e vendit;
2. Sektori për administratë;
3. Qendra për shërbim të qytetarëve;
4. Arkivi komunal;
5. Zyra e prokurimit publik dhe
6. Zyra për të drejtat e njeriut dhe komunitete.

## Sektori i Gjendjes Civile.

Me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më efikase, profesionale ndaj qytetarëve Sektori i Gjendjes Civile është i organizuar sipas zyrave të gjendjes civile të bashkësive lokale si Zyra e Gjendjes Civile në Gurrakoc e cila i ofron edhe shërbimet e gjendjes civile të Dobrushës, Zyra e Gjendjes Civile në Banjë kurse në Zyrën e Gjendjes Civile në Istog janë të përfshira Zyra e Gjendjes Civile Rakosh dhe Vrellë.

Qytetarët mund t'i realizojnë të drejtat e tyre në rregullimin e dokumenteve personale të gjendjes civile. Tani edhe me anë të e-Kioskave ofrohen shërbime 24 orë, e cila është mundësi e mirë sidomos për njerëzit e punësuar të cilët mund t'i kryejnë shërbimet e tyre edhe gjatë ditëve të festave si dhe në fundjavë. Këto e-kioske janë të vendosura në: Istog, Gurrakoc, Vrellë, Banjë dhe Rakosh.

Shërbimi i Gjendjes Civile si shërbim në kuadër të Drejtorisë për Administratë Komunale kryen shërbime të ndryshme si: bën regjistrimin e lindjeve brenda dhe jashtë vendit në librat amë të të lindurve, lidhjen dhe regjistrimin e martesave në librin amzë të martesave, regjistrimin e vdekjeve brenda dhe jashtë vendit, nxjerrjen e certifikatat e ndryshme të gjendjes civile, përfshirë, të lindjes, ekstraktin nga regjistri qendror i gjendjes civile, certifikatën e shtetësisë, të martesës, të vdekjes, të vendbanimit, të gjendjes martesore, të bashkësisë familjare, certifikatën e vdekjes, kurorëzimit, ç' lajmërimin e vendbanimit dhe regjistrimin e adresës së re të vendbanimit, pranim e kërkesës me dokumentacionin përcjellës për parashtrimin për fitimin e shtetësisë së Kosovës dhe dorëzimin e tyre për në Departamentin për Shtetësi në Prishtinë, pranimin e kërkesave të ndryshme në kuadër të përgjegjësisë së shërbimit të gjendjes civile.

Gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2024 janë pranuar 107 kërkesa dhe janë lëshuar 17.382 certifikata të ndryshme të gjendjes civile për përdorim brenda dhe jashtë vendit e të cilat më poshtë janë paraqitur në mënyrë tabelare.

Për periudhën janar-qershor të vitit 2024 përveç dokumenteve-certifikatave të lartcekura, janë parashtruar edhe 107 kërkesa të ndryshme të cilat janë si në vijim:

1. Kërkesa për korrigjimin e emrit ( 4 kërkesa dhe 4 aktvendime );
2. Kërkesa për regjistrimin e mëvonshëm të lindjes ( 7 kërkesa dhe 7 aktvendime );
3. Kërkesa për ndërrimin e emrit personal ( 16 kërkesa dhe 16 aktvendime );
4. Kërkesa për regjistrimin e mëvonshëm të vdekjes ( 38 kërkesa dhe 38 aktvendime );
5. Kërkesa për vërtetimin e kopjes së kartonit të ish RFSJ-së dhe Regjistrave ( 20 kërkesa );
6. Kërkesa për korrigjim në lindje dhe në martesë ( 1 kërkesë dhe 1 aktvendim );
7. Ankesa kundër vendimeve të ZGJC-së Istog ( 2 ankesa );
8. Kërkesa për korrigjimin e aktit të martesës ( 1 kërkesë dhe 1 aktvendim );
9. Kërkesa zyrtare për korrigjimin e aktit të martesës ( 4 kërkesa dhe 4 aktvendime );



10. Kërkesa zyrtare për korrigjimin e aktit të vdekjes ( 1 kërkesë dhe 1 aktvendim );
11. Kërkesë zyrtare për korrigjimin e mbiemrit ( 1 kërkesë dhe 1 aktvendim );
12. Kërkesë zyrtare për korrigjimin e numrit personal ( 1 kërkesë dhe 1 aktvendim );
13. Kërkesë për regjistrimin e vdekjes nga shtëpia e të moshuarve në Istog ( 1 kërkesës );
14. Kërkesë për lëshimin e aktit të vdekjes me qëllim të përdorimit në gjykatë ( 1 kërkesë );
15. Kërkesa për anulimin e lindjeve për shkak të regjistrimit të dyfishtë ( 02 kërkesa dhe 02 aktvendime );
16. Ankesë për mos lëshimin e aktit të vdekjes ( 1 ankesë dhe 1 aktvendim );
17. Kërkesë për korrigjimin e të dhënave të prindërve ( 1 kërkesë dhe 1 aktvendim );
18. Kërkesë për ndërrimin e gjendjes martesore ( 1 kërkesë );
19. Kërkesë për regjistrimin e rregullt të vdekjes ( 1 kërkesë );
20. Kërkesë për korrigjimin e vendimit të ZGJC lidhur me numrin personal ( 1 kërkesë dhe 1 aktvendim);

Lista e dokumenteve të lëshuara dokumentet e lëshuara nga zyrat e gjendjes civile - për përdorim të brendshëm dhe të jashtëm (Periudha e raportimit: 01/01/2024 - 30/06/2024)

Certifikatë e lindjes	Ekstrakt nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile	Certifikatë e shtetësisë	Certifikatë e martesës	Certifikatë e vdekjes	Certifikatë e vendbanimi	Certifikatë e gjendjes martesore	Deklaratë e bashkësisë familjare	Vërtetim nga arkivi	Totali
1884	5093	64	1280	835	1297	313	634	185	11585

Dokumentet e lëshuara nga zyrat e gjendjes civile - për përdorim të jashtëm

Certifikatë e lindjes	Ekstrakt nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile	Certifikatë e shtetësisë	Certifikatë e martesës	Certifikatë e vdekjes	Certifikatë e vendbanimi	Certifikatë e gjendjes martesore	Deklaratë e bashkësisë familjare	Vërtetim nga arkivi	Totali
3384	789	59	892	144	461	138	293	87	6247

### i. Sektori për administratë

Në kuadër të këtij sektori janë: udhëheqësi i sektorit, shërbimi i teknologjisë së informimit (2 IT), autoparku (2 shërbyes), zyrtari për logjistikë (1 shërbyes), shërbimi i përkthimit (2 shërbyes) dhe shërbimi për mirëmbajtje dhe pastrim të objektit të komunës (5 stafi administrativo mbështetës).

Gjatë periudhës janar-qershor të këtij viti, stafi kryesisht janë marr me realizimin e punëve: mirëmbajtja e rrjetit të internetit dhe intranetit, instalimi i programeve softuerike në kompjuterët e stafit civil, mirëmbajtja dhe riparimet softuerike të kompjuterëve të tërë stafit civil dhe politik të administratës komunale dhe punë të tjera të teknologjisë së informimit. Shërbimi i përkthyesve gjatë periudhës raportuese ka bërë përkthime të të

gjitha shkresave, vendimeve, procesverbaleve, raporteve dhe dokumenteve të lëshuara nga zyra e kryetarit, drejtorit komunale, kuvendi, komitetet e tij dhe organet të tjera të themeluara nga kuvendi dhe Kryetari. Në këtë periudhë raportuese janë përkthyer më shumë se 300 shkresa dhe dokumente të cekura. Po ashtu shërbimi i përkthimeve ka bërë përkthimin simulant dhe përkthime të drejtpërdrejta gjatë të gjitha mbledhjeve të kuvendit të komunës, dhe takimeve të ndryshme të organizuara nga Kryetari dhe komisioneve dhe komiteteve të themeluara nga kuvendi dhe Kryetari. Nga stafi i autoparkut është bërë furnizimi i rregullt i të gjitha automjeteve zyrtare me karburante dhe evidenca e shpenzimeve të tyre sipas drejtorive komunale, është bërë mirëmbajtja e automjeteve, duke u kujdesur që të gjitha automjetet të jenë në gjendje funksionale. Nga zyra e logjistikës është bërë, sipas kërkesës së stafit, furnizimi me material të nevojshëm për zyre dhe furnizim me material higjieniko-sanitar. Nga shërbimi i mirëmbajtjes, është bërë mirëmbajtja e objektit të komunës në aspektin e pastërtisë të të gjitha zyrave, nyjave sanitare dhe korridoreve, mënjanimi i defekteve dhe riparimi i prishjeve të dyerve, dritareve mobileve dhe karrigeve të stafit si dhe mirëmbajtja e ngrohjes qendrore të objektit të komunës, duke përfshirë edhe furnizimin me lëndë djegëse.

Në kuadër të Drejtorisë, shqyrtohen kërkesa të ndryshme nga kuadri mi fushëveprimit të drejtorisë, duke përfshirë kërkesa për vijimin e stazhit të praktikës, si nga ata/ato që kanë përfunduar studimet, në të gjitha fakultete, si në ato private dhe publike dhe studentët të cilët ende i vijojnë studimet, po ashtu në të gjitha fakultetet, pa dallim, si ato private dhe publike. Gjatë kësaj periudhe raportuese janë lëshuar: 7 vendime të ndryshme nga përgjegjësia e drejtorisë, dhe 26 kërkesa dhe shkresa të ndryshme të komunikimit të brendshëm dhe komunikimit jashtë komunës.

## ii. **Arkivi komunal.**

Arkivi Komunal, në Istog, funksionin e kryen në harmoni me dispozitat pozitive, Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin për Arkivin dhe aktet e brendshme normative të pushtetit lokal.

Në kuadër të administratës kryhen edhe shumë punë të përbashkëta administrative për nevoja të organeve komunale, nder to edhe arkivimi i të gjitha shkresave dhe lëndëve të rëndësishme.

Për periudhën raportuese Janar -Qershor të vitit 2024 punëtorët e Arkivit Komunal në Istog kanë punua në sistemimin dhe klasifikimin e lëndës arkivore që është kriju si rezultat I punës së organeve Komunale të Administratës në Istog .

Për shkak të rëndësisë që kishte lënda e krijuar arkivore që ishte kryesisht rezultat I punës së Zyrës së Prokurimit prioritet kryesor në tremujorin e parë të periudhës raportuese I është dhënë klasifikimit dhe sistemimit të kësaj lënde arkivore.

Kjo lëndë arkivore është sistemuar dhe klasifikuar për ruajtje në 18 regjistratorë.

Në muajin e parë të periudhës së dytë raportuese është punua në klasifikimin e lëndës arkivore të Organeve tjera komunale të administratës në Komunën e Istogut. Për shkak të rëndësisë së kësaj lënde arkivor me prioritet I është qasur klasifikimit të lëndës arkivore për të cilat kërkesat e palëve janë më të shpeshta për shfrytëzim të kësaj lënde arkivore. Lënda arkivore është klasifikua sipas periudhës së krijuar me ç’ raste i është bashkëngjitur edhe materiali tjetër përcjellës arkivor. Kjo lëndë arkivore është sistemua në kuti përkatëse arkivore.

Kjo lëndë arkivore është klasifikua dhe sistemua edhe në 5 (pesë) regjistrator.

Për periudhën raportuese gjashtë mujore është punua edhe në shqyrtimin e 22. (njëzetedy) kërkesave të palëve. Këto kërkesa të palëve kryesisht kishin të bënin me të drejtën e realizimit të statusit të pensionistit kryesisht për veprimtarit zejtare të zejtarëve të pavarur që kishin ushtrua këto veprimtari në periudhën para vitit 1999. Për natyrën juridike të këtyre çështjeve lënda arkivore është e pakët me faktin se mungojnë të dhënat për kontributet e paguara për sigurimin pensional për ushtruesit e veprimtarive zejtare.

Me shtimin e vëllimit të lëndës arkivor është rritë edhe interesimi I studimit të lëndës së krijuar arkivore për qëllime të hulumtimit shkencorë.

Kemi qenë të përkushtuara edhe në përmbushjen me afat të kërkesave të parashtruara nga studiuesit për shfrytëzuesit e lëndës arkivore nga palët e interesuara.

Në këtë periudhë janë paraqitë 4.kërkesa prej të cilave të gjitha janë realizua.

Kishte kërkesa të ndryshme nga të interesuarit për kompletimin e dosjeve të firmave private, pastaj kërkesa për gjetjen e lëndës arkivore që kanë të bëjnë me çështjeve statusore siç janë aktvendimet për ndryshimin e emrit mbiemrit dhe çështjeve tjera .

Për të dhënat e kërkuara janë lëshuar edhe vërtetimet përkatëse për lëndën e shfrytëzuar arkivore.

Marrë në tërësi edhe përkundër vështirësive rezultatet e arritura në punë për periudhën raportuese janë të mira.

Vërejtjet dhe sugjerimet eventuale që mund të paraqiten janë të mirëseardhura me kusht që në të ardhmen puna të perfeksionohet kurse ndonjë lëshim eventual të korrigjohet.

### iii. Qendra për shërbim të qytetarëve.

Përmes kësaj zyre qytetarët më lehtë mund t’i adresojnë kërkesa e tyre dhe të marrin përgjigje. Në këtë kuptim të gjitha kërkesat për të gjitha organet komunale kalojnë përmes këtij shërbimi. Gjithashtu nga kjo zyre udhëzohen të gjithë qytetarët për realizimin e të drejtave të tyre në pushtetin lokal dhe për procedurat e realizimit të këtyre të drejtave. Gjatë periudhës Janar-Qershor 2024, në këtë shërbim janë pranuar një numër i madh i kërkesave të cilat gjenden në tabelën e mëposhtme të drejtuar të gjitha drejtoritë, kryetarit dhe kuvendit.

Drejtoria	Pranuar	Ne Proces	Miratuar	Refuzuar	Hedhur Poshtë	Pezulluar	Ceduar	Anuluar	Përfunduar	Totali

Drejtoria për Administratë dhe Personel	17	243	836	8	0	0	0	7	14,363	15,474
Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	0	5	19	14	0	0	0	0	0	38
Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim	0	44	1	0	0	0	0	0	0	45
Drejtoria për Arsim	4	377	1,618	132	0	1	0	77	0	2,209
Drejtoria për Punë të Inspeksionit	0	30	26	2	0	0	0	1	0	59
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	7	192	423	1	0	0	0	2	0	625
Drejtoria për Shërbime Publike dhe Siguri	3	199	129	42	0	0	0	2	0	375
Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë	8	171	4,039	1	0	0	0	5	0	4,224
Kryetari i Komunës	4	150	12	0	0	0	0	1	0	167
Zyra Lokale e Komuniteteve	1	19	0	0	0	0	0	0	0	20
Kuvendi Komunal	0	7	1	0	0	0	0	0	0	8
Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis	1	172	143	2	0	0	0	3	0	321
Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport	1	14	32	11	0	1	0	3	0	62
Drejtoria për Buxhet dhe Financa	1	25	30	4	0	0	0	3	0	63
	47	1,648	7,309	217	0	2	0	104	14,363	23,690

Numri i kërkesave sipas Drejtorive, gjashtëmuor: 04.01-04.07-2024

#### iv. Zyra e Prokurimit

Ju prezantojmë aktivitetet e zhvilluara të cilat janë të procesuara nga zyra e prokurimit: publikimi i njoftimit për kontratë anulimet për arsyeje të tejkalimit të vlerës së planifikuar dhe të mos marrje pjesë konkurrencë të operatorëve ekonomik deri të nënshkrimi i kontratës:

Zyra e Prokurimit në Komunën e Istogut ka vazhduar të operojë në përputhje me ligjet dhe rregulloret vendore për administratën publike.

Përgjegjshmëria kryesore ka përfshirë:

Prokurimin e mallrave, shërbimeve dhe punëve sipas nevojave nga njësitë - drejtoritë e ndryshme të komunës bazuar në Planifikimin e prokurimit për vitin 2024.

Lloji i njoftimit të publikuar	Numri i publikimeve
Njoftim për kontratë	46

Njoftim për dhënie të kontratës	23
Njoftim për nënshkrim të kontratës	23
Kërkesa për rishqyrtim në AK	16
Ankesa në OSHP	1

Nga 46 Njoftimet për kontratë (aktivitetet) e publikuara, 10 Njoftime për kontratë janë të publikuara me pjese (lote), pra 10 Njoftime për kontratë përmbajnë 63 aktivitete të prokurimit e që në total janë të publikuara 99 aktivitete të prokurimit të cilat janë furnizime, shërbime dhe pune të ndryshme, në vlera të mesme, të vogla dhe minimale.

Ky raport përfshinë një pasqyrë të qartë dhe të përgjegjshme të performances së Zyrës së Prokurimit në Komunën e Istogut gjatë periudhës 6-mujore. Të gjitha proceset e prokurimit janë kryer duke përmbushur ligjet dhe rregulloret vendore dhe qendrore të prokurimit publik, duke siguruar transparencë dhe drejtësi në zgjedhjen e furnizuesve. Zyra e Prokurimit angazhohet për vazhdimin e përmirësimit të proceseve dhe për të përmbushur nevojat e përdoruesve të tij brenda standardeve të larta të qeverisjes dhe përgjegjshmërisë administrative.

#### **v. Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete**

Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete është mekanizëm monitorues për respektimin e të drejtave të njeriut në relacionin komunë-qytetarë, funksion si sektor/njësi e veçantë në kuadër të Drejtorisë për Administratë Komunale.

Misioni i Sektorit për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete është vëzhgimi i respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe reagimi për vënien e tyre në vend, sensibilizimi i qytetarëve për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tyre, përmirësimi i akteve nënligjore komunale, praktikës për zbatimin e këtyre akteve, barazia gjinore, të drejtat e fëmijëve, mundësi të barabarta dhe mos diskriminim, të drejtat e komuniteteve, përdorimi i gjuhëve, kundër trafikimit me qenie njerëzore, personat me aftësi të kufizuar.

#### **Struktura e Sektorit për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete :**

1. Udhëheqësja e Sektorit për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete;
2. Zyrtarja për Barazi Gjinore e caktuar edhe në detyrat: Zyrtare për Mbrojtje nga Diskriminimit dhe
3. Zyrtarja për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Riintegrim.

Tabela 1. Lëndët e pranuar dhe të shqyrtuara nga DPUM për janar - qershor 2023.

Koha	Leje ndërtimi	Kushte ndërtimi	Certifikatë përdorimi	Leje për rrënim	Pëlqimet dhe njoftime (të ndryshme)	Përgjigje (refuzuara)	Në proces (të bartura)
Janar	0	0	4	3	51	8	10
Shkurt	1	0					
Mars	7	2					
Prill	13	2					
Maj	9	6					
Qershor	9	5					
Gjithsej	39	15	4	3	51	8	10

Drejtoria realizon të hyra nga taksat për leje të ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës dhe nga taksa administrative për leje të ndërtimit, bazuar në “Rregullore mbi taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 2024. Në të hyra kanë ndikuar edhe taksa për Shndërrimin e tokës bujqësore në atë ndërtimore.

Në këtë periudhë raportuese janë në fazën projektuese këto projekte:

1. Rregullimi i trotuareve në Istog(zona urbane) në vlerë 40.000,00€
2. Rregullimi i shtratit të lumit-Istog, nga Burimi deri të ura te restorant TROFT në vlerë prej 200.000,00€
3. Ndërtimi i sistemit te ri te ujësjellësit, gjelbërimit dhe ndriçimit ne qendër te Istogut 116.304,00€
4. Mirëmbajtja e adresave në vlerë prej 7.500,00€

Është vazhduar puna në plotësimin e informatave në sistemin e monitorimit të procedurës për marrjen e lejes së ndërtimit ku paraqiten informatat për qytetarë, si dhe është punuar në informimin e zyrtarëve për lëndët të cilave u ofrohet afati ligjor i shqyrtimit. Në këtë periudhë është ripunuar dokumenti me udhëzues dhe informatorë për qytetarë për procedurën e aplikimit për leje të ndërtimit. Përveç trajtimit të lëndëve, zyrtarët e sektorit kanë qenë të angazhuar edhe me aktivitete të tjera përcjellëse, si mbikëqyrje të projekteve që investohen nga Komuna, si dhe mbikëqyrje të planeve rregulluese në revidim.

Një ndër aktivitetet është vazhdimi dhe mirëmbajtja e rrugëve, i udhëhequr nga DPUM-Istog bashkëpunim me Departamentin e Adresave Prishtinë, punë kjo e përfunduar me rezultat pozitiv.

Duhet theksuar se përmes Zyrës për marrëdhënie me publikun, në mënyrë të organizimit të ngjarjeve të ndryshme brenda drejtorisë, takimet me institucione dhe palë të ndryshme, si dhe prononcime mediatike të cilat kanë të bëjnë me DUNMM-në.

Aktivitetet e planifikuara:

- Zbatimi i Bazës ligjore për planifikim e ndërtim-shqyrtimit të lëndëve me një dinamikë të pranueshme, duke respektuar afatet ligjore;
- Hartimi i dokumenteve me rregullativa që lehtësojnë funksionimin e Sektorit;
- Vlerësimi i lëndëve nga Planerët urban, si dhe marrja e vendimeve për lëndët ku ka dilema në zgjidhje;
- Përgatitjet që të integrohen të dhënat e lejeve të ndërtimit në Sistemin vrojtues;
- Përpunimi i faqes së Komunës sa i përket Drejtorisë;
- Përmirësimi i shërbimit të informimit të qytetarëve;
- Hartimi i zgjidhjeve urbane dhe prezantimi në drejtori dhe në publik;
- Avancimi i sistemit të vrojtimit të lejeve
- Informimi i qytetarëve për çfarëdo informate që u intereson sa i përket Urbanizmit;
- Takimet me palë për identifikimin e problemeve, adresimin dhe shqyrtimin e tyre në bazë të legjislacionit në fuqi;
- Identifikimi i pengesave në zbatim të planeve;

- Kryerja e lëndëve në bazë të kërkesave të palëve në afat;
- Mbikëqyrja e kontratave të të gjitha llojeve;
- Finalizimi i rregulloreve të filluara;
- Këshillimi i drejtorit dhe sektorëve tjerë për çështjet e ndërtimit;
- Identifikimi dhe regjistrimi i objekteve – certifikatë përdorimi, të ndërtuara me leje;
- Fushata informuese dhe sensibilizuese;
- Pranimi i aplikacioneve të reja për legalizim;
- Legalizimi i objekteve të dy kategorive;
- Hartimi i përmbajtjes minimale (sqarimi) të dokumentacionit për aplikim për legalizim;
- Hartimi i draftit të parë për Planin lokal të veprimit në mjedis;
- Rritja e sipërfaqeve gjelbëruese dhe mbjellja e drurëve, duke përfshirë disa parqe të planifikuara më parë;
- Fushata vetëdijesuese nëpër institucionet shkollore në lidhje me shumë aspekte mjedisore për qëllim vetëdijesimi;
- Shtimi i sipërfaqeve gjelbëruese në pjesët e ndryshme të qytetit;
- Mbjellja e drurëve dekorativë;
- Shënimi i aktiviteteve mjedisore, si: 22 Prilli - Dita botërore e Tokës, 5 Dhjetori - Dita Botërore e Mjedisit, si dhe aktivitet rreth organizimit të Javës për ndryshime klimatike, në bashkëpunim me REC dhe MMPHI;
- Një ndër aktivitetet e planifikuara më të rëndësishme për vitin 2023, ka qenë Memorandumi i bashkëpunimit të Agjencionit kadastral për mirëmbajtje të adresave dhe vendosja e shenjave të komunikacionit dhe emërtimin e rrugëve publike në komunën e Istogut.
- Këtë vit ka qenë e planifikuar që përmes një analize më të thellë të lëndëve, ligjeve në fuqi dhe përmes një pune të palodhshme, të arrihet më shumë në ngritjen profesionale të nëpunësve të Sektorit të shërbimeve të përbashkëta, në mënyrë që të evitohen gabimet e kaluara në përpilimin e vendimeve të këtij organi.

## **Legalizimi**

Me këtë raport ju njoftoj më punën dhe zhvillimet në procesin e legalizimit në DPUM për periudhën Janar –Qershor

Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis në vitin 2024, ka pranuar kërkesa të reja për procesin e legalizimit gjithsejtë 55 aplikime për legalizim të ndërtimeve të dy kategorive.

Gjatë periudhës Janar-Qershor të vitit 2024 kemi shqyrtuar dhe marrë këto vendime për aplikimet e pranuar:

1. Vendime për Legalizim – 37,
2. Vendime për listë të pritjes – 13,



Ju njoftoj që jemi në shqyrtim të kërkesave të cilat ende janë në procedure, pasi që një numër te madh të tyre e kemi pranuar përmes aplikimit me postë në përfundim të afatit dhe mundësisë për aplikim, kërkesa këto të cilat këto kanë mangësi në dokumentacion, dhe përmes shkresave zyrtare i kemi njoftuar palët për plotësim të dokumentacionit, të njëjtat do ti trajtojmë dhe shqyrtojmë me efikasitet pas kompletimit .

## **Spektori i Adresave**

Sipas Autorizimit të Kryetarit të Komunës Nr.Br.01-527/022, të datës 25.07.2022 jam autorizuar për kryerjen e detyrave të punës shtesë pa Kompensim të zyrtarit për Regjistrim të Adresave, ku gjatë kësaj periudhe kam pranuar 12 kërkesa për emërtim, ndryshim të emrave të rrugëve, në kuadër të kësaj kemi lëshuar 312 vërtetime të adresave , dhe kemi pajisur me numra të shtëpisë shume qytetarë të cilët janë paraqitur ne zyrën e drejtoratit të urbanizmit.

Sipas vendimeve të kryetarit të komunës gjatë periudhës Janar –Qershor isha pjesë e grupeve punuese si anëtar në hartimin e rregulloreve të brendshme Komunale dhe anëtar i komisioneve të ndryshme në cilësinë e anëtarit dhe kryesuesit të komisionit, komisione disa nga të cilat janë me mandat dhe vazhdojnë të jenë aktive edhe për pjesën tjetër të vitit. Prej fillimit të muajit Mars 2023 sipas vendimit të kryetarit të komunës jam sistemuar në Zyrën Ligjore, për të cilën ne vazhdimësi sipas nevojave hartoj vendime, kontrata dhe marrëveshje të ndryshme.

## **Mjedisi**

- Gjatë gjashte mujorit te vitit 2024 nga Spektori për Mbrojtje të mjedisit janë realizuar këto detyra:

Gjatë këtij gjashte mujori janë parashtruar 10 kërkesa për tu pajisur me Leje Mjedimore Komunale , Janë lëshuar 08 Vendime për LMK të shoqëruar me 08 procesverbale te hartuara ne teren . Jemi ne përfundim te Hartimit te Planit Lokal te cilësisë se ajrit.

Kemi përcaktuar të gjitha zonat përgjatë rrugëve dhe trotuareve për mbjelljen e fidanëve duke përfshi edhe disa nga pronat publike dhe zonat e domosdoshme për gjelbërim.

Takimi më nxënës , bizneseve kanë ndikim ne mjedis për ngritjen e Kapaciteteve për mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit.

Po ashtu kemi qenë pjesëmarrës në disa Komisione për probleme të natyrës mjedisore, angazhime dhe Punëtori te Ekipeve Komunale AZHR –Perëndim Bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës ka qenë në nivel për plotësimin e formularëve të ndryshëm dhe ofrimin e të dhënave nga sektori mjedisor duke përfshirë ajrin, ujin dhe token.

Kemi qenë pjesëmarrës në disa Komisione për probleme të natyrës mjedisore, në bashkëpunim me Inspektorët Komunal dhe të Drejtorive Komunale si Drejtorinë për Bujqësi , Drejtorin për Kulturë Rini dhe Sport dhe atë për Zhvillim Ekonomik , të gjitha këto në bazë të detyrës zyrtare.

## **DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT**

### **RAPORTI I PUNËS PËR PËRIUDHËN JANAR-QERSHOR 2024**

Drejtoria Komunale e Arsimit, kryen detyrat dhe obligimet në përputhje me Ligjin për Arsim parauniversitar në Republikën e Kosovës nr.04/L-032, Ligjin Për Arsim në Komunat e Republikës së Kosovës nr.03/L-068, Ligjin për Arsimin dhe aftësimin Profesional nr.04 L-138,Ligjin për Arsimin dhe Aftësimin e të rriturve në Republikën e Kosovës nr. 04/L-143, Ligjin për Edukimin në fëmijërinë e hershme nr.08/L-153,Udhëzimin Administrativ Nr.03/2022 për përfshirjen e Fëmijëve në Institucione Parashkollore në Kosovë, si dhe UA të MASHTI-it që përcaktojnë përgjegjësit e Komunës për organizimin e procesit edukativo-arsimor në të gjitha nivelet si dhe aktet tjera komunale dedikuar kësaj fushe.

Drejtoria Komunale e Arsimit në Istog, bazuar në vendimet dhe udhëzimet e Ministrisë së Arsimit , Shkencës ,Teknologjisë dhe Inovacionit ka ndërmarr të gjitha masat që viti shkollor-mësimor 2023/24 të përfundoj sipas normave të përcaktuara .

**Viti mësimor 2023/2024, ka filluar me 1 shtator** dhe ka përfunduar (sipas Kalendarit shkollor të MASHTI-it) sipas këtyre datave:

Përfundimi i vitit mësimor për klasë është:

- -Klasat e 12-ta -maturantët, më 16 maj 2024,
- -klasat e 9-ta ,10-ta dhe 11-ta,me 6 qershor 2024,
- -klasat e parafillorës dhe nga 1-8-ta, më 24 qershor 2024.kurse
- -Institucionet e parashkollores- kopshteve do ta përfundojnë më 31 korrik 2024.

Organizimi i punës është udhëhequr dhe menaxhuar nga DKA-ja, drejtorët e shkollave dhe stafi profesional, prindër dhe nxënës, përmes organeve udhëheqëse të shkollës në bashkëpunim te vazhdueshëm me akterët tjerë si MASHTI dhe Sektorin e Inspektoratit për Arsim gjithnjë duke respektuar Ligjin e Arsimit parauniversitar si dhe udhëzimet e lartë cekura.

Avancimi profesional i mësimdhënësve gjatë kësaj periudhe ka vazhduar bazuar në ofertën e MASHTI-it, ofertuesve tjerë dhe në të gjitha rastet është menaxhuar mirë nga DKA-ja dhe adresimi ka qenë aspekti profesional i mësimdhënësve. Për avancimin e tyre profesional janë organizuar këto lloj trajnimesh:

- Trajnimi për mësueset edukatore të parafilloret dhe parashkolloret në kuadër të marrëveshjes Komuna e Istogut dhe Qendrës terapeutike Heimerer “Vlersimi i zhvillimit gjuhësor dhe të folurit të fëmijët e çerdheve, kopshteve parashkollore në komunën e Istogut”, më këto TEMA:
  - Menaxhimi i sjelljeve sfiduese,
  - Testet Skringing për moshat nga 0-7 vjeç,
  - Diagnostika e disleksisë për pedagogët e shkollave fillore ,
  - Metodat efektive në Edukimin e fëmijëve ne Nevoja të Veçanta Arsimore, Aftësia e Kufizuar, Përdorimi i Lojës dhe Metodave Kreative dhe Mësimi Tematik,

- Sesione ONLINE të trajnimit nga mësimdhënësit e nivelit fillor në kuadër të marrëveshjes ndërmjet DKA-së dhe SHPIK-KODIMI
- Shkathtësitë – shprehjet e adoleshencës
- Gjithë përfshirja në edukimin fizik-lojërat dhe sportet (pjesëmarrës mësimdhënësit e dukatës fizike, edukatore, asistencë të fëmijëve me nevoja të veçanta dhe psikolog ),
- Mbrojtja e fëmijëve nga interneti,

Në muajin Maj 2024, në të gjitha shkollat fillore të mesme të ulëta ka përfunduar procesi i Vlerësimit të brendshëm-Vetëvlerësimi nga ekipi i shkollës kurse nga Ekipi Komunal është bërë Vlerësimi Kolegial në bazë të marrëveshjes DKA dhe KoSED,

Në kuadër Vlerësimi nga Ekipa Komunale janë kryer këto aktivitete:

-Hospitimi në orë mësimore të mësimdhënësit-nga kolegu,

-Takime me aktive profesionale,

-Takime me Këshillat drejtuese,

-Takime me këshillat e nxënësve,

-Takime me Ekipin Vetëvlerësimi të shkollës,

- Vlerësim i planeve të punës në të gjitha nivelet, PZhSh, dosjet e mësimdhënësve -nxënësve, shqyrtim i dokumentacionit shkollor, libra Amë, ditar të punës,...

Ky proces ka përfunduar për këtë vit shkollor—për të rifilluar përsëri në vitin shkollor të ardhshëm. Për çdo shkollë është punuar Raport me Rekomandime dhe Udhëzime.

Këto organizime dhe monitorime janë bërë në bazë të obligimeve që dalin nga politikat qendrore e lokale të bazuara në planet, strategjitë dhe protokollet e aprovuara me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm të performances së shkollës në kontest të rritjes së cilësisë në arsim.

Drejtoria Komunale e Arsimit në bashkëpunim me drejtorët e shkollave dhe akterët tjerë institucional lokal dhe qendror ,ka organizuar dhe monitoruar procesin mësimor, testin e maturës ,e poashtu edhe testin e arritshmerisë .

DKA-ja ka organizuar Gara Komunale në lëndët e shkencave natyrore për nxënësit e klasave 6-9 në nivel komune.

Poashtu ka organizuar që nxënësit të marrin pjesë në garat Republikane për lëndët e shkencave natyrore si dhe në lëndën e edukatës fizike në të gjitha disiplinat.

Poashtu DKA-ja është në fazën përfundimtare të përgatitjes dhe shpalljes së konkursit për vendet e lira të punës.

Drejtoria Komunale e Arsimit bashkë me shkollat është e angazhuar në procesin e parandalimit braktisjes dhe mos regjistrimit të fëmijëve në shkolla. Në secilën shkollë janë të funksionalizuara Ekipi për parandalim dhe braktisje .

DKA-ja ka analizuar nevojat dhe ju kemi përgjigjur kërkesave për vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta dhe kjo ka qenë kompetencë e ekipit komunal për vlerësim pedagogjik i cili ju është përgjigjur çdo kërkesë që është iniciuar duke vlerësuar dhe analizuar çështjet me rekomandime për kompetentet.

Sektori administrativ sipas planifikimit dhe dinamikës së punës për periudhën raportuese ka realizuar e që konsiderohet si me të rëndësishme:

- Pranimi ,shqyrtimi dhe vendosja me mbi 265 lëndëve të natyrave të ndryshme që e karakterizojnë drejtoratin e arsimit.
- Janë lëshuar 8 vendime për pushim të lehonisë
- Janë lëshuar 16 vendimeve për pensionim të stafit arsimor
- Janë lëshuar 60 vendimi për pagës të mbi normës
- Shpalljen e disa konkurseve për pranim të stafit arsimor
- Janë lëshuar 25 kontrata të punës për mësimdhënës dhe punëtor teknik të të gjitha niveleve të cilët janë pranuar sipas procedurave të rregullta ligjore.
- Shpallja e konkursit për ndarjen e bursave Komunale
- Shqyrtimi i kërkesave për qasje në dokumente zyrtare.
- Shqyrtimi i ankesave të drejtuara këtij drejtorati nga natyrat të ndryshme

Në përfundim të vitin shkollor 2023/24 numri i nxënësve që do të nënshtrohen :

- Testit të arritshmërisë janë 482 nxënës, kurse
- Testit të maturës 385 nxënës.
- Në klasën e parë janë planifikuar që të regjistrohen 458 nxënës.

### **Projektet kapitale**

Drejtoria Komunale e Arsimit me kohë ka bërë përgatitjet e dokumentacionit komplet për procedura të prokurimit ,disa nga këto projekte kanë përfunduar me nënshkrim kontrate dhe disa tjera janë pothuajse në fazën e nënshkrimit të kontratave për implementimet e tyre. Projektet që kanë përfunduar me nënshkrim kontrate dhe realizim të saj janë:

- Furnizimi me pajisje për kabinetin e informatikës ”IAAP “Mithat Frashëri”-Gurakoc
- Furnizimi dhe montimi i pajisjeve për Sistemin hyrje –dalje në IAAP “Mithat Frasherit”-Gurakoc
- Furnizimi me material për mirëmbajtjen e shkollave,

Projektet që janë në procesin e vlerësimit janë:

- Renovimi i kulmit të sallës së edukatës fizike dhe furnizimi dhe montimi I derës hyrëse në shfmu”Ismail Qemali”- Saradran,
- Punimi i cokllës së rrethojës dhe zhvendosja dhe vendosja e rrethojës në Gjimnazin “Haxhi Zeka”-Istog,
- Renovimi i kulmit, klasave dhe nyjave sanitare në shf “Martin Camaj”-Serbobran,
- Renovimi I kulmit dhe hyrjes së objektit të shfmu ”Avni Rrustemi”-Zallq,
- Furnizimi me rekuizita për fëmijë për kopshtet: Gëzimi Ynë, Shpresa Jonë, Lulet e Jetës, Ardhmëria Jonë. Dhe Pëllumbat e Ardhmërisë,
- Furnizimi me perde shiritore-për institucione arsimore,
- 

Në proces të tenderimit janë:

- Transporti i nxënësve nga vendbanimet në shkolla-relacione të ndryshme, si dhe transporti i mësimdhënësve dhe shërbyesve tjerë .

- Rrethoja e poligonit sportive dhe vendosja e barit sintetik në shfmu “Zymer Zeka”-Kaliqan,
- Furnizimi me bari(tepih) sintetik ne fushën e shfmu “Hysni Zajmi”-Vrellë,
- Furnizimi me material shpenzues për klasë-për institucione arsimore,

Kurse të mëposhtmet pritet shumë shpejtë të shpallen procedurat e tenderimit:

- Furnizimi me lektyra shkollore-për institucione arsimore,
- Blerja e generatorit për IP ”Gëzimi Ynë”-Istog, si dhe
- Blerja e gjeneratorëve për Institucione tjera arsimore

Projektet e reja kapitale të cilat janë financuara nga MASHTI-i janë:

-Përfundimi Palestrës sportive në shfmu Martin Camaj-Gurakoc  
 -Renovimi i kulmit shfmu Bajram Curri-Istog,  
 -Instalimi i pajisjeve për shtrirjen e rrjetit të internetit në tërë shkollë-nga Rrjeti Kosovar për Hulumtim dhe Edukim.

Ndërsa nga Donacionet:

-Tabelë e mençur, projektor, laptop dhe printer ,në shf “B.Curri “-Dubravë,(donacion nga Kfori Italian)  
 -Tabelë e mençur dhe projektor dhe shfmu “Martin Camaj”-Gurakoc(donacion nga Kfori Italian).  
 -Llaptop dhe printer në shf “Martin Camaj”-Serbobran(donacion nga Kfori Italian).  
 -11 Llaptop, tabelë e mençur, projektor dhe printer në shfmu “Tre dëshmorët”-Uçë(donacion nga Kfori Italian).  
 -Tabelë e mençur dhe projektor në shf “Ismail Qemali”-Trubuhoc(donacion nga Kfori Italian).  
 -Shfmu “Martin Camaj”-Gurakoc,një printer/fotokopje/skaner nga NLB Banka-Istog,

**AKTIVITETET ME NXENËS:**

Nga Kfori Italian janë mbajtur këto kurse për nxënësit e shkollave të mesme dhe disa fillore  
 -Vetëmbrojtja në raste të ndryshëm, siguria në përgjithësi dhe kursi i gjuhës italiane.

Shërbimi Policor i Kosovës -dega në Istog ka mbajtur takime me nxënës me temat luftimi i :

-Bullizmit në shkolla,  
 -Dukuritë negative (droga, alkooli etj.) shkaqet dhe pasojat e përdorimit të tyre.

Si dhe takime informuese :

-Vetëdijesimi i nxënësve se si të sillem në komunikacion(është organizuar në të gjitha shkollat gjatë gjysmëvjetorit të dytë).

Nga Oj TOKA është organizuar aktiviteti për mbrojtjen e mjedisit me moton “Klubet e gjelbërta”,pjesëmarrëse shkollat e mesme dhe dy shkolla fillore,

Kurse nga marrëveshja e përbashkët MASHT-i-DKA-ja- Ministria e Kulturës ,me projektin “Drejt maleve”, në kursin e skijimit kanë marrë pjesë 50 nxënës (nga 4 shkolla)me dy mësimdhënës, me qëndrim 5 ditore.

Në bazë të marrëveshjes DKA- OJQ TOKA është organizuar aksioni “Ditët e solidaritetit”(pjesëmarrës 30 nxënës të Gjinnazit Haxhi Zeka),të cilët kanë punuar me pagesë të kompanitë private. Shuma e mbledhur nga ky solidaritet do të dedikohet ndonjë projekti të vogël e mirë e Gjinnazit.

Shoqata Japoneze JACA me aksionin “Mbledhja e drunjëve” ,ka bërë mbjelljen e tyre në tri Shkolla: Gjimnaz “Haxhi Zeka”, shfmu ”Bajram Curri”-Istog dhe shf “Bajram Curri”-Dubravë.

## ***DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT*** ***RAPORTI I PUNËS PËR PËRIUDHËN JANAR-QERSHOR 2024***

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sporti gjatë gjysmës së vitit 2024 ka realizuar disa projekte në infrastrukturë e poashtu ka zhvilluar një varg aktivitete kulturore dhe sportive. Këto aktivitete janë organizuar në nivele të shkollave, nivel lokal dhe në nivel komunal e shtetëror në të gjitha degët .

### **Infrastruktura**

Projektet kapitale në lëminë e infrastrukturës që aktualisht janë në zhvillim:

1. Ndërtimi i Stadiumit të Qytetit “Demush Mavraj” - Faza IV, kanë filluar punimet dhe është bërë pagesa e situacionit të parë të përkohshëm.
2. Ndërtimi i njeve të reja sanitare dhe zhveshtoreve në Palestrën e Sporteve – nuk është filluar ende me procedura sepse në Palestër është duke u realizuar projekti për rregullimin e kulmit – memorandum mes MKRS-së dhe Komunës.
3. Ndërtimi i Qendrës Rinore në fshatin Staradran - Procedurat e prokurimit janë përfunduar dhe pritet fillimi i punës.
4. Ndërtimi i sallës së Sporteve në Vrellë - Projekti është në fazën e tenderimit, ka pasur ankesa nga operatorët ekonomik dhe ende është në proces të shqyrtimit të ankesave.
5. Jashtë planifikimeve të projekteve kapitale janë bërë edhe dy investime të nevojshme në fushën e sportit pasi që Palestra është e mbyllur për çdo aktivitet, andaj me qëllim të krijimit të kushteve për klubet sportive ka përfunduar “Shtrimi i gerflorit – Palestra Dresha”, dhe është në procedura të prokurimit “Staza për Atletikë”. Poashtu mirëmbajtja e hapësirave sportive: poligoneve sportive, fushës së Stadiumit, objektit të Shtëpisë së Kulturës etj.

### **Spektori i Kulturës**

Aktivitetet kulturore dhe artistike të realizuara gjatë gjashtëmujorit të parë përfshijnë:

1. “Lexuesi i vitit” në bashkëpunim me Bibliotekën e qytetit janë shpërblyer me mirënjohje tre lexuesit e dalluar për vitin 2023.
2. “Gara e pavarësisë” garë në mes shkollave fillore në valle, ese, recitim dhe shfaqje teatrale për nder të festës së Pavarësisë.
3. Vizitë në Presidencë dhe Kuvendin e Republikës së Kosovës për nder të Ditës së Pavarësisë me nxënës të klasës së 5-të SH.F.M.U.”Bajram Curri”, Istog.

4. Program kulturo-artistik me këngë dhe valle për nder të Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, me temën "Trashëgimia Kulturore - Pasqyrë dhe Urë".
5. Kolonia e artit dhe ekspozita tematike për 17 Shkurt "Promovimi i pasurive të Trashëgimisë kulturore dhe natyrore përmes artit në Komunën e Istogut".
6. Promovimi i librit "Histori në Vargje" më 28 Shkurt.
7. Program kulturor-artistik nga Shoqata e Vëllazërisë Kosovë – Malësi e madhe “Martin Dreshaj” tek memoriali i dëshmorëve të UÇK-së në Vrellë për nder të 12 Prillit – Dita e Dëshmorëve.
8. Promovimi i librit "Çështje sociolinguistike të terminologjisë në mediet e Kosovës dhe Shqipërisë" nga Dr. Sejdi Gashi, me mbështetje nga Komuna, Drejtoria dhe Institutit Albanologjik.
9. Program artistik nga OJQ “Folklori i Podgurit” në parkun e qytetit për Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve - 1 Qershori.
10. Promovimi i librit "Premtimi" i nxënësës Valentina Kajtajaj, financuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
11. Koncert në Parkun e qytetit për nder të 25 vjetorit të Çlirimit të Istogut me këngëtarë të shquar dhe valle Popullore.
12. Intervista në Radio Televizionin e Kosovës me qëllim të prezantimit të aktiviteteve kulturore të DKRs-së.

## **Sektori i Rinisë dhe Sportit**

Aktivitetet e realizuara në Sektorin e Rinisë dhe Sportit për gjashtëmuorin e parë të vitit 2024 janë:

1. Ligjërata në bashkëpunim me FSK-në dhe Policinë e Kosovës për klasat e XII-ta të shkollave të mesme me moton “Me nder i shërbej Atdheut”, për nder të festës së Pavarësisë.
2. Organizimi i ceremonisë "Sportisti i Vitit" ndarja e mirënjohjeve për sukseset e Klubeve Sportive gjatë vitit 2023.
3. Gara në hendboll për shkolla fillore "Tre Dëshmorët e Shkollës Shqipe", në bashkëpunim me OJQ "Sporti Shkollor".
4. Turniri tradicional në Shah "Tre Dëshmorët e Shkollës Shqipe".
5. Thirrje publike për kategorizimin e Klubeve Sportive të Komunës së Istogut dhe nënshkrimi i kontratave me Klubet Sportive përfituese nga thirrja publike për kategorizimin e Klubeve Sportive.
6. Aktivitete sportive në nder të 12 Prillit - Ditës së Dëshmorëve, me performimin e Klubit të Ping Pongut dhe klubeve të Karatesë "Liria" dhe "E&E Wazari".
7. Asambleja e gjashtë rinore nga UNMIK-u ku rinia Istogase pati mundësi shkëmbimin e ideve dhe përvojave mes 130 pjesëmarrësve të Asamblesë nga Kosova dhe regjioni i Ballkanit perëndimor.

8. Aktivitet sportive nga Klubi i Ping Pongut dhe klubit të Basketbollit në parkun e qytetit për nder të ditës së çlirimit të Komunës së Istogut me rrethinë
9. Bashkëpunim i mirë me KFOR-in Italian, si rezultat pranimi i donacionit nga KFOR-i për Klubin e Futbollit të femrave.
10. Vizita sistematike Klubeve Sportive dhe përcjellja e aktiviteteve të tyre.

### **Biblioteka e qytetit “Brezi i ri”**

Biblioteka e qytetit gjatë periudhës Janar – Qershor 2024 ka realizuar këto aktivitete:

1. Punë e vazhdueshme me lexuesit – anëtarësimi i lexuesve të rinjë.
2. Sistemimi i tërë materialit bibliotekar dhe mirëmbajtja e hapësirës e gjithë materialeve poseduese.
3. Zgjedhja e lexuesve të dalluar për vitin 2023 dhe ndarja e mirënjohjeve për lexuesit e dalluar.
4. Pranimi i materialeve të reja nga donator të ndryshëm, përpunimi i tyre fizik, regjistrimi dhe sistemimi i tyre.
5. Përpilimi i listës së materialeve të kërkuara (librave), për bibliotekë për vitin 2024.
6. Takime dhe biseda me lexues të vegjël, me qëllim stimulimin për lexim dhe vetëdijesimin për rëndësinë e librave dhe leximit.
7. Vizita nga nxënës të shkollave fillore në mënyrë të organizuar, së bashku me mësueset e tyre.
8. Gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2024 në bibliotekë janë regjistruar: 49 lexues me pagesë, 54 lexues pa pagesë dhe 4 lexues me asistencë sociale dhe veteran, gjithsejtë 107 lexues të rregullt.

### **Spektori Muze - Arkeologji**

Aktivitetet e realizuara në Sektorin Muze – Arkeologji për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2024 janë:

1. Mirëmbajtja dhe sistemimi i materialeve – aseteve të muzeut
2. Pjesëmarrje në Muzeun Etnologjik të Pejës, në inaugurimin e pranim-dorëzimit, të Xhubletës Ilirio –Shqiptare që familja e Gjergj Dedvukaj nga Bardhaj i Hotit me banim në Michigan të SHBA-së,



ia dhuroi Muzeut Etnologjik të Pejës. Tashmë e pranuar ne UNESCO, si trashëgimi e kulturës botërore.

3. Prezantimi dhe promovimi i aseteve të muzeut para vizitorëve të shumtë, gjatë periudhës janar – qershor në muzeun e qytetit kishte shumë vizita ekipore të shkollave të rajonit, OJQ të ndryshme si dhe vizita individuale (rreth 25 persona).
4. Intervista në televizionet lokale nga zyrtari për muze ku u prezantuan astete e muzeut, gjetjet arkeologjike dhe fakte tjera të trashëgimisë për Komunën e Istogut.
5. Nga MKRS-ja dhe QRTK-ja jemi njoftuar se Burgu i Gurrakocit tashmë aset në regjistrin e Trashëgimisë Kulturore me Nr. Unik në data bazë 4812, së shpejti pritet të fillojnë punimet në pastrimin dhe konsolidimin e tij.

### Sektori i muzikës

Aktivitetet e realizuara në Sektorin e Muzikës për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2024 janë:

1. Formimi i korit të fëmijëve, ushtrime dhe aktivitete të rregullta të korit.
2. Përgatitjet dhe mbajtja e koncerteve dhe organizimeve për festa të ndryshme.
3. Ushtrime javore të AKV „Selman Kadria”, përgatitje për pjesëmarrje në festivalet e Folklorit në qytete të ndryshme të Kosovës dhe rajonit.
4. AKV “Selman Kadria” morri pjesë në disa Festivale Folklorike ku prezantoi shkëlqyeshëm Kulturën dhe Traditat tona përmes këngëve dhe valleve, me këtë rast ata edhe morën çmime për paraqitjet e tyre.

Festivalet në të cilat u prezantuan janë:

“Lulëkuqet e Prillit” – Kamenicë

“Anadrinia jehon” – Rahovec

“I këndojmë Lirisë” – Klinë

“Eshkë e ndezur mbi Shkelzen” – Deqan.

Numri i Kërkesave	Miratuar	Refuzuar	Në Proces	Anuluar	Pezulluar	Ceduar
51	31	11	4	3	1	1

# **DREJTORIA PËR BUJQËSI DHE HIDROEKONOMI**

## **RAPORTI I PUNËS PËR PËRIUDHËN JANAR-QERSHOR 2024**

### **Sektori i Bujqësisë**

Bazuar në programin për bujqësi dhe zhvillim rural 2024 të Drejtorisë brenda periudhës raportuese janë zhvilluar takime me organizatat e ndryshëm partnere që fokus kanë bujqësinë, FAO-në, Syri i Vizionit, Islamik Relief Kosova, MBPZHR për koordinim të aktiviteteve dhe të programeve të ndryshme për vitin 2024. Po ashtu gjatë kësaj periudhe kemi pasur një numër të takimeve me palë të ndryshme-fermer -biznese dhe institucione të ndryshme etj. Realizimi i aktiviteteve të ndryshme në drejtorin sektorin e bujqësisë që kanë qenë të planifikuara në programin e punës.

#### **1. Aktivitetet në periudhën, janar- qershor 2024**

Ne kuadër të DBZHR-së-së nga muaji janar janë realizuar një mori aktivitete. Ndër me kryesorët do të paraqiten të specifikuar sipas kohës në të cilën kanë ndodhur.

- Në muajin janar janë përgatitur të gjitha kërkesat dhe lëndët e vitit paraprak ,ku janë dorëzuar për arkivim tek zyrtarja kompetente e arkivës komunale
- Po ashtu jemi përgatitur dhe kanë përfunduar me kohë procedurat për rritje të stafit në drejtori për pagesa direkte (janë pranuar 4 zyrtar të rinj me kontrata për shërbime të veçanta ,përmes ligjit të prokurimit, të cilët janë trajnuar dhe të përgatitur për procedurat e aplikimit dhe digjitalizimit të parcelave dhe kanë punuar në aplikimin e fermerëve për pagesa direkte.
- Janë bërë të gjitha përgatitjet e furnizimit me material shpenzues dhe pajisje teknologjike për mbarëvajtjen e procesit të aplikimit për pagesat direkte
- Janë iniciuar procedurat e zotimit të mjeteve për projektet kapitale
- Pranim dhe përgjigjeje në kërkesa të palëve
- Shërbime të tjera në kuadër të drejtorisë si; këshilla, ekspertiza vërtetimi për fermer, etj.
- Vlerësimi i dëmeve të ndryshme , nga fatkeqësitë natyrore dhe tjera etj.
- Përfundimi i procedurave për vend gjuetinë e përbashkët MOKNA dhe nënshkrimi i kontratës
- Përgatitja e procedurave të prokurimit për investime kapitale dhe kërkesat për shpalljen e tenderëve

#### **2. Lëndët e pranuar dhe zgjidhja e tyre**

##### **2.1 Kërkesat drejtuar drejtorisë së bujqësisë**

- Gjatë kësaj periudhe raportuese janë pranuar 38 kërkesa të ndryshme të palëve, drejtuar në sektorin e bujqësisë.

Pranuar	Ne proces	Miratuara	Ceduara	Refuzuara	Pezulluar	Anuluar
Kërkesa te rregullta	1	19	4	14	0	0
Aplikime për pagesa direkte	00	1210	00	00	00	00
<b>Totali i lendeve te trajtuara</b>						<b>1248.00</b>

- Gjatë fazës se aplikimit te fermerëve për pagesa direktet janë pranuar dhe procedura 1210 aplikacione te specifikuar si me poshtë:

Nr.	Sektori		Viti 2024	Sipërfaqja/ ha	Nr. i aplikacioneve
1	Lavërtari	Grurë sipërfaqe		1,929.69	483
		Grurë kg		/	/
		Grurë për farë		91.8	4
		Misër		1,879.57	567
		Thekër		18.11	6
		Elb		47.95	31
		Tërshërë		55.87	31
		Lule dielli		167.51	5
2	Perime kulturë	Perime në fushë		165.97	113
		Perime në sera		2.15	10
		Fasule monokulturë		3.86	4
		Kunguj misiri		20	22
		Vreshta		14.39	2
3	Pemëtari	Pemë		336.2	201
		Pemë të imta		6.54	5
		Material fidanor		52,500	1
4	Blegtori	Lopë qumështore	20 muaj – 12 vjet	4,120 krerë	387

		Mështjerra	14 - 20 muaj	420	143
		Qumësht litra	Gjashtëmujori I	/	/
			Gjashtëmujori II	/	/
		Bletë		7,096 koshere	116
		Dele		6,283 krerë	68
		Dhi		873 krerë	14
		Viça për majmëri	Gjashtëmujori I	/	/
			Gjashtëmujori II	/	/
		Dosa		/	/
5	Therje të raportuara	Gjedhe-	Gjashtëmujori I	/	/
			Gjashtëmujori II	/	/
6	Shpeztari	Pula		22,400	3
7	Akuakulturë	Peshk	Gjashtëmujori I	/	/
			Gjashtëmujori II	/	/
8	Bimë mjekësore dhe aromatike	Konvencionale		69.83	7
9	Bujqësi organike	Organike		172.13	8
Totali:		Ara		4980.57 (Ha)	
		Qumësht (litra) I+II		(Litra)	
		Akuakulturë (Peshk) I+II		(Kg)	
		Viça për majmëri I+II		(krerë)	
		Therje të raportuara (gjedhe) I+II		(krerë)	

Totali i lëndëve;

- Aplikim për subvencione ; 1210 copë
- Kërkesa te palëve përmes arkivit, 38 copë

---

Totali i kërkesave te trajtuara ; 1248 kërkesa

### 3. Projektet kapitale

Janë zotuar mjetet për projekte kapitale sipas listës se projekteve dhe kanë filluar procedurat e prokurimit për një pjesë te projekteve;  
Janë shpallur tenderi për projektet:

- Betonimi i kanalit te Duqeve ne Gurrakoc,
- Betonimi i Kanalit te Ujitjes Lagjeja Ahmet Cani,
- Betonimi i kanalit te ujitjes Prigod-Lagjeja Blakaj,
- Betonimi i kanalit te ujitjes vija e "Ahmet Ages " në Vrellë,
- Betonimi i kanalit te ujitjes Baicë-Kashicë
- Betonimi i kanalit Kloka ne Muzhevina

Për projektet kapitale ka pasur ngecje ne inicim te procedurës tenderuese për shkak te mungese se projekteve zbatuese për shpalljen e procedurave te prokurimit.

## ***DREJTORIA E SHËNDETËSISË***

### ***RAPORTI I PUNËS PËR PËRIUDHËN JANAR-QERSHOR 2024***

#### **I. SHËNDETËSIA**

Në gjashtëmujorin e parë të punës të vitit 2024 e terë puna dhe angazhimi i Drejtoratit për Shëndetësi ka qenë e drejtuar në përmirësimin dhe në ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore për qytetarët e komunës së Istogut. Rëndësi e veçantë i është kushtuar sidomos zbatimit të reformave në lëmin e Mjekësisë Familjare, përmirësimit të kushteve të punës dhe të infrastrukturës në objektet shëndetësore. Gjatë kësaj periudhe të raportimit, në bashkëpunim me menaxhmentin e QKMF kemi bërë vizita të vazhdueshme në QKMF dhe të gjitha qendrat tjera shëndetësore (QMF dhe AMF), ku jemi njoftuar për së afërmi me kushtet dhe nevojat e tyre. Pastaj vëmendje i kemi kushtuar edhe shërbimit të diagnostikës (Rëntgenit dhe shërbimit të Laboratorit). Për funksionimin sa me të mirë dhe pa ndërprerë të këtij shërbimi, kemi bërë zgjerimin e listës së analizave të cilat mund të kryhen në këtë shërbim. Kemi bërë furnizimin e rregullt me reagenca dhe për këtë qëllim në këtë periudhë janë shpenzuar rreth **12,600.00€**. Shërbimi i Rëntgenit gjatë kësaj periudhe ka punuar pa ndërpre duke kryer qindra shërbime radiologjike duke përfshi edhe Mamografin i cili gjatë kësaj periudhe ka funksionuar shumë mirë dhe janë kryer rreth 175 shërbime Mamografike. Shërbimi i Emergjencës po ashtu ka funksionuar 24 orë pa ndërprerë me kapacitete të shtuara ku janë të angazhuar rreth gjashtë ( 6) Mjek specialist dhe mjekë të mjekësisë së përgjithshme dhe numër të mjaftueshëm të stafit të mesëm shëndetësorë dhe staf teknik. Furnizimi me barna nga Lista Esenciale, nuk ka qenë i kënaqshëm dhe herë pas here kemi pas mungesë të medikamenteve dhe vonesa në furnizim. Për këtë arsye për shkak të furnizimit jo të mirë me medikamente nga Lista Esenciale e cila është obligim i Ministrisë së Shëndetësisë, drejtorati për shëndetësi për çdo muaj nga buxheti i sajë benë plotësimin e kësaj liste me medikamente dhe terapi të nevojshme për kryerjen e shërbimeve shëndetësore.

Sa i përket projekteve të cilat kanë qenë të parapara për vitin 2024, Të gjitha projektet të cilat janë të planifikuar të realizohen në këtë vit janë në procedurë të prokurimit ose në fazën e nënshkrimit të kontratës. **Shqyrtimi i kërkesave**- Gjatë kësaj periudhe, këtij drejtorati i janë parashtruar një numër i madh i kërkesave të cilat kanë të bëjnë me kërkesa për ndihmë financiare për blerjen e medikamenteve dhe kërkesa për kompensimin e karburanteve për individët të cilët janë duke u trajtuar me Kemio-Terapi dhe Rrezatime dhe

personat të cilët janë në dializë ku si mjet transporti përdorin automjetet private. Për realizimin e këtyre kërkesave gjatë kësaj periudhe kemi ndarë **11152 litra** karburant me vlerë prej **13,772.00€**.

Edhe në këtë vit kemi vazhduar me projektin me titull “ **Përkujdesja Shëndetësore Shtëpiake dhe Ambulator –Home Care 2023**” i cili realizohet me vizita sistematike në shtëpi për personat dhe familjet me nevojë. Përmes këtij projekti gjatë këtij viti janë realizuar **586** vizita mjekësore shtëpiake, dhe **2054** shërbime duke ju ofruar shërbime të ndryshme mjekësore për njerëzit me nevojë.

Home-Care Istog ka pasur mbështetje të vazhdueshme nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, janë siguruar vizitat në teren nga mjekët, për përfituesit e projektit, është bërë sigurimi i medikamenteve esenciale nga barnatorja qendrore e Qkmf- së Istog, sigurimi i gazave, instrumenteve sterile, sigurimi i kateterave , qeseve për stomë etj.

### **Shërbimet në QKMF**

- Në **Q.K.M.F, Q.M.F** dhe **AMF** Gjithsejtë janë kryer **15,048** vizita mjekësore, **35,329** shërbime.
- Triazhim **393** vizita mjekësore, **512** shërbime
- Laborator **4,908** vizita mjekësore, **146,623** shërbime.
- Rentgen **2,392** vizita mjekësore, **4,076** shërbime.
- Mamografi **203** vizita mjekësore, **371** shërbime.
- Stomatologji **1,689** vizita mjekësore, **2,936** shërbime.
- Pediatri **2,338** vizita mjekësore, **4,398** shërbime.
- Emergjencë **13,327** vizita mjekësore, **18,219** shërbime.
- Internistika: **3,585** vizita mjekësore, **6,093** shërbime.
- Vizitave shtëpiake: Nga ekipi mjekësore mjek, infermier si dhënia e terapisë intravenoze, vendosja e kateterit si dhe shërbime tjera janë kryer **1,079** pacient/e, **2,158** shërbime.
- Gjinekologji: **246** Vizita gjinekologjike, **1,399** shërbime të maternitetit.
- Shëndeti i Nënës dhe Fëmijës 0-3 vjet: Vizita për shëndetin e nënës dhe fëmijës kanë qenë gjithsej **558**.
- Vizita mjekësore nga SH.Mendor: Ekipi i Pejës nga Dr.Nusret Pepaj - Neuropsikiater si dhe infermieret gjithsej vizita mjekësore janë **202** si dhe trajtimi me terapi muskulare si me moditen depo **68** amp dhe amp Haldol depo **95**, të gjitha ampulatjanë të blera nga Komuna e Istogut.
- **Furnizimi me Barna:**
- Gjate këtij gjashtëmujori, furnizimi me barna dhe material shpenzues nga Lista Esenciale ka qenë relativisht i mirë. Sa i përket furnizimit me terapi tabelare, nuk jemi furnizuar mirë me antikuagulant si p.sh.: aspirinë, tableta për yndyrë, si dhe antiasmatik. Terapia ampulare është blerë sepse shumica kanë munguar si psh: diklofen, dexazon, urbazon, gentamycin, trodon etj.Ndërsa sa i përket materialit shpenzues ka pasur disa mungesa si p.sh.: shiringa, kanilla, fllaster, sistema, gaza etj.
- **Vazhdimi me plan programin e ZHVP-së për Mjek dhe Infermier:** Janë zhvilluar ligjërata për ZHVP sipas plan programit. Nga muaji Mars kemi filluar me planë programe për Infermier, janë zhvilluar 10 ligjërata për Infermier. Po ashtu janë mbajtur trajnime të organizuara nga AQH (organizata për cilësi në shëndetësi).
- **Vaksinimi i rregullt:**  
Janë aplikuar: Vaksina **5,290**, Shërbimet: **10,483**

- Vizita sistematike: **5,026** vizita;
- **Të hyrat vetanake:** Gjatë periudhës, Janar - Qershor 2024 nga Bashkëpagesat (participimi) janë realizuar të hyra gjithsej: **26,349.80 €**.

<b>RAPORTI INSULINAVE JANAR – QERSHOR 2024</b>					
<b>Nr.</b>	<b>Muajt</b>	<b>PACIENTAT</b>	<b>ANALOG INSULINE ME VEPRIM TE SHPEJTT (Novorapid)</b>	<b>ANALOG INSULINE ME VEPRIM TE ZGJATUR (Levemir)</b>	<b>ANALOG INSULINE BIFAZIKE ME VEPRIM TE MESEM DHE TE SHPEJTE (Novomix)</b>
1	<b>Janar</b>	<b>238</b>	<b>262</b>	<b>157</b>	<b>935</b>
2	<b>Shkurt</b>	<b>234</b>	<b>229</b>	<b>134</b>	<b>955</b>
3	<b>Mars</b>	<b>228</b>	<b>253</b>	<b>147</b>	<b>892</b>
4	<b>Prill</b>	<b>224</b>	<b>256</b>	<b>163</b>	<b>864</b>
5	<b>Maj</b>	<b>226</b>	<b>223</b>	<b>133</b>	<b>920</b>
6	<b>Qershor</b>	<b>215</b>	<b>235</b>	<b>111</b>	<b>840</b>
	<b>Totali</b>	<b>1,365</b>	<b>1,458</b>	<b>845</b>	<b>5,406</b>

# DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

## RAPORTI I PUNËS PËR PËRIUDHËN JANAR-QERSHOR 2024

### Sektori për Mbrojtje dhe Shpëtim

- ❖ Plani i Gatishmërisë Emergjente i cili është bazë për hartimin e Planit Operativ Emergjent është plotësuar me shënime të reja siç janë shënimet nga institucionet e Arsimit dhe Shëndetësisë, pas vërshimeve të nëntorit 2022 dhe janarit 2023 e mbas takimeve të shumta me UNDP-AME i njëjti së bashku me planin e vlerësimit të rrezikut është miratuar nga UNDP-ja me plotësimet e nevojshme.
- ❖ Plani Operativ Emergjent është miratuar nga Asambleja Komunale dhe është nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe nuk është publikuar në ueb faqen e Komunës.
- ❖ Plani në rast tërmeti është bërë grumbullimi i shënimeve të bodrumeve të ndërtesave kolektive të cilat në situata emergjente mund t'i plotësojnë kushtet për strehimore kolektive, por lëvizjet e shpeshta të banorëve në disa ndërtesa shumë-katëshe paraqesin problem për hartimin e planit për strehim dhe evakuim në rast rreziku. Poashtu mos mbulimi i vendit të lirë të zyrtarit për planifikim në kuadër të sektorit për Mbrojtje dhe shpëtim shkakton ngecje reale në hartimin e Planit.

Poashtu lidhur me hartimin e këtij plani problem në vazhdim paraqet mungesa e akteve ligjore normative dhe mungesa e hapësirave për strehim, gjegjësisht strehimoreve. Për këtë arsye jemi në fazën e identifikimeve të Bodrumeve në objekte kolektive duke identifikuar edhe pronaret me qëllim vlerësimi për shfrytëzim si strehimore në raste emergjente

- ❖ Do të ishte mirë që Drejtorati i Administratës së bashku me Drejtorin e Financave të nënshkruajnë marrëveshje e mirëkuptimit në pritje, me klauzulë se kompensimi për angazhim do të bëhet proporcionalisht me çmimin e tregut në ditën e angazhimit në intervenim.
- ❖ Sektori është përgjigjur kërkesave të qytetarëve me shkrim siç janë: lëshimi i certifikatave mbi shërbimin ushtarak, vërtetimi për plotësimin e kushteve për mbrojtje nga zjarri, vërtetime në raste të djegies së shtëpisë apo pronë personale, ndihma për dëmet e krijuara nga vërshimet e janarit etj.
- ❖ Drejtori i Drejtoratit dhe Udhëheqësi i Sektorit për Mbrojtje dhe Shpëtim kanë pas një varg takimesh me IOM, UNDP, FAO dhe AME si dhe organizata tjera të bamirësisë në bashkëpunim me Drejtorin e Mirëqenies Sociale për sigurimin e ndihmave materiale për familjet e prekura nga vërshimet e janarit. Drejtorati e ka paraqitur në Kuvend raportin e vërshimeve, i njëjti është miratuar dhe dorëzuar Komisionit Qendror për Vlerësimin e dëmeve pranë MPB-së gjegjësisht Qeverisë së Kosovës. Me kërkesën e këtij komisioni forma e formularëve të dëmeve janë ndryshuar tri herë pa ndërhyrë në vlerën e dëmeve individuale si dhe vlerën totale të dëmeve.
- ❖ Shefi i Sektorit për mbrojtje dhe shpëtim përpos detyrave në kuadër të sektorit është i angazhuar edhe në kuadër të Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi (EVSB-së) në realizimin e projekteve në bashkëpunim me UNDP-në, me qendrën për informim dhe siguri si dhe në organizimin e mbledhjeve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, komisioni për të zhdukur, Shërbimin Sprovues të Kosovës për monitorimin e të dënuarve me punë në dobi të përgjithshme.

Problem të madh paraqet **komunikimi në raste të fatkeqësive (situata emergjente)**, sistemi i radiolidhjeve nuk funksionon fare. Ne si sektor bazuar edhe në përshkrimin e detyrave të punëve kemi qenë të angazhuar në kryerjen e detyrave bazuar në kërkesat e qytetarëve, si dhe kemi kontribuar në hartimin e projekteve të ndryshme nga lista e projekteve të parapara për këtë vit.

- ❖ Nga ana e zyrtarit për Monitorimin e Kamerave të Sigurisë janë kryer dhe realizuar një varg detyrash, i cili ka qenë i angazhuar në mirëmbajtjen, kontrollin, mbikëqyrjen dhe modifikimin e sistemit të kamerave të Sigurisë në Objektin e Komunës, në stacionin e Policisë, në QKMF-Istog dhe në objektet arsimore të komunës sonë. Mungesa e një personeli adekuat në zyrën e monitorimit dhe vëzhgimit në stacionin policor, për prishjet eventuale apo ndërhyrjes për mirëmbajtjen e kamerave po paraqet problem



rreth komunikimit (**Polici-Monitorues i Kamerave**).Gjithashtu zyra e monitorimit dhe vëzhgimit në objektin e Komunës nuk i përbush kërkesat për monitorim(**siguri dhe konfidencialitet**) adekuat duke pasur parasysh lëvizjet e shumta të zyrtarëve tjerë që janë të ngarkuar me detyrë po në të njëjtën zyre. Njëherit zyrtari për Monitorimin e Kamerave pranë sektorit për Emergjencë Mbrojtje dhe Shpëtim, me vendim të kryetarit (periudhë katërvjeçare) ka qenë i angazhuar edhe pranë komisionit për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, komision i cili me plotë përgjegjësi i është përgjigjur kërkesave të shumta të qytetarëve të komunës sonë.

Gjatë këtij gjashtëmujori Shërbimi i Zjarrfikësve ka pasur 102 dalje (intervenime). Intervenimet më së miri paraqiten si në tabelën e mëposhtme.

PASQYRA E NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË ZJARREVE: **JANAR - DHJETOR 2024**

2024	Zjarrë në Objekte ndërtimore						Zjarrë në Objekte ekonomike				Zjarrë në Pajisje elektrike				Zjarrë në Sipërfaqe të hapura				Zjarrë në Autom.	Gjith.
	Banesa / shtëpi	Objekte ndimse	Plevica - Shtalla	Objekte kolektive	Oxhaqe	Të tjera	Publike	Objekte Biznesi	Objekte Industriale	Të tjera	Pajisje elektrike	Paisjet shpërndarse	Gjeneratora	Të tjera	Mal	Bari i that	Sipërfaqe bujqësore	Të tjera	Automjete motorrike	
Janar	2	0	0	0	0	0	0	0	0	2	0	0	0	0	1	0	1	1	7	
Shkurt	1	1	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	4	16	0	13	0	36	
Mars	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2	2	5	0	4	1	14	
Prill	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	12	2	0	4	2	22	
Maj	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	2	0	3	
Qershor	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	9	0	9	1	20	
Korrik																				
Gusht																				
Shtator																				
Tetor																				
Nëntor																				
Dhjetor																				
Gjithsejtë	3	4	0	0	0	1	0	0	0	2	1	0	2	18	33	0	33	5	102	

Me gjithë numrin e vogël të personelit Shërbimi i Zjarrfikësve arrin, por me vështirësi të mbuloi detyrat, nevoja për rritjen e stafit është primare sidomos edhe për 10 zjarrfikës.

Gjendja e auto teknikes është funksionale deri me tani, duhet kryer servisimi periodike i tyre si dhe pajisjeve përcjellëse. Shërbimi i zjarrfikësve ka nevojë për momentin për blerjen e pompave te shpinës për sezonin e verës. Ka nevojë qe një pjesë e tubacionit sintetik te ndërrohet për shkak te vjetërsisë.

Nga rastet e zjarreve te cekura me lart 3 raste janë objekte banimi dhe shumica e tyre kanë kaluar pa ndonjë dëm të madh.

**Forma tabelare e rasteve te zjarreve për te cilat janë punuar raportet përkatëse dhe është bërë vend shikimi e rastit, 2024**

<b>Nr, data.</b>	<b>Pronari , adresa</b>	<b>Shtepi / biznes</b>	<b>Obj. percjellëse</b>	<b>Te tjera ( ushqim bagëtije dru prod.bujq. vetura), etj.</b>	<b>Shkak i zjarrit.</b>	<b>Dëmet</b>	<b>Sheni me</b>
<b>Date : 11.01. 2024</b>  <b>Nr: 001/ '24</b>	<b>Sejdi Brahim Nicaaj</b> Muzhevinë, rruga Mustafë Blakaj	Shtepi		/	dyshohet te jet shkaktuar nga paisje elektronike sdspter telefonash dhe laptopi.	mobileri, garderob ë libra, dyshemej a, fasada e tavanit tv resever etj,..	edhe kjo lagje ka nje rrjet elektrik furnizu es ne gjendje jo te mirë
<b>Date : 24.01. 2024</b>  <b>Nr: 002/ '24</b>	<b>Trubuhoc,</b> Rr; Emrush Çeta <b>pronë publike</b>			Lis i mbrojtur	rasti është Zjarrvënije, fëmijet me mjete pirroteknike	/	
<b>Date : 29.01. 2024</b>  <b>Nr: 003/ '24</b>	<b>Ekrem Arifaj nga Pemishta,</b> Rr; ..17 Shkurti”, nr; 506			Veturë, Mercedes 180 Benzin	probleme me ndezje, ndezje e dhunshme.	e tërë vetura	Moskuj desi njerëzo rë.
<b>Date : 29.01. 2024</b>  <b>Nr: 004/ '24</b>	<b>Zenun Meta j</b> Kaliqan, rruga, „Tre Deshmoret”, nr; 10	shtepi		/	oxhaku, mot me erë	të vogla, një skaj I trarit te kulmit	mospas trimi I oxhakut
<b>Date : 05.02. 2024</b>  <b>Nr: 005/ '24</b>	<b>Mirsad (</b> <b>Feriz)</b> <b>Kelmendit,</b> Rakosh, rruga Hajriz Metaj			fidane pemesh, kumbull	zjarrë i cili ka fillu nga rruga, qellimi I pastrimit te barojave	dëme ne instalim te sistemit pikëpikë te ujitjes	moskuj desi njerëzo rë

<b>Date :</b> <b>08.02.</b> <b>2024</b> <b>Nr:</b> <b>341/006/'24</b>	<b>Milorad (Radoje) Zuvij Berkovë, Klinë</b>			siperfaqe malore	zjarrvënije	mbetet te vl;ersohe n nga eksp te pylltarisë	moskuj des. Pastrami I barojave
<b>Date :</b> <b>12.02.</b> <b>2024</b> <b>Nr: 007/'24</b>	<b>Shaban Musë Sahitaj</b> Uçë, rruga; Ibish Tali, nr 50	Shtepi, kati i siperm me ushqun bagëtije		/	oxhaku, mot me nga erë	ushqim bagëtije I sistemuar siper në kat te pabanuar	mospas trim I oxhakut
<b>Date :</b> <b>16.02.</b> <b>2024</b> <b>Nr: 008/'24</b>	<b>Faik Berisha , rr; Lidhja e Pejes, Dobrushë</b>		garazhë, për gjesende shtepiake		nga zjarri fushorë aty afër	kulmi, dhe masë drunore për ngrohje	moskuj desi njerëzore
<b>Date :</b> <b>20.02.</b> <b>2024</b> <b>Nr: 009/'24</b>	<b>Avdyl Zemaj</b> Prekallë, rruga; Imer Osmanaj		mbetje veturash, hekurishte		vet pronari, ka ndezë barin e thatë		moskuj desi njerzore
<b>Date :</b> <b>21.02. 2024</b> <b>Nr: 010/'24</b>	<b>Shkolla, Ndre Mjeda në Rakosh</b>	object publik	aneksi I ngrohjes		mosfukcioni m I pompes, aktivizimi I ventili te presionit te lartë	pjesë instalimi te qarkullimit te ujit te nxehtë	mosmirëmbajtja dhe mungesa e serviseve te rregullta
<b>Date :</b> <b>19.02.</b> <b>2024</b> <b>Nr: 011/'24</b>  <b>Date :</b> <b>04-05/ 03/ 2024</b>  <b>Nr: 012/'24</b>	Stojan Donqiq fshati Bingjë, komuna e Kl;ines  Zjarrë në zonen industriale,		strehë e ushqimit te bagëtisë  goma te djegura		dushohet në zjarrvënije  Zjarrvënije, për nxjerrjen e mases metalike nga gomate, telin.	objekti dhe rreth 700 duaj sanë  hapsirë publike ne zonen industriale te komunes	nuk kam intervenuar ekipet zjarrfikese  menaxhim jo i

							mirë I hapsirës publike
<b>Date : 12/03/ 2024</b> <b>Nr: 013/ '24</b>	<b>Sokol Ademaj nga Uça,</b> në rrugën Col Bajraktari			zjarrë fushorë mexhë	dyshohet zjarrvënije	dëme te vogla	nuk kan interve nuar ekipet zjarrfik ëse.
<b>Date : 18.03. 2024</b> <b>Nr: 014/385 /'24</b>	<b>Bajram Nush Berisha Vulljakë, Klinë</b>		objekt percjelles		neglizhim I zjarrit, mbeturina te ndezura	kulmi I objektit	moskuj des
<b>Date : 25.03. 2024</b> <b>Nr: 015/391 /'24</b>	<b>Nazmi Ragip Gashi</b> fshati Sferkë , Klinë	shtepi banimi			oxhaku	kulmi I shtepisë	
<b>Date : 02/04/ 2024</b> <b>Nr: 016/ '24</b>	<b>Xhejrane (Kuqaj) Osmanaj, nga Kaliqani</b>			veturë, golf II, disel	probleme me instalim	e tërë vetura	
<b>Date : 02/04/ 2024</b> <b>Nr: 017/ '24</b>	<b>Adem Fazlijaj</b> rruga Haxhi Kajtazaj Dragolec, Istog			ushqim bagëti je dhe ahur	shkendija nga lidhja e shkurt e tensionit te lartë, e perkrahur nga era	1200 duaj sanë dhe 500 duaj kashtë	gjendja jo e mire e rrjestit furnizues
<b>Date : 05/04/ 2024</b> <b>Nr: 018/ '24</b>	<b>Belicë</b>			zjarrë fushor-malor	zjarrvënije, vet barinjet e fshatit per kullosa	zjarret kan kapluar edhe mallet	moskuj desi
<b>Date : 08/04/ 2024</b> <b>Nr: 019/ '24</b>	<b>Sadik Ademaj</b> Lubovë, rruga Ramë Ademaj		objekt përcjellës		zjarri ka ardhë si pasoj e ndezjes së malit		moskuj desi

03 .04. 2019	Kosh, Osojan, Belicë, Polanë, pronë publike			Zjarrë I hapur Siperfaqe pyjore	Zjarrvënije	Siperfaqe e konsideru eshme	Zjarrë I cili zgjatë me dit.
Nr: 012 / '19						respektivish t mexhës për ta pastruar	
<b>Date :</b> <b>29.04.</b> <b>2024</b>	<b>Venfrid Toplana</b> Pograxhë, Klinë			zjarr pyjor- fushorë	zjarrvënije,	siperfaqe e pyjeve halorë pisha	vend per piknik dhe mund te jet nga zjarret e pikniqe ve
<b>Nr: 021</b> <b>/24</b>							
<b>Date :</b> <b>22.05.</b> <b>2024</b>	<b>në Dubravë, Rukolli Kompany</b>		objekt percjelles		instalimi	pjes te instalimit	gjendja jo e mirëe instalim it
<b>Nr: 022</b> <b>/24</b>							
<b>Date :</b> <b>03.06.</b> <b>2024</b>	<b>„LAAB AUTO” rr. Bardh Isufi, Banjë</b>			automjet transporti per mallra frigorifer Mercede	dyshohet zjarrvënije	pothuaj tërë automjeti	
<b>Nr: 023</b> <b>/24</b>							
Tabela 68. Ndërtimi i qendrës për grumbullimin dhe transferin e mbeturinave

Tabela 69. Pyllëzimi dhe ripyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura të pyjeve në territorin e Komunës

Tabela 70. Përshatja e planeve të mbrojtjes nga zjarri ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike

Tabela 71. Nxitja/promovimi i përdorimit të farave/fidanëve rezistente ndaj ndryshimeve klimatike

Tabela 72. Hartimi i Protokollit për Masat Mbrojtëse nga Nxehtësia dhe Zbatimi i Udhëzimeve

Tabela 73. Planifikimi dhe ndërtimi i stehimoreve emergjente

Tabela 74. Krijimi dhe trajnimi i ekipeve vullnetare për rastet e emergjencave natyrore

Tabela 75. Akumulimi i ujit në zona turistike – malore (në shërbim të emergjencave, shuarjeve të zjarre, etj.)

Tabela 76. Ndërtimi i pikave hidrante në fshatra

Tabela 77. Krijimi i sistemi për mbrojtjen e turistëve dhe banorëve të zonave malore nga fatkeqësitë natyrore

Tabela 78. Promovimi i bujqësisë organike dhe agroturimzit përmes subvencionimit të fermerëve me serra, bletë, bagëti të imta etj

Tabela 79. Edukimi dhe informimi për ndryshime klimatike dhe zhvillim të qëndrueshëm

Tabela 80. Plani i veprimit për luftimin e varfërisë energjetike në Komunën e Istogut

Tabela 81. Mbështetja e komunës familjeve në nevojë për pagesën e faturave të energjisë elektrike

Tabela 82. Mbështetja e familjeve në nevojë për sigurimin e lëndës djegëse (dru zjarri) për ngrohje

Tabela 83. Subvencionimi për zbatimin e masave për eficiencë të energjisë në shtëpitë e banimit të familjeve në nevojë

Tabela 84. Subvencionimi për përmirësimin e eficiencës të sistemeve për ngrohjen e hapsirës dhe përdorimi i burimeve të ripërtëritshme të energjisë në shtëpitë e banimit të familjeve në nevojë

Tabela 85. Përmirësimi i rrjetit për furnizim me energji elektrike në territorin e komunës së Istogut

Tabela 86. Formimi i qendrës informuese komunale për varfëri energjetike

Tabela 87. Pasqyra e emetimeve të CO2 e PVEQK

## LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Harta e Kosovës

Figura 2. Organogrami i Komunës së Istogut

Figura 3. Logo e iniciatives së Marrëveshjes së Kryetarëve të Komunave

Figura 4. Shpërndarja e konsumit të energjisë sipas sektorëve

Figura 5. Emetimet e përgjithshme të CO<sub>2eq</sub> sipas sektorëve në bazë të pjesmarrjes në përqindje

Figura 6. Reshjet mesatare vjetore (mm) ne Kosove 1900-2021

Figura 7. Reshjet mesatare vjetore (mm) ne Peje 2002-2021

Figura 8. Ndryshimi mesatar vjetor i temperaturës (°C)

Figura 9. Ndryshimi i akumuluar i reshjeve (%)

Figura 10. Caqet indikative dhe trajektorja për reduktimin e emetimeve të gazrave serrë (GS)"

Burimi: Rezultate nga modelimi

Figura 11. Shpërndarja e përgjithshme e potencialit të uljes së emetimeve sipas sektorëve

Figura 12. Përqindja e uljes së emetimeve pas masave, në 2030

## SHKURTESAT DHE AKRONIMET

BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BERZH	BERZH (Banka Evropiane për rindërtim dhe zhvillim)
BRE	Burimet e ripërtëritshme të energjisë
EE	Efiçienca e energjisë
ESCO	Energy Service Companies (Kompanitë për shërbime energjetike)
FKEE	Fondi i Kosovës për efiçencë të energjisë
GLN	Gaz i lëngëzuar i naftës
GS	Gazërat Serrë
IBE (BEI)	Inventari bazë i emetimeve (Baseline Emission Inventory)
IHMK	Institui hidrometeorologjik i Kosovës
KEK	Korporata energjetike e Kosovës
KfW	Banka Gjermane për zhvillim dhe rindërtim
KRM	Kompania regjionale e mbeturinave
KRU	Kompania regjionale e ujërave
ME	Ministria e ekonomisë
MEI	Monitorimi i Inventarit të Emitimeve
MK (CoM)	Marrëveshja e Kryetarëve (Covenant of Mayors)
MMPHI	Ministria e mjedisit, planifikimit hapësinor dhe infrastrukturës
PK	Palët kontraktuese
PVQGJ	Plani i veprimit për qytet të gjelbër
PVEQK (SECAP)	Plani i veprimit për energji të qëndrueshme dhe klimë (Sustainable Energy and Climate Action Plan)
PVEK	Plani i veprimit për energji dhe klimë 2025 - -2030
ShA	Shtetet anëtare
TC	Termocentral
VRC (RVA)	Vlerësimi i rrezikut dhe cenueshmërisë (Risk Vulnerability Assesment)
ZEU	Zona me emetim të ulët

## 1. Përmbledhje Ekzekutive

Vizioni për Kosovën në vitin 2030 vendos zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm, një cilësi të lartë të jetës dhe institucione efektive si objektivat kryesore. Një element themelor i vizionit për Kosovën në 2030 është anëtarësimi në organizatat euroatlantike, duke ndihmuar kështu rrugëtimin përpara të Kosovës drejt familjes së Bashkimit Evropian. Po ashtu, nëpërmjet këtij vizioni, Kosova synon të përputhet me zhvillimet teknologjike dhe mundësitë e ofruara nga digitalizimi, të kontribuojë në Agjendën e Gjelbër si një aktor rajonal. Si nënshkruese e Deklaratës së Sofijes për Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, Kosova ka përgjegjësi për të përmbushur objektivat e BE-së për energjinë dhe klimën deri në vitin 2030, duke përfshirë reduktimin e emetimeve të përgjithshme dhe sigurimin e një qasje të qëndrueshme në energji. Vizioni i Qeverisë së Kosovës është të zhvillojë një sektor energjetik pa emetim të dioksidit të karbonit CO<sub>2</sub> deri në vitin 2050, të integruar në tregun Pan-Evropian, duke garantuar siguri të furnizimit me energji të përballueshme për qytetarët. Vizioni i BE-së është që deri në vitin 2050, të gjithë do të jetojmë në qytete të dekarbonizuara dhe të qëndrueshme me qasje në energji të përballueshme, të sigurt dhe të qëndrueshme.

Plani i Veprimit për Energji të Qëndrueshme dhe Klimë/Sustainable Energy and Climate Action Plan (PVEQK/SECAP) është një mjet politik dhe një dokument teknik në të njëjtën kohë, dhe ka të bëjë me zbatimin dhe monitorimin e veprimeve për energjinë dhe klimën në nivel lokal. Politikat e deritashme dhe ekzistuese për energji dhe klimë të Komunës së Istogut kanë përfshirë më shumë adresimin e efikasitetit të energjisë përmes zbatimit të Planit komunal të veprimit për efikasitet të energjisë 2019-2021 të Komunës së Istogut. Një nga prioritetet kryesore është promovimi i përdorimit të energjisë së qëndrueshme dhe eficiente në ndërtesat publike dhe private. Kjo përfshinë iniciativa për izolimin termik të ndërtesave, instalimin e sistemeve të ngrohjes dhe ftohjes eficiente, si dhe përdorimin e burimeve të ripërtrishme të energjisë.

Nënshkruesit e Marrëveshjes së Kryetarëve të Komunave kanë marrë përsipër të reduktojnë emetimet e CO<sub>2</sub> (mundësisht edhe të gazeve të tjera serrë), në territoret lokale që administrohen prej tyre, me të paktën 40% deri në vitin 2030 krahasuar me vitin referent, për të rritur rezistencën ndaj ndryshimeve klimatike duke zbatuar parimin e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, shkëmbimin e përvojave, vizioneve, rezultateve dhe praktikave me autoritetet lokale dhe rajonale në BE dhe jashtë saj. Autoritetet lokale janë zotuar për të hartuar Planin e veprimit për energji të qëndrueshme dhe klimë - PVEQK, (anglisht: Sustainable Energy and Climate Action Plan – SECAP) dhe për ta zbatuar atë si dhe brenda periudhës prej dy vite të anëtarësimit në Marrëveshjen e Kryetarëve dhe të hartojnë dokumentacionin e raportit për zbatimin e PVEQK.

Komuna e Istogut ka vendosur t'i bashkohet Marrëveshjes së Kryetarëve (MK) të Komunave (anglisht: Covenant of Mayors – CoM) duke hartuar Planin e veprimit për energji të qëndrueshme dhe klimë (PVEQK), që përfshinë edhe marrjen e zotimit për zbatimin e tij. Nga këtu e tutje PVEQK-së di t'i referohet si Plani i veprimit. Objektivi kryesor i Planit të veprimit është zvogëlimi i emetimeve të CO<sub>2</sub> për më shumë se 40%, rrespektivisht 41.27%, deri në vitin 2030 nga zbatimi i masave të rekomanduara, apo 44,380.58 tCO<sub>2</sub> deri në vitin 2030. Masat për zbutje janë propozuar për sektorët kyç të "Marrëveshjes së Kryetarëve të Komunave", sektori i ndërtesave, sektori i transportit dhe sektori i ndriçimit publik.

Në Planin e veprimit i ka të përshkruara masat për zbutje dhe objektivat që duhet të arrihen me këtë plan në përpjektjet për zbutjen e efekteve nga ndryshimet klimatike. Gjithsej janë të propozuara 25

masa për zbutje të ndryshimeve klimatike. Në kuadër të masave janë të përfshira: masa organizative, studime dhe natyrisht zbatime të projekteve konkrete.

Në Planin e veprimit janë të integruara masat për përshtatje të cilat janë të bazuara në dokumentin Vlerësimi i rreziqeve të cënueshmërisë. Masat për përshtatje i adresojnë ato rreziqe në sektorët e ndërtimitarisë, transportit/infrastrukturës së trafikut, energjisë, menaxhimit të ujërave, planifikimit hapësinor dhe menaxhimit të tokës, mjedisit dhe biodiversitetit, bujqësisë e pylltarisë, kujdesit shëndetësor, mbrojtjes civile dhe emergjencave, si dhe ekonomisë dhe turizmit. Gjithsej janë propozuar 33 masa për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike.

Plani i veprimit e trajton edhe varfërinë energjetike. Varfëria energjetike paraqitet në formën e ngarkesës në pagesën e faturave për energjinë e shpenzuar, por gjithashtu edhe në formën e kualitetit të energjisë elektrike që merret nga rrjeti, kjo pasi në shumë raste tensioni i rrymës elektrike shumë shpesh është më i ulët dhe kjo në shumë raste ka krijuar vështirësi në përdorimin e pajisjeve të ndryshme elektrike. Për varfërinë energjetike janë propozuar 7 masa në kuadër të këtij Plani të veprimit.

## 2. Hyrje

Iniciativa ndërkombëtare “Marrëveshja e Kryetarëve të Komunave(MK) për energjinë dhe klimën” synon të forcojë dhe përmirësojë aktivitetet lidhur me energjinë dhe klimën në nivel të njësisë të qeverisjes lokale. Vetë iniciativa bazohet në tre shtylla (ulja e emetimeve të CO<sub>2</sub>, forcimi i rezistencës ndaj ndryshimeve klimatike dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojave) dhe merret me përshtatjen dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike, në mënyrë që të sigurohet qëndrueshmëri dhe rezistencë ndaj ndryshimeve klimatike në nivel lokal duke reduktuar emetimet e gazrave serrë(GS).

Njësitë e qeverisjes lokale,(që në rastin e Kosovës janë komunat), janë nismëtarët kryesorë të tranzicionit energjetik dhe të luftës kundër ndryshimeve klimatike në nivel administrimi që është më së afërti me qytetarët. Komunat ndajnë përgjegjësinë për luftimin e ndryshimeve klimatike bashkë me institucionet në nivel kombëtar dhe janë të gatshme të veprojnë pavarësisht nëse pjesëmarrësit e tjerë i përmbushin detyrimet e tyre.

Aderimi i Komunës së Istogut në iniciativën Marrëveshja e Kryetarëve të Komunave është shprehje e dëshirës dhe synimit politik dhe strategjik për të punuar në vazhdimësi për përmirësimin e kushteve ekonomike, ekologjike dhe sociale të qytetarëve të saj, nëpërmjet realizimit të vizionit të përmirësimit të efikasitetit energjetik dhe dekarbonizimit në territorin e saj, me masa adekuate përshtatjeje dhe përshtatjeje ndaj ndryshimeve klimatike, që garanton zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të komunës që është në harmoni me mjedisin jetësor.

Si politikë komunale, Istogu synon mbrojtjen e tokës bujqësore, riaktivizimin e sistemit të ujitjes, kufizimin e zgjerimit të vendbanimeve, mbrojtjen e shumëllojshmërisë së peizazheve natyrore, ndërtimin e një sistemi të integruar të furnizimit me ujë për tërë komunën, si dhe ndërtimin e një sistemi të ri dhe të ndarë të kanalizimit fekal dhe atmosferik për të siguruar mjedisin e qëndrueshëm dhe të shëndetshëm për banorët tanë.

Politikat e transportit dhe mobilitetit në Istog përfshijnë shkurtimin e distancave mes fshatrave dhe qendrave lokale dhe Istogut si qendër kryesore, duke përdorur forma të ndryshme të transportit, si dhe promovimin e transportit alternativ përveç udhëtimit me veturë. Ata gjithashtu synojnë promovimin e qasjes së sigurt në rrugë, duke reduktuar pikat e qasjes përgjatë rrugëve rajonale dhe

rrugës përmbledhëse, dhe ndarjen e trafikut tranzit dhe lokal kur është e nevojshme. Politikat përfshijnë gjithashtu sigurimin e qasjes adekuate në ndërtesat dhe ngastrat në zonat e destinuara për zhvillim, promovimin e zhvillimit të cilat nuk dëmtojnë resurset mjedisore dhe skenike, si dhe asfaltimin e rrugëve të reja dhe rikonstruktimin e atyre ekzistuese vetëm kur është e nevojshme.

Politika e menaxhimit të mbeturinave bazohet në parimin e prioritetit, duke dhënë përparësi aktiviteteve për reduktimin, minimizimin dhe procesimin e mbeturinave përpara se të shkojnë në deponi. Përbushja e këtij parimi do të kërkojë që prodhuesit të përballojnë kostot e masave parandaluese për ndotjen e mjedisit, trajtimin dhe asgjësimin e mbeturinave të tyre. Po ashtu, ndotësit do të kenë përgjegjësi të mbajnë të gjitha kostot për menaxhimin e mbeturinave, duke përfshirë masat parandaluese dhe eliminimin e dëmit të shkaktuar nga aktivitetet e tyre. Ky plan përfshin edhe garantimin e të drejtës së qasjes së publikut në informacione relevante dhe pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje, duke përfshirë hartimin dhe miratimin e planeve kombëtare për menaxhimin e mbeturinave. Gjithashtu, politika synon përmirësimin gradual të menaxhimit të mbeturinave duke ndërmarrë veprime në etapa.

Përmes Planit Komunal të Eficiencës së Energjisë, komuna e Istogut promovon një planifikim afatmesëm për arritjen e objektivave mjedisore dhe ekonomike.

Objektivi i përgjithshëm i Planit të Veprimit të Eficiencës së Energjisë për Komunën e Istogut është zvogëlimi i konsumit të energjisë në ndërtesat publike, transport dhe ndriçim publik, rritja e nivelit të komoditetit, zvogëlimi i kostos së shpenzimeve të energjisë si dhe krijimi i sistemit për menaxhimin e energjisë në komunën e Istogut.

Me ligjin e ri të Kosovës për ndryshime klimatike nr. 08/L-250, përcaktohet se komunat, kur është e nevojshme, mund të hartojnë Planin Komunal për energji dhe klimë, i cili duhet të jetë në përputhje të plotë me Planin Kombëtar për energji dhe klimë, dhe i cili miratohet nga Kuvendet Komunale të komunave respektive.

## 2.1. Marrëveshja e Kryetarëve të Komunave për energji dhe klimë

Komisioni Evropian më 29 janar 2008, ka filluar nismën për të lidhur kryetarët e qyteteve evropiane të ndërgjegjshme për energjinë në një rrjet të përhershëm me qëllim shkëmbimin e përvojave në zbatimin e masave efektive për përmirësimin e eficiencës energjetike të zonave urbane. Nisma e quajtur "Covenant of Mayors for Climate and Energy (Covenant of Mayors – CoM)" apo në gjuhën shqipe "Marrëveshja e Kryetarëve të Komunave për klimë dhe energji (Marrëveshja e Kryetarëve – MK)", përfaqëson iniciativën më të madhe në botë të fokusuar në aktivitetet lokale të energjisë dhe klimës.

Një nga instrumentet kyçe për inkurajimin e planifikimit strategjik dhe të vazhdueshëm të masave të përshtatjes dhe zbutjes ndaj ndryshimeve klimatike në nivel lokal është krijimi i Planit të Veprimit për Energji të Qëndrueshme dhe Klimë (PVEQK) për komunat/qeverisjet lokale, me udhëzime të veçanta për metodologjinë për krijimin e Planit të Veprimit, grumbullimin dhe raportimin standardizuar të të dhënave për të arritur objektivat dhe detyrimet e përcaktuara deri në vitin 2030.

Prandaj, autoritetet lokale - nënshkruarit e Marrëveshjes ndajnë një vizion të përbashkët që do të sigurojë dekarbonizimin dhe qëndrueshmërinë e qyteteve dhe komunave ku qytetarët e tyre do të kenë qasje në energji të sigurtë, të qëndrueshme dhe të përballueshme për të gjithë.

Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike do të thotë të parashikosh efektet negative të ndryshimeve klimatike dhe të marrësh masat e duhura për të parandaluar ose reduktuar dëmet që këto efekte mund të shkaktojnë dhe për të përfituar nga mundësitë që mund të shfaqen në këtë proces.

Marrëveshja e Kryetarëve të Komunave është përgjigja e qyteteve të përparuara evropiane ndaj sfidave të ndryshimeve klimatike globale dhe nisma e parë dhe më ambicioze e Komisionit Evropian që synon drejtpërdrejt autoritetet lokale dhe qytetarët përmes përfshirjes së tyre aktive vullnetare në luftën kundër ngrohjes globale. Kjo iniciativë përfaqëson një qasje të re në zbatimin e politikës energjetike dhe klimatike, sepse për herë të parë filloi zbatimin e ashtuquajturës qasje "nga poshtë-lart", një model bashkëpunimi në nivel shumë-sektorial dhe një kuadër aktivitetesh të udhëhequra nga konteksti i mjedisit lokal gjatë zbatimit të aktiviteteve në nivel lokal.

Në tetor të vitit 2015, pas një procesi konsultimi për të ardhmen e marrëveshjes së Kryetarëve të Komunave, Komisioni Evropian lansoi një Marrëveshje të re të integruar të Kryetarëve të Komunave për klimën dhe energjinë që shkon përtej synimeve të përcaktuara për vitin 2020. Nënshkruarit e Marrëveshjes së re marrin përsipër të zvogëlojnë emetimet e tyre të CO<sub>2</sub> (dhe eventualisht edhe gazrat e tjerë serrë) dhe të miratojnë një qasje të përbashkët për zgjidhjen e zbutjes dhe përshtatjes së ndryshimeve klimatike. Nënshkruarit angazhohen të zvogëlojnë emetimet e CO<sub>2</sub> me të paktën 40% deri në vitin 2030 dhe të rrisin qëndrueshmërinë e qyteteve ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike.

Për të konvertuar angazhimin e tyre politik në masa dhe projekte praktike, nënshkruarit e Marrëveshjes angazhohen të miratojnë Planine Veprimit për Energji të Qëndrueshme dhe Klimë (PVEQK) që përshkruan aktivitetet kryesore që ata synojnë të ndër marrin brenda dy viteve nga data e vendimit të Kuvendit të Komunës për t'iu bashkuar Marrëveshjes së Kryetarëve të Komunave.

Nënshkruarit e Marrëveshjes së Kryetarëve të Komunave pajtohen me vizionin e përbashkët për vitin 2050, i cili përcakton:

- **Dekarbonizimin e territorit lokal** duke kontribuar në kufizimin e rritjes së mesatares globale të temperaturës nën 1.5°C, në përputhje me Marrëveshjen ndërkombëtare të Parisit mbi klimën arritur në konferencën COP21 në dhjetor të vitit 2015;
- **Forcimin e ripërtitjes së territorit lokal** duke forcuar kapacitetet për përshtatje ndaj ndikimeve të pashmangshme të ndryshimeve klimatike;
- **Mundësinë që të gjithë qytetarët të kenë qasje në energji të sigurt, të qëndrueshme dhe të përballueshme** dhe të kontribuojnë në cilësinë më të lartë të jetës dhe në përmirësimin e sigurisë së energjisë.

Nënshkruarit e marrëveshjes marrin përsipër që:

- të zvogëlojnë emetimet e CO<sub>2</sub> (mundësisht gazeve të tjera me efekt serrë) në zonën lokale me të paktën 40% deri në vitin 2030 krahasuar me vitin referent, nëpërmjet përmirësimit të efikasitetit të energjisë dhe rritjes së përdorimit të burimeve të ripërtitshme të energjisë;



- rrisin rezistencën ndaj ndryshimeve klimatike për shkak të zbatimit të parimeve të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike;
- shkëmbimin e përvojave, vizioneve, rezultateve dhe praktikave me autoritetet lokale dhe rajonale në rajon dhe BE, nëpërmjet bashkëpunimit të drejtpërdrejtë dhe shkëmbimit të njohurive, në kuadër të marrëveshjes së "Marrëveshjes Globale të Kryetarëve të Komunave";
- përgatitjen e Planit të veprimit për energji të qëndrueshme dhe klimë (PVEQK) brenda dy viteve nga data e aderimit në Marrëveshje dhe dokumentacionin përkatës për raportimin mbi zbatimin e Planit të Veprimit.

Kërkesat që duhet të plotësohen në mënyrë që PVEQK të pranohet si pjesë e iniciativës së Marrëveshjes janë:

- Plani i veprimit duhet të miratohet nga Kuvendi Komunal
- Plani i veprimit duhet të përmbajë qartë objektivin e reduktimit të specifikuar në Marrëveshje (p.sh. të paktën 40% e emetimeve të CO<sub>2</sub> deri në vitin 2030);
- Plani i veprimit duhet të bazohet në rezultatet e një Inventari bazë të emetimeve (IBE) dhe Vlerësimit të Rrezikut dhe vënueshmërisë (VRrC);
- Plani i veprimit duhet të mbulojë sektorët kyç të aktivitetit, të paktën ndriçimin publik, ndërtesat dhe trafikun.

Inventari referent i emetimeve duhet të përfshijë ndriçimin publik, ndërtesat dhe trafikun

## 2.2. Përshkrimi i Komunës së Istogut

Komuna e Istogut ndodhet në pjesën veriperëndimore të Kosovës, afër qytetit të Pejës, pranë kufirit me Shqipërinë dhe Malin e Zi. Përfshinë një sipërfaqe prej rreth 453.84 kilometra katrorë dhe është vendosur në një rajon me pejsazh të bukur natyror. Istogu është i njohur për trashëgiminë e pasur kulturore, me disa vende historike dhe monumente që datojnë në periudhat romake dhe osmane. Komuna gjithashtu organizon disa festivale tradicionale dhe ngjarje të cilat tërheqin vizitorë nga të gjithë Kosova dhe përtej.

Istogu si komunë është e pasur edhe më resurse nëntokësore, ka linjit në kuadër të basenit të Dukagjinit. Banja-Illixhja, e njohur për ujin shërues termomineral, qe nga periudha Ilire, është njëherazi edhe vendburim potencial i mermerit onix të cilësisë elite. Rezerva të mermerit ka edhe në fshatin Syne dhe Studenicë.

Komuna e Istogut është e pasur me hidrografi dhe atë Burimi i Istogut, Burimi i Vrellës si dhe kufizimi me Drinin e Bardhë. Në Banjë gjendet edhe Burimi i ujit termomineral. Burimi i Istogut përdoret për pije; për ekonomi peshku; dhe për prodhimin e energjisë elektrike.

Komuna e Istogut konsiderohet si rajoni më i pasur me trashigimi kulturore dhe natyrore në Kosovë. Sipas Listës së Trashigimisë Kulturore të Kosovës (2022) komuna e Istogut ka 28 lokalitete arkeologjike, dhe 32 monumente arkitektonike.

Istogu ka natyrë të pastër ekologjike, me bjeshkë atraktive, dhe klimë të volitshme cilat janë bazë për zhvillimin e turizmit dhe agroturizmit.




Figura 1. Harta e Kosovës

Informatat e fundit statistikore për komunën dhe qytetin janë të vitit 2011. Në bazë të ati regjistrimi, Komuna e Istogut ka një popullsi prej 39,289 banorësh, që kryesisht përbëhet nga shqiptarët. Komuna gjithashtu është shtëpi për komunitete më të vogla boshniakë, romë dhe grupet etnike të tjera.

Istogu ka një infrastrukturë relativisht të zhvilluar, me rrugë të asfaltuara, qasje në energji elektrike, dhe një sistem funksional të furnizimit me ujë. Megjithatë, ende ka vend për përmirësime, sidomos në fushën e shërbimeve publike dhe zhvillimit të infrastrukturës.

Sektori i bujqësisë në Komunën e Istogut me fokus në blegtori, prodhimin e produkteve të qumështit, dhe kultivimin e kulturave bujqësore., konsiderohet si sektori më i rëndësishëm ndër aktivitetet e përgjithshme ekonomike. Duke iu falënderuar potencialeve prodhuese që i ka komuna e Istogut: tokës pjellore, burimeve të ujit dhe klimës si dhe moshës së re të popullatës, agrikultura ka rol të rënd me fokus në blegtori, prodhimin e produkteve të qumështit, dhe kultivimin e kulturave bujqësore. sishëm në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik dhe agrar duke prezantuar kështu një lëmi me perspektivë për zhvillim. Prodhimi i peshkut konsiderohet një veprimtari me rëndësi për komunën dhe ka perspektivë në zhvillimin e mëtejme duke u bazuar në pasurinë e ujërave (kapacitetet ekzistuese në Istog, Trofta me 400 ton/vit, dhe prodhuesit tjerë të vegjël).

Një pjesë e **Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"** shtrihet edhe në territorin e komunës së Istogut, duke rritur kështu mundësinë e mbrojtjes dhe shfrytëzimit më të mirë të këtij potenciali turistik, jo vetëm në kufinj të tij por edhe në zonën që e rrethon.

Territori i Komunës së Istogut karakterizohet me klimë kontinentale të butë, ku ndikim të madh ka afërsia Bjeshkëve të Thata nga pjesa veriore, që ka ndikim të madh në ndryshimin e shpeshtë të temperaturës gjatë ditës. Ky territor nuk ndryshon shumë sipas kushteve të temperaturës nga

territoret tjera të pjesës veriore të rrafshit të Dukagjinit, të cilat janë në një pjesë të madhe nën ndikimin e klimës kontinentale dhe që kanë më pakë nxehtësi dhe më tepër të reshura. Temperaturat mesatare mujore sillet prej 0.5 °C në janar deri në 23.3°C në gushtë. Temperatura mesatare vjetore është 11.3°C, ndërsa në periodën vegetative 17.6° C. Sasia vjetore e të reshurave është mesatarisht afro 740 mm.

Regjioni i gjerë i Istogut përshkohet me klimë të mesme kontinentale në të cilën përpos faktorëve të jashtëm ndikojnë edhe faktorët lokal të brendshëm prej të cilëve më të rëndësishmit janë lartësia mbidetare, drejtimi i shtrirjes së masiveve malore, drejtimi i shtrirjes së luginave, afërsia me detin Adriatik dhe pellgun e lumit “Drini i Bardhë”.

Gjatë dimrit reshjet zakonisht janë me borë, ku trashësia e shtresës dhe kohëzgjatja e mbajtjes varen nga lartësia mbidetare dhe morfologjia e terrenit, si dhe ekspozicioni i terrenit.

Erërat kanë rëndësi të madhe, si modifikues të klimës në regjionin e gjerë të Istogut sepse bartin me vete karakteristikat e klimës nga vijnë. Në Istog më së shpeshti fryjën erëra nga jug-perëndimi, perëndimi dhe lindja.

Duhet theksuar se në Istog e rrethinë frynë herë-herë një erë e fuqishme lokale të cilën vendasit e quajnë “meqava” dhe e cila formohet me zbritjen e masave të ftohta ajrore nëpër shpatijët malore. Kjo erë përfshinë të gjitha fshatrat rrëzë shpatijëve malore prej fshatit Syrganë e gjerë në Kaliban dhe arrin shpejtësinë deri në 150 kilometra në orë, me këtë rast shkakton dëme të mëdha në objekte të banimit, kulme, si dhe në bujqësi, posaçërisht në pemëtari.

### 2.3. Vizioni i Komunës së Istogut në aspektin e klimës dhe energjisë

Vizioni për Istogun në 2050 është të jetë një komunë e gjelbër, e cila ka një ekonomi të qëndrueshme të bazuar në shfrytëzimin e burimeve natyrore dhe energjisë së pastër. Ky vizion synon të sigurojë një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm për qytetarët, duke ndërmarrë masa të rëndësishme për zvogëlimin e emetimeve të gazrave serrë dhe mbrojtjen e shëndetit publik.

Komuna e Istogut do të përpiqet të përdorë teknologjinë dhe inovacionin për të shfrytëzuar burimet natyrore si dielli, era, dhe uji në mënyrë të qëndrueshme për prodhimin e energjisë së pastër.

Në aspektin e mbrojtjes së mjedisit, komuna do të promovojë praktika të qëndrueshme të mbrojtjes së tokës, ujit, dhe biodiversitetit. Kjo përfshinë praktika të mira bujqësore, mbrojtjen e pyjeve dhe zonave të mbrojtura natyrore, si dhe ndërmarrjen e masave për zvogëlimin e mbeturinave dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Në një nivel më të gjerë, ky vizion synon të bëjë komunën e Istogut një shembull pozitiv për komunitetet e tjera në Kosovë dhe në rajon, për të inkurajuar përdorimin e energjisë së pastër dhe praktikave të qëndrueshme për të përmirësuar cilësinë e jetës dhe të mjedisit.

Istogu 2050, një komunë e gjelbër, me ekonomi të bazuar në shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe energjisë së pastër, në shërbim të zvogëlimit të emetimeve të gazrave serrë dhe mbrojtjes së shëndetit publik.
---

## 2.4. Caqet e komunës së Istogut për energji dhe klimë

Qëllimet e Strategjisë së Përgjithshme për Zhvillimin e Mjedisit Urban dhe Rural përfshijnë promovimin e agrikulturës me prodhimtari primare dhe përpunimin e produkteve bujqësore cilësore, zhvillimin e turizmit shëndetësor, malor dhe rural, përkrahjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme për të rritur konkurrueshmërinë, arritjen e një zhvillimi social të balancuar me qasje të barabartë në shërbime për të gjithë, zhvillimin e qëndrueshëm hapësinor për të mbrojtur trashëgiminë natyrore dhe kulturore të komunës dhe rajonit, si dhe zhvillimin e një infrastrukture teknike të integruar dhe funksionale për të gjitha zonat. Objektivat specifike përfshijnë mbrojtjen e tokës bujqësore, riaktivizimin e sistemit të ujitjes, kufizimin e zgjerimit të vendbanimeve, mbrojtjen e shumëllojshmërisë së peizazheve natyrore, ndërtimin e një sistemi të integruar të furnizimit me ujë për tërë komunën, si dhe ndërtimin e një sistemi të ri dhe të ndarë të kanalizimit fekal dhe atmosferik.

Caqet e qytetit të Istogut në kontekstin e politikës së energjisë dhe klimës janë të përcaktuara për të kursyer energji dhe për të zvogëluar emetimet e parashikuara të CO<sub>2</sub>. Këto qëllime janë përcaktuar gjatë nënshkrimit të Marrëveshjes së Kryetarëve të Komunave dhe përfshijnë:

1. Zvogëlimin e emetimeve të CO<sub>2</sub> për 40% deri në vitin 2030, krahasuar me inventarin e emetimeve të vitit baze 2017.

2. Rritjen e ripertritjes ndaj ndryshimeve klimatike përmes zbatimit të principeve të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike.

Bazuar në Inventarin Bazë të Emetimeve të Gazërave Serrë për Istogun, i cili ka qenë në 107,544.71tCO<sub>2</sub>, është vendosur një synim indikativ për zvogëlimin e emetimeve të CO<sub>2</sub> me 41.27% deri në vitin 2030, në krahasim me vitin 2017.

## 2.5. Organizimi i komunës së Istogut

Komuna e Istogut është njësi themelore e vetëqeverisjes lokale e cila ka Statutin e vetë. Komuna përgjegjësitë e veta i ushtron, organizon dhe udhëheq nëpajtueshmëri të plotë me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008, Statutin e Komunës dhe Rregulloren e punës së Kuvendit.

Organet e Komunës janë:

1. Kuvendi i Komunës, si organi më i lartë vendimmarrës i Komunës dhe
2. Kryetari i Komunës, si organi më i lartë ekzekutiv i Komunës.

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë përfaqësues dhe vendimmarrës i Komunës i cili ushtron funksionet e pushtetit lokal të përcaktuara me ligj dhe Statut. Kuvendin e Komunës e përbëjnë 27 Këshilltarë. Mandati i anëtarëve të Kuvendit është 4 /katër/ vjet. Kompetencat që Kuvendi i Komunës nuk mund t'i delegojë në organe të tjera janë të ndryshme dhe të rëndësishme. Së pari, ato përfshijnë miratimin e Statutit dhe Rregullores së punës, si dhe të gjitha rregulloret e tjera komunale, përfshirë ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre. Gjithashtu, Kuvendi është përgjegjës për miratimin e buxhetit dhe planeve investuese, si dhe për miratimin e çështjeve financiare të rezervuara për Kuvendin sipas Statutit dhe rregullores së punës. Përveç këtyre, Kuvendi duhet të

miratojë planin vjetor dhe raportin vjetor. Po ashtu, ai është përgjegjës për themelimin e Komisioneve të kërkuara sipas Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe për vendosjen e nivelit të tarifave dhe ngarkesave. Krijimi dhe përdorimi i simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të Komunës, në pajtim me Ligjin në fuqi, gjithashtu janë kompetenca që i takojnë Kuvendit. Emërimi dhe riemërimi i rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike është një tjetër përgjegjësi e rëndësishme. Kuvendi është gjithashtu përgjegjës për arritjen e marrëveshjeve ndërkomunale dhe brenda komunale, si dhe për marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të Komunave të Republikës së Kosovës. Në fund, Kuvendi ka edhe përgjegjësi të tjera që kërkohen me Ligj.

Kryetari i Komunës është udhëheqës i organit ekzekutiv të komunës dhe zgjidhet drejtpërdrejtë nga qytetarët me të drejtë vote, në përputhje me Ligjin për Zgjedhjet Komunale që është në fuqi. Kryetari i Komunës zgjidhet për mandat katër vjeçar. Kryetari i Komunës ka një sërë përgjegjësish të rëndësishme që ai i zbaton. Së pari, ai përfaqëson Komunën dhe vepron në emër të saj. Kryetari ka kompetencë mbi të gjitha ato përgjegjësi që nuk i janë dhënë eksplicit Kuvendit të Komunës apo Komiteteve të tij. Ai gjithashtu ekzekuton aktet e Kuvendit të Komunës dhe ka autoritet për të emëruar apo shkarkuar zëvendësit e tij/saj. Për më tepër, ai propozon zhvillimin komunal, planet rregullative dhe investuese, si dhe buxhetin vjetor për miratim në Kuvendin e Komunës dhe ekzekuton buxhetin e miratuar.

Raportimi para Kuvendit të Komunës për situatën ekonomiko-financiare të Komunës dhe zbatimin e planeve investuese bëhet së paku njëherë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga Kuvendi i Komunës.

#### 2.5.1. Organogrami i komunës




Figura 2. Organogrami i Komunës së Istogut

### 2.5.2. Organogrami i komunës për zbatimin e PVEQK

Një numër i Drejtorive komunale janë të angazhuara për zbatimin e PVEQK. Rol kyq kanë Sektori për mbrojtjen e mjedisit dhe energjisë efiçente në kuadër të Drejtorisë së Urbanizmit, si dhe Sektori për Investime Kapitale si pjesë e Drejtorisë për Investime Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave. Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim e cila menaxhon mobilitetin si dhe ndriçimin publik, ka rëndësi të veçantë në zbatimin e PVEQK-së. Gjithashtu, të përfshira në zbatim të PVEQK-së janë edhe drejtoritë ne vijim, si Drejtoria për Planifikim Strategjik, Drejtoria e Parqeve, dhe Drejtoria e Bujqësisë.

Ne bazë të Ligjit për Eficiencë të Energjisë dhe dhe UA nr. 09-2017 parashihet themelimi i Zyrave Komunale të Energjisë. Zyra Komunale për energji do të jetë përgjegjëse për raportimin e arritjeve në drejtim të EE në të gjithë sektoret e shërbimeve komunale. Në gjendjen ekzistuese Komuna e Istogut ka një Menaxher të Energjisë në kuadër të drejtorisë për Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, që merret me menaxhimin e energjisë vërtet në kuadër të kësaj drejtorie, që kryesisht ka të bëjë me ndriçimin publik.

## 3. Metodologjia

### 3.1. Çka është Plani i Veprimit për Energji të Qëndrueshme dhe Klimë (PVEQK)

Plani i Veprimit për Energji të Qëndrueshme dhe Klimë (PVEQK) është një dokument strategjik i zhvilluar si pjesë e iniciativës Kombëtare të Kryetarëve të Komunave.

PVEQK përcakton strategjitë dhe masat lokale për të arritur synimet klimatike dhe të energjisë të Bashkimit Evropian. Përfshinë zakonisht plane për reduktimin e emetimeve të CO<sub>2</sub>, përmirësimin e efikasitetit të energjisë dhe adaptimin ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike. Zhvillimi i PVEQK është një përpjekje bashkëpunuese që përfshinë qeverisjet lokale, palët e interesuara dhe komunitetin. Shërben si plan strategjik për qytetet dhe rajonet për të kaluar drejt një të ardhme të qëndrueshme dhe me emetim të ulët të karbonit.

PVEQK paraqet një dokument kyç në nivel qyteti, i cili, bazuar në të dhënat e mbledhura mbi gjendjen ekzistuese, identifikon dhe jep udhëzime të sakta dhe të qarta për zbatimin e projekteve dhe masave të efikasitetit të energjisë, përdorimit të burimeve të ripërtrishme të energjisë, përshtatjen ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike dhe luftimit të varfërisë së energjisë. Plani i Veprimit përqendrohet në ndikimet afatgjata të ndryshimeve klimatike në nivelin e komunitetit lokal, merr parasysh efikasitetin e energjisë dhe vendos qëllime dhe rezultate matëse lidhur me uljen e konsumit të energjisë dhe emetimit të CO<sub>2</sub>.

Qëllimi kryesor i PVEQK është të arrijë që masat e propozuara të çojnë në uljen e emetimeve të CO<sub>2</sub> për të paktën 40% deri në vitin 2030, duke siguruar një tranzicion të drejtëpërdrejtë të energjisë, dhe duke zbatuar masa për të bërë njësitë e qeverisjes lokale të rezistueshme dhe të përshtatshme ndaj ndryshimeve të pashmangshme të klimës.

Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Kryetarëve të Komunave për Energji dhe Klimë, komunat e reja angazhohen për të përgatitur Planin e Veprimit për Energji të Qëndrueshme dhe Klimë, i cili duhet t'iparaqitet Komisionit Evropian brenda një periudhe dyvjeçare nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes. Gjithashtu komuna zotohet të hartoj raporte periodike.

Dokumenti i SECAP-it duhet të përmbajë:

- Inventarin bazë për emetimet për monitorimin e masave të zbatueshme të ndikimeve të ndryshimeve klimatike.
- Masat përs zbatje të ndikimit të ndryshimeve klimatike.
- Analizën e rrezikut dhe vlerësimin e cenueshmërisë së sektoreve të veçanta ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike.
- Masat e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike.
- Masat për luftimin e varfërisë së energjisë.

Detyrimet nga Plani i Veprimit shtrihen në të gjithë territorin e qytetit, përfshirë sektorin publik dhe atë privat. Plani përcakton aktivitete në sektore të ndryshme, me theks në sektorët e ndërtimit, transportit dhe ndriçimit publik, ku autoriteti lokal ka ndikimin më të madh dhe që më së shumti kontribuojnë në konsumin e energjisë dhe emetimin e CO<sub>2</sub>.

Në përgjithësi, Plani i Veprimit në të gjitha segmentet e tij duhet të përputhet me kornizat institucionale dhe ligjore në nivelin e BE, nacionale dhe lokale dhe të përfshij periudhën deri në vitin 2030.

Komisioni Evropian, në qëllim të lehtësimit të përgatitjes dhe zbatimit të PVEQK dhe për të krahasuar rezultatet e arritura midis qyteteve evropiane, ka përgatitur dokumente për krahasime dhe këtë Plan të Veprimit është bërë në përputhje me udhëzimet dhe mjeteve brenda këtyre dokumenteve, duke përfshirë Manualin për Përgatitjen e Planit të Veprimit për Efiçencën e Energjisë dhe Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike;

[https://publications.jrc.ec.europa.eu/repository/bitstream/JRC112986/jrc112986\\_kj-na-29412-en-n.pdf](https://publications.jrc.ec.europa.eu/repository/bitstream/JRC112986/jrc112986_kj-na-29412-en-n.pdf); Rekomandimet për Raportimin e Marrëveshjes së Kryetarëve të Komunave për Klimën dhe Energjinë <https://eu-mayors.ec.europa.eu/en/resources/reporting>; Veglat e disponueshme në platformën Urban-Adaptation Support Tool (Urban-AST)

[https://sustainable-infrastructure-tools.org/tools/urban-adaptation-support-tool-uast/#:~:text=The%20Urban%20Adaptation%20Support%20Tool,monitoring%20climate%20change%20adaptation%20plans.](https://sustainable-infrastructure-tools.org/tools/urban-adaptation-support-tool-uast/#:~:text=The%20Urban%20Adaptation%20Support%20Tool,monitoring%20climate%20change%20adaptation%20plans.;); dhe Rekomandimet për luftimin e varfërisë së energjisë nga Marrëveshja e Kryetarëve të Komunave dhe Komisioni Evropian [https://eu-mayors.ec.europa.eu/en/library/energy\\_poverty](https://eu-mayors.ec.europa.eu/en/library/energy_poverty).

### 3.2. Procesi i punës, të dhënat e përdorura

Plani i Veprimit për Energjinë e Qëndrueshme dhe Klimën (PVEQK), është hartuar në përputhje me Udhëzimet e përpiluara në kuadër të Marrëveshjes së Kryetarëve të Komunave për Klimën dhe Energjinë (The Covenant of Mayors for Climate and Energy Guidelines) dhe shabllonin e Planit të Veprimit për Energjinë e Qëndrueshme dhe betejën kundër ndryshimeve klimatike të përpiluar nga Zyra e Marrëveshjes së Kryetarëve të Komunave dhe Zyra e Iniciativës Mayors Adapt, në bashkëpunim me Qendrën e Përbashkët të Kërkimeve të Komisionit Evropian.



Figura3. Logo e iniciativës së Marrëveshjes së Kryetarëve të Komunave

Komisioni Evropian, me qëllim të lehtësimit të përgatitjes dhe zbatimit të PVEQK dhe krahasimit të rezultateve të arritura ndër qytetet evropiane, ka përgatitur dokumente mbështetëse, dhe ky Plan veprimi është hartuar në përputhje me udhëzimet dhe veglat brenda këtyre dokumenteve:

1. Manuali për përgatitjen e Planit të Veprimit për Efiçencën e Energjisë dhe Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike;
2. Rekomandimet për raportimin e Marrëveshjes së Kryetarëve të Komunave për Klimën dhe Energjinë;



3. Mjetet në dispozicion në platformën Urban-Adaptation Support Tool (Urban-AST);
4. Rekomandimet për luftimin e varfërisë së energjisë të Marrëveshjes së Kryetarëve të Komunave dhe Komisionit Evropian.

Sipas udhëzimeve, Plani i Veprimit për Energji të Qëndrueshme dhe Klimë duhet të përmbajë:

- Inventarin bazë të emetimeve të CO<sub>2</sub> për monitorimin e masave të zbutjes të ndikimit të ndryshimeve klimatike;
- Masat e zbutjes të ndikimit të ndryshimeve klimatike (Mitigation);
- Analizën e rreziqeve klimatike dhe vlerësimin e cenueshmërisë së sektorëve të veçantë ndaj ndikimit të ndryshimeve klimatike;
- Masat e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike (Adaptation);
- Masat për luftimin e varfërisë së energjisë (Energy poverty).

### 3.3. Aktivitetet përgatitore për nisjen e procesit për zhvillimin e PVEQK/SECAP

Aktivitetet përgatitore për nisjen e procesit për zhvillimin e Planit të Veprimit për Energjinë e Qëndrueshme dhe Klimën (PVEQK/SECAP) filluan me sigurimin e vullnetit politik të komunës, duke siguruar mbështetjen e Kryetarit dhe Asamblesë Komonale të Istogut. Pas kësaj, u identifikuan aktorët e rëndësishëm dhe u krijua një grup punues për hartimin e PVEQK, përfshirë përfaqësues të autoriteteve lokale, sektorëve të ndryshëm të qytetit, shoqërinë civile dhe sektorin privat. Analiza e situatës së tanishme në qytet u bë në lidhje me energjinë dhe klimën, duke përfshirë inventarin e emetimeve të gazrave serrë dhe konsumin e energjisë në sektorët kyçe. U përpilua një plan konsultimi me të gjithë aktorët e interesuar për të mbledhur mendime dhe sugjerime për PVEQK. Gjithashtu, u identifikuan fondet e mundshme dhe burimet e tjera financiare për mbështetjen e hartimit dhe zbatimit të PVEQK, ndërsa u përpilua një listë me prioritetet dhe qëllimet e dëshiruara për të përfshirë në PVEQK, duke u bazuar në analizën e situatës dhe konsultimet e bëra me aktorët e interesuar. Planifikimi i një procesi të qartë dhe të strukturuar për hartimin e PVEQK u bë duke përfshirë afatet kohore dhe detyrat e përcaktuara për çdo aktor të përfshirë.

1. Sigurimi i vullnetit politik të komunës, gjegjësisht mbështetja e Kryetarit dhe Asamblesë Komonale të Istogut.

2. Identifikimi i aktorëve të rëndësishëm dhe krijimi i një grupi punues për hartimin e PVEQK. Këtu përfshihen përfaqësues të autoriteteve lokale, sektorëve të ndryshëm të qytetit, shoqërinë civile dhe sektorin privat.

3. Analiza e situatës së tanishme në qytet në lidhje me energjinë dhe klimën, duke përfshirë inventarin e emetimeve të gazrave të ndotjes së ajrit dhe konsumin e energjisë në sektorët kyçe.

4. Përpilimi i një plani të konsultimit të gjerë me të gjithë aktorët e interesuar për të mbledhur mendime dhe sugjerime për PVEQK.

5. Identifikimi i fondeve të mundshme dhe burimeve të tjera financiare për mbështetjen e hartimit dhe zbatimit të PVEQK.

6. Përpilimi i një listë me prioritetet dhe qëllimet e dëshiruara për të përfshirë në PVEQK, duke u bazuar në analizën e situatës dhe konsultimet e bëra me aktorët e interesuar.

7. Planifikimi i një procesi të qartë dhe të strukturuar për hartimin e PVEQK, duke përfshirë afatet kohore dhe detyrat e përcaktuara për çdo aktor të përfshirë.

### 3.4. Zhvillimi (përpilimi) i Planit të veprimit për energji të qëndrueshme dhe klimë (PQVEK)

Një nga elementët kryesorë të Planit të Veprimit është qëllimi për të reduktuar emetimet e CO<sub>2</sub>-shit të qytetit të Istogut deri në vitin 2030. Planit duhet të përcaktojë qëllime specifike për zvogëlimin e emetimeve të CO<sub>2</sub> për sektorët dhe nën-sektorët e konsumit të energjisë në zonën e qytetit të Istogut.

Për të përcaktuar qëllimet reale për vitin 2030 për kursimet në energji dhe nivelet e emetimeve të CO<sub>2</sub>, është e rëndësishme të mblidhen të dhëna cilësore për situatën e energjisë dhe konsumit të energjisë për vitin bazë. Hapi fillestar në këtë proces është klasifikimi i sektorëve të konsumit të energjisë në qytetin e Istogut.

IBE përfshin emetimet nga tre sektorët e konsumit final të energjisë në Komunë: sektorin e ndërtesave, të transportit dhe ndriçimit publik, në përputhje me klasifikimin e sektorëve në rekomandimet e Marrëveshjes së Kryetarëve. Llogaritja përfshin emisionin e drejtpërdrejtë (nga djegia e karburanteve) dhe emisionin indirekt (nga energjia elektrike dhe konsumi i energjisë termike).

Sektorët e aktiviteteve të përfshirë në IBE, janë:

– **Sektori i ndërtesave**

- Ndërtesat komunale, pajisjet/objektet (sektor kyç i KK);
- Ndërtesat terciare, pajisjet/objektet (sektor kyç i KK);
- Ndërtesat rezidenciale (sektor kyç i KK);
- Të tjera: Bujësia, Pylltaria – i gjithë konsumi final i energjisë dhe emetimet e GS që ndodhin në ndërtesa, objekte dhe makineri të sektorit primar (bujqësi dhe pylltari); sikur që janë objektet e kafshëve, sistemet e ujitjes dhe makineritë bujqësore.

– **Ndriçimi publik;**

– **Sektori i transportit**

- Flota komunale (sektor kyç i KK);
- Transporti publik (sektor kyç i KK);
- Transporti privat dhe komercial (sektor kyç i KK).

– **Furnizimi me energji**

- Energjia elektrike e importuar në territorin e komunës dhe inputet e asociuara dhe emetimet (në tCO<sub>2</sub>ose tCO<sub>2</sub>-eq).
- Prodhimi lokal i energjisë (PLE) - vetëm energjitë e ripërtëritshme (p.sh., energjia e erës; energjia nga hidrocentralet e vogla; energjia fotovoltaike; gjeotermike)

Inventari Bazë i Emetimeve (IBE) të CO<sub>2</sub> u realizua për vitin 2017, në bazë të të dhënave të grumbulluara. IBE-ja e Komunës së Istogut është hartuar në përputhje me Protokollin e Panelit Ndërqeveritar për Ndryshimin e Klimës (IPCC) dhe Marrëveshjes së Kryetarëve të Komunave, duke përdorur faktorët e emetimeve të IPCC dhe në raste të vecanta edhe faktorët nacional të emetimeve.

### 3.5. Korniza ligjore e rëndësishme për PVEQK

#### 3.5.1. Niveli i BE-së

Në përgjithësi, korniza ligjore e Bashkimit Evropian (BE) siguron një bazë të qëndrueshme për zhvillimin dhe zbatimin e Planeve të Veprimit për Energjinë e Qëndrueshme dhe Klimën në nivel lokal, duke ndihmuar qytetet dhe komunat të kontribuojnë në caqet më të larta të klimës dhe energjisë së BE-së.

Korniza ligjore e BE-së ka vendosur një bazë ligjore të gjerë për të adresuar ndryshimet klimatike dhe për të promovuar praktikën e energjisë të qëndrueshme. Kjo kornizë përfshinë udhëzime, rregullore dhe iniciativa të ndryshme që synojnë të zvogëlojnë emetimet e gazrave serrë, të rrisin eficiencën e energjisë dhe të promovojnë burimet e energjisë së ripërtrishme.

Një komponent kyç e kësaj kornize është Direktiva për Eficiencën e Energjisë, e cila vendos caqe të detyrueshme për vendet e BE-së për të përmirësuar eficiencën e energjisë me një përqindje të caktuar në një periudhë të specifikuar. Një direktivë tjetër e rëndësishme është Direktiva për Energjinë e Ripërtrishme, e cila vendos caqe për pjesën e energjisë së ripërtrishme në shkallën e energjisë në BE.

Gjithashtu, BE-ja ka adoptuar Rregulloren për Veprimin për Klimën, e cila kërkon që vendet e BE-së të zhvillojnë Planet Kombëtare të Energjisë dhe Klimës (NECP) për të siguruar përparimin drejt caqeve të energjisë dhe klimës së BE-së.

#### 3.5.2. Niveli kombëtar dhe lokal

Në Kosovë, Korniza Ligjore për Planin e Veprimit për Energjinë e Qëndrueshme dhe Klimën përfshinë ligjet, rregulloret dhe politikat që rregullojnë veprimtarinë në fushën e energjisë dhe klimës. Ligji për Energjinë përcakton strukturën institucionale dhe juridike për sektorin e energjisë në Kosovë dhe parashikon hapat për diversifikimin e burimeve të energjisë dhe përmirësimin e eficiencës të energjisë. Ligji për Eficiencën e Energjisë synon të promovojë eficiencën e energjisë në të gjitha sektorët, duke përfshirë ndërtesat, transportin dhe industrinë. Në bazë të Ligjit për Eficiencën e Energjisë parashihet themelimi i Zyrës Komunale për Energjinë. Zyra Komunale për energjinë do të jetë përgjegjëse për raportimin e arritjeve në drejtim të eficiencës së energjisë në të gjitha sektorët e shërbimeve komunale.

Plani Kombëtar për Energji dhe Klimë përcakton vizionin dhe objektivat e Kosovës për të përmirësuar sigurinë dhe shëndetin e sektorit të energjisë dhe për të ndihmuar në luftën kundër ndryshimeve klimatike. Caku i përcaktuar i zvogëlimit të Gazrave Serrë në nivel kombëtar për vitin 2030, krahasuar me 2016 është 16.3%.

Ligji për Klimën synon të zbatojë masat për zvogëlimin e efekteve të ndryshimeve klimatike në nivel kombëtar. Me këtë ligj për ndryshimet klimatike nr. 08/L-250, parashikohet që komunat, kur është e nevojshme, të hartojnë Planin Komunal për energjinë dhe klimën, i cili duhet të jetë në përputhje të plotë me Planin Kombëtar për energjinë dhe klimën dhe i cili miratohet nga Kuvendët Komunal të komunave të tyre.

Kjo kornizë ligjore dhe politike ofron bazën për zhvillimin dhe zbatimin e PVEQK në nivel lokal në Kosovë, duke ndihmuar qytetet dhe komunat të kontribuojnë në qëllimet e përgjithshme të energjisë dhe klimës.

### 3.6. Përfshirja e palëve të interesit

Për zhvillimin e PVEQK-së për Istogn palët e interesit janë përfshirë në të gjitha fazat. Përfaqësuesit e palëve të interesuara u përfaqësuan në grupin e punës për PVEQK përmes institucioneve publike, shoqatave të qytetarëve, iniciativave civile dhe sektorit lokal të biznesit. Ata u njohën si një kapacitet shumë i rëndësishëm për zbatimin e planit dhe u inkurajuan të luajnë një rol aktiv në procesin e zbatimit të PVEQK-se.

Palët e interesuara janë përfshirë në përgatitjen e Inventarit Bazë të Emetimeve dhe në Vlerësimin e Rrezikut dhe Cenueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike. Ata gjithashtu morën pjesë në procesin e identifikimit dhe priorizimit të veprimeve që do të jenë subjekt i planit të veprimit.

Istogu do të vazhdojë të mbajë dhe të zhvillojë bashkëpunimin me palët e interesuara për të siguruar një qasje të përfshirë dhe të qëndrueshme në zbatimin e PVEQK dhe për të përmirësuar efektivitetin dhe impaktin e politikave dhe masave për energjinë dhe klimën në nivel lokal.

### 3.7. Procesi i monitorimit dhe vlerësimit

Procesi i monitorimit dhe vlerësimit për PVEQK është një i domosdoshëm për sigurimin e qëndrueshmërisë dhe suksesit të planit. Duke pasur një proces të mirëfillt të monitorimit dhe vlerësimit, Istogu mund të sigurojë se PVEQK zbatohet në mënyrë efektive.

Procesi i Monitorimit dhe Vlerësimit i PVEQK përfshinë veprimet për të mbledhur dhe analizuar të dhënat për përmbushjen e caqeve të planit dhe për të vlerësuar efektivitetin dhe ndikimin e masave të ndërmarra në zbatim të këtij plani. Së pari duhet përzgjedhur indikatorët e performancës që do të ndihmojnë në vlerësimin e përmbushjes së caqeve të PVEQK dhe në monitorimin e progresit të zbatimit të masave. Në vazhdim bëhet mbledhja e të dhënave për konsumin e energjisë, emetimet e gazrave serra, përdorimin e burimeve të energjisë së ripërtrishme dhe të dhëna të tjera relevante për zbatimin e PVEQK. Analiza e të dhënave të mbledhura bëhet për të vlerësuar përmbushjen e objektivave të PVEQK dhe për të identifikuar tendencat dhe sfidat në zbatimin e masave. Hap i fundit është vlerësimi i efektivitetit dhe ndikimit të masave të ndërmarra në zbatimin e PVEQK, duke përdorur indikatorë të performancës dhe të dhënat të mbledhura.

Raportimi dhe komunikimi i rezultateve bëhet në mënyrë periodike për përdorim të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe komunikimin e rezultateve me palët e interesuara dhe publikun në përgjithësi. Sipas iniciativës "Marrëveshja e Kryetarëve të Komunave" (Covenant of Mayors), Istogu obligohet të

paraqes Raport Monitorimi çdo dy vjet pas fillimit të zbatimit të Planit, me qëllim të vlerësimit, monitorimit dhe verifikimit të çaqeve. Një raport i tillë duhet të përfshij një inventar të përditësuar të gazrave serrë në përputhje me monitorimin (MEI - Monitorimi i Inventarit të Emetimeve), të përgatitur duke përdorur metodologjinë dhe të dhënat hyrëse të njëjta si inventari bazë i emetimeve, në mënyrë që të mundësohet krahasimi dhe të përcillet progresi.

### 3.8. Aspekti financiar në nivel të komunës

Aspekti financiar i zbatimit të PVEQK në nivelin e komunës së Istogut është i rëndësishëm dhe kërkon kujdes dhe planifikim të kujdesshëm. Financimi i projekteve mund të jetë vecanërisht sfidues për shkak të buxhetit të limituar për investime të reja.

Istogu do të duhet të vlerësojë burimet financiare aktuale dhe të identifikojnë burime shtesë të financimit për të mbështetur zbatimin e PVEQK. Kjo mund të përfshijë qasjen në grante dhe subvencione nga programe kombëtare ose ndërkombëtare, shfrytëzimin e investimeve nga sektori privat nëpërmjet partneritetit publik-privat, dhe eksplorimin e mekanizmave inovativë të financimit.

Investimet totale kapitale për zbatim të PVEQK janë 66,325,000.00, dhe atë31,325,000.00 shkon për masat e zbutjes, kurse 34,910,000.00 për përshtatje. Sa i perket burimeve të financimit, kryesisht janë burime të jashtme (të dhënat e detajuara në tabelën 22).

Për periudhën 2024 – 2026, Komuna e Istogut ka planifikuar një numër të konsiderueshëm të projekteve kapitale, të cilat përkrahin zbatimin e PVEQK. Kështu, për infrastrukturë rrugore, trotuare, ndriçimit public, dhe rregullim të rrejtve të kanalizimit komuna ka buxhetuar 7mil EUR. Për sektorin e bujqësisë, gjegjësisht kanale të ujitjes, bujësi organike dhe bletari komuna ka ndarë buxhet prej 1.1mil EUR. Sektori i Planifikimit Urban dhe Mjedisit do të ketë buxhet prej 2mil EUR, të paraparë për rregullim të shtratit të lumit të Istogut; ndërtim të parkut pushues dhe rekreativ në Banjë; rregullim të trotuareve në zonat urbane Banjë, Vrellë, Gurrakoc dhe Istog; dhe ndërtim të sistemit të ri të ujësjellësit, gjelbrimit dhe ndriçimit në qendër të Istogut.

### 3.9. Pasqyra e Komunës

#### 3.9.1. Vlerësimi i opsioneve të përshtatjes

Vlerësimi i opsioneve për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike në Komunën e Istogut është bërë në bazë të konsultimeve publike me palët relevante të interesit.

Qëllimi kryesor i procesit të konsultimit ishte diskutimi i çështjeve dhe prioriteteve të komunës në lidhje me përshtatjen dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike, për të kontrolluar nëse masat e parapërzgjedhura për përshtatjen dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike mund të jenë të dobishme dhe të zbatueshme për komunën, për të përcaktuar masat e reja gjithëpërfshirëse dhe t'u japin përparësi dhe vlerësim masave të përcaktuara për përshtatjen dhe zbutjen e klimës.

Para se masat e përcaktuara t'i prezantoheshin publikut, për të parë opinionin e tyre se çfarë duhet të ketë prioritet dhe cilat janë masat që mund të zbatohen lehtësisht, u realizua një vlerësim paraprak nga një ekip konsulentësh, të cilët përgatiten një pasqyrë të gjendjes aktuale në aspektin e efekteve të ndryshimeve klimatike, dhe u përcaktuan rreziqet përkatëse klimatike dhe shtrirja e tyre, së bashku me ndryshimet e pritshme në intensitet dhe frekuencë.

Masat u përcaktuan bazuar në një vlerësim gjithëpërfshirës të rreziqeve dhe dobësive nga ndryshimet klimatike në sektorët e mëposhtëm: ujë, bujqësi, pylltari, shëndetësi dhe sektorin ekonomik. Bazuar në rreziqet dhe nivelin e cenueshmërisë dhe ekspozimit, u përcaktuan masat për trajtimin e rrezikut dhe potencialin për parandalim në të ardhmen.

Pas kësaj, janë zhvilluar konsultimet e palëve të interesuara për prioritizimin e masave zbutëse dhe përshtatëse. Konsultimet dhe diskutimet i kanë mundësuar komunës së Istogut të gjejë një rrugë të qartë të zbatimit përmes një sërë aktiviteteve prioritare, dhe si e tillë konsiderohet si bazë për arritjen e masave efektive zbutëse dhe përshtatëse.

Metodologjia e vlerësimit të opsioneve u zhvilluar përmes një procesi me tre hapa ku hapi i parë ishte një kombinim i punës në tavolinë dhe dy punëtorive për prioritizimin e masave zbutëse dhe përshtatëse përmes një konsultimi interaktiv me palët e interesuara relevante të komunës së Istogut.

Grupi komunal për hartimin e SECAP shërbeu si një platformë për të konsultuar dhe përcaktuar sektorët dhe masat prioritare. Grupi i punës për hartimin e SECAP u përfshi në vlerësimin e masave të propozuara zbutëse dhe përshtatëse sipas Inventarëve Bazë të Emisioneve të BIA-s dhe raporteve RVA (Risk dhe Vulnerability Assessment), të cilat kombinohen me projektet e dala nga dokumentet strategjike si komunale dhe krijoj listën paraprake të masave. Kjo listë është ndarë në sektorë dhe është filtruar në bazë të faktit nëse janë zbatuar, janë në proces zbatimi apo mbeten për t'u zbatuar në vitet në vijim.

Lista paraprake u vlerësua me disa kritere. Rëndësia ishte kriteri i parë që është marrë në konsideratë që nënkupton marrjen parasysh të strategjive të tyre sektoriale dhe ndikimin që mund të kenë në ndryshimet klimatike. Krahas këtij prioritizimi, masat janë vlerësuar në bazë të kornizës buxhetore afatmesme me ç'rast prioritet kanë pasur projektet që kanë qenë në zhvillim e sipër si dhe ato që pritet të realizohen brenda kornizës buxhetore. Efikasiteti i masave për sa i përket ndikimit të veprimeve të caktuara në zbutjen dhe/ose rezultatet e përshtatjes ishte një ndër kriteret e tjera të aplikuara për të parë se sa mund të bëhet me një sërë masash në drejtim të zbutjes ose përshtatjes me efektet e ndryshimit klimatike në varësi të dobësive të identifikuara në raporte. Prioriteti i veprimeve që sjellin sinergji dhe përfitime në zbutjen dhe përshtatjen, p.sh., përmirësimi i energjisë së rinovueshme dhe transportit për t'i bërë ballë ngjarjeve të pafavorshme të motit, ose investimi në gjelbërimin urban që veprojnë si absorbues të karbonit dhe reduktojnë nxehtësinë ekstreme urbane në të njëjtën kohë, janë konsideruar si kriter shtesë.

Takimi i parë konsultativ u mbajt në gusht 2023, së bashku me ekspertët dhe grupin punues të komunës që ishin përgjegjëse për zhvillimin e SECAP. Aktiviteti u organizua në formatin e një punëtorie me metodën World Coffee ku grupet e punës patën mundësinë të diskutojnë dhe të vendosin për masat prioritare për secilin sektor dhe cilat masa mund të zbatohen dhe janë të rëndësishme për çdo departament të qeverisjes lokale. Këtu u morën për bazë edhe projektet ekzistuese në kuadër të dokumenteve strategjike komunale. Duke aplikuar kriteret e rëndësishë, efektivitetit, buxhetimit dhe sinergjisë që mund të kenë projektet/masat në sektorë të ndryshëm, u arrit një listë e projekteve me prioritet në secilin sektor.

Prioritetizimi i masave është bërë në kuadër të ushtrimit të prioritizimit bazuar në parametrat e mëposhtëm: kostot për çdo masë/veprim, ekspozimi ndaj popullsisë apo sa popullsi jeton në zonë,

kompetencat e autoriteteve vendore (përgjegjësia për zbatimin), afati për zbatimin, buxhetin e kërkuar, ndikimin e rrezikut dhe numrin e paralajmërimeve për masën specifike.

Pas përfundimit të aktivitetit për prioritizimin e masave përshtatëse dhe zbutëse, një tjetër ngjarje u organizua në shtator të vitit 2023 në Istog, ku pjesëmarrës ishin nga grupi i vendimarrësve dhe palëve të interesuara (autoritetet kombëtare, agjencitë, ndërmarrjet publike, organizatat e shoqërisë civile). Qëllimi i punëtorisë së dytë ishte të vërtetohet me vendimmarrësit listën e projekteve/masave dhe sektorëve me prioritet të dala nga punëtorja e parë e Komunës së Istogut. Lista është diskutuar dhe vërtetuar (konfirmuar) me pak ndryshime ndërsa janë pranuar konfirmime me shkrim për sektorët e tjerë që nuk ishin të përfaqësuar në këtë seminar.

Hapi i dytë përfshinte organizimin e sondazhit online me mjetin e anketës google. Pyetësorët u shpërndanë të anketuarve potencialë për të angazhuar publikun e gjerë në dhënien e përparësive të masave për zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Objektivi i anketës ishte të marrë përgjigje nga popullata e komunës së Istogut për prioritizimin e masave të planifikuara për zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në SECAP Komunal 2023-2030.

Publiku i gjerë u angazhua në një anketë në internet ('Format e Google') përmes një pyetësoi të strukturuar. Anketa u publikua në ueb faqen e komunës së Istogut dhe në mediat sociale me qëllim që të arrihet një përfaqësim i balancuar i të gjitha grupeve të komunitetit. Pyetjet e anketës ishin organizuar në katër seksione: Informacioni i përgjithshëm për të anketuarit: masat dhe veprimet për të zbutur/reduktuar ndikimin e ndryshimeve klimatike, masat dhe veprimet për përshtatjen ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike dhe komente të tjera. Masat dhe veprimet u vlerësuan sipas rëndësisë që kishin për të anketuarit e anketës për të kontribuar në përmirësimin e kushteve të mjedisit të përbashkët. Prioritizimi është bërë në bazë të masave që kanë marrë prioritetin më të lartë, pra më shumë se 12 pikë në punëtorinë e parë për prioritizimin e masave. Duke përdorur pyetësorin Google publiku i gjerë pati mundësinë t'i jepte përparësi masave duke përdorur metodën e shkallëzimit (1 është më e ulëta në shkallë dhe 5 është më e larta) në pyetësorin me zgjedhje të shumëfishta. Në bazë të numrit të përgjigjeve të të anketuarve që kanë votuar për një projekt të caktuar si prioritet të lartë, është bërë vlerësimi i të gjitha projekteve lidhur me prioritetin për realizim.

Rezultatet e anketës janë analizuar, prezantuar dhe diskutuar më tej me përfaqësuesit komunalë. Procesi i konsultimit, duke përfshirë të dhëna nga palët e interesuara dhe publiku është përmbledhur në listën e sektorëve dhe masave prioritare që komuna duhet t'i zbatojë në të ardhmen e afërt. Rezultatet përfundimtare të prioritizimit të masave përshtatëse bazuar në të gjitha aktivitetet dhe punëtoritë e realizuara janë shpalosur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 1: Rezultatet e prioritizimit të masave përshtatëse

Sektori	Masa e propozuar	Vlerësimi sipas prioritetit
Ujërat	Përfundimi i rrjetit të ujësjellësit për ujë të pijshëm në Istog	87%
Ujërat	Përfundimi i ndërtimit të sistemit të ujërave të zeza (kanalet e ujërave të zeza)	87%
Energjia	Instalimi/vendosja e kablllove elektrike nëntokësore në kuadër	86%

	të rrjetit shpërndarës të energjisë elektrike	
Ujërat	Zëvendësimi i gypave të azbestit me ato të plastikës në rrjetin e ujësjellësit	85%
Ujërat	Studimi i fizibilitetit për impiantin për trajtimin e ujërave të zeza dhe ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza	85%
Mjedisi dhe biodiversiteti	Ndërtimi i qendrës për grumbullimin dhe transferin e mbeturinave	83%
Ndërtesat	Aplikimi i “kulmeve të sheshta” në zona me rrezik nga stuhitë e forta	80%
Transporti	Trajtimi i ujërave atmosferike përgjatë rrugëve	77%
Transporti	Studimi për rrugët e rrezikuara nga përmytjet dhe vërshimet dhe propozimi i masave mbrojtëse për zbatimin e tyre	77%
Bujqësia dhe Pylltaria	Pyllëzimi dhe ripyllëzimi	77%
Transporti	Mbrojtja e sipërfaqeve të rrugëve nga temperaturat e larta përmes mbjelljes së drurëve/pemëve që krijojnë hije	72%
Ujërat	Ndërtimi i digës së ujit në Istog	72%
Ujërat	Trajtimi i ujërave urbane në zonat rurale përmes projekteve të bazuara në zgjedhje natyrore	72%
Planifikimi Hapësinor dhe Menaxhimi i Tokës	Zhvillimi dhe zbatimi i konceptin të bazuar në lagje, duke u fokusuar në zonat e gjelbra, rekreative dhe sportive	72%
Ujërat	Rigjenerimi i burimeve ujore (Gurrat e Bardhë)	71%
Bujqësia dhe Pylltaria	Nxitja/promovimi i përdorimit të farave/fidanëve rezistente ndaj ndryshimeve klimatike	71%
Ekonomia dhe Turizmi	Krijimi i sistemi për mbrojtjen e turistëve dhe banorëve të zonave malore nga fatkeqësitë natyrore	71%
Ujërat	Rregullimi dhe renovimi i kanaleve të ujitjes dhe kullimi i tokave bujqësore	70%
Mbrojtja Civile dhe Emergjencat	Planifikimi dhe ndërtimi i stehimoreve emergjente	69%
Ujërat	Rritja e kapacitetit të tubit të furnizimit për rezervuarin e ujit	68%
Ekonomia dhe Turizmi	Akumulimi i ujit në zona turistike – malore (në shërbim të emergjencave, shuarjeve të zjarre, etj.)	67%
Mbrojtja Civile dhe Emergjencat	Krijimi i ekipeve vullnetare për rastet e emergjencave natyrore	67%
Ujërat	Ndërtimi i digës së ujit në Shushicë	64%
Mbrojtja Civile dhe Emergjencat	Trajnimi i ekipeve vullnetare për rastet e emergjencave natyrore	62%
Transporti	Ndërtimi i hijeve artificiale duke përdorur bimë të gjelbra	60%
Planifikimi Hapësinor dhe Menaxhimi i Tokës	Ndërtimi dhe shenjëzimi i shtigjeve ndërkufitare të ecjes në zonat malore	53%

### 3.9.2. Strategjia në rast të ngjarjeve ekstreme klimatike

Drejtoria për Emergjencat, Mbrojtje dhe Shpëtim të Komunitetit të Istogut, në kuadër të kompetencave, autorizimeve dhe përgjegjësisë ligjore, kujdeset për aspektin e sigurisë në zonat urbane dhe rurale



të qytetit, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, komunitetet lokale dhe Forumet e Sigurisë në Bashkësi. Drejtorja harton dhe azhurnon planet dhe projektet për fatkeqësitë natyrore dhe për fatkeqësitë tjera, në përputhje me ligjet dhe udhëzimet administrative nga niveli qendror dhe lokal. Drejtorja ndërmerr masa për të parandaluar, zvogëluar dhe eliminuar pasojat nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

Drejtorja reagon ndaj situatave të shkaktuara dhe merr masa mbrojtëse, zvogëlon situatën e shkaktuar nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera dhe siguron kushtet themelore për jetën. Për më tepër, organizon edhe trajnimin e njësive vullnetare të zjarrfikësve dhe të tjerëve për rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësitë tjera në bashkëpunim me Drejtorinë e Mbrojtjes nga Zjarret.

Drejtorja për Emergjencë, Mbrojtje dhe Shpëtim menaxhon sistemin e alarmit publik në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësitë tjera, i teston ato dhe merr informacione nga qytetarët dhe institucionet tjera komunale në qendrën e thirrjeve 0800 122 33 dhe 0800 122 44, i proceson dhe i dërgon ato sa më shpejt dhe efikas në personin ose institucionin përkatës 24/7. Në raste emergjente, drejtorja i propozon Kryetarit të Komunës shpalljen e gjendjes emergjente dhe propozon masat për përbalimin e situatës. Në raste të Fatkeqësive Natyrore dhe fatkeqësive tjera, merret me evakuimin dhe strehimin e qytetarëve nga zona e rrezikut; ajo kujdeset për mirëmbajtjen dhe funksionalizimin e strehimoreve publike.

Drejtorja menaxhon projektet në fushën e Emergjencave; mobilizon dhe aktivizon mekanizmat, strukturat dhe potencialin reagues për mbrojtje dhe shpëtim, angazhon kompanitë komunale, kompanitë e kontraktuara nga komuna dhe kompanitë tjera për intervenime emergjente në raste të Fatkeqësive Natyrore dhe Fatkeqësive tjera.

### 3.9.3. Varfëria energjetike

Komuna e Istogut ndodhet në veriperëndim të Kosovës. Istogu është një nga qytetet në këtë komunë dhe është një vend i rëndësishëm kulturor dhe historik në rajon. Komuna e Istogut përballet me një sfidë të madhe të ngjashme me komunat e tjera të Kosovës – çështjen e përhapur të varfërisë energjetike. Kjo gjendje e ndërlikuar, e thurur nga fijet e rritjes së kostove të energjisë, infrastrukturës së vjetruar dhe pajisjeve joefikase, i kapërcen thjesht implikimet ekonomike, duke ndikuar thellësisht në strukturën e familjeve dhe në jetën e përbashkët. Ndërsa Komuna e Istogut po përballet me këto sfida, përpjekjet e fokusuara janë duke u zhvilluar për të hartuar një kurs drejt zgjidhjeve të qëndrueshme që jo vetëm adresojnë shqetësimet e menjëhershme, por gjithashtu hedhin themelet për qëndrueshmëri afatgjatë.

Çështjet në lidhje me varfërinë energjetike mbulohen në legjislacione të ndryshme që lidhen me energjinë. Një nga rastet e para që trajton varfërinë energjetike është Direktiva 2009/72/EC e 13 korrikut 2009 mbi rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike dhe Direktiva 2009/73/EC e datës 13 korrik 2009 mbi rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit. Të dyja direktivat kërkojnë që Shtetet Anëtare (ShA) dhe Palët Kontraktuese (PK) të sigurojnë masa mbrojtëse të përshtatshme për konsumatorët në nevojë. Rrjedhimisht, çdo Shtet Anëtarë (ShA) dhe Palë Kontraktuese (PK), do të përcaktojnë konceptin e konsumatorëve në nevojë që mund t'i referohet varfërisë energjetike, në mes tjerash, ndalimit të ç'kryes së energjisë elektrike për këta konsumatorë në kohë kritike. Gjithashtu, SHA dhe PK do të marrin masat e duhura për të mbrojtur konsumatorët përfundimtarë në zonat e largëta që janë të lidhur me sistemin e energjisë elektrike

dhe/ose gazit. Legjislatiioni kërkon që SHA dhe PK të marrin masat e duhura, të tilla si formulimi i planeve kombëtare të veprimit për energjinë, sigurimi i përfitimeve në sistemet e sigurimeve shoqërore për të siguruar furnizimin e nevojshëm me energji elektrike/gaz për konsumatorët në nevojë, ose sigurimi i mbështetjes për përmirësimet e efikasitetit të energjisë, për të adresuar energjinë. Këto masa nuk duhet të pengojnë hapjen efektive të tregut <sup>1</sup>.

Mund të përkufizohet se: “varfëria energjetike është një situatë kur një person përpiqet shumë për ta mbajtur shtëpinë e tij të ngrohtë në mënyrë adekuate në dimër dhe të freskët në verë. Ata përpiqen shumë për të paguar faturat e energjisë elektrike, zakonisht jetojnë në shtëpi me ndriçim të dobët ose nuk janë në gjendje të përdorin pajisjet shtëpiake sipas nevojës. Atyre mund t'u mungojë - pjesërisht ose plotësisht - aksesin në rrjetin elektrik, duke u përjashtuar nga shoqëria dhe duke vuajtur pasoja negative si rezultat” <sup>2</sup>.

### **Varfëria energjetike në Kosovë**

Çështja e varfërisë energjetike në Kosovë ka marrë një vëmendje të madhe, siç është theksuar në Strategjinë Energjetike të Republikës së Kosovës 2022-2031. Skemat e reja, strukturat e çmimeve dhe masat legjislative po futen për të zbutur varfërinë energjetike, duke theksuar bashkëpunimin ndërmjet ministrive, organeve rregullatore dhe një spektri të gjerë aktorësh për të siguruar një përgjigje gjithëpërfshirëse dhe efektive.

Sipas Agjensisë së Statistikave të Kosovës, sipas të dhënave të vitit 2017, tregohet se 43% e amvisrive në Kosovë nuk kanë patur mundësi të paguajnë shërbimet komunale dhe faturat të paktën dy herë gjatë vitit dhe një pjesë afërsisht e njëjtë nuk kanë mundur të përballojnë ngrohjen e mjaftueshme të shtëpive të tyre gjatë sezonit të dimrit <sup>3</sup>. Sipas Ligjit për Energjinë Elektrike Nr. 05/L-085 përkufizohet se **Konsumator në nevojë**, është një konsumator familjar, i cili për shkak të gjendjes sociale gëzon disa të drejta të veçanta lidhur me furnizimin me energji elektrike, të siguruar në raste përjashtimore sipas përcaktimeve të këtij ligji. Në paragrafin 1 të nenit 49 në të njëjtin ligj, thuhet: Ministria përgjegjëse për mirëqenie sociale, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për energji, Ministrinë e Financave dhe në konsultim me Rregullatorin dhe hisedarët tjerë në sektorin e energjisë elektrike, duhet të zhvillojë një program të detajuar për përcaktimin e statusit të konsumatorëve në nevojë, fushëveprimit të të drejtave të tyre, si dhe masave që kanë për qëllim mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë në mbulimin e kërkesës së tyre për energji elektrike. Kurse, në paragrafin 2 të të njëjtin nen thuhet se Programi i trajtimit të konsumatorëve në nevojë i përcaktuar në paragrafin 1. të këtij neni do të aprovohet nga Qeveria dhe paraqet elementet mbi bazën e të cilave mund të përfshihet në program konsumatori në nevojë.

### **Sfidat dhe angazhimi i komunës**

Brenda Istogut, banorët ballafaqohen me sfida sikur që janë: pabarazitë në të ardhura, shpenzime të mëdha të energjisë, ndërtesa joeficiente dhe qasje e kufizuar në zgjidhjet moderne të energjisë. Si përgjigje, liderët komunalë të Istogut demonstrojnë përkushtim ndaj një strategjie gjithëpërfshirëse të harmonizuar me idealet evropiane, duke u përpjekur për energji të qëndrueshme, të sigurt dhe të

---

<sup>1</sup> Study on Addressing Energy Poverty in the Energy Community Contracting Parties. DOOR, EIHP December 2021, Zagreb

<sup>2</sup> Po aty

<sup>3</sup> Energy Poverty in Kosovo, Impact Assessment of Energy Poverty on Vulnerable Groups in Kosovo. Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Office in Kosovo 2022

përballueshme për të gjithë. Ky përkushtim manifestohet përmes veprimeve të prekshme që synojnë transformimin e peizazhit energjetik të Istogut dhe nxitjen e mirëqenies socio-ekonomike.

### **Furnizimi me Energji Elektrike:**

Për të adresuar sfidat e furnizimit me energji elektrike, Istogu aktualisht është duke kaluar nëpër një rinovim të rëndësishëm të infrastrukturës, me fokus strategjik në minimizimin e humbjeve në transmision, integrimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë. Ngjashëm me komunat tjera të Kosovës, iniciativat përqendrohen gjithashtu në promovimin e pajisjeve me efikasitet të energjisë, me bashkëpunime me shitësit me pakicë që sigurojnë përmbushjen e objektivave të dyfishtë të përballueshmërisë dhe qëndrueshmërisë.

### **Pajisjet me efikasitet të lartë energjetike:**

Iniciativat për të promovuar përdorimin e pajisjeve me efikasitet më të lartë energjetike shtrihen përtej fushatave dhe stimujve ndërgjegjësues. Bashkëpunimet me shitësit me pakicë dhe prodhuesit po nxisin disponueshmërinë e pajisjeve të përballueshme, me efikasitet të lartë, duke lehtësuar barrën financiare për familjet dhe duke kontribuar ndjeshëm në qëndrueshmërinë ekonomike dhe mjedisore.

### **Integrimi i Energjisë së Ripërtëritshme:**

Në harmoni me përpjekjet më të gjera rajonale, Komuna e Istogut është duke eksploruar në mënyrë aktive mundësitë për integrimin e pandërprerë të burimeve të ripërtëritshme të energjisë, si energjia diellore, e ujit dhe e erës. Kjo lëvizje strategjike jo vetëm që diversifikon përzjerjen e energjisë, por gjithashtu rrit sigurinë energjetike, duke kontribuar në një infrastrukturë energjetike më të qëndrueshme dhe elastike që përputhet me qëllimet globale mjedisore. Suksesi i iniciativave energjetike të Komunës së Istogut varet nga angazhimi i fuqishëm i komunitetit, programet arsimore dhe bashkëpunimi me një grup të ndryshëm të palëve të interesuara. Partneritetet me furnizuesit e energjisë, institucionet kërkimore dhe bizneset lokale luajnë një rol kyç në zbatimin e zgjidhjeve të qëndrueshme, promovimin e pronësisë komunale dhe sigurimin e një qasjeje me përputhje të përgjithshme për zbutjen e varfërisë energjetike.

### **Veprimet për luftimin e varfërisë energjetike**

Plani gjithëpërfshirës i veprimit i Komunës së Istogut përfshin një qasje të shumëanshme, duke përfshirë monitorimin e treguesve kyç, rritjen e efikasitetit të energjisë në familjet e cenueshme dhe përdorimin e teknologjisë për ndërhyrje në kohë reale. Programet proaktive të asistencës financiare synojnë në mënyrë strategjike përmirësimet e efikasitetit të energjisë dhe rritjen e përdorimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë, me qëllimin përfundimtar të reduktimit të shpenzimeve të energjisë shtëpiake dhe rritjen e niveleve të të ardhurave.

### **Kuadri Ligjor dhe Mbrojtja e Konsumatorit:**

Ligji për Energjinë Elektrike në Kosovë shërben si gur themeli për përcaktimin e konsumatorëve në nevojë dhe mandaton zhvillimin e një programi të detajuar për mbrojtjen e tyre. Bashkëpunimi ndërmjet ministrive, organeve rregullatore dhe aktorëve të tjerë jo vetëm që inkurajohet, por konsiderohet thelbësor për zbatimin e programeve gjithëpërfshirëse që sigurojnë qasje në energji elektrike për ata që kanë nevojë. Ky kuadër ligjor nënvizon përkushtimin për mbrojtjen e

konsumatorit dhe vendos terrenin për masa proaktive për të adresuar sistematikisht varfërinë energjetike.

#### Bashkëpunimi i Komunitetit të Energjisë:

Në përputhje me kërkesat e Komunitetit të Energjisë për adresimin e varfërisë energjetike, Komuna e Istogut angazhohet në mënyrë aktive në bashkëpunimin rajonal. Komuniteti i Energjisë thekson rëndësinë e zhvillimit të strategjive dhe masave nga shtetet anëtare për të trajtuar në mënyrë gjithëpërfshirëse varfërinë energjetike. Komuna e Istogut përfiton nga ky bashkëpunim duke shkëmbyer njohuritë, praktikatat më të mira dhe njohuritë me shtetet e tjera anëtare, duke pasuruar qasjen e saj për luftimin e varfërisë energjetike me perspektiva rajonale.

#### Masat dhe sfidat aktuale:

Përkundër zbatimit të një programi të ndihmës financiare në Kosovë, çështjet strukturore vazhdojnë, duke nënvizuar domosdoshmërinë për masa më të gjera sistematike që adresojnë faktorët e ndryshëm që kontribuojnë në varfërinë energjetike në Komunën e Istogut. Sfidat kërkojnë një përpjekje të kujdesshme dhe të qëndrueshme për të kapërcyer pengesat dhe për të siguruar efektivitetin e nismave të vazhdueshme dhe të ardhshme.

#### Adresimi i sfidave sistematike:

Përtej përmirësimeve të infrastrukturës, adresimi i sfidave sistematike përfshin nxitjen e një kulture të vetëdijes për energjinë. Programet arsimore duhet të shtrihen në shkolla dhe qendra komunitare, duke e pajisur brezin e ri me njohuri për të çuar përpara praktikatat e qëndrueshme. Për më tepër, partneritetet me bizneset lokale mund të përdoren për të krijuar mundësi punësimi në sektorin e energjisë së ripërtërishme, duke adresuar njëkohësisht zvogëlimin e papunësisë dhe duke promovuar praktikat e qëndrueshme.

#### Përfundimi:

Trajtimi efektiv i varfërisë energjetike në Komunën e Istogut kërkon një qasje gjithëpërfshirëse dhe bashkëpunuese, duke u mbështetur në përkushtimin e zyrtarëve komunalë dhe masat specifike që pasqyrojnë iniciativat e suksesshme. Komuna e Istogut jo vetëm që përballlet me një çështje kritike, por gjithashtu shfaqet si një dritare për zhvillim të qëndrueshëm urban, duke përfituar nga masat bashkëpunuese brenda Komunitetit të Energjisë dhe duke shfaqur qëndrueshmëri dhe stabilitet në kontekstin më të gjerë rajonal. Korniza bashkëpunuese me Komunitetin e Energjisë pasuron qasjen e Istogut ndaj varfërisë energjetike, duke siguruar që ai të mbetet në ballë të zhvillimit të qëndrueshëm brenda peizazhit rajonal.

## 4. INVENTARI BAZË I EMETIMEVE (IBE)

Inventarit Bazë të Emetimeve (IBE) përbën një nga elementet e detyrueshme të Planit të veprimit për energji të qëndrueshme dhe klimë – PVEQK (angl. SECAP - Sustainable Energy and Climate Action Plan) dhe aspektin kyç në përmbushjen e angazhimeve sipas kërkesave të Iniciativës së Marrëveshjes së Kryetarëve të Komunave (angl. Covenant of Mayors Initiative). IBE është zhvilluar në bazë të

informacionit të besueshëm në lidhje me konsumin/prodhimin e energjisë dhe emetimet e gazrave serrë (GS) në territorin e Komunës së Istogut.

IBE dhe inventarizimi i mëtejshëm i emetimeve të CO<sub>2</sub> përbëjnë vegëlën kryesore që u mundëson autoriteteve komunale të përcaktojnë masat prioritare dhe eficiencën e masave të zbatuara prej tyre, që synojnë reduktimin e emetimit të gazeve serrë.

**Metodologjia** për përpilimin e BEI-së bazohet në udhëzimet dhe rekomandimet e Udhëzuesit “Hoë to develop a Sustainable Energy and Climate Action Plan (SECAP)”, Part 2 – Baseline Emission Inventory (BEI) and Risk and Vulnerability Assessment (RVA), 2018.

Procesi për zhvillimin e IBE-së ka përfshirë vlerësimin e gjendjes aktuale për sektorët në aspektin e konsumit të energjisë dhe emetimeve të GS për territorin e Komunës së Istogut, ku janë identifikuar dokumentet më të rëndësishme zhvillimore komunale dhe strategjitë sektoriale për identifikimin e burimeve të të dhënave sipas sektorëve komunal që janë relevante për emetimet e GS.

Për përcaktimin e emetimeve **është përdorur çasja e bazuar në aktivitetet e sektorëve**. Kjo metodë ka përparësi për shkak të disponueshmërisë së të dhënave për kompletimin e IBE. Metoda e bazuar në aktivitete përfshinë emetimet që ndodhin gjatë djegies së lëndëve djegëse dhe bazohet në faktorët e emetimeve që përdoren nga IPCC dhe në raste të vecanta edhe faktorët nacional të emetimeve.

Në këtë inventar, janë konsideruar tre GS më jetëgjatë: CO<sub>2</sub>, CH<sub>4</sub> dhe N<sub>2</sub>O. **Llojet e emetimeve** të GS që janë përfshirë në IBE, janë: **emetimet e drejtëpërdrejta** ato që fizikisht ndodhin nga burimet e emetuesve brenda territorit administrativ të komunës, **emetimet indirekte** që përfshin konsumin e energjisë të shpenzuar por jo të prodhuar brenda territorit të Komunës.

**Viti bazë i inventarit** është caktuar bazuar në metodologjinë e IPCC 2006 dhe të Kornizës së raportimit të Marrëveshjes së Kryetarëve të Komunave (Covenante of Mayors). Kriteri kryesor në përzgjedhjen e vitit bazë është disponueshmëria e të dhënave të nevojshme për llogaritjen e emisioneve të GS që në këtë raport janë prezantuar si CO<sub>2</sub> equivalent. Bazuar në konsultimet e bëra, viti bazë i inventarit të emetimeve për Komunën e Istogut është caktuar të jetë viti 2017.

BEI përfshin emetimet nga tre sektorët e konsumit final të energjisë në Komunë: sektorin e ndërtesave, të transportit dhe ndriçimit publik, në përputhje me klasifikimin e sektorëve në rekomandimet e Marrëveshjes së Kryetarëve. Llogaritja përfshin emisionet e drejtëpërdrejta (nga djegia e karburanteve) dhe emisionet jo të drejtëpërdrejta (nga energjia elektrike dhe konsumi i energjisë termike për ngrohje).

#### 4.1. Inventari referent për emetimet e CO<sub>2</sub> në ndërtesa

Inventari për sektorin e ndërtesave përfshinë emetimet nga ndërtesat publike komunale, ndërtesat e ndërmarrjeve publike, ndërtesat e shërbimeve private (ndërtesat terciare jo komunale) dhe ndërtesat rezidenciale (ndërtesat e banimit).

**Ndërtesat publike** përfshijnë të gjitha ndërtesat që janë në pronësi komunale apo që menaxhohen nga komuna dhe shpenzimet energjetike paguhen prej saj. Këtu hyjnë, ndërtesat e administrates publike, ndërtesat arsimore, ndërtesat e shëndetësisë, ndërtesat e kulturës, trashëgimisë kulturore e ndërtesat dhe objektet sportive. Inventari i emetimeve të GS për këto ndërtesa është llogaritur në bazë të konsumit të energjisë, që përfshin energjinë elektrike dhe lëndët djegëse të shpenzuara nga këto ndërtesa në vitin bazë.

**Ndërtesat terciare jo komunale** përfshijnë ndërtesat e shërbimeve private si, furrat, restorantet, kafeteritë, zyrat, dyçanet, depot, hotelet dhe spitalet e sektorit privat. Analiza e konsumit të energjisë dhe emetimet e GS janë bazuar në të dhënat nga studimi i Fondacionit Kosovar të Mijëvjeçarit: “Furnizimi i menaxhimit të projektit, menaxhimi i informacioneve për cilësinë e ajrit, ndryshimi i sjelljes dhe shërbimet e komunikimit” dhe përfshijnë të dhëna për energjinë nga biomasa (dru zjarri dhe pelet), GLN, qymyri dhe vaji për ngrohje (dizeli) janë përdorur për llogaritjen e energjisë së shpenzuar dhe emetimeve të GS. Ndërsa, konsumi i energjisë elektrike është marrë nga KEDS/KESCO përmes institucionit komunal.

Edhe të dhënat për **sektorin rezidencial** janë marrë dhe përpunuar nga i njëjti burim, pra Analiza e konsumit të energjisë dhe emetimet e GS janë bazuar në të dhënat nga studimi i Fondacionit Kosovar të Mijëvjeçarit: “Furnizimi i menaxhimit të projektit, menaxhimi i informacioneve për cilësinë e ajrit, ndryshimi i sjelljes dhe shërbimet e komunikimit”, kurse të dhënat për konsumin e energjisë elektrike për vitin bazë, 2017, janë marrë nga KEDS/KESCO. Sektori rezidencial, është sektori që ka konsumin më të madh të energjisë krahasuar me sektorët tjerë.

Një përmbledhje e konsumit të energjisë për sektorin e ndërtesave është prezantuar në tabelën 2.

Tabela 2. Përmbledhja e konsumit të energjisë për sektorin e ndërtesave

		KONSUMI FINAL I ENERGJISË [MWh]				BRE	
		Lëndët djegëse fosile					
Sektori	Energjia elektrike	GLN	Dizel	Benzinë	Linjit	Biomasa drusore	Gjithsej
Ndërtesat publike komunale, pajisjet dhe objektet	564.1		763.3	2.3	1513.7	4109.0	<b>6,952.4</b>
Ndërtesat terciare (jo komunale), pajisjet dhe objektet	12580.1	7746.5	2868.4			25169.4	<b>48,364.4</b>
Ndërtesat rezidenciale	42636.6	3512.0			845.9	189790.9	<b>236,785.3</b>
<b>Total</b>	<b>55,780.7</b>	<b>11,258.5</b>	<b>3,631.7</b>	<b>2.28</b>	<b>2,359.6</b>	<b>219,069.3</b>	<b>292,102.1</b>

Llogaritja e emetimeve të CO<sub>2eq</sub> për sektorin e ndërtesave, pajisjeve dhe objekteve është bazuar në energjinë e shpenzuar sipas lëndëve djegëse dhe faktorëve të emetimeve. Të dhënat për faktorët e emetimeve sipas IPCC dhe faktorët kombëtarë të emetimeve janë prezantuar në tabelën 3.

Tabela 3. Vlerat kalorifike neto të paracaktuara dhe faktorët e emetimeve të CO<sub>2</sub> sipas IPCC, 2006 dhe faktorët kombëtarë

Lloji i lëndës djegëse	Vlera kalorifike neto [TJ/Gg]	Vlera kalorifike neto [MWh/t]	Vlera kalorifike neto [MWh/m <sup>3</sup> ]	Faktori i emetimeve të CO <sub>2</sub>		Faktori i emetimeve të CO <sub>2ek</sub> (*), [t/MWh]
				[kg/TJ]	[t/MWh]	
Linjiti	11.9	3.3		101000	0.364	0.365
Biomasa					0	0.007
Dizeli (nafta)	43.0	11.9	9.758	74100	0.267	0.268
Benzin	44.3	12.3	9.102	69300	0.249	0.250
Gaz i lëngëzuar i naftës (GLN)	47.3	13.1	5.458	63100	0.227	0.227
Mazut	40.4	11.2	9.856	77400	0.279	
Energjia elektrike					1.131 <sup>(5)</sup>	

Emetimet e CO<sub>2eq</sub> të këtij sektori janë llogaritur **69,003.7**CO<sub>2eq</sub> për vitin 2017 (tabela 4).

Tabela 4. Emisionet e GS [tCO<sub>2eq</sub>] për sektorin e ndërtesave, pajisjeve dhe objekteve

Sektori	Lëndët djegëse fosile					BRE	Gjithsej
	Energjia elektrike	GLN	Dizel	Benzinë	Linjit	Biomasa drusore	
Ndërtesat publike komunale, pajisjet dhe objektet	637.9	0	204.6	0.6	552.5	28.8	1,424.3
Ndërtesat terciare (jo komunale), pajisjet dhe objektet	14,226.1	1758.5	768.7			176.2	16,929.5
Ndërtesat rezidenciale	48,215.3	797.2			308.8	1,328.5	50,649.9
<b>Totali</b>	<b>63,079.4</b>	<b>2,555.7</b>	<b>973.3</b>	<b>0.6</b>	<b>861.3</b>	<b>1,533.5</b>	<b>69,003.7</b>

#### 4.2. Inventari referent për emetimet e CO<sub>2</sub> në transport

Ky sektor përfshinë emetimet nga flota komunale e makinave, transportin publik, makinat private dhe ato komerciale.

**Flota komunale e makinave** i përfshin të gjitha makinat në pronësi ose të përdorura nga autoritetet komunale. Të dhënat për konsumin e energjisë janë siguruar nga autoritetet komunale. Lënda djegëse për ngasjen e makinave të flotës komunale është dizeli, ndërsa sasia e energjisë e konsumuar nga dizeli është 35,220.00 litër apo 343 MWh, për vitin 2017.

**Transporti publik** përfshinë autobusët komercial dhe transport tjetër të përdorur për transportin e udhëtarëve. Sipas të dhënave nga autoritetet komunale për transport publik: autobusë, kombibusë dhe makinat taxi në territorin e komunës, janë shpenzuar gjithsej 330,000.00 litër naftë (dizel) apo 3,220.14 MWh për vitin bazë.

**Makinat private dhe komerciale** i përfshijnë makinat private të udhëtarëve dhe makinat tjera që i referohen transportit të personave dhe të mirave materiale. Të dhënat për llogaritjen e energjisë së shpenzuar dhe të llogaritjes së emetimeve janë bazuar në të dhënat nga studimi i Fondacionit Kosovar të Mijëvjeçarit: "Furnizimi i menaxhimit të projektit, menaxhimi i informacioneve për cilësinë e ajrit, ndryshimi i sjelljes dhe shërbimet e komunikimit". Të dhënat lidhur me numrin e makinave të regjistruara janë siguruar nga autoritetet komunale të Istogut. Konsumi i lëndëve

<sup>4</sup> Udhëzuesi për Planin e qëndrueshëm të veprimit për energji dhe klimë i Marrëveshjes së Kryetarëve

<sup>5</sup> E llogaritur në bazë të përzierjes energjetike për energjinë elektrike në Kosovë, bazuar në emetimet nga "Bilanci vjetor i energjisë elektrike dhe termike për vitin 2017", Zyra e rregullatorit të energjisë (ZRRE) e Kosovës.

djegëse nga transporti privat dhe komercial është: naftë 13,119,854.07 litër, benzinë 853,892.19 litër dhe GLN 2,057.87 ton, që shprehur në energji është gjithsej 128,023.54 MWh/vit.

Konsumi i energjisë sipas kategorive të sektorit të transportit është prezantuar në tabelën 5.

Tabela 5. Konsumi i energjisë për sektorin e transportit

Kategoria	Energjia elektrike	GLN	Dizel	Benzinë	Gjithsejt
Flota komunale e makinave	0	0	343.7	0	<b>343.68</b>
Transporti public	0	0	3220.1	0	<b>3,220.14</b>
Transporti privat dhe komercial	0	11.2	128023.5	7772.1	<b>135,806.90</b>
<b>Totali</b>	<b>0</b>	<b>11.23</b>	<b>131,587.4</b>	<b>7772.1</b>	<b>139,370.7</b>

Llogaritja e emetimeve të CO<sub>2eq</sub> për sektorin e transportit është bazuar në energjinë e shpenzuar sipas lëndëve djegëse dhe faktorëve të emetimeve (tabela 4). Emetimet e përgjithëshme të CO<sub>2eq</sub> për territorin e komunës për sektorin e transportit janë: **37,211 tCO<sub>2eq</sub>** (tabela 6).

Tabela 6. Emisionet e GS[tCO<sub>2eq</sub>] për sektorin e transportit për komunën e Istogut

Kategoria	Energjia elektrike	GLN	Dizel	Benzinë	Gjithsejt
Flota komunale e makinave	0	0	92.1		92.1
Transporti public	0	0	863.0		863.0
Transporti privat dhe komercial	0	0	34310.3	1,943.0	36,255.9
<b>Totali</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>35265.4</b>	<b>1,943.0</b>	<b>37,211.0</b>

#### 4.3. Inventari referent për emetimet e CO<sub>2</sub> në ndriçim publik

Ndriçimi publik në pronësi ose që operohet nga autoritetet komunale, përfshinë ndriçimin e rrugëve, hapësirave publike dhe dritat e trafikut. Të dhënat e përdorura për analizë janë marrë nga KEDS/KESCO përmes institucionit komunal. Sipas këtyre të dhënave, konsumi i energjisë elektrike nga ndriçimi publik për vitin 2017 është 197.8 MWh. Ndërsa emetimet e e përgjithëshme CO<sub>2eq</sub> të këtij sektori janë 223.7tCO<sub>2eq</sub>.

#### 4.4. Inventari i përgjithëshëm referent për emetimet e CO<sub>2</sub> në Komunën e Istogut

##### 4.4.1. Konsumi i përgjithëshëm i enegjisë në Komunën e Istogut

Përmbledhja e përgjithëshme e konsumit të energjisë për komunën e Istogut sipas sektorëve, për vitin 2017 është treguar në tabelën 8. Makro-sektori me konsumin më të madh është ai i ndërtesave me konsum 292,299.9 MWh, dhe pastaj makro-sektori i transportit me 139,370.7 MWh. Sipas sektorëve të aktiviteteve, ai rezidencial ka konsumin më të madh prej 236,785.37 MWh apo 54.33%



të konsumit të përgjithshëm, pas tij vjen transporti me 139,370.71 MWh apo 31.98%, dhe mandej ndërtesat terciare me 48,364.38 MWh apo 11.1 % (figura 4).

Tabela 7. Përmbledhja e konsumit total të energjisë sipas sektorëve për vitin 2017

Sektori	KONSUMI FINAL I ENERGJISË [MWh]							Gjithsej
	Energjia elektrike	Lëndët djegëse fosile				BRE	Gjithsej	
		GLN	Dizel	Benzinë	Linjit	Biomasa drusore		
<b>NDËRTEASAT, PAJISJET DHE OBJEKTET</b>								
Ndërtesat publike komunale, pajisjet dhe objektet	564.1		763.3	2.3	1513.7	4109.0	<b>6,952.4</b>	
Ndërtesat terciare (jo komunale), pajisjet dhe objektet	12580.1	7746.5	2868.4			25169.4	<b>48,364.4</b>	
Ndërtesat rezidenciale	42636.6	3512.0			845.9	189790.9	<b>236,785.3</b>	
Ndriçimi public	197.8						<b>197.8</b>	
<b>Nën totali</b>	<b>55,978.5</b>	<b>11,258.5</b>	<b>3,631.7</b>	<b>2.28</b>	<b>2,359.6</b>	<b>219,069.3</b>	<b>292,299.9</b>	
<b>TRANSPORTI</b>								
Flota komunale e makinave			343.7				<b>343.68</b>	
Transporti public			3220.1				<b>3,220.14</b>	
Transporti privat dhe komercial		11.2	128023.5	7772.1			<b>135,806.90</b>	
<b>Nën totali</b>		<b>11.23</b>	<b>131,587.4</b>	<b>7772.1</b>			<b>139,370.7</b>	
<b>TË TJERA</b>								
Bujqësia dhe pylltaria			4,128.5				<b>4128.45</b>	
<b>Gjithsej</b>	<b>55,978.50</b>	<b>11,269.7</b>	<b>139,347.5</b>	<b>7,774.4</b>	<b>2,359.6</b>	<b>219,069.3</b>	<b>435,799.0</b>	




Figura 4. Shpërndarja e konsumit të energjisë sipas sektorëve

Prodhimi lokal i energjisë në Komunën e Istogut është prodhimi i energjisë elektrike nga HC “Burimi” dhe prodhimi i energjisë elektrike nga impianti i energjisë diellore PV “Onix”. Prodhimi i energjisë elektrike në territorin e komunës është 1602 MWh/vit, ndërsa konsumi është 55,979.0 MWh/vit. Në territorin e komunës nuk ka sistem të ngrohjes në distance.

#### 4.4.2. Inventari i përgjithshëm referent për Komunën e Istogut

Emetimet e përgjithshme të CO<sub>2eq</sub> janë përmbledhur në tabelën 9. Sipas llogaritjeve, sektori i aktiviteteve me emetimet më të mëdha është ai i rezidencial me 518,159.0 tCO<sub>2eq</sub>, pas tij vjen sektori i transportit me 253,151.81 tCO<sub>2eq</sub>, pastaj sektori i ndërtesave terciare me emetime në sasi prej 246,778.68 tCO<sub>2eq</sub> (figura 5).

Tabela 8. Përmbledhje e inventarit total të emisionit bazë të GS në Komunën e Istogut për vitin 2017

Sektori	EMETIMET FINALE [tCO <sub>2eq</sub> ]							Gjithsej
	Lëndët djegëse fosile					BRE		
	Energjia elektrike	Ngrohja e qytetit	GLN	Dizel	Benzin ë	Linjit	Biomasa drusore	
<b>NDËRTEASAT, PAJISJET DHE OBJEKTET</b>								
Ndërtesat publike komunale, pajisjet dhe objektet	637.9	0	0	204.6	0.6	552.5	28.8	1,424.3
Ndërtesat terciare (jo komunale), pajisjet dhe objektet	14,226.1	0	1758.5	768.7	0		176.2	16,929.5

Ndërtesat rezidenciale	48,215.3	0	797.2	0	0	308.8	1,328.5	50,649.9
Ndriçimi public	223.7	0		0	0			223.7
<b>Nën totali</b>	<b>63,303.1</b>	<b>0</b>	<b>2,555.7</b>	<b>973.3</b>	<b>0.6</b>	<b>861.3</b>	<b>1,533.5</b>	<b>69,227.4</b>
<b>TRANSPORTI</b>								
Flota komunale e makinave	0		0	92.1	0			92.1
Transporti publik	0		0	863.0	0			863.0
Transporti privat dhe komercial	0		0	34310.3	1,943.0			36,255.9
<b>Nën totali</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>35265.4</b>	<b>1,943.0</b>			<b>37,211.0</b>
<b>TË TJERA</b>								
Bujqësia, pylltaria, shfrytëzimi i tokës	0			1.106.4				1.106.4
<b>TË TJERA QË NUK LIDHEN ME ENERGJI</b>								
<b>Gjithsej</b>	<b>63,303.1</b>		<b>2,558.2</b>	<b>37,345.1</b>	<b>1,943.6</b>	<b>861.3</b>	<b>1533.5</b>	<b>107,544.8</b>




Figura 5. Emetimet e përgjithëshme të CO<sub>2eq</sub> sipas sektorëve në bazë të pjesmarrjes në përqindje

## 5. VLERËSIMI I RREZIKUT DHE CENUESHMERISE (VRC)

Vlerësimi i cenueshmërisë dhe rrezikut ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike (RVA) për zonën administrative të qytetit të Istogut paraqet bazën për krijimin e një plani veprimi për zhvillim të qëndrueshëm dhe ndryshime klimatike për Istogn.

Metodologjia u bazua në kriteret e përcaktuara nga Marrëveshja e Kryetarëve të Komunave për udhëzimet për klimën dhe energjinë. RVA analizon tre komponentë kryesorë:

- Karakteristikat e rrezikut klimatik (shikon ngjarjet ose tendencat fizike të lidhura me klimën dhe ndikimet e tyre fizike. Eksploron nivelin aktual të rrezikut të këtyre rreziqeve dhe ndikimet e prishme bazuar në parashikimet e ndryshimeve klimatike);
- Ekspozimi (identifikon elementë p.sh. njerëzit, mjetet e jetesës, speciet ose ekosistemet, shërbimet etj., që ndodhen në vende dhe mjedise që mund të ndikohen negativisht. Kuptimi i dimensionit hapësinor të ekspozimit do të jetë i rëndësishëm. Harta e ekspozimit e mbështet në masë të madhe këtë proces;
- Cenueshmëria është funksion i ndjeshmërisë dhe kapacitetit adaptues të njerëzve. Ndjeshmëria vlerëson shkallën në të cilën një sistem ose specie ndikohet, qoftë negativisht ose përfituese nga ndryshueshmëria klimatike e ndryshimit. Kapaciteti adaptiv vlerëson aftësinë e sistemeve, institucioneve, njerëzve dhe organizmave të tjerë për t'u përshtatur me dëmtimin e mundshëm për të përfituar nga mundësitë ose për t'u përgjigjur pasojave.

Korniza metodologjika bazohet në metodologjinë e përcaktuar nga udhëzimet: Libri i Burimeve të Vulnerabilitetit dhe Shtojca më e re e Rrezikut, të cilat janë në përputhje me Raportin Sintezë të IPCC AR5.

### 5.1. Të dhënat klimatike për Komunën e Istogut

**Reshjet** - Që nga viti 1930 e deri më sot ne Kosovë ka pasur një ndryshim në sasinë e reshjeve me një tendencë për ulje të sasisë së reshjeve (figura 6). Temperatura mesatare vjetore e reshjeve për periudhën 1930-1990 ishte 820 mm, ndërsa për periudhën 190-2021 ishte 680 mm. Ndërsa figura 7 tregon se ka luhatje në sasinë totale të reshjeve nga viti në regjionin e Pejes. Te dhenat i referohen stacionit meteorologjik ne Peje, meqense ne Istogu nuk ka stacion meteorologjik. Reshjet janë mjaft në rënie në verë, ndërsa janë në rritje në të gjitha stinët e tjera.




Figura 6. Reshjet mesatare vjetore (mm) ne Kosove 1900-2021




Figura 7. Reshjet mesatare vjetore (mm) ne Peje 2002-2021

Temperaturat - Rritjet e temperaturës janë evidente sidomos nga vitet '80. Të dhënat e IHMK-së, evidentojnë se në Pejës ka pasur lëvizje të temperaturave mesatare vjetore me trend të rritjes. Analiza e tendencave sezonale evidentoi se temperatura e kapelës është në rritje në të gjitha stinët.

Tabela 9: Temperaturat maksimale vjetore në rajonin e Pejës

Stacioni meteorologjik I Pejës					
Viti	Temperaturat maksimale te vitit	Viti	Temperaturat maksimale te vitit	Temperaturat maksimale te vitit	Temperaturat maksimale te vitit
<b>2009</b>	16.0	<b>2013</b>	17.2	<b>2017</b>	17.1
<b>2010</b>	17.2	<b>2014</b>	17.3	<b>2018</b>	17.4
<b>2011</b>	15.1	<b>2015</b>	16.6	<b>2019</b>	17.5
<b>2012</b>	17.4	<b>2016</b>	16.9	<b>2020</b>	18.0

Tabela 10: Temperaturat minimale vjetore në rajonin e Pejës

Stacioni meteorologjik I Pejës					
Viti	Temperaturat minimale te vitit	Viti	Temperaturat minimale te vitit	Viti	Temperaturat minimale te vitit
<b>2009</b>	7.5	<b>2013</b>	8.6	<b>2017</b>	8.1
<b>2010</b>	6.4	<b>2014</b>	6.9	<b>2018</b>	7.8
<b>2011</b>	5.0	<b>2015</b>	7.6	<b>2019</b>	6.8
<b>2012</b>	6.8	<b>2016</b>	6.3	<b>2020</b>	7.4

Era - Gjatë periudhës 2008-2019 janë regjistruar mesatare vjetore të shpejtësisë së erës pothuajse konstante pa ndonjë ndryshim të theksuar. Viti 2015 shënon vitin me shpejtësinë mesatare vjetore të erës me të vogël 0.5 m/s ndërsa vitet 2011 dhe 2013 me shpejtësinë më të madhe mesatare vjetore 1.3 m/s (tabela 11).

Tabela 11: Era mesatare vjetore në rajonin e Pejës

Stacioni meteorologjik ne Peje					
Viti	Era mesatare (m/s)	Viti	Era mesatare (m/s)	Viti	Era mesatare (m/s)
<b>2008</b>	0.7	<b>2012</b>	1.3	<b>2016</b>	0.9
<b>2009</b>	0.9	<b>2013</b>	1.3	<b>2017</b>	0.7
<b>2010</b>	1.2	<b>2014</b>	0.8	<b>2018</b>	0.7
<b>2011</b>	1.3	<b>2015</b>	0.5	<b>2019</b>	0.9

**Parashikimet** - Nuk ka parashikime për ndryshimet klimatike në veçanti për Istogun. Meqenëse të dhënat historike të klimës specifike për Kosovën janë gjithashtu të kufizuara, parashikimet e përdorura janë ato që janë të zbatueshme për rajonin e Ballkanit Perëndimor. Vlerësimi i parashikimeve të ndryshimeve klimatike u realizua përmes përdorimit të të dhënave të disponueshme nga studimi për ndryshimet klimatike në rajonin e Ballkanit Perëndimor në vitin 2018<sup>6</sup>. Për të vlerësuar ndikimin e ngrohjes globale në ndryshimet klimatike në të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor, janë zgjedhur dy parametra meteorologjikë: temperatura T (temperatura e verës në qershor-korrik-gusht: QKG) dhe reshjet P (akumulimi ditor). Vlerat ditore për periudhën 1961-2015 janë analizuar duke përcaktuar periudhën 1961-1980 si periudhën klimatike "të shkuar", dhe 1996-2015 si periudhën klimatike "të tashme".

Vlerësimi i përgjithshëm i vulnerabilitetit dhe rrezikut të ekonomive në rajonin e Ballkanit Perëndimor (BP) ofroi gjithashtu njohuri në çështjet e përbashkëta të lidhura me ndryshimet klimatike. Prioritetet e BP për tu përshtatur me ndryshimet klimatike dhe për të zbutur ndikimet e tyre u përcaktuan udhëhequr nga analiza e kryer mbi Studimin e Ndryshimeve Klimatike në Rajonin e Ballkanit Perëndimor (Maj 2018), mbështetur nga Strategjia për Europën Juglindore (SEE) 2020 (2013) dhe Raporti i Pestë i Vlerësimit të Panelit Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike (IPCC AR5, 2014). Sipas sjelljes aktuale të njeriut, u përzgjedhën si më të mundshëm dy skenarë të emetimeve globale të Gazrave Serrë, të përfaqësuar nga skenarët e Mënyrave të Përfaqësimit të Përqëndrimeve (RCP) të IPCC AR5, për të shënuar pragjet e ulëta dhe të larta për ndryshimin në të ardhmen: skenari i stabilizimit (RCP4.5) si prag i ulët - në rast të uljes globale të emetimeve të Gazrave Serrë pas vitit 2040, dhe skenari i rritjes së vazhdueshme (RCP8.5) si prag i lartë - në rast se asnjë nga masat e uljes globale të emetimeve të Gazrave Serrë nuk zbatohen, i quajtur gjithashtu skenari "biznesi si zakonisht".

Tabela 12. Informacion mbi Ndryshimet Klimatike (Burimi: Studimi mbi ndryshimet klimatike në rajonin e Ballkanit Perëndimor në vitin 2018)

	$\Delta T$ (°C) VJT		$\Delta T$ (°C) QKG		$\Delta P$ (%) VJT		$\Delta P$ (%) QKG	
	RCP4.5	RCP8.5	RCP4.5	RCP8.5	RCP4.5	RCP8.5	RCP4.5	RCP8.5
<b>E ardhmja e afert (2016-2035)</b>	0,5 – 1,0	0,5 – 1,5	1,0 – 1,5	1,0 – 1,5	-5	-5	-30	-30
<b>Mes shekulli (2046-2065)</b>	1,5 – 2,0	2,0 – 3,0	2,0 – 3,0	2,0 – 3,0	-5	0	-30	-30

<sup>6</sup> Studimi mbi ndryshimet klimatike në rajonin e Ballkanit Perëndimor, 2018

<b>Fund shekulli (2081-2100)</b>	2,0	–	4,0	–	2,0	–	> 5,0	0	-30	-40	-50
	3,0		5,0		3,0						

Informacioni bazë mbi ndryshimet klimatike në rajonin e Kosovës tregon një rritje alarmanete të temperaturës në të gjithë territorin:

- Gjatë periudhës së të ardhmes së afërt (2016-2035), e cila po ndodh tashmë, pritet që rritja mesatare vjetore (VJT) e temperaturës të arrijë 0,5 - 1,0 °C, por me një rritje të vazhdueshme të GS globale deri në 1,5 °C;
- Gjatë periudhës së mes shekullit (2046-2065), pritet që rritja mesatare vjetore e temperaturës të arrijë 1,5 - 2,0 °C, dhe deri në 2,0 - 3,0 °C me një rritje të vazhdueshme të GS globale;
- Gjatë fundit të shekullit (2081-2100), sjellja e rritjes së temperaturës mesatare vjetore tregon se edhe nëse emetimet globale të GS stabilizohen, ato do të vazhdojnë të rriten për një shtesë prej 0 - 1,0 °C që nga periudha e mes shekullit (deri në 2,0 - 3,0 °C në krahasim me klimën e tanishme), dhe në rast të rritjes së vazhdueshme globale të GS, rritja e temperaturës do të arrijë 4,0 - 5,0 °C në të gjithë rajonin në krahasim me klimën e tanishme.
- Rritja e temperaturës gjatë verës (Qershor-Korrik-Gusht: QKG) është më e lartë se sa mesatares vjetore deri në 0,5 - 1,0 °C, dhe në rast të rritjes së vazhdueshme globale të GS, temperatura për këtë sezon do të tejkalojë 5,0 °C në fund të periudhës së fundit të shekullit në krahasim me klimën e tanishme.




Figura 8. Ndryshimi mesatar vjetor i temperaturës (°C) për të ardhmen e afërt 2016-2035 (kolona e majtë), mes shekullit 2046-2065 (kolona e mesme) dhe fund shekullit 2081-2100 (kolona e djathtë) në krahasim me periudhën bazë (1986-2005) sipas RCP4.5 (rreshti i sipërm) dhe RCP 8.5 (rreshti i poshtëm) – Burimi: Studimi mbi ndryshimet klimatike në rajonin e Ballkanit Perëndimor në vitin 2018

Ndryshimi i akumuluar i reshjeve është më kompleks për t'u analizuar, ku konkluzionet më të rëndësishme janë:



13	Përfundimi i rrjetit të ujësjellësit për ujë të pijshëm në Istog dhe zëvendësimi i gypave të azbestit me ato të plastikës në rrjetin e ujësjellësit	PO (84%)	6,000,000	Buxheti i Komunës, KRU Hidrodrini dhe Donatorë	2024-2030
14	Ndërtimi i digës së ujit në Istog	PO (72%)	3,000,000	Buxheti i Komunës, KRU Hidrodrini dhe Donatorë	2025-2030
15	Ndërtimi i digës së ujit në Shushicë	PO (64%)	2,000,000,00	Buxheti i Komunës, KRU Hidrodrini dhe Donatorë	2025-2030
16	Rigjenerimi i burimeve ujore (Gurrat e Bardha)	PO (71%)	Te percaktohet nga komuna dhe KRU Hidrodrini	Buxheti i Komunës dhe KRU Hidrodrini	2025-2028
17	Rritja e kapacitetit të tubit të furnizimit për rezervuarin e ujit	PO (68%)	Te percaktohet nga Komuna dhe KRU Hidrodrini	Buxheti i Komunës, KRU Hidrodrini dhe Donatorë	2025-2028
18	Rregullimi dhe renovimi i kanaleve të ujitjes dhe kullimi i tokave bujqësore	PO (70%)	520,000	Buxheti i Komunës, KRU Hidrodrini dhe MBPZHR	2024-2028
19	Zhvillimi dhe zbatimi i konceptin të bazuar në lagje, duke u fokusuar në zonat e gjelbra, rekreative dhe sportive	PO (72%)	Te percaktohet nga Komuna	Buxheti i Komunës, Donatorë dhe Bizneset e ndërtimit	2026-2029
20	Ndërtimi dhe shenjzimi i shtigjeve ndërkufitare të ecjes në zonat malore	PO (53%)	25,000	Komuna e Istogut	2025-2028
21	Zgjerimi i rrjetit të zonave të mbrojtura në territorin e komunës së Istogut	JO	30,000	Komuna e Istogut	2027-2029
22	Ndërtimi i qendrës për grumbullimin dhe transferin e mbeturinave	PO (83%)	60,000	Komuna e Istogut, KRM Pastrimi dhe Donatorët	2025-2027
23	Pyllëzimi dhe ripyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura të pyjeve në territorin e Komunës	PO (83%)	500,000	Komuna e Istogut dhe Agjencia e Pyjeve	2024-2030
24	Përshtatja e planeve të mbrojtjes nga zjarri ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike	JO	50,000	Komuna e Istogut	2026-2028

25	Nxitja/promovimi i përdorimit të farave/fidanëve rezistentë ndaj ndryshimeve klimatike	PO (71%)	500,000	Komuna e Istogut, Agjencia për Zhvillim Rural	2025-2028
26	Hartimi i Protokollit për Masat Mbrojtëse nga Nxehtësia dhe Zbatimi i Udhëzimeve	JO	500,000	Komuna e Istogut	2026-2028
27	Planifikimi dhe ndërtimi i stehimoreve emergjente	PO (69%)	200,000	Komuna e Istogut	2025-2028
28	Krijimi dhe trajnimi i ekipeve vullnetare për rastet e emergjencave natyrore	PO (69%)	200,000	Komuna e Istogut	2025-2028
29	Akumulimi i ujit në zona turistike – malore (në shërbim të emergjencave, shuarjeve të zjarre, etj.)	PO (67%)	200,000	Komuna e Istogut	2025-2028
30	Ndërtimi i pikave hidrante në fshatra	JO	100,000	Komuna e Istogut	2025-2028
31	Krijimi i sistemi për mbrojtjen e turistëve dhe banorëve të zonave malore nga fatkeqësitë natyrore	PO (71%)	100,000	Komuna e Istogut	2025-2028
32	Promovimi i bujqësisë organike dhe agroturimit përmes subvencionimit të fermerëve me serra, bletë, bagëti të imta etj.	JO	500,000	Komuna e Istogut, Agjencia për Zhvillim Rural	2025-2028
33	Edukimi dhe informimi për ndryshime klimatike dhe zhvillim të qëndrueshëm	JO	200,000	Komuna e Istogut	2025-2028

Tabela 22. Buxheti në total i zbatimit të PVEQK

Masa	Buxheti (EUR)
Zbutje	33,615,000.00
Përshtatje	34,910,000.00
Varfëria energjetike	NA
<b>Buxheti në total (EUR)</b>	<b>68,525,000.00</b>

## 6.1. Zbutja

Zbutja e ndryshimeve klimatike në Komunën e Istogut përfshinë një përpjekje të vazhdueshme për të parandaluar efektet negative të ndryshimeve klimatike në nivel lokal, duke përqendruar veçanërisht në reduktimin e emetimeve të CO<sub>2</sub> për të frenuar ngrohjen e mëtejshme të atmosferës.

Masat për zbutjen e ndryshimeve klimatike në territorin e Komunës së Istogut përfshijnë zbatimin e zgjidhjeve që promovojnë përdorimin e energjisë me efikasitet më të lartë, rritjen e përdorimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe zhvillimin e shoqërisë në një mënyrë që të jetë ekonomikisht më e qëndrueshme duke mbrojtur mjedisin jetësor.

Përdorimi i burimeve të ripërtëritshme të energjisë, si turbinat e erës, energjia diellore, gjeotermale ose energjia nga uji, është një pjesë e rëndësishme e kësaj strategjie, pasi ato ndihmojnë në reduktimin e emetimeve të gazrave me efekt serra në atmosferë. Megjithatë, zbatimi i këtyre

teknologjive përballon sfida të cilat lidhen me shpenzimet e kapitalit, financimin, perceptimin publik dhe varësinë afatgjatë të tregut dhe institucioneve nga karburantet fosile.

Teknologjitë e burimeve të ripërtëritshme të energjisë (BRE) kanë bërë progres në efikasitet dhe janë bërë më ekonomike, duke ofruar një zgjidhje të qëndrueshme për mbrojtjen e mjedisit dhe sigurimin e furnizimit me energji. BRE përveç që mundësojnë diversifikim dhe decentralizim të gjenerimit të energjisë, përdorimi i tyre mundëson uljen e emetimeve të gazrave serrë nga gjenerimi i energjisë, duke ndikuar në uljen e rreziqeve nga ndryshimet klimatike, sidomos në zonat rurale (IPCC 2022).

Përveç ngritjes së efikasitetit të energjisë dhe përdorimit të BRE, në Komunën e Istogut janë përfshirë masa të ndryshme vetëdijesuese, informuese dhe promovuese, që synojnë të ndryshojnë sjelljen e qytetarëve dhe të promovojnë praktika të qëndrueshme të konsumit dhe menaxhimit të energjisë dhe burimeve natyrore në përgjithësi.

Masat për zvogëlimin e emetimeve të CO<sub>2</sub> në sektorin e ndërtesave për Komunën e Istogut

Në këtë pjesë, janë përfshirë në përgjithësi masat që synojnë zvogëlimin e emetimeve të gazrave serrë të shkaktuara nga sektori i ndërtimit në Komunën e Istogut. Masat janë ndarë në kategoritë e mëposhtme:

- Promovimi, vetëdijesimi, informimi dhe ndryshimi i sjelljes;
- Ndërtesat publike;
- Ndërtesat rezidenciale (ndërtesat e banimit);
- Ndërtesat komerciale.

Masat prioritare janë përcaktuar në tabelat e tyre korresponduese, së bashku me parametrat e mëposhtëm:

- Palët përfshirë në zbatim;
- Korniza kohore e zbatimit;
- Institucioni përgjegjës për zbatim;
- Vlerësimi i kursimeve të energjisë;
- Vlerësimi i nivelit të zvogëlimit të emetimeve të gazrave serrë (GS);
- Burimet e mundshme të financimit;
- Përkrahje dhe shkurtër i masës dhe mënyra e zbatimit.

Për të lehtësuar, çdo masë është përmbledhur në tabelën e saj korresponduese. Burimet e mundshme të financimit për zbatimin e secilës mase janë përcaktuar në bazë të mekanizmave të mundshëm ekzistues financiar në Kosovë.

#### 6.1.1. Sektori i ndërtimit

##### **a. Promovimi, vetëdijesimi, informimi dhe ndryshimi i sjelljes së popullatës**

Masat dhe aktivitetet e planifikuara në kuadër të PVEQK për t'u zbatuar nga Komuna e Istogut kanë për qëllim rritjen e mirëqenies së popullatës si përdorues fundorë të energjisë. Në mënyrë që masat e propozuara të zbatohen me sukses, është shumë e rëndësishme që ato të pranohen nga komuniteti. Për këtë arsye, janë propozuar masa për ndërgjegjësim, informim dhe edukim në lidhje me përdorimin eficient të energjisë, burimeve të qëndrueshme dhe ndryshimeve klimatike.

Projektet e vetëdijesimit dhe informimit mundësojnë zhvillimin e tregut për specialistë të energjisë dhe burimeve të ripërtëritshme të energjisë. Përfituesit përfundimtarë dhe komuniteti duhet të përfshihen në proceset e planifikimit dhe zbatimit të masave për të siguruar suksesin e tyre. Bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile dhe grupet lokale është thelbësor për identifikimin e nevojave të komunitetit dhe për zhvillimin e strategjive të përshtatshme.

Përfundimisht, përpjekjet për promovim dhe vetëdijesim duhet të jenë të qëndrueshme dhe të përshtatshme me karakteristikat e komunitetit të Istogut, duke siguruar një mjedis më të mirë për të gjithë banorët e kësaj komune.

Tabela 23. Promovimi dhe mbështetja e rritjes së efijencës së energjisë (EE), përdorimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë (BRE)

<b>Numri rendor i masës</b>	1
<b>Emërtimi i masës</b>	Promovimi dhe mbështetja e rritjes së efijencës së energjisë (EE), përdorimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë (BRE) dhe informimi për ndryshimet klimatike për qytetarët
<b>Përfshirja në listën prioritare të projekteve</b>	PO (68 %)
<b>Bartësi i zbatimit</b>	Komuna e Istogut
<b>Partneri në zbatim</b>	Organizatrat e shoqërisë civile (OSHC)
<b>Palët tjera të përfshira</b>	Qeveria e Kosovës Donatorët
<b>Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)</b>	2025 - 2030
<b>Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)</b>	60,000.00
<b>Vlerësimi i kursimit të energjisë (MWh)</b>	8,715.98
<b>Vlerësimi i uljes së emetimeve (tCO<sub>2</sub>)</b>	2,150.89
<b>Burimi i financimit</b>	Buxheti komunal, Ministria e Ekonomisë, Donatorët
<b>Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>– Qëllimi i kësaj mase është të rrisë ndërgjegjësimin dhe informimin e popullatës për rëndësinë e efijencës së energjisë (EE), përdorimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë (BRE) dhe për efektet e ndryshimeve klimatike. Aktivitetet e kësaj mase përfshijnë:</li> <li>– Organizimi i fushatave vetëdijësuese dhe informuese në shkollat e Komunës për EE dhe efektet e ndryshimeve klimatike, duke përfshirë kurse edukative, punëtori, seminare dhe gara për nxënësit, duke inkurajuar financimin e punimeve të nxënësve në lidhje me EE, BRE dhe ndryshimet klimatike.</li> <li>– Përgatitja, shtypja dhe shpërndarja e materialeve promovuese në formën e broshurave të shtypura dhe në formë digjitale përmes faqes zyrtare të internetit të</li> </ul>

	<p>Komunës dhe rrjeteve sociale.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Informimi i qytetarëve për trendet në lidhje me energjinë, mënyrat e kursimit të energjisë dhe tarifave të energjisë, duke ofruar këshilla për përdorimin maksimal të tarifave të lira të energjisë.</li> <li>– Hapja e një qendre informative, ku qytetarët, përfshirë ata në nevojë dhe kategoritë me nevoja të veçanta energjetike, mund të marrin informacion për EE, BRE, teknologjitë dhe alternativat për energjinë elektrike, ngrohjen dhe ftohjen. Këto qendra gjithashtu mund të ofrojnë informacion lidhur me mundësinë e shfrytëzimit të subvencioneve dhe grantëve të ndryshme për EE dhe BRE, që mund të ofrohen nga qeveria, donatorët apo nga programet komunale.</li> <li>– Këto veprime synojnë të ndërtojnë një kulturë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme në lidhje me përdorimin e energjisë dhe të kontribuojnë në përmirësimin e kushteve mjedisore dhe të jetesës në Komunën e Istogut.</li> </ul>
--	--

Tabela 24. Informimi/vetëdijësimi dhe ndryshimi i sjelljes për të punonjësit dhe shfrytëzuesit e ndërtesave publike komunale

<b>Numri rendor i masës</b>	2
<b>Emërtimi i masës</b>	Informimi/vetëdijësimi dhe ndryshimi i sjelljes për të punonjësit dhe shfrytëzuesit e ndërtesave publike komunale të Komunës së Istogut
<b>Përfshirja në listën prioritare të projekteve</b>	PO (68 %), (e ndërlidhur me masën paraprake)
<b>Bartësi i zbatimit</b>	Komuna e Istogut
<b>Partneri në zbatim</b>	Organizatave të shoqërisë civile (OSHC)
<b>Palët tjera të përfshira</b>	Kompanitë konsulente (sektori privat)
<b>Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)</b>	2025 – 2030, në vazhdimsi
<b>Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)</b>	70,000.00
<b>Vlerësimi i kursimit të energjisë (MWh)</b>	281,82
<b>Vlerësimi i uljes së emetimeve (tCO<sub>2</sub>)</b>	151.27
<b>Burimi i financimit</b>	Buxheti komunal, Ministria e Ekonomisë (ME), Donatorët
<b>Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi</b>	<p>Kjo masë synon që të bëjë informimin dhe edukimin përmes zbatimit të rregullt të një sërë aktiviteteve, që përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Organizimin e punëtorive apo seminareve informuese për format e kursimit të energjisë, përdorimit të BRE dhe efekteve nga ndryshimet klimatike;</li> <li>– Përpilimin dhe shpërndarjen e materialeve</li> </ul>

	<p>informuese/edukative, sikur që janë broshurat, fletëpalosjet, posterët, e të ngjashme.</p> <p>Vlerësimi i kursimit të energjisë nga masat për ngritje të vetëdijësimit dhe informimit në ndërtesat publike është i vështirë të përcaktohet, por bazuar në përvojën nga vendet e ndryshme Evropiane, kursimi i pëafërt për periudhë dhjetëvjeçare sillet rreth 7% të energjisë për ngrohje dhe rreth 5% të energjisë elektrike. Pasi PVQEK për Komunën e Istogut e ka periudhën e zbatimit për 6 vjetë, atëherë është vlerësuar se kursimi i energjisë për ngrohje do të sillet rreth 4%, kurse të energjisë elektrike rreth 3% të shpenzimit të përgjithshëm të energjisë në ndërtesat publike komunale në krahasim me vitin bazë të IBE që është viti 2017.</p>
--	---

Tabela 25. Zbatimi i standardeve minimale të Performancës së Energjisë

<b>Numri rendor i masës</b>	3
<b>Emërtimi i masës</b>	Zbatimi i Standardeve Minimale të Performancës së Energjisë në ndërtesa
Përfshirja në listën prioritare të projekteve	JO
<b>Bartësi i zbatimit</b>	Komuna e Istogut
<b>Partneri në zbatim</b>	MMPHI, Investitorët e ndërtimit
<b>Palët tjera të përfshira</b>	Donatorët
<b>Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)</b>	2026 - 2027
<b>Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)</b>	20,000.00 €/vit (kosto operative)
<b>Vlerësimi i kursimit të energjisë (MWh)</b>	
<b>Vlerësimi i uljes së emetimeve (tCO<sub>2</sub>/vit)</b>	7,800.00
<b>Burimi i financimit</b>	Buxheti komunal, MMPHI, ME Donatorët, Fondet shtetërore dhe rajonale,
<b>Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi</b>	<p>Standardet Minimale të Performancës së Energjisë (SMPE) përcaktojnë nivelin minimal të performancës së energjisë që pajisjet shtëpiake, ndriçimi dhe pajisjet elektrike duhet t'i përmbushin ose t'i tejkalojnë për t'u ofruar për shitje ose për përdorim tregtar.</p> <p>Aktet nënligjore vendore përcaktojnë standardet për cilësinë e përbërësve të paketës së ndërtimit që ndikojnë në performancën e energjisë. Të gjitha ndërtesat e reja duhet të ndërtohen sipas këtyre standardeve të energjisë. Si pjesë e</p>



	<p>procesit të lejes së ndërtimit, për çdo objekt të ri dhe/ose rinovim të objektit ekzistues, është e nevojshme të plotësohen standardet minimale të performancës së energjisë.</p> <p>Regjistri Kombëtar i Performancës së Energjisë në Ndërtesa ("RKPEN") është baza qendrore e të dhënave për performancën energjetike të ndërtesave. Ky regjistër përdoret nga institucionet përgjegjëse qeveritare, profesionistë të licencuar dhe publiku i gjerë për të monitoruar dhe vlerësuar performancën energjetike të ndërtesave.</p>
--	--

#### b. Ndërtesat publike komunale

Ndërtesat publike përfaqësojnë një burim të rëndësishëm për të përdorur energjinë me efikasitet dhe për të zvogëluar emetimet e CO<sub>2</sub> në mjedis. Përveçse janë shembuj të përkushtimit të institucioneve komunale, ato gjithashtu ofrojnë një mundësi të shkëlqyer për të ndërtuar politika dhe strategji për të luftuar ndryshimet klimatike në nivel lokal.

Ndërtesat publike, si në rastin e Komunës së Istogut, janë qendra e përpjekjeve për të ulur emetimet e CO<sub>2</sub> dhe për të përmirësuar efikasitetin energjetik. Përmes përdorimit të teknologjive të ndryshme për energjinë e qëndrueshme, si izolimi i ndërtesave, instalimi i sistemeve të ngrohjes dhe ftohjes efikase, si dhe përdorimi i burimeve të ripërtëritshme të energjisë, Komuna e Istogut synon të reduktojë kostot e energjisë për ndërtesat e saj publike dhe të kontribuojë në zvogëlimin e emetimeve të gazrave të efektit së serrë dhe gjithashtu të promovojë shembuj të mirë që mund të ndiqen nga sektori komercial dhe ai i banimit.

Në të njëjtën kohë, këto ndërtesa publike shërbejnë si shembuj të sjelljes së mirë ndaj mjedisit në komunitetin lokal. Duke u shërbyer si shembuj të përpjekjeve për të arritur qytete të qëndrueshme dhe të përgjegjshme ndaj mjedisit, ato inkurajojnë të tjerët, përfshirë sektorin e biznesit dhe komunitetin lokal, për të ndjekur rrugën drejt veprimeve më të qëndrueshme dhe miqësore ndaj mjedisit.

Për këto arsye, ndërtesat publike janë një komponent kyç i përpjekjeve për të luftuar ndryshimet klimatike dhe për të siguruar një të ardhme më të qëndrueshme për qytetarët e Komunës së Istogut dhe për të gjithë qytetarët e zonës së tyre.

Tabela 26. Krijimi dhe funksionalizimi i Sistemit Komunal për menaxhim të energjisë (SKME)

<b>Numri rendor i masës</b>	4
<b>Emërtimi i masës</b>	Krijimi dhe funksionalizimi i Sistemit Komunal për menaxhim të energjisë (SKME) për Komunën e Istogut
Përfshirja në listën prioritare të projekteve	JO
<b>Bartësi i zbatimit</b>	Komuna e Istogut
<b>Partneri në zbatim</b>	Ministria e Ekonomisë (ME)
<b>Palët tjera të përfshira</b>	Donatorët
<b>Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)</b>	2025 - 2027
<b>Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)</b>	50,000

<b>Vlerësimi i kursimit të energjisë (MWh)</b>	486.67
<b>Vlerësimi i uljes së emetimeve (tCO<sub>2</sub>)</b>	99.54
<b>Burimi i financimit</b>	Buxheti komunal, Ministria e Ekonomisë (ME), Donatorët
<b>Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi</b>	<p>Në kuadër të kësaj mase përfshihet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Funkcionalizimi i Zyrës Komunale për Energji (ZKE), ose krijimi i një sektori të veçantë në kuadër të ndonjë drejtoria komunal që ndërlidhet më shumë me aktivitetet lidhur me energjinë dhe mjedisin. Plotësimi me staf të nevojshëm profesional dhe përshkrimi i detyrave të punës që lidhen me menaxhimin e energjisë, në bazë të organigramit të përgaditur paraprakisht për organizimin e ZKE/Sektorit ;</li> <li>– Monitorimi, raportimi dhe vendosja e të dhënave në softwerin komunal për menaxhim të energjisë për konsumin mujor të energjisë dhe ujit në ndërtesat publike, si dhe konsumit mujor të energjisë elektrike në ndriçimin publik;</li> <li>– Monitorimi i konsumit të energjisë në ndërtesat rezidenciale dhe ato komerciale (të shërbimeve) në tërë territorin e Komunës;</li> <li>– Ngritja e kapaciteteve profesionale të stafit të ZKE (apo sektorit të veçantë) përmes trajnimeve për planifikim dhe zbatimin e masave për EE, teknologjitë e BRE-ve, përdorimin e softuerëve për menaxhim të energjisë dhe platformave për monitorim, verifikim dhe raportim;</li> <li>– Trajnimi i stafit përkatës profesional të drejtorive tjera brenda komunës për marrjen e njohurive për planifikimin dhe zbatimin e masave të EE në ndërtesa dhe ndriçimin publik, marrjen e njohurive për pajisjet ngrohëse dhe klimatizimit, mirëmbajtjen e tyre dhe metodat themelore për llogaritjen e kursimeve të energjisë dhe llogaritjen e emetimeve të GS;</li> <li>– Trajnimi i punëtorëve që operojnë me sistemet e ngrohjes dhe ftohjes nëpër të gjitha ndërtesat publike komunale për mënyrën e operimit me efikasitet të lartë të sistemeve;</li> <li>– Zbatimi i kritereve të efikasitetit të energjisë në prokurim të produkteve të ndryshme nga ana e komunës;</li> <li>– Pjesëmarrja e stafit adekuat të komunës së Istogut në konferenca, punëtori, që organizohen brenda dhe jashtë vendit me qëllim të fitimit të njohurive lidhur me zhvillimet e reja rreth EE, BRE dhe masave sa i përket ndryshimeve klimatike;</li> <li>– Organizimi i seminareve informuese lidhur me ndryshimin e sjelljes të të gjithë të punësuarve në të gjitha ndërtesat publike komunale.</li> </ul>

Tabela 27. Përmirësimi i efikasitetit të energjisë në ndërtesat publike komunale

<b>Numri rendor i masës</b>	5
<b>Emërtimi i masës</b>	Përmirësimi i efikasitetit të energjisë në ndërtesat publike komunale (shkollat, objektet/pronat komunale, ambulancat dhe qendrat mjekësore, etj).
<b>Përfshirja në listën prioritare të projekteve</b>	PO (70%), Kjo masë do të zbatohet gradualisht
<b>Bartësi i zbatimit</b>	Komuna e Istogut
<b>Partneri në zbatim</b>	FKEE,
<b>Palët tjera të përfshira</b>	Donatorët
<b>Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)</b>	2025-2030,
<b>Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)</b>	3,000,000.00
<b>Vlerësimi i kursimit të energjisë (MWh)</b>	2,149.56
<b>Vlerësimi i uljes së emetimeve (tCO<sub>2</sub>)</b>	1,153.8
<b>Burimi i financimit</b>	Buxheti Komunal, FKEE, Donatorët, Bankat (BERZH, BB, KfW, etj.)
<b>Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi</b>	<p>Masat përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Auditimin energjetik të të gjitha ndërtesave publike komunale të cilat nuk kanë raport të auditimit energjetik në 3 vitet e fundit. Në bazë të rezultateve të auditimit energjetik, të bëhet prioritetizimi i ndërtesave që do t'u nënshtrohen renovimit me zbatimin e masave për EE.</li> <li>– Në bazë të rezultateve të auditimit energjetik do të bëhet zbatimi i masave për EE në mbështjellësin e ndërtesave, në sistemet e ngrohjes së hapsirës dhe ndriçimit të brendshëm përputhje me standardet dhe kriteret për performancë të energjisë të ndërtesave, dhe që kryesisht do të përfshijë: izolimin termik të mureve të jashtme; izolimin termik të kulmeve (tavanëve), ndërrimin e dritareve dhe dyerve të jashtme; zëvendësimin e llambave për ndriçim; zëvendësimin e gjenerimit ekzistues të energjisë për ngrohje të hapsirës me gjenerim më afiçient apo me përdorim të pompave termike, përdorimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë për ngrohje dhe ngrohje të ujit sanitar; etj.</li> </ul>

Tabela 28. Instalimi i sistemeve për gjenerim të energjisë elektrike nga BRE, gjegjësisht moduleve PV, në ndërtesat publike komunale

<b>Numri rendor i masës</b>	6
-----------------------------	---

<b>Emërtimi i masës</b>	Instalimi i sistemeve për gjenerim të energjisë elektrike nga BRE, gjegjësisht moduleve PV, në ndërtesat publike komunale
<b>Përfshirja në listën prioritare të projekteve</b>	PO (70%), Kjo masë është e ndërlidhur me masën paraprake
<b>Bartësi i zbatimit</b>	Komuna e Istogut
<b>Partneri në zbatim</b>	Ministria e Ekonomisë (ME), FKEE,
<b>Palët tjera të përfshira</b>	Donatorët, Kompanitë ESCO
<b>Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)</b>	2025-2030, investim gradual
<b>Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)</b>	465,000.00
<b>Vlerësimi i kursimit të energjisë (MWh)</b>	568.94
<b>Vlerësimi i uljes së emetimeve (tCO<sub>2</sub>)</b>	597.96
<b>Burimi i financimit</b>	Buxheti Komunal, Ministria e Ekonomisë (ME), FKEE, Donatorët, Bankat (BERZH, BB, KfW, etj.), Kompanitë ESCO
<b>Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi</b>	<p>Masat përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Studimi i fizibilitetit për potencialin e gjenerimit të energjisë elektrike nga modulet PV në kulmet e ndërtesave publike komunale. Studimi do të analizojë të gjitha ndërtesat publike komunale, dhe do të jep rekomandimin për potencialin për secilën ndërtesë:</li> </ul> <p>Kapaciteti i mundshëm për t'u instaluar, sipërfaqja e moduleve që mund të instalohen, masa në (kg) e moduleve, energjia që mund të gjenerohet në vit, si dhe kontributi në zvogëlimin e emetimeve të CO<sub>2</sub> nga instalimi i sistemit</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Investimi në instalimin e sistemeve PV në ndërtesat publike komunale, sipas rekomandimeve dhe prioriteteve të ndërtesave që kanë më shumë potencial dhe kushte më të volitshme për instalimin e këtyre sistemeve.</li> </ul>

Tabela 29. Instalimi i sistemeve diellore termike për ngrohje të ujit sanitar, në ndërtesat publike komunale

<b>Numri rendor i masës</b>	7
<b>Emërtimi i masës</b>	Instalimi i sistemeve diellore termike për ngrohje të ujit sanitar, në ndërtesat publike komunale, si: çerdhe të fëmijëve dhe shtëpi të pleqve
<b>Përfshirja në listën prioritare të projekteve</b>	PO (70%), Kjo masë është e ndërlidhur me masën 5.
<b>Bartësi i zbatimit</b>	Komuna e Istogut
<b>Partneri në zbatim</b>	Ministria e Ekonomisë (ME), FKEE,
<b>Palët tjera të përfshira</b>	Donatorët
<b>Periudha e fillimit/përfundimit</b>	2025-2027

<b>(vitet)</b>	
<b>Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)</b>	35,000.00
<b>Vlerësimi i kursimit të energjisë (MWh)</b>	60.14
<b>Vlerësimi i uljes së emetimeve (tCO<sub>2</sub>)</b>	44.99
<b>Burimi i financimit</b>	Buxheti Komunal, Ministria e Ekonomisë (ME), FKEE, Donatorët
<b>Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi</b>	<p>Në kuadër të kësaj mase to të bëhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Planifikimi, furnizimi dhe instalimi i sistemeve për ngrohjen e ujit sanita me kolektorë diellorë.</li> <li>– Trajnimi i stafit teknik që do të merret me operimin e sistemeve të instaluar.</li> <li>– Monitorimi i plotë një-vjeçar i funksionimit të sistemeve të instaluar dhe mentorimit të stafit teknik që merret me operimin dhe mirëmbajtjen e këtyre sistemeve.</li> </ul>

Tabela 30. Masat e efijencës së energjisë në KRU "Hidrodrini"

<b>Numri rendor i masës</b>	8
<b>Emërtimi i masës</b>	Masat e efijencës së energjisë në KRU "Hidrodrini"
<b>Përfshirja në listën prioritare të projekteve</b>	PO (63%)
<b>Bartësi i zbatimit</b>	KRU "Hidrodrini"
<b>Partneri në zbatim</b>	Komuna e Istogut, FKEE
<b>Palët tjera të përfshira</b>	Donatorët
<b>Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)</b>	2026-2028
<b>Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)</b>	155,000.00
<b>Vlerësimi i kursimit të energjisë (MWh)</b>	Do të vlerësohet kur të bëhet auditimi energjetik
<b>Vlerësimi i uljes së emetimeve (tCO<sub>2</sub>)</b>	Do të vlerësohet kur të bëhet auditimi energjetik
<b>Burimi i financimit</b>	KRU "Hidrodrini", FKEE, Komuna e Istogut, Donatorët
<b>Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi</b>	<p>Ujësjetësi KRU "Hidrodrini" është kompani publike regjionale përgjegjëse për furnizim me ujë të pijshëm dhe trajtimin e ujërave të zeza që përfshinë komunat: Pejë, Klinë, Istog, Deçan dhe Junik. Masat e propozuara përfshijnë objektet dhe pajisjet e KRU "Hidrodrini" që janë në territorin e Komunës së Istogut.</p> <p>Një përshkrim i masave të marra për të përmirësuar retijencën e energjisë në Ujësjetësin KRU "Hidrodrini" do të përfshijë disa</p>

	<p>hapa kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Auditimi energjetik i ndërtesave/objekteve dhe pajisjeve të KRU “Hidrodrini” që gjenden në territorin e Komunës së Istogut. Auditimi energjetik do të analizojë konsumin e energjisë nga ndërtesat/objektet dhe nga pajisjet, sidomos pompat qarkulluese. Auditimi gjithashtu do të analizojë humbjet e ujit të pijshëm në rrjetin gyporë.</li> <li>- Zbatimi i masave për përmirësimin e efijencës së energjisë, apo edhe përdorimin e energjisë elektrike nga modulet PV, varësisht nga rezultatet dhe rekomandimet e dala nga auditimi energjetik.</li> <li>- Zbatimi i masave për zvogëlimin e humbjeve të ujit nga rrjeti gyporë.</li> <li>- Monitorimi i konsumit të energjisë pas zbatimit të masave për EE në objektet dhe pajisjet e KRU “Hidrodrini” në territorin e Komunës së Istogut.</li> </ul> <p>Zbatimi i masave do të zvoglojë shpenzimin e energjisë nga pajisjet dhe do të rrisë sigurinë e furnizimit më ujë të pijshëm të të gjithë qytetarëve të Komunës së Istogut.</p>
--	--

### c. Ndërtesat e banimit

Shtëpitë familjare dhe ndërtesat me shumë apartamente paraqesin një segment të rëndësishëm të peizazhit urban në Istog. Këto struktura jo vetëm që ndërtojnë infrastrukturën e qytetit, por gjithashtu kanë një ndikim të rëndësishëm në cilësinë e jetës dhe shëndetin e komunitetit lokal. Në këtë kontekst, përmirësimet në efijencën e energjisë dhe reduktimi i emetimeve të CO<sub>2</sub>-së kanë një rëndësi të jashtëzakonshme për të siguruar një mjedis jetese më të qëndrueshëm dhe të pastër për banorët e komunës.

Nëpërmjet investimeve në efijencë të energjisë, është e mundur të arrihet një nivel i lartë i performancës së energjisë në shtëpitë dhe ndërtesat shumëbanesore në Istog. Kjo do të rezultojë jo vetëm në një ulje të ndjeshme të emetimeve të CO<sub>2</sub>-së, por gjithashtu në uljen e faturave të energjisë për banorët. Një kosto e ulët e energjisë do të ndikojë pozitivisht te banorët e Istogut, duke u mundësuar atyre të kenë një jetë më të rehatshme dhe ekonomikisht më të qëndrueshme.

Për të inkurajuar këto përmirësime në sektorin e banimit në Istog, autoritetet lokale mund të zhvillojnë masa financiare, duke ofruar subvencione ose kredi me kushte të favorshme për investimet në efijencën e energjisë. Në të njëjtën kohë, masat ndërgjegjësuese janë të rëndësishme për të informuar banorët rreth përfitimeve të përdorimit të burimeve të qëndrueshme të energjisë dhe praktikave të ndërtimit të qëndrueshëm.

Në një kohë kur shqetësimet për ndryshimet klimatike dhe mbrojtjen e mjedisit po rriten, investimet në efijencën e energjisë dhe në teknologjitë e pastra janë të domosdoshme për të siguruar një të ardhme më të qëndrueshme për të gjithë komunitetin e Istogut. Duke vepruar në këtë drejtim, autoritetet lokale dhe banorët mund të bëjnë një kontribut të rëndësishëm për të ndërtuar një komunë më të pastër, më të shëndetshme dhe më të qëndrueshme për brezat e ardhshëm.

Tabela 31. Përmirësimi i efijencës të energjisë në ndërtesat individuale të banimit

<b>Numri rendor i masës</b>	9
<b>Emërtimi i masës</b>	Përmirësimi i efijencës të energjisë dhe përdorimi i BRE për sistemet e ngohjes në ndërtesat individuale të banimit
<b>Përfshirja në listën prioritare të projekteve</b>	PO (68%)
<b>Bartësi i zbatimit</b>	Komuna e Istogut
<b>Partneri në zbatim</b>	Ministria e Ekonomisë (ME) MMPHI, FKEE. Pronarët e ndërtesave të banimit
<b>Palët tjera të përfshira</b>	Donatorët, Sektori privat që merret me fushën e ndërtimit
<b>Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)</b>	2025-2030, do të jetë një masë e vazhdueshme
<b>Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)</b>	5,175,000.00
<b>Vlerësimi i kursimit të energjisë (MWh)</b>	8,130.11
<b>Vlerësimi i uljes së emetimeve (tCO<sub>2</sub>)</b>	4,500.1
<b>Burimi i financimit</b>	Buxheti Komunal, Ministria e Ekonomisë (ME), MMPHI, FKEE, Donatorët, Bankat
<b>Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi</b>	<p>Përmirësimi i efijencës së energjisë në ndërtesat individuale të banimit në Komunën e Istogut synon të ofrojë mbështetje për banorët në zvogëlimin e humbjeve të energjisë për ngrohje në mbështjellësin e ndërtesës, në rritjen e efijencës së energjisë në sistemet e ngrohjes së hapsirës si dhe në përdorimin e BRE në sistemet për ngrohjen e hapsirës dhe ujit sanitar. Këto masa përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mbështetje për zbatimin e masave për efijencë të energjisë në shtëpitë individuale: komuna ofron këshilla dhe ndihmë për zbatimin e masave për efijencë të energjisë në shtëpitë individuale, duke përfshirë izolimin termik të mureve të jashtme, tavanit (kulmit) të shtëpive, si dhe zëvendësimin e dritareve dhe dyerëve të jashtme ekzistuese me dyer e dritare me efijencë të lartë në përputhje me standardet për performancë të energjisë në ndërtesa.</li> <li>- Mbështetje për zëvendësimin e sistemeve jo-efijente për gjenerim të energjisë për ngrohje me instalimin e pompave termike për ngrohje të hapsirës në ndërtesa.</li> <li>- Mbështetje për instalimin e sistemeve diellore termike për ngrohje të ujit sanitar: Komuna gjithashtu ofron ndihmë për instalimin e sistemeve diellore termike për prodhimin e ujit të ngrohtë sanitar në banesat individuale. Kjo teknologji përdor diellin për të ngrohur ujin, duke kontribuar në uljen e koston dhe emetimeve të CO<sub>2</sub>-së nga ngrohja e ujit sanitar.</li> </ul>

Tabela 32. Instalimi i sistemeve diellore fotovoltaike (PV) në ndërtesat e banimit

<b>Numri rendor i masës</b>	10
<b>Emërtimi i masës</b>	Instalimi i sistemeve për gjenerim të energjisë elektrike nga modulet fotovoltaike (PV) në ndërtesat e banimit
<b>Përfshirja në listën prioritare të projekteve</b>	PO (68%), është e ndërlidhur me masën 9
<b>Bartësi i zbatimit</b>	Komuna e Istogut
<b>Partneri në zbatim</b>	Ministria e Ekonomisë (ME), FKEE, Pronarët e ndërtesave të banimit
<b>Palët tjera të përfshira</b>	Donatorët, Sektori privat që merret me instalimin e sistemeve PV
<b>Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)</b>	2025-2030, do të jetë një masë e vazhdueshme
<b>Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)</b>	1,350,000.00
<b>Vlerësimi i kursimit të energjisë (MWh)</b>	1,560.00
<b>Vlerësimi i uljes së emetimeve (tCO<sub>2</sub>)</b>	1,166.9
<b>Burimi i financimit</b>	Buxheti Komunal, Ministria e Ekonomisë (ME), FKEE, Donatorët, Bankat
<b>Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi</b>	<p>Subvencionimi për instalimin e sistemeve diellore fotovoltaike (PV): ndihmë financiare dhe teknike për instalimin e paneleve diellore fotovoltaike në ndërtesat e banimit. Kjo teknologji lejon prodhimin e energjisë elektrike duke përdorur energjinë diellore, e cila është e pastër dhe e qëndrueshme.</p> <p>Instalimi i sistemeve PV për gjenerim të energjisë elektrike, do të kontribuojë në rritjen e sigurisë së furnizimit me energji elektrike dhe zvogëlimin e emetimeve të CO<sub>2</sub> duke kontribuar në zbutjen ndaj ndryshimeve klimatike.</p> <p>Pasi që pritet që një pjesa më e madhe e mbështetjes të jetë nga niveli qendror i qeverisjes, përqindja me të cilën do të subvencionohen përfituesit do të varet nga objektivat e përgjithëshme të Kosovës dhe nga fondeve të cilat do të mund të jenë në dispozicion për këtë masë, si nga niveli qendror ashtu edhe nga buxheti i Komunës së Istogut.</p>

Tabela 33. Masat për EE, Ndërtesa rezidenciale – ndërtesa me shumë apartamente

<b>Numri rendor i masës</b>	11
<b>Emërtimi i masës</b>	Masat për efikasitet të energjisë në ndërtesat rezidenciale – ndërtesat shumë banesore
<b>Përfshirja në listën prioritare të projekteve</b>	PO (68%)



<b>Bartësi i zbatimit</b>	Komuna e Istogut
<b>Partneri në zbatim</b>	Ministria e Ekonomisë (ME), MMPHI, FKEE
<b>Palët tjera të përfshira</b>	Donatorë Sektori privat që merret me fushën e ndërtimit
<b>Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)</b>	2025-2029
<b>Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)</b>	350,000.00
<b>Vlerësimi i kursimit të energjisë (MWh)</b>	550.0
<b>Vlerësimi i uljes së emetimeve (tCO<sub>2</sub>)</b>	295.2
<b>Burimi i financimit</b>	Buxheti Komunal, Ministria e Ekonomisë (ME), MMPHI, FKEE, Donatorët, Bankat
<b>Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi</b>	<p>Izolimi termik i mbështjellësit të ndërtesave, ndërrimi i dyerve dhe dritareve të jashtme, izolimi termik i kulmit, zëvendësimi i ndriçimit të brendshëm me ndriçim eficient.</p> <p>Një mënyrë tjetër për të përmirësuar eficiencën e energjisë në ndërtesa është përdorimi i materialeve të përshtatshme për izolimin termik, si pllaka izoluese dhe dërrasa low-e për dyert dhe dritaret. Sistemet e automatizuara të kontrollit të temperaturës dhe ndriçimit gjithashtu ndihmojnë në menaxhimin e energjisë duke përdorur teknologjitë e sensorëve për të rregulluar ambientin në mënyrë eficiente. Investimi në teknologji të ripërtëritshme për prodhimin e energjisë, si panelet diellore dhe gjeneratorët e energjisë së erës, gjithashtu mund të ulë ndikimin e ndërtesës në mjedis dhe koston e energjisë.</p>

Tabela 34. Instalimi i ndriçimit me sensorë në hapësirat e përbashkëta të ndërtesave shumë banesore

<b>Numri rendor i masës</b>	12
<b>Emërtimi i masës</b>	Instalimi i ndriçimit me sensorë në hapësirat e përbashkëta të ndërtesave shumë banesore
<b>Përfshirja në listën prioritare të projekteve</b>	PO (63%), kjo masë është e ndërlidhur me masën paraprake 11.
<b>Bartësi i zbatimit</b>	Komuna e Istogut
<b>Partneri në zbatim</b>	
<b>Palët tjera të përfshira</b>	Donatorë
<b>Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)</b>	2025-2027
<b>Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)</b>	20,000.00
<b>Vlerësimi i kursimit të</b>	71.4

<b>energjisë (MWh)</b>	
<b>Vlerësimi i uljes së emetimeve (tCO<sub>2</sub>)</b>	75.1
<b>Burimi i financimit</b>	Komuna e Istogut
<b>Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi</b>	Instalimi i sistemeve të ndriçimit me sensorë në hapësirat e përbashkëta të ndërtesave shumë banesore në Istog është një hap përpara drejt përmirësimit të efikasitetit dhe sigurisë energjetike në këtë komunitet. Kjo teknologji e ndriçimit përdor sensorë për të identifikuar prezencën e personave në hapësirat e përbashkëta, duke e aktivizuar ose fikur ndriçimin bazuar në nevojën aktuale. Përveçse ndihmon në zvogëlimin e konsumit të energjisë, ajo gjithashtu rrit sigurinë dhe komfortin për banorët e ndërtesave. Ky investim demonstroi angazhimin ndaj praktikave të qëndrueshme dhe modernizimit të mjedisit dhe komunitetit në Istog.

#### d. Nën sektori i ndërtesave komerciale dhe shërbimeve

Nën sektori i ndërtesave komerciale dhe shërbimeve për Istogun përshkruhet si një pjesë e ekonomisë lokale të qytetit të Istogut. Ky sektor përfshin një gamë të gjerë të aktiviteteve ekonomike që lidhen me ndërtimin dhe shërbimet, të cilat shërbejnë për nevojat komerciale dhe të shërbimeve të komunitetit.

Ndërtesat komerciale në këtë sektor përfshijnë ndërtesa për biznese, dyqane, restorante, hotele, qendra tregtare, dhe të tjera. Këto ndërtesa janë vendet ku bizneset operojnë dhe shërbejnë publikun në mënyrë të drejtpërdrejtë. Përveç kësaj, sektori i ndërtesave komerciale përfshin edhe ambiente për zyra, ambiente për prodhim dhe depo, si dhe ndërtesa për shërbime të ndryshme profesionale dhe komerciale.

Në anën tjetër, sektori i shërbimeve për Istogun përfshin një sërë shërbimesh që ofrohen në qytet për të përmbushur nevojat e komunitetit dhe bizneseve lokale. Këto shërbime përfshijnë shërbimet e bankave dhe institucioneve financiare, shërbimet shëndetësore, shërbimet arsimore, shërbimet e transportit, kujdesin për kafshët e kafshëve të cilat janë të përfshira në fushën e shërbimeve veterinarë, dhe shërbimet e kujdesit personal dhe bukurisë, mes të tjerash. Në përgjithësi, nën sektori i ndërtesave komerciale dhe shërbimeve për Istogun paraqet një element kyç të ekonomisë lokale, duke krijuar vende pune, duke përmirësuar infrastrukturën e qytetit, dhe duke përmirësuar cilësinë e jetës së banorëve të tij.

Tabela 35. Zbatimi i masave për efikasitet të energjisë, instalimi i sistemeve PV dhe sistemeve diellore për ngrohjen e ujit sanitar në ndërtesat komerciale dhe të shërbimeve private

<b>Numri rendor i masës</b>	13
<b>Emërtimi i masës</b>	Zbatimi i masave për efikasitet të energjisë, instalimi i sistemeve diellore fotovoltaike PV dhe sistemeve diellore për ngrohjen e ujit sanitar në ndërtesat komerciale dhe të shërbimeve private.
<b>Përfshirja në listën prioritare të projekteve</b>	PO (62%)

<b>Bartësi i zbatimit</b>	Komuna e Istogut
<b>Partneri në zbatim</b>	Ministria e Ekonomisë (ME), FKEE, Sektori komercial dhe ai i shërbimeve private
<b>Palët tjera të përfshira</b>	Donatorët Sektori privat i ndërtimit, Sektori privat që merren me instalimin e sistemeve të ngrohjes, Sektori privat që merren me instalimin e sistemeve PV
<b>Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)</b>	2025-2030, do të jetë masë e vazhdueshme
<b>Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)</b>	1,100,000.00
<b>Vlerësimi i kursimit të energjisë (MWh)</b>	1,465.8
<b>Vlerësimi i uljes së emetimeve (tCO<sub>2</sub>)</b>	1,415.8
<b>Burimi i financimit</b>	Buxheti Komunal, Ministria e Ekonomisë (ME), FKEE, Donatorët, Bankat, Pronarët e ndërtesave
<b>Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi</b>	<p>Mbështetja teknike dhe financiare nga autoritetet komunale shërben si një burim i rëndësishëm për zvogëlimin e emetimeve të CO<sub>2</sub> në ndërtesat komerciale dhe ato të shërbimeve private. Qëllimi kryesor i kësaj mbështetjeje është promovimi dhe zbatimi i projekteve inovative të përdorimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë, si dhe rritja e efikasitetit të përdorimit të energjisë në këto subjekte. Kjo përkrahje jo vetëm që inkurajon zhvillimin ekonomik lokal, por gjithashtu kontribuon në përmirësimin e mjedisit dhe promovimin e një mjedisi të qëndrueshëm në nivel lokal. Në këtë mënyrë, komuniteti vendas përfiton jo vetëm nga avancimet teknologjike, por edhe nga avantazhet ekonomike dhe mjedisore të një përdorimi më të zgjuar dhe të qëndrueshëm të burimeve të energjisë.</p> <p>Veprimet që do të mbështeten janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Instalimi i sistemeve për gjenerim të energjisë nga sistemet diellore fotovoltaike (PV),</li> <li>– Instalimi i sistemeve diellore për ngrohje të ujit sanitar,</li> <li>– Zbatimi i masave për efikasitet të energjisë në mbështjellësin e ndërtesave komerciale dhe shërbimeve si dhe përmirësimi i efikasitetit të sistemeve të ngrohjes së hapsirës në ato ndërtesa.</li> </ul>

#### 6.1.2. Sistemi i ngrohjes së qytetit

Ngrohtorja e qytetit që do të ndërtohet në bazë të Përgaditjes së studimit të fizibilitetit për sistem të ngrohjes qendrore me burime të ripërtëritshme të energjisë (BRE) për Komunën e Istogut është një projekt thelbësor për furnizimin e energjisë të ngrohjes për banorët, ndërmarrjet dhe institucionet në këtë qytet të Kosovës.

Ky projekt do të përdorë burime të ripërtëritshme të energjisë, siç janë energjia diellore, biomasa, dhe energjia e erës, për të prodhuar ngruhtësi për nevojat e qytetit. Kjo përdorim i burimeve të ripërtëritshme jo vetëm që redukton varësinë nga burimet e energjisë fosile, por gjithashtu ndihmon në zvogëlimin e ndikimit negativ të emetimit të gazrave të efektit të serrë në atmosferë.

Ngruhtorja e qytetit do të krijojë një sistem të integruar për prodhimin, transportimin dhe shpërndarjen e ngruhtësisë në të gjithë zonën e qytetit të Istogut. Kjo do të përfshijë ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme për transportimin e ngrohjes, si dhe ndërtimin e stacioneve dhe të rrjetit të shpërndarjes në të gjithë qytetin.

Në tërësi, ndërtimi i kësaj ngruhtoreje të qytetit në bazë të përgaditjes së studimit të fizibilitetit për sistemin e ngrohjes qendrore me burime të ripërtëritshme të energjisë (BRE) do të sjellë përfitime të mëdha për komunitetin lokal në Istog. Kjo përfshin furnizimin me një burim më të qëndrueshëm dhe më të pastër të ngrohjes, si dhe krijimin e vendeve të reja të punës dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe mjedisit të qytetit.

Tabela 36. Përgatitja e studimit të fizibilitetit për sistem të ngrohjes qendrore me burime të ripërtëritshme të energjisë (BRE)

<b>Numri rendor i masës</b>	14
<b>Emërtimi i masës</b>	Ndërtimi i sistemit të ngrohjes për qytetin e Istogut me përdorim të BRE: - Përgatitja e studimit të fizibilitetit për sistem të ngrohjes qendrore me burime të ripërtëritshme të energjisë (BRE) - Ndërtimi i sistemit ngrohjes qendrore me BRE
<b>Përfshirja në listën prioritare të projekteve</b>	PO (74%)
<b>Bartësi i zbatimit</b>	Komuna e Istogut
<b>Partneri në zbatim</b>	Ministria e Ekonomisë (ME), FKEE
<b>Palët tjera të përfshira</b>	Donatorët
<b>Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)</b>	2025-2030
<b>Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)</b>	16,000,000.00
<b>Vlerësimi i kursimit të energjisë (MWh)</b>	-
<b>Vlerësimi i uljes së emetimeve (tCO<sub>2</sub>)</b>	-
<b>Burimi i financimit</b>	Buxheti komuna, Ministria e Ekonomisë (ME), Donatorët, Bankat
<b>Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi</b>	- Përgatitja e studimit të fizibilitetit për sistem të ngrohjes qendrore me burime të ripërtëritshme të energjisë (BRE) për Istogun është një proces thelbësor që ka për qëllim të kuptojë në thellësi mundësitë dhe përfitimet e një sistemi të tillë për qytetin e Istogut në Kosovë. Ky studim fillon me një analizë të hollësishme të nevojave të qytetit për ngrohje, duke përfshirë popullsinë, strukturën e banesave, dhe nevojat e sektorëve të ndryshëm të ekonomisë lokale. - Në vijim, hulumtohet dhe identifikohet gamë e gjerë e

	<p>burimeve të energjisë së ripërtëritshme që janë në dispozicion në zonën e Istogut. Kjo përfshin vlerësimin e potencialeve për energjinë diellore, biomasën, dhe energjinë e erës, duke u përqendruar në kapacitetin e tyre për të furnizuar ngrohje për qytetin.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Pas identifikimit të burimeve potenciale, studimi fokusohet në vlerësimin e teknologjive të përshtatshme për prodhimin dhe shpërndarjen e ngrohjes në mënyrë eficiente dhe të qëndrueshme. Ky proces përfshin analizën e teknologjive të njohura dhe të reja në fushën e ngrohjes me burime të ripërtëritshme, duke marrë parasysh aspektet teknike, ekonomike dhe mjedisore.</li> <li>- Përfundimisht, përgatitja e studimit të fizibilitetit për sistemin e ngrohjes me burime të ripërtëritshme të energjisë për Istogun ofron një bazë të fortë të informacionit për vendimmarrjen e ardhshme në lidhje me furnizimin me energji të ngrohjes për komunitetin e qytetit. Ky studim siguron një strategji të qëndrueshme dhe të përgjegjshme për të ardhmen e furnizimit me ngrohje për Istogun dhe për zhvillimin e qytetit në përgjithësi.</li> <li>- Pas përfundimit të studimit do të bëhet projekti inxhinierik për sistemin dhe pastaj do të bëhet instalimi, gjëgjësisht ndërtimi i sistemi qendror i ngrohjes në distancë për ngrohjen e hapësirave në ndërtesat në qytetin e Istogut. Burimet energjisë që do të përdoren do të jena ato që do të rekomandohen nga Studimi i fizibilitetit dhe që mund të përfshijnë përdorimin e ashklave nga biomasa drusore, apo edhe energjinë diellore nga kolektorët diellorë apo gjithashtu mund të përfshijnë edhe përdorimin e pompave termike.</li> </ul>
--	---

### 6.1.3. Transporti publik në Istog

Transporti publik në Istog është një pjesë kritike e infrastrukturës urbane, duke ofruar një shërbim të rëndësishëm për banorët dhe vizitorët e qytetit. Për momentin, ka një gamë të gjerë shërbimesh të transportit publik, duke filluar nga autobusët që ofrojnë transport të rregullt nëpër rrugët kryesore të qytetit deri te mini-busët që lidhin Istogun me qytete të tjera në Kosovë dhe më gjerë.

Për të përmirësuar transportin publik në Istog, janë ndërmarrë një sërë përpjekjesh. Prioritet ka qenë modernizimi i flotës së autobusëve, duke sjellë autobusë të rinj dhe më të përshtatshëm për nevojat e qytetarëve. Infrastruktura rrugore është gjithashtu përmirësuar për të lehtësuar qarkullimin dhe për të bërë rrugët më të sigurta për përdoruesit e transportit publik. Në stacionet e autobusëve, janë ndërmarrë masa për të përmirësuar shërbimet dhe sigurinë për udhëtarët, duke përfshirë rregullimin e informacionit për oraret e udhëtimit, instalimin e mjeteve të sigurisë, si dhe përmirësimin e infrastrukturës së stacioneve për të bërë qëndrimin më të rehatshëm për udhëtarët.

Gjithashtu, është punuar për të zgjeruar rrjetin e transportit publik për të përshkruar më shumë zona të qytetit dhe për të ofruar shërbime më të mira për qytetarët në zonat rurale dhe të largëta. Në përgjithësi, investimet dhe përmirësimet në transportin publik të Istogut janë të rëndësishme për të përmirësuar cilësinë e jetës së banorëve dhe për të promovuar një qytetari të qëndrueshme dhe të përgjegjshme. Kjo kërkon një angazhim të vazhdueshëm për të investuar në infrastrukturën dhe shërbimet e transportit publik, si dhe për të promovuar përdorimin e saj si zgjedhje të preferuar për lëvizjet urbane.

Tabela 37. Hartimi i planit të mobilitetit për dekarbonizimin e transportit në Komunën e Istogut

<b>Numri rendor i masës</b>	15
<b>Emërtimi i masës</b>	Hartimi i planit të mobilitetit për dekarbonizimin e transportit në Komunën e Istogut.
<b>Përfshirja në listën prioritare të projekteve</b>	JO
<b>Bartësi i zbatimit</b>	Komuna e Istogut
<b>Partneri në zbatim</b>	MMPHI
<b>Palët tjera të përfshira</b>	Donatorët, Kompanitë konsulente
<b>Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)</b>	2025-2026
<b>Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)</b>	100,000
<b>Vlerësimi i kursimit të energjisë (MWh)</b>	-
<b>Vlerësimi i uljes së emetimeve (tCO<sub>2</sub>)</b>	-
<b>Burimi i financimit</b>	Buxheti komunal, MMPHI, Donatorët
<b>Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi</b>	<p>Hartimi i planit të mobilitetit për dekarbonizimin e transportit në Komunën e Istogut përshkruan një strategji të strukturuar për të përmirësuar qarkullimin urban dhe për të reduktuar ndikimin e transportit në ndryshimet klimatike në nivel lokal.</p> <p>Ky plan përfshin një analizë të hollësishme të situatës aktuale të transportit në qytet, duke përfshirë studimin e llojeve të transportit të përdorura aktualisht, volumin e trafikut, problemet e trafikut, dhe ndotjen mjedisore nga transporti. Bazuar në këtë analizë, plani i mobilitetit harton objektivat afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata për të përmirësuar qarkullimin dhe për të ndikuar në mënyrë pozitive në mjedisin e qytetit.</p> <p>Për të arritur qëllimet e përcaktuara, plani i mobilitetit duhet të përshkruajë një sërë masash dhe projektesh konkrete, duke përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Promovimi i transportit publik: Nxitja e përdorimit të transportit publik përmes uljes së kostove, zgjerimit të rrjetit të linjave, dhe përmirësimit të shërbimeve.</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Stimulimi i transportit të qëndrueshëm: Inkurajimi i përdorimit të mjetve të qëndrueshme, si biçikleta dhe makinat elektrike, përmes investimeve në infrastrukturë dhe ofrimin e incentivave financiare.</li> <li>- Rregullimi i trafikut: Rritja e sigurisë rrugore dhe ulja e bllokimeve duke zbatuar politika të qarkullimit të qëndrueshëm dhe duke ndërtuar infrastrukturë të përshtatshme për të lehtësuar qarkullimin.</li> <li>- Promovimi i shërbimeve të ndarjes së makinave: Inkurajimi i përdorimit të shërbimeve të ndarjes së makinave për të zvogëluar numrin e makinave private në qytet.</li> <li>- Hulimtim dhe zhvillimi i energjisë së qëndrueshme: Investimi në teknologji të reja për transportin publik dhe për zhvillimin e infrastrukturës së mbushjes së makinave elektrike.</li> <li>- Përmes implementimit të këtyre masave dhe projekteve të përcaktuara në Planin e Mobilitetit, Komuna e Istogut synon të përmirësojë cilësinë e jetës për banorët e saj duke promovuar një transport më të qëndrueshëm dhe më të pastër për mjedisin.</li> </ul>
--	---

Tabela 38. Ndërtimi i rrugëve, trotuarëve dhe shpateve të trotuarëve në qytetin e Istogut

<b>Numri rendor i masës</b>	16
<b>Emërtimi i masës</b>	Ndërtimi i rrugëve, trotuarëve dhe shpateve (pjerrinave) të trotuarëve në qytetin e Istogut
<b>Përfshirja në listën prioritare të projekteve</b>	PO (79%)
<b>Bartësi i zbatimit</b>	Komuna e Istogut
<b>Partneri në zbatim</b>	
<b>Palët tjera të përfshira</b>	Donatorët
<b>Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)</b>	2025-2028
<b>Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)</b>	185,000.00
<b>Vlerësimi i kursimit të energjisë (MWh)</b>	-
<b>Vlerësimi i uljes së emetimeve (tCO<sub>2</sub>)</b>	-
<b>Burimi i financimit</b>	Buxheti i Komunës së Istogut
<b>Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi</b>	<p>Ndërtimi i shpateve të trotuarëve për Istogun është një masë e rëndësishme për përmirësimin e infrastrukturës urbane dhe sigurisë së këmbësorëve në qytet. Kjo përfshin ndërtimin e hapësirave shtesë në anët e trotuarëve, të cilat janë të dedikuara për këmbësorët, duke i dhënë më shumë hapësirë ata për ecje të lirë dhe të sigurtë.</p> <p>Rregullimi i trotuarëve do të ndihmojë në promovimin e ecjes</p>

	<p>dhe do të ndikoj në zvogëlimin e përdorimit të makinave që kontribuon direkt në zvogëlimin e emetimeve të CO<sub>2</sub>.</p> <p>Masat do të përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Ndërtimi i shtigjeve për këmbësorë në qytet dhe vendosja e shtegut në trotuare për orientim të personave me shikim të dobët dhe personave të verbër;</li> <li>– Ndërtimi i shpateve (pjerrinave) në trotuare për të mundësuar kalimin e karrocave të personave me nevoja të veçanta dhe nënave/prindërve me karroca fëmijësh;</li> </ul> <p>Shenjëzimi i shiritave për levizje me karroca të personave me nevoja të veçanta dhe nënave/prindërve me karroca fëmijëshMe ndërtimin e shpateve të trotuareve, qyteti i Istogut investon në sigurinë rrugore dhe komfortin e qytetarëve të tij. Këto shpate ofrojnë një rrugë alternative për këmbësorët, duke i larguar ata nga rrugët e trafikuar dhe duke i shpërndarë ata në trotuar, ku ata mund të ecin më lirshëm dhe më të qetë.</p> <p>Përveçse ndihmon në sigurinë rrugore, ndërtimi i shpateve të trotuareve gjithashtu promovon një stil jetese më aktive dhe të shëndetshme për banorët e Istogut. Kjo hapësirë shtesë për ecje nxit aktivitetet fizik dhe ndihmon në promovimin e një mjedisi më tërheqës dhe më të shëndetshëm në qytet.</p>
--	--

Tabela 39. Ndërtimi i shtigjeve për biçikleta

<b>Numri rendor i masës</b>	17
<b>Emërtimi i masës</b>	Ndërtimi i shtigjeve për biçikleta
<b>Përfshirja në listën prioritare të projekteve</b>	PO (76%)
<b>Bartësi i zbatimit</b>	Komuna e Istogut
<b>Partneri në zbatim</b>	
<b>Palët tjera të përfshira</b>	MMPHI, Donatorët
<b>Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)</b>	2025-2028
<b>Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)</b>	100,000.00
<b>Vlerësimi i kursimit të energjisë (MWh)</b>	-
<b>Vlerësimi i uljes së emetimeve (tCO<sub>2</sub>)</b>	1,087.68
<b>Burimi i financimit</b>	Buxheti komunal, MMPHI, Donatorët
<b>Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi</b>	Istogu është një komunë e përkushtuar në promovimin e mënyrave të qëndrueshme dhe aktive të transportit. Si pjesë e zbatimit të masave të Planit të Mobilitetit, do të ndërmarren masa të rëndësishme për të përmirësuar infrastrukturën për



	<p>biçikletat dhe lëvizjen aktive këmbësore.</p> <p>Një nga këto masa përfshin trajtimin e shtigjeve për biçikleta në të gjithë territorin e komunës që përfshinë ndërtimin e shtigjevetë dedikuara për biçikletat për të siguruar një mënyrë të sigurt dhe të përshtatshme për qytetarët dhe vizitorët për të lëvizur nëpër qytet.</p> <p>Prioriteti i ndërtimit të shtigjeve të biçikletave do të jetë për qytetin e Istogut dhe lidhjen e fshatrave më të afërta me shtigje të biçikletave.</p> <p>Këto masa tregojnë përkushtimin e komunës së Istogut për të krijuar një mjedis urban tërheqës dhe të qëndrueshëm për banorët dhe për të përmbushur nevojat e tyre për një lëvizje më të shëndetshme dhe më të qëndrueshme. Natyrisht, kjo masë do të ndikoj në zvogëlimin e përdorimit të makinave dhe zvogëlimin e emetimeve të CO<sub>2</sub>.</p>
--	--

Tabela 40. Instalimi i pikave për mbushjen e biçikletave elektrike

<b>Numri rendor i masës</b>	18
<b>Emërtimi i masës</b>	Instalimi i pikave për mbushje për biçikleta dhe trotineta elektrike në tërë territorin e komunës, përfshirë pikat e turizmit rural.
<b>Përfshirja në listën prioritare të projekteve</b>	PO (52%)
<b>Bartësi i zbatimit</b>	Komuna e Istogut
<b>Partneri në zbatim</b>	
<b>Palët tjera të përfshira</b>	ME, Donatorët
<b>Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)</b>	2025-2028
<b>Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)</b>	100,000.00
<b>Vlerësimi i kursimit të energjisë (MWh)</b>	-
<b>Vlerësimi i uljes së emetimeve (tCO<sub>2</sub>)</b>	362.56
<b>Burimi i financimit</b>	Buxheti komunal, ME, Donatorët
<b>Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi</b>	<p>Për të promovuar përdorimin e biçikletave dhe mbrotjen e ndotjes së mjedisot nga transporti, Komuna e Istogut do të ndërtoj pika mbushëse për biçikleta dhe trotineta pranë shtigjeve për biçikleta në vende të caktuara që janë më shumë të frekuentuara apo në afërsi të institucioneve shkollore, administrative, apo edhe qendrave tregtare.</p> <p>Gjithashtu pikat mbushëse do të vendosen edhe në zonat atraktive turistike që janë në territorin e Komunës së Istogut.</p>

Tabela 41. Promovimi, informimi, dhe ndërgjegjësimi - rëndësia e trafikut të biçikletave

<b>Numri rendor i masës</b>	19
<b>Emërtimi i masës</b>	Ndërgjegjësimi/promovimi i rëndësisë së trafikut të biçikletave e këmbësorëve dhe zhvillimi i iniciativave për reduktimin e përdorimit të automjeteve
Përfshirja në listën prioritare të projekteve	PO (57 %)
<b>Bartësi i zbatimit</b>	Komuna e Istogut
<b>Partneri në zbatim</b>	Organizatat e shoqërisë civile (OSHC)
<b>Palët tjera të përfshira</b>	MMPHI, Donatorët
<b>Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)</b>	2026 - 2028
<b>Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)</b>	20,000
<b>Vlerësimi i kursimit të energjisë (MWh)</b>	-
<b>Vlerësimi i uljes së emetimeve (tCO<sub>2</sub>)</b>	1,087.68
<b>Burimi i financimit</b>	Buxheti komunal, MMPHI, Donatorët
<b>Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi</b>	<p>Ndërgjegjësimi dhe promovimi i trafikut të biçikletave dhe këmbësorëve në Komunën e Istogut janë pjesë e një përpjekje të gjerë për të promovuar transportin mjedisor dhe shëndetësor në qytet. Kjo iniciativë synon të ndërgjegjësojë qytetarët për rëndësinë e mjeteve të transportit me emision të ulët dhe të promovojë një kulturë të re të qarkullimit në qytet, duke iu dhënë prioritet biçikletave dhe këmbësorëve.</p> <p>Përmes fushatave të informimit dhe ndërgjegjësimit nëpërmjet mediave të ndryshme, qytetarët janë të informuar për përfitimet e përdorimit të biçikletave dhe këmbësorëve, përfshirë përfitimet për shëndetin, mjedisin dhe qarkullimin në qytet.</p> <p>Organizimi i aktiviteteve komunitare: Ngjarje të ndryshme si marshime të biçikletave dhe gara organizohen për të ndërgjegjësuar dhe inkurajuar përdoruesit e potencialë të këtyre mjeteve të transportit.</p> <p>Bashkëpunimi me organizatat dhe shoqëritë civile: Komuna bashkëpunon me organizata dhe shoqëri civile për të rritur ndërgjegjësimin dhe përdorimin e biçikletave dhe këmbësorëve në qytet.</p> <p>Këto përpjekje synojnë të krijojnë një mjedisi më të përshtatshëm dhe më të sigurt për përdoruesit e biçikletave dhe këmbësorëve në Komunën e Istogut, duke kontribuar në përmirësimin e trafikut urban, shëndetit publik dhe cilësisë së mjedisit.</p>

Tabela 42. Renovim i rrugëve ekzistuese në lokacionet atraktive turistike

<b>Numri rendor i masës</b>	20
-----------------------------	----

<b>Emërtimi i masës</b>	Renovim i rrugëve ekzistuese në lokacionet atraktive turistike malore
<b>Përfshirja në listën prioritare të projekteve</b>	PO (70%)
<b>Bartësi i zbatimit</b>	Komuna e Istogut
<b>Partneri në zbatim</b>	Qeveria e Kosovës
<b>Palët tjera të përfshira</b>	Ministria për Zhvillim Rajonal (MZHR), Donatorë
<b>Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)</b>	2025-2030
<b>Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)</b>	3,000,000.00
<b>Vlerësimi i gjenerimit të energjisë nga BRE (MWh)</b>	-
<b>Vlerësimi i uljes së emetimeve (tCO<sub>2</sub>)</b>	362.56
<b>Burimi i financimit</b>	Buxheti i Komunës së Istogut, Ministria për Zhvillim Rajonal (MZHR), Donatorët
<b>Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Komuna e Istogut, e vendosur në zemër të maleve të Rugovës në Kosovë, është një destinacion i veçantë turistik për ata që janë tërhequr nga bukuria natyrore dhe kultura e këtij rajoni. Për të përshkruar përmirësimin e transportit dhe renovimin e rrugëve ekzistuese në këtë komunë, duhet të theksohet roli i tyre në përmirësimin e qasjes dhe eksplorimit të atraksioneve të turizmit.</li> <li>- Për fillim, transporti në këtë zonë është kritik për të siguruar qasje të lehtë për turistët dhe vendasit në destinacionet kryesore turistike. Rrugët ekzistuese që lidhin qytetet, fshatrat, dhe atraksionet kryesore turistike janë thelbësore për zhvillimin e turizmit. Përmirësimi i këtyre rrugëve do të ndikojë drejtpërdrejt në përmirësimin e infrastrukturës së transportit publik dhe privat.</li> <li>- Në veçanti, renovimi i rrugëve në lokacionet turistike kryesore si Shpella e Radacit, Liqeni i Rugovës, dhe stacionet e skijimit në Rugovë do të ndihmojë në rritjen e atraktivitetit të këtyre destinacioneve. Kjo gjithashtu mund të përfshijë zgjerimin e rrugëve, përmirësimin e shenjave rrugore dhe ndërhyrjet për të përmirësuar sigurinë dhe qasjen në këto zona.</li> <li>- Përveç kësaj, investimet në transportin lokal mund të përfshijnë edhe zgjerimin e rrjetit të transportit publik nëpër komunë për të lehtësuar lëvizjen e vendasve dhe turistëve brenda territorit. Kjo do të bëjë të mundur që edhe ata që nuk kanë qasje në mjetin e tyre të lëvizin lehtësisht për të eksploruar bukurinë e kësaj zone.</li> <li>- Në një pikëpamje më të gjerë, përmirësimi i transportit dhe renovimi i rrugëve në komunën e Istogut do të ndikojë drejtpërdrejt në zhvillimin e turizmit lokal dhe në rritjen e ekonomisë së zonës duke sjellë më shumë turistë dhe ndihmës për vendasit. Kështu, kjo nxitje në infrastrukturën e</li> </ul>

	transportit do të sjellë përparim të qëndrueshëm dhe zhvillim për komunën e Istogut.
--	--

Tabela 43. Ndërtimi i shtigjeve për lëvizje aktive për ecje, këmbësorë.

<b>Numri rendor i masës</b>	21
<b>Emërtimi i masës</b>	Ndërtimi i shtigjeve për lëvizje aktive për ecje, këmbësorë.
<b>Përfshirja në listën prioritare të projekteve</b>	PO (76%)
<b>Bartësi i zbatimit</b>	Komuna e Istogut
<b>Partneri në zbatim</b>	Qeveria e Kosovës
<b>Palët tjera të përfshira</b>	Ministria për Zhvillim Rajonal (MZhR), MMPHI, Donatorët
<b>Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)</b>	2025-2028
<b>Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)</b>	50,000.00
<b>Vlerësimi i kursimit të energjisë (MWh)</b>	-
<b>Vlerësimi i gjenerimit të energjisë nga BRE (MWh)</b>	181.28
<b>Vlerësimi i uljes së emetimeve (tCO<sub>2</sub>)</b>	
<b>Burimi i financimit</b>	Buxheti i Komunës së Istogut, Ministria për Zhvillim Rajonal (MZhR), MMPHI, Donatorët
<b>Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndërtimi i shtigjeve për lëvizje aktive, të dedikuara për këmbësorë, është një iniciativë e rëndësishme për të përmirësuar infrastrukturën urbane në Istog dhe për të inkurajuar një mënyrë të shëndetshme dhe të qëndrueshme të transportit. Kjo masë synon të krijojë një ambient më tërheqës dhe më të sigurt për këmbësorët, duke përmirësuar sigurinë rrugore dhe duke promovuar një stil jetese më aktive.</li> <li>- Ndërtimi i shtigjeve të dedikuara për këmbësorë ofron një rrugë alternative për udhëtimin, e cila redukton rrezikun e aksidenteve dhe kontribuon në zvogëlimin e ngufatje të trafikut në rrugët kryesore. Këto shtigje janë të projektuara për të përmbushur nevojat e përdoruesve të lëvizjes aktive, duke ofruar një mjet të sigurt dhe tërheqës për të udhëtuar në qytet.</li> </ul>

Tabela 44. Instalimi i pikave të mbushjes së baterive për automjetet elektrike nga modulet fotovoltaike (PV)

<b>Numri rendor i masës</b>	22
<b>Emërtimi i masës</b>	Instalimi i pikave të mbushjes së baterive për automjetet (automobilat) elektrikë nga modulet fotovoltaike (PV)
<b>Përfshirja në listën prioritare</b>	PO (52 %)

të projekteve	
<b>Bartësi i zbatimit</b>	Komuna e Istogut
<b>Partneri në zbatim</b>	ME
<b>Palët tjera të përfshira</b>	Donatorët
<b>Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)</b>	2025-2030
<b>Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)</b>	100,000.00
<b>Vlerësimi i kursimit të energjisë (MWh)</b>	-
<b>Vlerësimi i uljes së emetimeve (tCO<sub>2</sub>)</b>	133.1
<b>Burimi i financimit</b>	Buxheti komunal, ME, Donatorët
<b>Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Instalimi i pikave të mbushjes së baterive për automjetet me panele diellore (PV) është një masë inovative dhe e rëndësishme në Istog për të promovuar përdorimin e makinave elektrike dhe për të ulur ndotjen e mjedisit. Kjo iniciativë synon të krijojë një infrastrukturë të përshtatshme për pronarët e makinave elektrike, duke u mundësuar atyre të mbushin bateritë e tyre në mënyrë të lehtë dhe të rehatshme, për të vazhduar udhëtimet e tyre.</li> <li>- Këto pikë mbushjeje janë të vendosura në pikat strategjike nëpër qytet, duke përfshirë zonat qendrore dhe të biznesit, si dhe rrugët kryesore të trafikut. Instalimi i tyre në lidhje me panelet diellore (PV) siguron një burim të qëndrueshëm energjie dhe ul koston e energjisë së përdorur për të mbushur bateritë e makinave elektrike.</li> <li>- Përveçse ndihmon në përhapjen e përdorimit të makinave tërheqëse për mjedisin, instalimi i këtyre pikave të mbushjes së baterive për automjetet me PV gjithashtu kontribuon në zvogëlimin e ndotjes së ajrit dhe uljen e emetimeve të gazrave të efektit serrë, duke përmirësuar në këtë mënyrë cilësinë e ajrit në qytet.</li> <li>- Kjo masë shërben si një hap drejt një qyteti më të qëndrueshëm dhe më të pastër, duke inkurajuar përdorimin e teknologjisë së pastër dhe të energjisë së ripërtëritshme në transport, dhe duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve të Istogut.</li> </ul>

Tabela 45. Elektrifikimi i flotës së automjeteve të transportuesve privatë për shërbimet taxi

<b>Numri rendor i masës</b>	23
<b>Emërtimi i masës</b>	Elektrifikimi i flotës së automjeteve të transportuesve privatë për shërbimet taxi
<b>Përfshirja në listën prioritare</b>	JO

të projekteve	
<b>Bartësi i zbatimit</b>	Komuna e Istogut
<b>Partneri në zbatim</b>	Kompanitë e shërbimeve taxi
<b>Palët tjera të përfshira</b>	Donatorët, Bankat
<b>Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)</b>	2025-2030
<b>Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)</b>	1,500,000.00
<b>Vlerësimi i kursimit të energjisë (MWh)</b>	-
<b>Vlerësimi i uljes së emetimeve (tCO<sub>2</sub>)</b>	158.85
<b>Burimi i financimit</b>	Buxheti komunal, Donatorët, Pronarët e makinave taxi
<b>Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Elektrifikimi i flotës së automjeteve të transportuesve privatë, siç janë taksitë, është një masë me rëndësi për të zvogëluar ndotjen e mjedisit dhe për të promovuar një transport më të qëndrueshëm dhe më të pastër në qytet. Kjo iniciativë synon të zëvendësojë automjetet tradicionale me ato elektrike, duke përdorur burime të energjisë më të pastër dhe më të qëndrueshme.</li> <li>- Përmes elektrifikimit të flotës së taksive, autoritetet lokale inkurajojnë përdorimin e makinave me zero emetim të gazrave të ndotjes së ajrit, duke ulur ndikimin e tyre në cilësinë e ajrit dhe duke kontribuar në përmirësimin e mjedisit urban. Kjo masë gjithashtu ndihmon në uljen e nivelit të zhurmës në qytet dhe në zvogëlimin e kosto-efektivitetit të operacioneve të transportit.</li> <li>- Një studim i realizuar nga Agjencia Amerikane e Energjisë (EPA) tregoi se automjetet elektrike kanë një efikasitet mesatare më të lartë (rreth 60-70%) në krahasim me automjetet me motor me djegie të brendshëm (rreth 20-30%). Kjo tregon një potencial të madh për kursimin e energjisë nëse flota e automjeteve kalon nga karburanti i tradicional në elektricitet.</li> <li>- Përveç përfitimeve mjedisore, elektrifikimi i flotës së taksive gjithashtu ofron një përvojë më të përshtatshme dhe më të modernizuar për pasagjerët, duke ofruar një alternativë më tërheqëse për transportin urban. Gjithashtu, kjo iniciativë inkurajon zhvillimin dhe përdorimin e teknologjisë së pastër në fushën e transportit, duke kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit për mjedisin dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës për banorët.</li> </ul>

#### e. Flota komunale e automjeteve

Flota komunale e automjeteve për Komunën e Istogut është një nga fushat ku ka potencial të madh për përparim dhe modernizim, përfshirë dhe përdorimin e mjeteve elektrike. Në këtë drejtim, ka disa hapa që mund të merren për të promovuar dhe zbatuar elektrifikimin e flotës komunale:

**Investime në mjetet elektrike:** Autoritetet vendore mund të investojnë në blerjen e mjeteve elektrike për flotën e tyre komunale. Kjo përfshin automjete të tilla si autobusë elektrikë për transportin publik, makinat elektrike për shërbimet komunale si mbledhja e mbeturinave dhe shërbimet e pastrimit të qytetit.

**Infrastruktura e nevojshme:** Është e rëndësishme të zhvillohet infrastruktura për mbushjen e mjeteve elektrike. Kjo përfshin ndërtimin e stacioneve të ngarkimit të shpejtë dhe të ngarkimit të shëndetshëm nëpër qytet për të lehtësuar përdorimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve elektrike.

**Incentivat për përdorimin e mjeteve të pastër:** Autoritetet vendore mund të ofrojnë incentiva për kompanitë private dhe qytetarët për të blerë dhe përdorur automjetet elektrike. Kjo mund të përfshijë taksa të ulëta regjistrimi, taksa të reduktuara parkimi për mjetet elektrike, dhe përfitime tjera fiskale për pronarët e mjeteve elektrike.

**Ndërgjegjësim dhe edukim:** Është e rëndësishme të ndërgjegjësohet publiku për përfitimet e përdorimit të mjeteve elektrike. Kampanjat dhe programe të ndërgjegjësimit mund të ndihmojnë në rritjen e ndërgjegjësimit për ndikimin e makinave tradicionale në mjedis dhe për përfitimet e kalimit drejt mjeteve të pastër.

Përmirësimi i flotës komunale të automjeteve në Istog drejt një mjedisi më të pastër dhe më të qëndrueshëm është një hap kyç për zhvillimin e qytetit dhe për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve të tij.

Tabela 45. Zëvendësimi i 10 deri 15 automjete të flotës komunale me ato elektrike deri në vitin 2030

<b>Numri rendor i masës</b>	24
<b>Emërtimi i masës</b>	Zëvendësimi i 10 deri 15 automjete të flotës komunale me ato elektrike deri në vitin 2030
<b>Përfshirja në listën prioritare të projekteve</b>	PO (36%)
<b>Bartësi i zbatimit</b>	Komuna e Istogut
<b>Partneri në zbatim</b>	
<b>Palët tjera të përfshira</b>	Donatorët
<b>Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)</b>	2025-2030, Kjo masë do të zbatohet gradualisht
<b>Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)</b>	360,000.00
<b>Vlerësimi i kursimit të energjisë (MWh)</b>	-
<b>Vlerësimi i uljes së emetimeve (tCO<sub>2</sub>)</b>	76.25
<b>Burimi i financimit</b>	Buxheti i Komunës së Istogut, Donatorët, Bankat
<b>Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi</b>	Në kuadër të masës për ndërrimin e makinave të flotës komunale me makinat elektrike në Komunën e Istogut deri në vitin 2030, synohet zëvendësimi gradual i 10 deri në 15

	<p>automjeteve ekzistuese me makinat elektrike. Kjo masë ka për qëllim të përparojë në drejtim të një flote më të pastër dhe më të qëndrueshme, duke kontribuar në reduktimin e ndikimit negativ të transportit në mjedis dhe promovimin e teknologjisë së energjisë së qëndrueshme.</p> <p>Hapat konkret për të zbatuar këtë masë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Identifikimi i automjeteve për zëvendësim: Identifikimi i automjeteve të flotës komunale që mund të zëvendësohen me makinat elektrike, duke u përqendruar në ato që janë më të vjetra dhe me shpenzime më të larta për mirëmbajtje dhe përdorim.</li> <li>– Hulimtim dhe blerja e makinave elektrike: Kërkimi i mundësive për blerjen e makinave elektrike të përshtatshme për nevojat e komunës së Istogut dhe procedurat për të siguruar financa për blerjen e tyre.</li> <li>– Zhvillimi i infrastrukturës së nevojshme: Ndërtimi i stacioneve të mbushjes (karikimin) për makinat elektrike në territorin e komunës së Istogut, për të siguruar një infrastrukturë të përshtatshme për përdorimin dhe mirëmbajtjen e tyre.</li> <li>– Ndërgjegjësimi dhe edukimi i personelit: Trajnimi i personelit të përfshirë në përdorimin dhe mirëmbajtjen e makinave elektrike, duke i njohur ata me karakteristikat dhe teknologjitë e reja të këtyre makinave.</li> </ul> <p>Kjo masë synon të jetë një hap konkret drejt përmirësimit të cilësisë së ajrit dhe të mjedisit në qytetin e Istogut, si dhe në përmirësimin e efieciencës dhe qëndrueshmërisë së flotës komunale të automjeteve.</p>
--	--

#### 6.1.4. Ndrichiimi Publik

Ndrichiimi publik i rrugëve është një aspekt i rëndësishëm për qytetin e Istogut, duke u kthyer në një prioritet për autoritetet vendore. Si një qytet në zhvillim në Kosovë, Istogu ka përjetuar një rritje të shpejtë në vitet e fundit, dhe përmirësimi i infrastrukturës urbane, përfshirë ndriçimin e rrugëve, ka qenë një fokus i veçantë.

Në dekadën e fundit, përpjekjet për të përmirësuar ndriçimin në rrugët e Istogut kanë qenë të dukshme. Autoritetet vendore kanë investuar në zëvendësimin e dritave të vjetra me teknologji më efieçiente si dritat LED, duke synuar të ulin konsumin e energjisë dhe të rrisin cilësinë e ndriçimit. Përveç kësaj, janë bërë investime në instalimin e semaforëve të rinj dhe shenjave të rrugëve për të rritur sigurinë dhe qarkullimin e lehtë në qytet.

Megjithatë, ende ka nevojë për përmirësime dhe investime të mëtejshme në ndriçimin e rrugëve në Istog, veçanërisht në zonat me trafik të lartë dhe në qendrën e qytetit. Përmirësimi i ndriçimit publik do të ndihmojë në rritjen e sigurisë rrugore, uljen e rreziqeve të aksidenteve dhe ndihmën në shkëputjen e qytetit nga errësira natyrore, duke bërë kështu Istogun një destinacion më tërheqës për banorët dhe vizitorët.

Tabela 46. Krijimi i ndriçimit rrugor të “mençur” në tërë territorin e komunës



<b>Numri rendor i masës</b>	25
<b>Emërtimi i masës</b>	Krijimi i ndriçimit rrugor të “mençur” në tërë territorin e komunës
<b>Përfshirja në listën prioritare të projekteve</b>	PO (82%)
<b>Bartësi i zbatimit</b>	Komuna e Istogut
<b>Partneri në zbatim</b>	ME, FKEE
<b>Palët tjera të përfshira</b>	Donatorët, Kompanitë që punojnë në fushën e ndriçimit të rrugëve, Kompanitë që ofrojnë shërbime të energjisë
<b>Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)</b>	2025-2027
<b>Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)</b>	250,000.00
<b>Vlerësimi i kursimit të energjisë (MWh)</b>	161.5
<b>Vlerësimi i uljes së emetimeve (tCO<sub>2</sub>)</b>	169.7
<b>Burimi i financimit</b>	Buxheti i Komunës së Istogut, ME, FKEE
<b>Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi</b>	<p>Në këtë masë, synohet krijimi i një sistemi të mençur të ndriçimit rrugor në të gjithë territorin e komunës së Istogut. Kjo përfshin instalimin e teknologjive moderne të ndriçimit, si dritat LED dhe sistemet e automatizuara të ndriçimit, në mënyrë që të sigurohet një përdorim më eficient i energjisë dhe një ndriçim më i mirë i rrugëve nëpër të gjitha zonat e qytetit.</p> <p>Krijimi i një sistemi të mençur të ndriçimit rrugor do të sjellë përparime të rëndësishme në qytetarinë e Istogut. Nëpërmjet kësaj mase, pritet të realizohen disa avantazhe:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Eficiencë energjetike: Teknologjitë e ndriçimit të mençur, si dritat LED, përdorin energji më pak se sistemet tradicionale të ndriçimit. Kjo do të çojë në uljen e konsumit të energjisë dhe në reduktimin e kostove për energjinë elektrike.</li> <li>– Ndriçim më i mirë: Instalimi i dritave LED dhe sistemeve të automatizuara të ndriçimit do të sigurojë një ndriçim më të qëndrueshëm dhe më të përshtatshëm për nevojat e trafikut rrugor në të gjitha kohërat e ditës.</li> <li>– Siguri Rrugore: Ndriçimi i përmirësuar do të ndikojë pozitivisht në sigurinë rrugore, duke përmirësuar dukshmërinë dhe njohjen e kushteve të rrugës për shoferët dhe për udhëtarët.</li> <li>– Përparim urban: Krijimi i një ndriçimi rrugor të mençur do të përmirësojë pamjen urbane të qytetit dhe do të rrisë komoditetin dhe sigurinë për banorët dhe vizitorët e Istogut.</li> </ul> <p>Përmes kësaj mase, qeverisja lokale synon të krijojë një ambient më tërheqës dhe më të qëndrueshëm për qytetarët dhe për të gjithë ata që e përdorin rrugët në territorin e komunës së Istogut.</p>

## 6.2. Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike

Përshtatja ndaj ndryshime klimatike sipas Ligjit nr. 08/L-250 për ndryshime klimatike (neni 3 paragrafi 1.20), përkufizohet si *ndërmarrja e veprimeve të duhura për të parandaluar ose minimizuar dëmet dhe efekte që mund të shkaktojnë ndryshime klimatike, ose përfitimin nga mundësitë që mund të shfaqen dhe parashikohen nga to.*

Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike është një temë e detyrueshme e Planit të Veprimit për Energji të Qëndrueshme dhe Klimë për komunën e Istogut. Aktivitete që lidhen me përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike kanë për qëllim reduktimin e cenueshmërisë së sistemeve natyrore dhe sociale ndaj ndryshimeve klimatike dhe rritjen e rezistencës së tyre ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike, si dhe shfrytëzimit e efekteve të mundshme pozitive që janë pasojë e ndryshimeve klimatike.

Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike është prezantuar në kuadër të Planit të Veprimit përmes një plani masash përshtatëse në ndryshimet klimatike. Masat e përshtatjes ndaj ndryshime klimatike janë si rrjedhojë e një analize paraprake mbi vlerësimin e riskut dhe cënueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike në komunën e Istogut dhe analizës së rrezikut dhe vlerësimin e cenueshmërisë së sektorëve individualë ndaj ndikimeve ndryshimi i klimës.

### 6.2.1. Sektori i ndërtimit

Zhvillimi dhe investimi në sektorin e ndërtimit është vazhdimisht nën presionin e ndryshimit të kushteve klimatike dhe gjithashtu i ndërlidhur me ngjarje ekstreme të motit. Për shkak të nevojës për qëndrueshmëri të ndërtesave dhe duke marrë në konsideratë vlerën e madhe ekonomike që ka infrastruktura, gatishmëria dhe rezistenca ndaj ndikimeve të ardhshme e shkaktuar nga ndryshimet klimatike është jashtëzakonisht e rëndësishme.

Ndikimi i ndryshimeve klimatike prek veçanërisht industrinë e ndërtimit për shkak të jetëgjatësisë së ndërtesave dhe për shkak të domosdoshmërisë dhe nevojës për të restauruar objektet ekzistuese për përballimin e këtyre kushtet klimatike që janë ose do të jenë të ndryshme nga ato në kohën kur janë projektuar dhe ndërtuar.

Sfidat kryesore për sektorin e ndërtimit dhe infrastrukturës së ndërtesave që kërkojnë aktivitete që duhet të zhvillohen në horizontet kohore relativisht të shkurtra janë:

- Sasia ekstreme e reshjeve, që shkaktojnë ndikime përmes depërtimit të ujit, dëmtimit të themeleve dhe nëntokës së ndërtesave, shkatërrimin e ndërtesave dhe infrastrukturës përcjellëse të tyre, etj.;
- Valët e të nxehtit ekstrem, që shkaktojnë ndikime përmes dëmtimit dhe plakjes së përshpejtuar të materialeve, reduktimit të komoditeti të jetesës dhe efekteve të mundshme negative në shëndetin e njeriut, rritjen e sasisë së energjisë që nevojiten për ftohje të ndërtesave, etj.;
- Ekspozimi i ndërtesave ndaj sasive të mëdha të reshjeve të bores, që shkaktojnë dëme kryesisht në kulmet e tyre;
- Rreziku i rrëshqitjes së tokës i cili rrit nevojën për rritjen e e qëndrueshmërisë së strukturave të ndërtesës duke rritur themelet e tyre.
- Rreziku nga stuhitë ku ndërtesat mund të jenë të ndjeshme varësisht nga mënyra se si janë projektuar (p.sh. të ulëta rezistenca ndaj ngjarjeve ekstreme të motit si stuhitë) ose për shkak të vendndodhjes ku janë ndërtuar (ekspozimi ndaj erërave).

Tabela 47. Hartëzimi i nevojave të ndërtesave për zbatimin e teknologjive të gjelbra

Numri rendor i masës	1
Përfshirja në listën prioritare të projekteve	JO
Emërtimi i masës	Hartëzimi i nevojave të ndërtesave për zbatimin e teknologjive të gjelbra
Bartësi i zbatimit	Komuna e Istogut/Drejtoria e Urbanizmit
Partneri në zbatim	
Palët tjera të përfshira	
Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)	2026-2028
Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)	100,000.00
Burimi i financimit	Buxheti i Komunës
Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi	<p>Qëllimi i kësaj mase është analizimi dhe dokumenti i zbatimit të teknologjive të gjelbra në ndërtesat publike, ndërtesat e banimit kolektiv dhe ndërtesa tregtare të komunës së Istogut. Hartëzimi do të përfshijë vlerësimin e kushteve mikroklimatike të strukturave dhe lokacionet e ndërtesave në të cilat mundë të aplikohen çatitë dhe fasadat e gjelbëra. Analiza do të përfshijë po ashtu edhe propozimin për shfrytëzimin e llojeve të përshtashme bimore që i përshtaten kushteve klimatike të qytetit të Istogut, me qëllim të arritjes së efekteve optimale si dhe informacionet për kufizimet teknike për aplikimin e teknologjive të gjelbra.</p> <p>Zbatimi i këtyre masave teknike është dëshmuar se kontribuon për rritjen e efijencës të ndërtesave në përshatatje ndaj ndryshimeve klimatike, duke rritur efijencën e përbaljes ndaj valemë të të nxehtit ekstrem, apo edhe rritjen e efikasitetet të ngrohjes duke reduktuar rrezikun nga të ftoftit ekstrem, si dhe reduktimin e konsumit të ujit.</p>

Tabela 48. Aplikimi i “kulmeve të sheshta” në zona me rrezik nga stuhitë e forta

Numri rendor i masës	2
Përfshirja në listën prioritare të projekteve	PO (80%)
Emërtimi i masës	Aplikimi i “kulmeve të sheshta” në zona me rrezik nga stuhitë e forta
Bartësi i zbatimit	Komuna e Istogut/Drejtoria e Urbanizmit
Partneri në zbatim	
Palët tjera të përfshira	
Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)	2024-2030, Kjo masë do të zbatohet gradualisht
Investimi i përgjithshëm i	500,000.00

vlerësuar (€)	
Burimi i financimit	Buxheti i Komunës, Donatorët
Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi	<p>Qëllimi i kësaj mase është analizimi i nevojës së zbatimit të teknologjive të kulmeve të sheshta në ndërtesat publike në zonat e rrezikuara nga erërat e forta (stuhitë). Analiza do të përfshijë po ashtu edhe propozimin e llojeve të përshtatshme të kulmeve të rrafshta dhe materialeve që i përshtaten kushteve klimatike të qytetit të Istogut, me qëllim të arritjes së efekteve optimale si dhe informacionet për kufizimet teknike për aplikimin e teknologjive të kulmeve të sheshta.</p> <p>Zbatimi i këtyre masave teknike do të kontribuoj në rritjen e efijencës të ndërtesave në përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike, duke rritur efijencën e përbaljes ndaj stuhive të forta.</p>

### 6.2.2. Sektor i Transportit/Infrastruktura e trafikut

Efektet e ndryshimeve klimatike janë vërtetuar se kanë efekte negative në infrastrukturën rrugore, hekurudhore dhe atë mbështetëse infrastrukturën e transportit. Për shkak të ndryshimit të kushteve klimatike priten të ketë intesitet me të shpeshtë të ngjarjeve të jashtëzakonshme të motit sikurs janë reshjet e dendura në periudha të shkurtra kohore (përmytje), erëra të forta (stuhi) dhe temperature extreme (valët e të nxehtit dhe periudhat e motit jashtëzakonisht të ftohtë). Ndikimi në infrastrukturë të trafikut në përgjithësi nënkupton ulje të sigurisë, rritje të kostove të riparimit dhe mirëmbajtjen dhe ndërprerje të qarkullimit në trafik. Infrastruktura rrugore, në varësi të llojit të ndikimit, rrezikohet të ndikohet në zvogëlimin e shpejtësisë dhe fluksit të trafikut, zvogëlimin e sigurisë në komunikacion si dhe dëme të drejtpërdrejta materiale dhe rritje të kostove për shkak të riparimeve dhe mirëmbajtjes.

Rreziqet mund të përmbliidhen në disa grupe kryesore:

- Dëmtimi i infrastrukturës së transportit për shkak të ngjarjeve ekstreme të motit sikurse janë rreshjet e dendura dhe temperaturat e larta;
- Dëmtimi i infrastrukturës së trafikut për shkak të shfaqjes së rrëshqitjeve të tokës;
- Shkatërrim më i shpejtë i infrastrukturës rrugore për shkak të rritjes së temperaturave extreme;

Andaj Komuna e Istogut ka nevojë për të organizuar një reagim të shpejtë dhe efektiv ndaj shqetësimeve kryesore në infrastrukturën e trafikut të shkaktuara si rezultat i ndikimeve të ndryshimeve klimatike

Tabela 49. Studimi për rrugët e rrezikuara nga përmytjet dhe vërshimet dhe propozimi i masave mbrojtëse për zbatimin e tyre

Numri rendor i masës	3
Përfshirja në listën prioritare të projekteve	PO (77%)
Emërtimi i masës	Studimi për rrugët e rrezikuara nga përmytjet dhe vërshimet dhe propozimi i masave mbrojtëse për zbatimin e tyre
Bartësi i zbatimit	Komuna e Istogut/Drejtoria e Shërbimeve Publike
Partneri në zbatim	MMPHI/Departamenti i Rrugëve

Palët tjera të përfshira	
Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)	2025-2026
Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)	50,000.00
Burimi i financimit	Komuna e Istogut
Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi	<p>Reshjet e dendura shkaktojnë vërshime të shpeshta në rrugët e Istogut për shkak të infrastrukturës jo të përshtatshme për pranimin dhe trajtimin e ujërave atmosferike që vijnë nga reshjet. Kjo situatë shkakton pasoja negative në rrjedhën e trafikut rrugor duke shkaktuar kufizime apo edhe ndalim të plotë të qarkullimit për përdorimin e disa seksioneve rrugore.</p> <p>Aktivitetet specifike të kësaj mase përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Analiza e gjendjes ekzistuese të infrastrukturës së rrugëve dhe që rrezikohen nga përmbytjet;</li> <li>• Identifikimi i rrugëve kryesore që kanë nevojë për përmirësimin e infrastrukturës teknike për pranimin dhe trajtimin e ujërave atmosferike;</li> <li>• Caktimi i rrugëve me prioritet të lartë dhe me nevoja emergjente për intervenime për përmirësimin e infrastrukturës teknike për pranimin dhe trajtimin e ujërave atmosferike;</li> <li>• Propozimi i një plani për përshtatjen e rreguvë kryesore të rrezikuara nga përmbytjet bazuar në intervenimet në përmirësimin e infrastrukturës teknike për pranimin dhe trajtimin e ujërave atmosferike;</li> <li>• Hartimi i një protokollit të masave dhe kufizime specifike për mirëmbajtjen e infrastrukturës teknike për pranimin dhe trajtimin e ujërave atmosferike;</li> <li>• Propozimi i një plani të monitorimit të vazhdueshëm të gjendjes së infrastrukturës teknike për pranimin dhe trajtimin e ujërave atmosferike përgjatë rrugëve kryesore.</li> </ul>

Tabela 50. Rregulimi i infrastrukturës teknike për trajtimin dhe integrimin e ujërave atmosferik përgjatë rrugëve kryesore

Numri rendor i masës	4
Përfshirja në listën prioritare të projekteve	PO (77%)
Emërtimi i masës	Rregulimi i infrastrukturës teknike për trajtimin dhe integrimin e ujërave atmosferik përgjatë rrugëve kryesore
Bartësi i zbatimit	Komuna e Istogut
Partneri në zbatim	KRU Hidrodrini
Palët tjera të përfshira	MMPHI

Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)	2024-2028
Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)	500,000.00
Burimi i financimit	Komuna e Istogut Donatorët
Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi	<p>Reshjet e dendura shkaktojnë vërshime të shpeshta në rrugët e Istogut për shkak të infrastrukturës jo të përshtatshme për pranimin dhe trajtimin e ujërave atmosferike që vijnë nga reshjet. Kjo situatë shkakton pasoja negative në rrjedhën e trafikut rrugor duke shkaktuar kufizime apo edhe ndalim të plotë të qarkullimit për përdorimin e disa seksioneve rrugore.</p> <p>Aktivitetet specifike të kësaj mase përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përmirësimin e infrastrukturës për trajtimin mekanik të reshjeve në kuadër të infrastrukturës rrugore përmes vendosjes së pajisjeve/infrastrukturës për trajtimin mekanik të reshjeve atmosferike;</li> <li>• Përmirësimin e infrastrukturës për pranimin e ujërave të reshjeve në kuadër të infrastrukturës rrugore përmes vendosjes së gypave dhe infrastrukturës tjetër teknike.</li> </ul>

Tabela 51. Mbrojtja e sipërfaqeve të rrugëve nga temperaturat e larta përmes mbjelljes së drurëve/pemëve që krijojnë hije

Numri rendor i masës	5
Përfshirja në listën prioritare të projekteve	PO (72%)
Emërtimi i masës	Mbrojtja e sipërfaqeve të rrugëve nga temperaturat e larta përmes mbjelljes së drurëve/pemëve që krijojnë hije
Bartësi i zbatimit	Komuna e Istogut/Drejtoria për Shërbime Publike
Partneri në zbatim	
Palët tjera të përfshira	Agjencia e Pyjeve të Kosovës
Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)	2024-2028
Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)	100,000.00
Burimi i financimit	Komuna e Istogut Donatorët
Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi	<p>Temperaturat e larta (mbi 30°C) dhe rrezet direkte të diellit shkaktojnë ndryshimet strukturore të sipërfaqeve të rrugës (asfaltit) dhe kanë pasoja negative në rrjedhën e trafikut në kuptimin kufizime apo edhe ndalime të plota për përdorimin e disa seksionet rrugore. Dëmtimet në sipërfaqet e asfaltit janë në rritje edhe për shkak të rritjes së volumit të trafikut që zhvillohet në to e sidomos në rrugët ku zhvillohet transporti public dhe rrugët për transportin e mallrave. Për të mbrojtur rrugët nga ndikimi i temperaturave të larta dhe ndikimi direkt i rrezve të diellit ka nevojë që të zbatohen masa të përshtatshme ndaj këtyre ndikimeve. Mbjellja e drunjëve</p>

	<p>që krijojnë hije përgjatë rrugëve, do të mbronte rrugët nga rrezet direkte të diellit dhe do të zvogëlonte ndikimin e temperaturave të larta në këto rrugë.</p> <p>Aktivitetet specifike të kësaj mase përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Analiza e gjendjes ekzistuese të rrugës të ekspozuara nga ndikimi i temperaturave të larta duke pasur parasysh llojin e asfaltit (përbërjen) dhe statusi strukturor;</li> <li>• Identifikimi i rrugëve kryesore që kanë nevojë për mbrojtje nga temperaturat e larta përmes mbjelljes së drunjëve që krijojnë hije përgjatë rrugëve;</li> <li>• Caktimi i rrugëve me prioritet të lartë dhe me nevoja emergjente për mbrojtje nga ndikimi i temperaturave të larta.</li> <li>• Identifikimi i llojeve të drunjëve më të përshtatshëm (rezistentë dhe që krijojnë hije) për mbjellje përgjatë rrugëve të identifikuara;</li> <li>• Mbjellja e drunjëve/pemëve që krijojnë hije përgjatë rrugëve të identifikuara;</li> </ul>
--	--

Tabela 52. Përshtatja e trotuarëve për lëvizjen e personave me nevoja të veçanta

Numri rendor i masës	6
Përfshirja në listën prioritare të projekteve	JO
Emërtimi i masës	Përshtatja e trotuarëve për lëvizjen e personave me nevoja të veçanta
Bartësi i zbatimit	Komuna e Istogut/Drejtoria për Shërbime Publike
Partneri në zbatim	Drejtoia për Planifikim Urban dhe Mjedis
Palët tjera të përfshira	
Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)	2025-2028
Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)	50,000.00
Burimi i financimit	Komuna e Istogut
Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi	<p>Në kuadër të përshatjes së infrastrukturës së lëvizjes në zonën urbane të qytetit, duhet të merrën për bazë edhe kërkesat për lëvizje edhe të personave me nevoja të veçanta dhe nënave me karroca të fëmijëve. Kjo kërkon zbatimin e masave për përshatjen dhe rregullimin e pjerrinave nëpër trotuarët e zonës urbane të qytetit, me qëllim të lehtësimit të lëvizjes së ktyre banorëve si dhe minimimin e rrezikut nga faktorët e ndryshëm.</p> <p>Aktivitetet specifike të kësaj mase përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Analiza e gjendjes ekzistuese të trotuarëve për lëvizjen e qytetarëve dhe identifikimi i lokacioneve për aplikimin e pjerrinave nëpër trotuarët e zonës urbane të qytetit.</li> <li>• Rregullimi i pjerrinave për lëvizjen e personave me nevoja të veçanta dhe nënave me karroca të fëmijëve nëpër trotuarët e</li> </ul>

përcaktuar.

### 6.2.3. Sektori i Energjisë

Efektet e ndryshimeve klimatike, të tilla si rritja e shpeshtësisë së ngjarjeve ekstreme të motit, ndryshimet në intensitetin e reshjeve, temperaturat ekstreme do të shkaktojnë ndikime negative në prodhimin, transmetimin, shpërndarjen dhe në kërkesat për konsum të energjisë. Ndikim të rëndësishëm në sistemet e transmetimit dhe shpërndarjes do të përfaqësojë modele të ndryshme sezonale të konsumit, si dhe ndikime të drejtpërdrejta fizike të motit ekstrem. Pjesët e vjetra të këtyre sistemeve janë sigurisht më të ndjeshmet. Prodhimi i energjisë elektrike kërcënohet nga reduktimi i efikasitetit të sistemit për shkak të p.sh. duke reduktuar disponueshmërinë e ujit për ftohje. Përmbytjet paraqesin një nga rreziqet më të mëdha për objektet e prodhimit të energjisë, por edhe për infrastrukturën fizike lidhëse. Kërkesat sezonale për furnizimin me energji do të ndryshojnë kryesisht nga nevoja për konsumin e energjisë elektrike dhe do të rritet gjatë valëve të theksuara të të nxehtit apo të të ftoftit, gjë që përfaqëson një barrë të konsiderueshme për sektorin e përgjithshëm të energjisë.

Rreziqet kryesore klimatike në sektorin e energjisë mund të përmbliidhen në këto grupe:

- Ngarkesa në sistemin energjetik për shkak të valëve të nxehtësisë;
- Dëmtime të sistemeve të shpërndarjes për shkak të ngjarjeve ekstreme të motit;
- Ndikime në infrastrukturën shpërndarëse të sistemet energjetike për shkak të rrëshqitjeve të dheut;
- Mungesa e ujit për ftohjen e impianteve të prodhimit të energjisë për shkak të thatësirave;

Tabela 53. Instalimi/vendosja e kablove elektrike nëntokësore në kuadër të rrjetit shpërndarës të energjisë elektrike

Numri rendor i masës	7
Përfshirja në listën prioritare të projekteve	PO (86%)
Emërtimi i masës	Instalimi/vendosja e kablove elektrike nëntokësore në kuadër të rrjetit shpërndarës të energjisë elektrike
Bartësi i zbatimit	Komuna e Istogut/Drejtoria e Shërbimeve Publike
Partneri në zbatim	KEDS
Palët tjera të përfshira	Operatorët privat që menaxhojnë rrjete të kablove (IPKO, ART Motion, Kujtesa etj.)
Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)	2024-2030
Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)	3,000,000.00
Burimi i financimit	Komuna e Istogut KEDS Operatorët privat
Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi	Rrjeti aktual shpërndarës i energjisë elektrike në Komunën e Istogut është i ndikuar shumë nga kushtet ekstreme të motit kryesisht nga erërat e forta dhe ga rrëshqitjet e tokës. Kjo ndikon që shumë vendbanime të mbësin për



	<p>një kohë të pacaktuar pa energjis por njëkohësisht ndikon edhe në efikasitetin e energjisë gjatë shpërndarjes. Komuna e Istogut ka nevojë për zbatimin e masave që do të përshtasin rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike ndaj këtyre ndikimeve dhe të rrisin furnizimin efikas me energji elektrike. Një nga këto masa efikase është edhe vendosja e rrjetit elektrik nën tokë në të gjitha zonat e banimit në territorin e komunës.</p> <p>Aktivitetet specifike të kësaj mase përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Analiza e gjendjes ekzistuese të rrjetit shpërndarës të energjisë elektrike të ndikuar nga kushtet ekstreme të motit;</li> <li>• Identifikimi i vendbanimeve që kanë nevojë emergjente për vendosjen e rrjetit elektrik nëntokësorë;</li> <li>• Vendosja e rrjetit elektrik nëntokësorë në vendbanimet e identikuara;</li> <li>• Hartimi i një protokollit të masave dhe kufizimeve specifike për vendosjen dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së rrjetit elektrik nëntokësorë;</li> </ul>
--	---

#### 6.2.4. Sektor i Menaxhimit të Ujit

Menaxhimi i ujit paraqet një sfidë të veçantë për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, duke pasur parasysh ndjeshmëri të lartë të ujit ndaj ndikimeve klimatike. Nëse nuk ndërmerren masa për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike mund të ketë dëmtime të mëdha dhe të shpeshta nga efektet negative të ujit në zona urbane dhe në infrastrukturë përmes përmytjeve dhe erozionit. Ndikimet tjera përfshijnë reduktime në furnizimin me ujë të popullsisë dhe ekonomisë për shkak të përdorimit të ujit dhe mungesa e ujit të freskët si pasojë e thatësirës. Mungesa e ujit do të shprehet edhe në sektorin e bujqësisë, për shkak të rritjes së nevojës për ujë (temperaturat e larta dhe avullimi), dhe në reduktimin e rendimentit të burimeve të disponueshme ujore. Megjithatë nevojitet të bëhen hulumtime më të detajuara ndërsektoriale dhe ndërdisiplinore për të identifikuar në mënyrë të detajuar ndikimet nga ndryshimet klimatike në sektorin e ujit dhe propozimin e masave specifike për përshtatje ndaj këtyre ndikimeve.

Rreziqet klimatike në sektorin e menaxhimit të ujërave mund të përmbliidhen në këto grupe kryesore:

- Reduktimi i disponueshmërisë së ujit të pijshëm për shkak të thatësirave afatgjate;
- Ndotja e stacioneve të pompimit të ujit;
- Rritja e rrezikut të përmytjeve;
- Dëmtime të sistemeve të furnizimit me ujë për shkak të rrëshqitjeve të dheut;

Tabela 54. Parandalimi i rrezikut nga përmytjet përmes rregullimit dhe pastrimit të shtrëtërve të lumenjëve

Numri rendor i masës	8
Përfshirja në listën prioritare të projekteve	JO
Emërtimi i masës	Parandalimi i rrezikut nga përmytjet përmes rregullimit dhe pastrimit të shtrëtërve të lumenjëve
Bartësi i zbatimit	Komuna e Istogut/Drejtoria e Shërbimeve Publike
Partneri në zbatim	KRU Hidrodrini
Palët tjera të përfshira	MMPHI Ministria e Ekonomisë

Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)	2024-2030
Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)	400,000.00
Burimi i financimit	Buxheti i Komunës MMPHI KRU Hidrodrini Donatorët
Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi	<p>Menaxhimi i resurseve ujore paraqet një sfidë të veçantë për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, duke pasur parasysh ndjeshmëri të lartë të ujit ndaj ndikimeve klimatike. Nëse nuk ndërmerren masa për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike mund të ketë dëmtime të mëdha dhe të shpeshta nga efektet negative të ujit në zona urbane dhe në infrastrukturë përmes përmytjeve dhe erozionit. Krahas rritjes së rrezikut të përmytjeve dhe erozionit mund të ketë edhe dëmtime tjera në infrastrukturën ujore për shkak të rrëshqitjeve të dheut.</p> <p>Për parandalimin dhe menaxhimin e përmytjeve dhe erozionit duhet të planifikohen masa kryesisht në rregullimin dhe pastrimin e shtretërve të lumenjëve.</p> <p>Aktivitetet specifike të kësaj mase përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rregullimi i shtratit të lumit „Kujavq“;</li> <li>• Rregullimi i shtratit të lumit „Shushica“, Kavragë – Tomoc;</li> <li>• Pastrimi dhe largimi i mbeturinave nga brigjet e lumenjëve në territorin e komunës së Istogut.</li> </ul>

Tabela 55. Ndërtimi i kolektorëve për ujërat e zeza

Numri rendor i masës	9
Përfshirja në listën prioritare të projekteve	PO (87%)
Emërtimi i masës	Ndërtimi i kolektorëve për ujërat e zeza
Bartësi i zbatimit	Komuna e Istogut/Drejtoria e Shërbimeve Publike
Partneri në zbatim	KRU Hidrodrini
Palët tjera të përfshira	MMPHI, ME
Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)	2024-2030
Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)	6,000,000.00
Burimi i financimit	Buxheti i Komunës së Istogut, KRU Hidrodrini, Donatorët

Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi	<p>Rrjeti aktual i kolektorëve të ujërave të ndotura urbane në Komunën e Istogut ende nuk është i kompletuar. Komuna e Istogut ka nevojë për planifikimin e masave që do të kompletin rrjetin e kolektorëve të ujërave të ndotura urbane. Kjo masë do të ndihmonte në përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike duke përmësuar menaxhimin e ujërave të ndotura urbane dhe rritjen e mundësisë së ripërdorimit të tyre.</p> <p>Aktivitetet specifike të kësaj mase përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Analiza e gjendjes ekzistuese të rrjetit të kolektorëve të grumbullimit të ujërave të ndotura urbane;</li> <li>• Identifikimi i vendbanimeve që kanë nevojë emergjente për vendosjen e kolektorëve të ujërave të ndotura urbane;</li> <li>• Vendosja e kolektorëve të ujërave të ndotura urbane në vendbanimet e identifikuara;</li> <li>• Hartimi i një protokollit të masave dhe kufizime specifike për vendosjen dhe mirëmbajtjen e kolektorëve të ujërave të ndotura urbane.</li> </ul>
--	--

Tabela 56. Përfundimi i ndërtimit të sistemit të ujërave të zeza (kanalet e ujërave të zeza)

Numri rendor i masës	10
Përfshirja në listën prioritare të projekteve	PO (87%)
Emërtimi i masës	Përfundimi i ndërtimit të sistemit të ujërave të zeza (kanalet e ujërave të zeza)
Bartësi i zbatimit	Komuna e Istogut/Drejtoria e Shërbimeve Publike
Partneri në zbatim	KRU Hidrodrini
Palët tjera të përfshira	MMPHI, Ministria e Ekonomisë
Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)	2024-2030
Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)	1,500,000.00
Burimi i financimit	Buxheti i Komunës së Istogut, KRU Hidrodrini, Donatorët
Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi	<p>Rrjeti aktual i sistemeve të ujërave të zeza në Komunën e Istogut ende nuk është i kompletuar dhe nuk i grumbulon të gjitha ujërat urbane. Komuna e Istogut ka nevojë për zbatimin e masave që do të kompletin rrjetin e kanalizimit të ujërave urbane dhe përshtjen e tyre ndaj ndikimeve klimatike me qëllim të zvogëlonin rrezikun nga këto ndikime.</p> <p>Aktivitetet specifike të kësaj mase përfshijnë rregullimin e kanalizimit për të gjitha vendbanimet që nuk kanë sistemë të kanalizimit për ujëra të zeza.</p>

Tabela 57. Studimi i fizibilitetit për impiantin për trajtimin e ujërave të zeza dhe ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza

Numri rendor i masës	11
Përfshirja në listën prioritare të projekteve	PO (87%)
Emërtimi i masës	Studimi i fizibilitetit për impiantin për trajtimin e ujërave të zeza dhe ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza
Bartësi i zbatimit	Komuna e Istogut/Drejtoria e Shërbimeve Publike
Partneri në zbatim	KRU Hidrodrini
Palët tjera të përfshira	MMPHI Ministria e Ekonomisë
Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)	2025-2030
Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)	8,025,000.00
Burimi i financimit	MMPHI Buxheti i Komunës së Istogut KRU Hidrodrini Donatorët
Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi	<p>Komuna e Istogut aktualisht nuk ka impiant për trajtimin e ujërave të urbane në zonën e qytetit dhe vendbanimet përreth. Trajtimi i ujërave të zeza do të zvogëlonte ndotjen e ujërave sipërfaqësore nga shkaktimi direkt i ujërave urbane dhe njëkohësisht do të rriste mundësinë e ripërdorimit të ujit të ndotur për nevoja të ndryshme. Gjithashtu mbetjet e llumit nga nga trajtimi i ujërave urbane do të mundë të përdoshin për prodhime të energjisë dhe prodhim të fertilizerëve.</p> <p>Aktivitetet specifike të kësaj mase përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përgaditja e studimit të fizibilitetit për ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujërave të urbane.</li> <li>• Përgaditja e projektit ideor dhe teknik për impiantin e trajtimit të ujërave urbane;</li> <li>• Ndërimi i impiantit për trajtimin e ujërave urbane;</li> <li>• Funkcionalizimi dhe lëshurja në funksion e impiantit për trajtimin e ujërave urbane;</li> </ul>

Tabela 58. Trajtimi i ujërave urbane në zonat rurale përmes projekteve të bazuara në zgjedhje natyrore

Numri rendor i masës	12
Përfshirja në listën prioritare të projekteve	PO (72%)
Emërtimi i masës	Trajtimi i ujërave urbane në zonat rurale përmes projekteve të bazuara në zgjedhje natyrore
Bartësi i zbatimit	Komuna e Istogut/Drejtoria e Shërbimeve Publike
Partneri në zbatim	KRU Hidrodrini
Palët tjera të përfshira	MMPHI Ministria e Ekonomisë

Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)	2025-2030
Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)	Të përcaktohet nga Komuna e Istogut
Burimi i financimit	MMPHI Buxheti i Komunës KRU Hidrodrini Donatorët
Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi	<p>Komuna e Istogut aktualisht nuk ka impiante për trajtimin e ujërave urbane në zonat rurale. Trajtimi i ujërave urbane do të ulte ndotjen e lumenjëve dhe do të rriste mundësinë e ripërdorimit të ujit për nevoja të ndryshme. Në zonat ruarale do të zbatohen impiante të trajtimit të ujërave të bazuara në zgjedhje natyrore përkatësisht trajtimin ekologjik të ujërave.</p> <p>Aktivitetet specifike të kësaj mase përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikimi i zonave ruarale potenciale për ndërtimin e impoinateve ekologjike të trajtimit të ujërave urbane;</li> <li>• Përgaditja e studimeve për ndërtimin e impianteve ekologjike të trajtimit të ujërave të ndotura urbane.</li> <li>• Përgaditja e projekteve ideor dhe teknik për ndërtimin e impianteve ekologjike të trajtimit të ujërave të ndotura urbane.</li> <li>• Ndërimi i impianteve ekologjike të trajtimit të ujërave të ndotura urbane.</li> <li>• Funkcionalizimi dhe lëshurja në funksion e impianteve ekologjike të trajtimit të ujërave të ndotura urbane.</li> </ul>

Tabela 59. Përfundimi i rrjetit të ujësjellësit për ujë të pijshëm në Istog dhe zëvendësimi i gypave të azbestit me ato të plastikës në rrjetin e ujësjellësit

Numri rendor i masës	13
Përfshirja në listën prioritare të projekteve	PO (84.30%)
Emërtimi i masës	Përfundimi i rrjetit të ujësjellësit për ujë të pijshëm në Istog dhe zëvendësimi i gypave të azbestit me ato të plastikës në rrjetin e ujësjellësit
Bartësi i zbatimit	Komuna e Istogut
Partneri në zbatim	KRU Hidrodrini
Palët tjera të përfshira	MMPHI Ministria e Ekonomisë
Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)	2024-2030
Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)	6,000,000.00
Burimi i financimit	Komuna e Istogut KRU Hidrodrini

	Donatorët
Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi	<p>Sistemi aktual i shpërndarjes së ujit të pijshëm, nuk është i mjaftueshëm për shpërndarjejn e ujit në të gjitha vendbanimet dhe në të gjitha ekonomitë familjare. Në shumë raste sistemi është i vjetër dhe është i ndikuar nga kushtet ekstreme të motit përfshirë temperaturat e larta, thatësiarat dhe shembjet e tokës. Kjo ndikon që shpeshherë që disa vendbanime dhe ekonomi familjare të mbesin pa furnizim me ujë të pijes. Komuna e Istogut ka nevojë për zbatimin e masave që do të përshtasin rrjetin e shpërndarjes së ujit të pijshëm ndaj këtyrë ndikimeve dhe to të zvogëlonin rrezikun nga mungesa e furnizimit me ujë të pijes.</p> <p>Aktivitetet specifike të kësaj mase përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Analiza e gjendjes ekzistuese të shpërndarjes së ujit të pijshëm;</li> <li>• Identifikimi i vendbanimeve që kanë nevojë emergjente për përmirësimin/vendosjen e rrjetit të shpërndarjes së ujit të pijshëm;</li> <li>• Vendosjen e rrjetit të shpërndarjes së ujit të pijshëm në vendbanimet e indentifikuara;</li> <li>• Zëvendësimi i gypave të azbestit me ato të plastikës në rrjetin e ujësjellësit;</li> <li>• Hartimi i një protokolli të masave dhe kufizime specifike për mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes së ujit të pijshëm.</li> </ul>

Tabela 60. Ndërtimi i digës së ujit në Istog

Numri rendor i masës	14
Përfshirja në listën prioritare të projekteve	PO (72%)
Emërtimi i masës	Ndërtimi i digës së ujit në Istog
Bartësi i zbatimit	Komuna e Istogut
Partneri në zbatim	KRU Hidrodrini
Palët tjera të përfshira	Donatoret MMPHI ME
Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)	2025-2030
Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)	3,000,000.00
Burimi i financimit	Komuna e Istogut KRU Hidrodrini Donatorët
Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi	Sistemi aktual i akumulimit të ujit të pijshëm, nuk është i mjaftueshëm për plotësimin e kërkesave për ujë të pijes për të gjitha vendbanimet dhe në të gjitha ekonomitë familjare. Ndikimi i kushteve klimatike ka lindur nevojën për rritjen e kapaciteteteve për akumulimin e ujit me qëllim të plotësimit të nevojave në rastet e thatësirave dhe temperaturave të larta. Komuna e Istogut planifikon zbatimin e masave që do të përshtasin

	<p>infrastrukturën për akumulimin e ujit të pijshëm dhe zvogëlimin e rrezikun nga mungesa e furnizimit me ujë të pijes.</p> <p>Aktivitetet specifike të kësaj mase përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përgaditja e studimit të fizibilitetit për ndërtimin e digës së Istogut;</li> <li>• Përgaditja e projektit ideor dhe teknik për ndërtimin e digës së Istogut;</li> <li>• Ndërimi i infrastrukturës së digës së Istogut;</li> </ul>
--	--

Tabela61. Ndërtimi i digës së ujit në Shushicë

Numri rendor i masës	15
Përfshirja në listën prioritare të projekteve	PO (64%)
Emërtimi i masës	Ndërtimi i digës së ujit në Shushicë
Bartësi i zbatimit	Komuna e Istogut
Partneri në zbatim	KRU Hidrodrini
Palët tjera të përfshira	MMPHI Ministria e Ekonomisë
Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)	2025-2030
Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)	2,000,000.00
Burimi i financimit	Komuna e Istogut KRU Hidrodrini Donatorët
Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi	<p>Sistemi aktual i akumulimit të ujit të pijshëm, nuk është i mjaftueshëm për plotësimin e kërkesave për ujë të pijes për të gjitha venbanimet dhe në të gjitha ekonomitë familjare. Ndikimi i kushteve klimatike ka lindur nevojën për rritjen e kapaciteteteve për akumulimin e ujit me qëllim të plotësimin të nevojave në rastet e thatësirave dhe temperaturave të larta. Komuna e Istogut planifikon zbatimin e masave që do të përshtasin infrastrukturën për akumulimin e ujit të pijshëm dhe zvogëlimin e rrezikun nga mungesa e furnizimit me ujë të pijes.</p> <p>Aktivitetet specifike të kësaj mase përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përgaditja e studimit të fizibilitetit për ndërtimin e digës së Shushicës;</li> <li>• Përgaditja e projektit ideor dhe teknik për ndërtimin e digës së Shushicës;</li> <li>• Ndërimi i infrastrukturës së digës së Shushicës;</li> </ul>

Tabela 62. Rigjenerimi i burimeve ujore (Gurrat e Bardha)

Numri rendor i masës	16
Përfshirja në listën	PO (71%)

prioritare të projekteve	
Emërtimi i masës	Rigjenerimi i burimeve ujore (Gurrat e Bardha)
Bartësi i zbatimit	Komuna e Istogut
Partneri në zbatim	KRU Hidrodrini
Palët tjera të përfshira	Donatoret MMPHI
Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)	2025-2028
Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)	Të përcaktohet nga Komuna dhe KRU Hidrodrini
Burimi i financimit	Komuna e Istogut KRU Hidrodrini Donatorët
Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi	<p>Sistemi aktual i furnizimit të ujit të pijshëm ka mungesë të burimeve të ujit të pijes për plotësimin e kërkesave për ujë të pijes për zonën urbane dhe venbanimet përreth. Ndikimi i kushteve klimatike në të ardhmen ka nevojën për rritjen e kapaciteteteve për furnizimit të ujit të pijshëm me burime ujore me qëllim të plotësimit të nevojave në rastet e thatësirave dhe temperaturave të larta. Komuna e Istogut planifikon zbatimin e masave që do të rrisin furnizimin me uje të pijshëm dhe zvogëlimin e rrezikun nga mungesa e furnizimit me ujë të pijes.</p> <p>Aktivitetet specifike të kësaj mase përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pergaditja e propozim projektit ideor për rigjenerimin e burimeve ujore (Gurrat e Bardha);</li> <li>• Kryerja e punimeve për rigjenerimin e burimeve ujore (Gurrat e Bardha);</li> </ul>

Tabela 63. Rritja e kapacitetit të tubit të furnizimit për rezervuarin e ujit

Numri rendor i masës	17
Përfshirja në listën prioritare të projekteve	PO (68%)
Emërtimi i masës	Rritja e kapacitetit të tubit të furnizimit për rezervuarin e ujit
Bartësi i zbatimit	Komuna e Istogut/Drejtoria për Shërbime Publike
Partneri në zbatim	KRU Hidrodrini
Palët tjera të përfshira	MMPHI Ministria e Ekonomisë
Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)	2025-2028
Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)	Te percaktohet nga Komuna dhe KRU Hidrodrini
Burimi i financimit	Komuna e Istogut KRU Hidrodrini Donatorët



Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi	<p>Sistemi aktual i furnizimit të ujit të pijshëm për rezervuarin e ujit, nuk është i mjaftueshëm për plotësimin e kërkesave për ujë të pijes për zonën urbane dhe venbanimet përreth. Ndikimi i kushteve klimatike në të ardhmen ka nevojën për rritjen e kapaciteteteve për furnizimit të ujit të pijshëm për rezervuarin e ujit me qëllim të plotësimin të nevojave në rastet e thatësirave dhe temperaturave të larta. Komuna e Istogut planifikon zbatimin e masave që do të përmirësojnë infrastrukturën për furnizimin me ujë të pijshëm dhe zvogëlimin e rrezikun nga mungesa e furnizimit me ujë të pijes.</p> <p>Aktivitetet specifike të kësaj mase përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pergaditja e propozim projektit ideor dhe teknik për furnizimin e rezervuarin e ujit me ujë të pijshëm.</li> <li>• Kryerja e punimeve për furnizim të rezervuarin e ujit me ujë të pijshëm.</li> </ul>
--	--

Tabela 64. Rregullimi dhe renovimi i kanaleve te ujitjes dhe kullimi i tokave bujqësore

Numri rendor i masës	18
Përfshirja në listën prioritare të projekteve	PO (70%)
Emërtimi i masës	Rregullimi dhe renovimi i kanaleve te ujitjes dhe kullimi i tokave bujqësore
Bartësi i zbatimit	Komuna e Istogut/Drejtoria për Bujqesi
Partneri në zbatim	KRU Hidrodrini
Palët tjera të përfshira	MBPZHR
Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)	2024-2028
Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)	520,000.00
Burimi i financimit	Komuna e Istogut KRU Hidrodrini MBPZH Donatoret
Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi	<p>Menaxhimi i ujit në sektorin e bujqësisë paraqet një sfidë të veçantë për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, duke pasur parasysh ndjeshmëri e lartë të mugesës së ujit për këtë sektor. Mungesa e ujit në sektorin e bujqësisë, vije kryesisht për shkak të rritjes së nevojës për ujë dhe zogëlimit të burimeve të disponueshme ujore për shkak të temperaturave të larta, thatësisë dhe avullimit. Nëse nuk ndërmerren masa për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike në sektorin e bujqësisë mundë të ketë dëme në rendimete të kulturave bujqësore por edhe në varfërimin e kullitetit të tokave bujqësore.</p> <p>Në kuadër të aktiviteteve për zbatimin e kësaj mase përfshihen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rregullimi i kanalit të ujitjes Dubovë – Kashicë – Saradran;</li> <li>• Rregullimi i kanalit të ujitjes në Dobrushë;</li> <li>• Rregullimi i kanalit të ujitjes Osmanaj-Dreje;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rregullimi i kanalit të ujitjes Prekall-Zabllaq;</li> <li>• Rehabilitimi i sistemit të ujitjes ana e djathtë Vrellë – Studenicë;</li> <li>• Rregullimi i kanaleve për kullimin e tokave bujqësore.</li> </ul>
--	--

#### 6.2.5. Planifikimi Hapësinor dhe Menaxhimit të Tokës

Planifikimi urban dhe hapësinor ka një rol kyç në zhvillimin e infrastrukturës së re. Në përgjithësi, Infrastruktura rezistente ndaj klimës nuk kufizohet në projektimin teknik, por fillon me cilësinë planifikimi hapësinor, duke zgjedhur vendndodhjen e duhur dhe duke vendosur masat e nevojshme kompensuese. Analiza opsioni në lidhje me efektet e mundshme të ndryshimeve klimatike për një vend të caktuar është i një rëndësie të veçantë.

Si rezultat i efekteve lokale, instalimet mund të vendosen ndryshe pa shkaktuar shtesë kostot për investitorët. Për të rritur rezistencën ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike, infrastruktura e gjelbër dhe masat e tjera mbrojtëse mund të japin kontribut të rëndësishëm, prandaj është e nevojshme të analizohet mundësi për të rritur pjesën e infrastrukturës së gjelbër. Infrastruktura e gjelbër është shpesh më e lirë si investim kapital, por edhe më e përshtatshme në aspektin mjedisor. Infrastruktura e gjelbër, e planifikuar dhe e ekzekutuar në mënyrë adekuate ofron përfitime të shumta, si duke reduktuar efektin e valëve të nxehtësisë, duke kontribuar në efizienzën e energjisë së ndërtesave, apo edhe duke sjellë efekte pozitive në shëndetin e njeriut dhe duke kontribuar në reduktimin e emetimeve të gazeve serrë.

Tabela 65. Zhvillimi dhe zbatimi i konceptin të bazuar në lagje, duke u fokusuar në zonat e gjelbra, rekreative dhe sportive

Numri rendor i masës	19
Përfshirja në listën prioritare të projekteve	PO (72%)
Emërtimi i masës	Zhvillimi dhe zbatimi i konceptin të bazuar në lagje, duke u fokusuar në zonat e gjelbra, rekreative dhe sportive
Bartësi i zbatimit	Komuna e Istogut /Drejtoria per Urbanizem
Partneri në zbatim	
Palët tjera të përfshira	Kompanite e ndërtimit Bizneset
Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)	2026-2029
Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)	Të përcaktohet nga Komuna e Istogut
Burimi i financimit	Komuna e Istogut Donatoret Bizneset e ndertimit
Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi	Gjatë procesit të rishkimit dhe ndryshimit të dokumenteve të planifikimit hapësinorë komunal si Planit Zhvillimor, Hartave Zonale dhe Planeve Rregulluese, një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet infrastrukturës së gjelbër, si një element i organizimit hapësinor, përkatësisht zhvillimit dhe zbatimit të konceptin të bazuar në lagje, duke u fokusuar në zonat e gjelbra, rekreative dhe sportive.  Qëllimi i kësaj mase është planifikimi strategjik dhe zhvillimi i

	infrastrukturës së gjelbër në zonën e qytetit të Istogut, veçanërisht në pikat ku priten zhvillimet e reja dhe në ato ku ka mungesë të hapësirave të gjelbra. Zbatimi i një mase të tillë do të ndikojë në përshtatje e zonës urbane ndaj përballimit të rreziqeve klimatike sikurse janë të nxehtit ekstrem dhe zvogëlimi i efekti i ekzistuesit të valëve të nxehtit apo edhe parandalimi i shfaqjes së valëve të reja të nxehtësisë në zonën e qytetit të Istogut. Zhvillimi dhe zbatimi i konceptin të bazuar në lagje, duke u fokusuar në zonat e gjelbra, rekreative dhe sportive do të të integrohen edhe në kushtet e ndërtimit të përfshira në procesin e lëshimit të lejeve ndërtimore.
--	---

Tabela 66. Ndërtimi dhe shenjëzimi i shtigjeve ndërkufitare të ecjes në zonat malore

Numri rendor i masës	20
Përfshirja në listën prioritare të projekteve	PO (53%)
Emërtimi i masës	Ndërtimi dhe shenjëzimi i shtigjeve ndërkufitare të ecjes në zonat malore
Bartësi i zbatimit	Komuna e Istogut
Partneri në zbatim	MINNT/Departamenti i Turizmit
Palët tjera të përfshira	Shoqatat e Turistëve Guidat Lokale
Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)	2025-2028
Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)	25,000.00
Burimi i financimit	Komuna e Istogut
Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi	Qëllimi i kësaj mase është planifikimi dhe ndërtimi i shtigjeve ndërkufitare të ecjes. Zbatimi i një mase të tillë do të ndihmojë në informimin dhe orientimin e turistëve në zonat malore. Kjo do të ndikojë në parandalimin e përballjes së tyre me rreziqe natyrore dhe klimatike në zonat malore përfshirë të nxehtit ekstrem, stuhitë, reshjet, shembjet e tokës dhe format e tjera të rreziqeve natyrore. Kjo masë do të ndihmojë po ashtu edhe në zhvillimin e turizmit malor apo ekoturizmit.

#### 6.2.6. Mjedisi dhe Biodiversiteti

Mjedisi dhe biodiversiteti përfaqësojnë një aset të rëndësishëm mbi bazën e të cilit komuniteti lokal zhvillon turizmin dhe parakushtet për një jetë komode për qytetarët e saj. Mjedisi është nën presionin e vazhdueshëm të aktiviteteve të njeriut përfshirë shfrytëzimin e burimeve natyrore, gjenerimin e mbeturinave dhe shkarkimin e ndotësve në mjedis.

Biodiversiteti është një koncept që bashkon bimët dhe llojet shtazore të pranishme në një habitat të caktuar, dhe është veçanërisht i rrezikuar për shkak të ndikimit të ndryshimeve klimatike. Rëndësia e biodiversitetit reflektohet edhe në ndikimin e tij në bujqësi.

Reziqet kryesore klimatike në sektorin e mjedisit dhe biodiversitetit mund të ndahen në disa grupe:

- Ndryshimet në numrin dhe shpërndarjen e llojeve;
- Ndryshimet e habitateve të banuara nga lloje të caktuara apo edhe humbja e habitateve;
- Ndryshimet fenologjike të cilat mund të çojnë në thyerje marrëdhëniet ndërmjet llojeve përkatësishtë përqindjes së llojeve pushtuese (llojeve të huaja);
- Ndryshimet në përbërjen e llojeve autoktone bimore dhe shtazore;
- Ndryshimet në proceset e ekosistemit dhe funksionimin e ekosistemit;

Zbatimi i masave për menaxhimin të përshtatur të ekosistemeve natyrore është një proces gjithëpërfshirës i cili përfshin aktivitetet e monitorimit të efekteve të mundshme klimatike dhe ndikimit të tyre në llojet dhe në ekosistemet e ndjeshme natyrore që mundëson edhe vlerësimin e efikasitetit të menaxhimit.

Tabela 67. Zgjerimi i rrjetit të zonave të mbrojtura në territorin e komunës së Istogut

Numri rendor i masës	21
Përfshirja në listën prioritare të projekteve	JO
Emërtimi i masës	Zgjerimi i rrjetit të zonave të mbrojtura në territorin e komunës së Istogut
Bartësi i zbatimit	Komuna e Istogut
Partneri në zbatim	Instituti për Mbrojtjen e Natyrës
Palët tjera të përfshira	MMPHI/AMMK
Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)	2027-2029
Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)	30,000.00
Burimi i financimit	Komuna e Istogut
Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi	<p>Biodiversiteti është i një rëndësie kyçe për ekonominë dhe mirëqenien e njerëzimit, por kërcënimi më i madh mjedisor tani është humbja e tij. Ruajtja e biodiversitetit dhe mirëmbajtja natyrore përmes shpalljes së zonave të reja të mbrojtura të natyrës është një nga format më të shpeshta dhe më të përshtashme. Territori i komunës së Istogut ka vlera natyrore të veçanta që kanë potencial për tu marrë në mbrojtje me qëllim të mbrojtjes së llojeve bimore dhe shtazore dhe habitateve me rëndësi të veçantë. Menaxhimi efikas dhe monitorimi i gjendjes së zonave të mbrojtura do të mundësojë marrjen e masave për mbrojtjen e këtyre zonave nga ndikimet klimatike dhe përshtatjen e tyre ndaj këtyre ndryshimeve.</p> <p>Në kuadër të aktiviteteve për zbatimin e kësaj mase përfshihen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Hulumtimi/studimi i vlerave natyrore në territorin e komunës;</li> <li>• Marrja në mbrojtje e zonave të reja të natyrës;</li> <li>• Menaxhimi dhe monitorimi i gjendjes së zonave të mbrojtura.</li> </ul>

Tabela 68. Ndërtimi i qendrës për grumbullimin dhe transferin e mbeturinave

Numri rendor i masës	22
Përfshirja në listën prioritare të projekteve	PO (83%)
Emërtimi i masës	Ndërtimi i qendrës për grumbullimin dhe transferin e mbeturinave
Bartësi i zbatimit	Komuna e Istogut
Partneri në zbatim	KRM Ambienti
Palët tjera të përfshira	MMPHI Donatorët
Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)	2025-2027
Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)	60,000.00
Burimi i financimit	Komuna e Istogut KRM Pastrimi Donatorët
Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi	Edhe sektori i mbeturinave është i ndikuar nga ndryshimet klimatike dhe veçanërisht nga efektet që sjellin eventet extreme të motit në shpërndarjen e mbeturinave apo edhe ndikimet që kanë deponitë ilegale në brigjet e lumenjëve në rritjen e potencialit për vërshime dhe përmytje. Qëllimi i masës është që në kuadër të përmrësimit të menaxhimit të mbeturinave të rregullohet sistemi për grumbullimin dhe transferimin e mbeturinave përmes rregullimit të një qendre. Në kuadër të kësaj qendre po ashtu do të promovohet dhe zbatohet koncepti 3R (Reduktimi, Ripërdorimi dhe Riciklimi) në funksion përmrësimit të menaxhimit të mbeturinave. Këto masa do të kontribuojnë edhe në përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike në këtë sektor përmes reduktimit të mbeturinave të hedhura në hapësira publike, si dhe planifikimit të infrastrukturës për reduktimin dhe riciklimin e mbeturinave.

#### 6.2.7. Bujqësia dhe Pylltaria

Bujqësia dhe pylltaria janë të ekspozuara ndaj rrezikut për shkak të ndryshimit të kushteve klimatike. Bujqësia është drejtpërdrejt e ekspozuar ndaj kushteve të motit, pra klimës ndryshimet. Intensiteti i proceseve fizike dhe (bio)kimike që ndodhin në tokë dhe në bimë përcaktohen kryesisht nga lagështia e tokës/ujit dhe nga temperatura e ajrit. Kjo ndikon në uljen e produktivitetit por edhe në reduktimin e disponueshmërisë së tokave të përshtatshme për mbjelljen e kulturave bujqësore;

Në anën tjetër rritja e shpeshtësisë së zjarreve në pyje është pasojë e drejtpërdrejtë e ndryshimit të klimës për shkak të reduktimit të sasisë dhe shpeshtësisë së reshjeve dhe rritjes së frekuncës së valëve të të nxehtit. Këto ndryshime sjellin edhe ndikime negative në reduktimin e disponueshmërisë së biomasës pyjore.

Rreziqet klimatike në sektorin e bujqësisë dhe pylltarisë mund të ndahen në grupet e mëposhtme:

- Rritja e shpeshtësisë së zjarreve në pyje dhe ndikimi negativ i ngjarjeve ekstreme të motit në ekosistemet pyjore;
- Reduktimi i disponueshmërisë së biomasës pyjore
- Rritja e kostove të menaxhimit të pyjeve

- Reduktimi i disponueshmërisë së tokës së punueshme;
- Mungesa e ujit për ujitje.

Komuna e Istogut duhet të planifikojë masa për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike në sektorin e bujqësisë dhe pylltarisë, për të reduktuar ndikimet negative në këta sektorë.

Tabela 69. Pyllëzimi dhe ripyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura të pyjeve në territorin e Komunës

Numri rendor i masës	23
Përfshirja në listën prioritare të projekteve	PO (83.30%)
Emërtimi i masës	Pyllëzimi dhe ripyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura të pyjeve në territorin e Komunës
Bartësi i zbatimit	Komuna e Istogut
Partneri në zbatim	Agjencia e Pyjeve të Kosovës
Palët tjera të përfshira	MBPZHR
Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)	2024-2030
Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)	500,000.00
Burimi i financimit	Komuna e Istogut Agjencia e Pyjeve të Kosovës
Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi	<p>Me qëllim të rritjes së aftësisë së ekosistemeve natyrore për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike komuna e Istogut do të zbatojë masa specifike për pyllëzimin dhe ripyllëzimin e sipërfaqeve të zhveshura të pyjeve të territorit të Komunës. Këto masa do të ndihmojnë në rregullimin e mikroklimës së zonës, reduktimin e erozionit, reduktimin e reshjeve dhe rregullimin e regjimit të ujërave.</p> <p>Në kuadër të aktiviteteve për zbatimin e kësaj mase përfshihen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikimi i zonave të pyjeve për realizimin e pyllëzimeve dhe ripyllëzimeve;</li> <li>• Identifikimin e llojeve të përshtatshme për pyllëzimin dhe ripyllëzimin e sipërfaqeve të zhveshura;</li> <li>• Realizimi i projekteve të pyllëzimit dhe ripyllëzimit të sipërfaqeve të zhveshura.</li> </ul>

Tabela 70. Përshtatja e planeve të mbrojtjes nga zjarri ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike

Numri rendor i masës	24
Përfshirja në listën prioritare të projekteve	JO
Emërtimi i masës	Përshtatja e planeve të mbrojtjes nga zjarri ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike
Bartësi i zbatimit	Komuna e Istogut
Partneri në zbatim	Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave

Palët tjera të përfshira	Agjencia e Pyjeve te Kosoves
Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)	2026-2028
Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)	50,000.00
Burimi i financimit	Komuna e Istogut
Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi	<p>Rritja e frekuencës së zjarreve shkaktohet drejtpërdrejt nga ndryshimi i kushteve klimatike, veçanërisht nga reduktimi i shpeshtësisë dhe sasisë së reshjet dhe nga valët ekstreme të të nxehtit, të cilat inicojnë nevojën për kryerjen e një analize të mbrojtjes ekzistuese nga zjarri planet, në bazë të të cilave ato plane duhet të përmirësohen.</p> <p>Në kuadër të aktiviteteve për zbatimin e kësaj mase përfshihen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Analiza e planeve ekzistuese lokale për mbrojtje të pyjeve nga zjarret;</li> <li>• Planifikimi i masave shtesë që do të përfshihen në kuadër të planeve ekzistuese për përmirësimin e tyre në aspektin e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike.</li> </ul>

Tabela 71. Nxitja/promovimi i përdorimit te farave/fidanëve rezistente ndaj ndryshimeve klimatike

Numri rendor i masës	25
Përfshirja në listën prioritare të projekteve	PO (71%)
Emërtimi i masës	Nxitja/promovimi i përdorimit te farave/fidanëve rezistente ndaj ndryshimeve klimatike
Bartësi i zbatimit	Komuna e Istogut/Drejtoria per Bujqesi
Partneri në zbatim	Agjencia për Zhvillim Rural
Palët tjera të përfshira	MBPZHR
Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)	2025-2028
Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)	500,000.00
Burimi i financimit	Komuna e Istogut Agjencia për Zhvillim Rural
Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi	<p>Bujqësia është një nga sektorët më të ekspozuar ndaj rrezikut për shkak të ndryshimit të kushteve klimatike. Bujqësia është drejtpërdrejt e ekspozuar ndaj kushteve të motit, pra klimës ndryshimet. Intensiteti i proceseve fizike dhe (bio)kimike që ndodhin në tokë dhe në bimë përcaktohen kryesisht nga lagështia e tokës/ujit dhe nga temperatura e ajrit. Kjo ndikon në uljen e produktivitetit por edhe në reduktimin e disponueshmërisë së tokave të përshtatshme për mbjelljen e kulturave bujqësore. Me qëllim të përshtatjes ndaj këtyre ndryshimeve nevojiten të zbatohen masa që kanë në fokus nxitjen dhe promovimin e përdorimit te farave/fidanëve rezistente ndaj ndryshimeve klimatike.</p>

	<p>Në kuadër të aktiviteteve për zbatimin e kësaj mase përfshihen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Testimi i farave/fidanëve rezistente ndaj ndryshimeve klimatike që i përshtaten kushteve klimatike të territorit të komunës së Proishtinës;</li> <li>• Ndërgjegjësimi, informimi, subvencionimi dhe nxitja e farmerëve për përdorimin e farave/fidanëve rezistente ndaj ndryshimeve klimatike.</li> </ul>
--	---

#### 6.2.8.Sektori i Kujdesit Shëndetësor

Sektori i kujdesit shëndetësor është veçanërisht i rëndësishëm kur bëhet fjalë për monitorimin e efekteve të ndryshimeve klimatike mbi komunitetin lokal. Ndryshimet klimatike do të ndikojnë në shëndetin e qytetarëve, prandaj është jashtëzakonisht e rëndësishme për të planifikuar aktivitete që synojnë mbrojtjen e tij. Ndryshimet klimatike do të shkaktojnë rreziqe të reja për shëndetin dhe rritjen e intensitetit të problemeve ekzistuese shëndetësore. Shëndeti i njerëzve, kafshëve dhe bimëve pritet të jetë ndikuar si drejtpërdrejt ashtu edhe indirekt. Efektet e drejtpërdrejta do të shkaktohen nga ndryshimet në intensitet dhe frekuencën e ngjarjeve ekstreme të motit, të tilla si valët ekstreme të të nxehtit dhe përmytjet. Efektet indirekte janë do të përfshijë ndryshimet në shfaqjen e sëmundjeve të transmetuara në mënyrë vektoriale (p.sh. sëmundjet transmetohet nga mushkonjat dhe rriqrat) ose nga brejtësit, si dhe shfaqja e ndryshimet në cilësinë e ujit, ushqimit dhe ajrit.

Rreziqet mund të ndahen në grupet e mëposhtme:

- Efektet negative në shëndetin e njeriut, të shkaktuara nga temperaturat e larta;
- Rritja e frekuencës së sëmundjeve të shkaktuara nga ndryshimet klimatike.

Tabela 72. Hartimi i Protokollit për Masat Mbrojtëse nga Nxehtësia dhe Zbatimi i Udhëzimeve

Numri rendor i masës	26
Përfshirja në listën prioritare të projekteve	JO
Emërtimi i masës	Hartimi i Protokollit për Masat Mbrojtëse nga Nxehtësia dhe Zbatimi i Udhëzimeve
Bartësi i zbatimit	Komuna e Istogut/Drejtoria për Shëndetësi
Partneri në zbatim	Ministria e Shëndetësisë Instituti Kombëtarë i Shëndetit Publik
Palët tjera të përfshira	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare KUR Hidrodrini
Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)	2026-2028
Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)	500,000.00
Burimi i financimit	Komuna e Istogut
Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi	Qëllimi i kësaj mase është zvogëlimi i rreziqeve për popullatën duke zbatuar masat që synojnë zbutjen e valës së të nxehtit efektet që përcaktohen nga Protokollit për Mbrojtjen nga Nxehtësia  Masat dhe Udhëzimet.



	<p>Për të reduktuar rreziqet për popullatën, si më poshtë masat që synojnë zbutjen e efekteve të valëve të të nxehtit duhet të jenë planifikuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Sistemi për paralajmërimin e hershëm të valëve të të nxehtit duhet të përmirësohet në mënyrë që të përshpejtohet rrjedha e informacionit për të gjitha grupet shoqërore;</li> <li>• Duhet të sigurohen kujdes i shtuar (nga familja, fqinjët, shërbimet sociale) për personat që kanë nevojë për ndihmë;</li> <li>• Grupet vulnerabël të qytetarëve (fëmijë, gra shtatzëna, të moshuarit, pacientët kronikë etj.) duhet të marrin kujdes të veçantë;</li> <li>• Duhet të identifikohen personat në rrezik të shtuar ose ata që kanë nevojë për ndihmë të veçantë;</li> <li>• Duhet të përcaktohen kapacitetet në rast të valës së të nxehtit përfshirë disponueshmëria e burimeve njerëzore dhe objekteve të kujdesit shëndetësor;</li> <li>• Transporti publik urban duhet të përshtatet ndaj valëve të të nxehtit duke organizuar linja më të shpeshta dhe të lira gjatë vapes me qëllim të mbrojtjes së shëndetit të qytetarëve, sigurimi i ajrit të kondicionuar në automjetet e transportit publik dhe mbrojtje nga dielli në stacionet e pritjes së transportit publik;</li> <li>• Duhet të instalohen burime të ujit të pijshëm pa pagesë në vendet e frekuentuara publike në mënyrë që ato të mund të përdoren gjatë valët e të nxehtit;</li> <li>• Duhet të përmirësohet monitorimi dhe informimi përmes rrjetit të matësve të indeksit të UV në zonën e qytetit.</li> </ul>
--	---

#### 6.2.9. Sektori i Mbrojtjes Civile dhe Emergjencave

Mbrojtja civile është një mjet bazë për mbrojtjen e komunitetit lokal nga kushtet ekstreme të motit sikurse janë përmbytjet, zjarret, stuhitë, temperaturat e larta dhe ngjarje tjera të motit. Marrja e masave për reduktimin e rrezikut nga ndryshimet klimatike në këtë sektor përfshinë kryesisht rritjen e nevojës për angazhimin e njësisve të mbrojtjes civile për shkak të motit ekstrem po edhe ndërtimin e infrastrukturës përkatëse për tu përballuar me rreziqet klimatike nga moti ekstrem.

Tabela 73. Planifikimi dhe ndërtimi i stehimoreve emergjente

Numri rendor i masës	27
Përfshirja në listën prioritarë të projekteve	PO (69%)
Emërtimi i masës	Planifikimi dhe ndërtimi i stehimoreve emergjente
Bartësi i zbatimit	Komuna e Istogut/Drejtoria e Emergjencave
Partneri në zbatim	Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave
Palët tjera të përfshira	
Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)	2025-2028
Investimi i përgjithshëm i	200,000.00

vlerësuar (€)	
Burimi i financimit	Komuna e Istogut
Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi	<p>Qëllimi i kësaj mase është planifikimi i ndërtimit dhe funksionalizimit të strehimoreve emergjente që do të shërbenin në rastet e kushteve eksteme meteorologjike dhe fatkeqësive natyrore.</p> <p>Në kuadër të aktiviteteve për zbatimin e kësaj mase përfshihen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikimi i lokacioneve të përshtatshme për planifikimi e ndërtimit të strehimoreve emergjente;</li> <li>• Ndërtimi dhe funksionalizimi i strehimoreve emergjente</li> <li>• Ndërgjegjësimi dhe informimi për rolin dhe rëndësinë e strehimoreve emergjente.</li> </ul>

Tabela 74. Krijimi dhe trajnimi i ekipeve vullnetare për rastet e emergjencave natyrore

Numri rendor i masës	28
Përfshirja në listën prioritarë të projekteve	PO (69%)
Emërtimi i masës	Krijimi dhe trajnimi i ekipeve vullnetare për rastet e emergjencave natyrore
Bartësi i zbatimit	Komuna e Istogut/Drejtoria e Emergjencave
Partneri në zbatim	Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave
Palët tjera të përfshira	Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna" Agjencia e Pyjeve të Kosovës Brigada e Zjarrfikësve
Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)	2025-2028
Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)	200,000.00
Burimi i financimit	Komuna e Istogut
Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi	<p>Zjarret pyjore janë një nga ndikimet potenciale që janë si pasojë e ndryshimeve klimatike si rezultat i temperaturave të larta. Komuna ka nevojë që të përshtatet ndaj këtij ndikimi përmes sistemebe të ndryshme të paralajmërimit përfshirë edhe ekipet e vullnetarëve. Qëllimi i kësaj mase është krijimi i ekipeve vullnetare për paralajmërim të zjarreve dhe fatkeqësive natyrore, si masë e përshtatjes për parandalimin e ndikimit të mundshëm të kushteve ekstreme të motit.</p> <p>Në kuadër të aktiviteteve për zbatimin e kësaj mase përfshihen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Krijimi i ekipeve vullnetare për paralajmërim të zjarreve të porsa nisura dhe intervenim në shuarjen e zjarreve të vogla që sapo kanë filluar.</li> <li>• Furnizimi me pajisje për shuarje të zjarreve dhe pajisje për mbrojtje nga zjarret për ekipet vullnetare.</li> <li>• Trajnenimi i ekipeve vullnetare për shuarjen e zjarreve në terrenet</li> </ul>

	malore dhe fushore.
--	---------------------

Tabela 75. Akumulimi i ujit ne zona turistike – malore (ne shërbim te emergjencave, shuarjeve se zjarre, etj.)

Numri rendor i masës	29
Përfshirja në listën prioritare të projekteve	PO (67%)
Emërtimi i masës	Akumulimi i ujit ne zona turistike – malore (ne shërbim te emergjencave, shuarjeve se zjarre, etj.)
Bartësi i zbatimit	Komuna e Istogut/Drejtoria e Emergjencave
Partneri në zbatim	BPZ (Brigada e Zjarrëfikësve), Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave
Palët tjera të përfshira	Organizatat e Shoqërisë Civile Shoqatat e turistëve
Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)	2025-2028
Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)	200,000.00
Burimi i financimit	Komuna e Istogut
Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi	<p>Qëllimi i kësaj mase është planifikimi i ndërtimit dhe funksionalizimit të akumulimit të ujit ne zona turistike – malore që do të shërbenin për shuarjen e zjarreve dhe sigurimin e ujit për shërbimet e emergjencave dhe grupet tjera të interesit.</p> <p>Në kuadër të aktiviteteve për zbatimin e kësaj mase përfshihen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikimi i lokacioneve të përshtatshme për planifikimi e ndërtimit të akumulimit të ujit ne zona turistike – malore;</li> <li>• Ndërtimi dhe funksionalizimi i të akumulimit të ujit ne zona turistike – malore;</li> <li>• Ndërgjegjësimi dhe informimi për rolin dhe rëndësinë e akumulimit të ujit ne zona turistike – malore;</li> </ul>

Tabela 76. Ndërtimi i pikave hidrante në fshatra

Numri rendor i masës	30
Përfshirja në listën prioritare të projekteve	JO
Emërtimi i masës	Ndërtimi i pikave hidrante në fshatra
Bartësi i zbatimit	Komuna e Istogut/Drejtoria e Emergjencave
Partneri në zbatim	Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave
Palët tjera të përfshira	Komunitetet Lokale
Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)	2025-2028
Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)	100,000.00

Burimi i financimit	Komuna e Istogut
Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi	<p>Qëllimi i kësaj mase është planifikimi i ndërtimit dhe funksionalizimit i pikave hidrante në fshatra (zona rurale) që do të shërbenin për sigurimin e ujit për nevojat e këtyre vendbanimebe në rastet e thatësisë dhe mugesës së ujit.</p> <p>Në kuadër të aktiviteteve për zbatimin e kësaj mase përfshihen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikimi i zonave rurale për planifikimi e ndërtimit të pikave hidrante;</li> <li>• Ndërtimi dhe funksionalizimi i pikave hidrante në fshatra;</li> <li>• Ndërgjegjësimi dhe informimi për rolin dhe rëndësinë e pikave hidrante;</li> </ul>

#### 6.2.10. Sektori i Ekonomisë dhe Turizmit

Turizmi është një nga sektorët që është jashtëzakonisht i ndjeshëm ndaj ndryshimeve klimatike. Si pasoje e ndryshimeve klimatike, sektori i turizmit do të përballet me kërkesa të reja për të ruajtur nivelin e cilësisë. Disa nga ndikimet e ndryshimeve klimatike në turizëm janë: rritja e kërkesave për energji për mirëmbajtje dhe komoditet për shkak të rritjes së ekstremeve të temperaturës, kërkesat e rritura për ndërhyrje mjekësore, ndikimi i ndryshimeve klimatike në lokalitetet dhe destinacionet turistike (ndotja e ajrit, ndikimet negative në biodiversitet dhe mirëmbajtja e peizazhit natyror).

Edhe sektorët tjerë të zhvillimit ekonomik do të jenë të ndikuar nga ndryshimet e klimës përfshirë këtu edhe sektorin e prodhimit bujqësorë.

Tabela 77. Krijimi i sistemit për mbrojtjen e turistëve dhe banorëve të zonave malore nga fatkeqësitë natyrore

Numri rendor i masës	31
Përfshirja në listën prioritare të projekteve	PO (71%)
Emërtimi i masës	Krijimi i sistemi për mbrojtjen e turistëve dhe banorëve të zonave malore nga fatkeqësitë natyrore
Bartësi i zbatimit	Komuna e Istogut/Drejtoria e Emergjencave
Partneri në zbatim	Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave
Palët tjera të përfshira	Komunitetet Lokale
Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)	2025-2028
Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)	100,000.00
Burimi i financimit	Komuna e Istogut
Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi	<p>Si rezultat i kushteve ekstreme të motit zonat e thella malore shpeshherë përballen me fatkeqësi natyrore që rrezikojnë jetën e banorëve të zonave dhe turistëve. Komuna duhet të përshtatet ndaj kësaj sistuate duke planifikuar masa që do të ndikonin në parandalimin dhe menaxhimin e duhur të këtyre ngjarjeve.</p> <p>Qëllimi i kësaj mase është krijimi i një sistemit për mbrojtje të banorëve dhe turistëve në raste të emergjencave si dhe në raste të fatkeqësive grupore ose individuale. Në kuadër të kësaj mase parashihet krijimi i</p>

	ekipve të kërkim-shpëtimit me theks të veçantë të veprimit në shtigjet e ecjes dhe çiklizimit malor si dhe në pikat me rrezikshmëri të lartë të lëvizjes dhe zonave me potencial të madh të zjarreve të egra malore.
--	--

Tabela 78. Promovimi i bujqësisë organike dhe agroturimit përmes subvencionimit të fermerëve me serra, bletë, bagëti të imta etj

Numri rendor i masës	32
Përfshirja në listën prioritare të projekteve	JO
Emërtimi i masës	Promovimi i bujqësisë organike dhe agroturimit përmes subvencionimit të fermerëve me serra, bletë, bagëti të imta etj.
Bartësi i zbatimit	Komuna e Istogut
Partneri në zbatim	Drejtoria e Bujqësisë
Palët tjera të përfshira	Agjencioni për Zhvillim Rural
Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)	2025-2028
Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)	500,000.00
Burimi i financimit	Komuna e Istogut Agjencioni për Zhvillim Rural
Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi	<p>Qëllimi i kësaj mase është suvencionimi i fermerëve për tu përshtatur ndaj ndryshimeve klimatike dhe prodhimit të qëndrueshme të bazuar në bujqësi organike dhe agroturizëm përmes subvencionimit të tyre me serra, bletë dhe bagëti të imta.</p> <p>Kjo masë përfshin aktivitetet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Zhvillimi i kritereve dhe procedurave për grantet për subvencionimin e fermerëve;</li> <li>• Identifikimin e fermerëve potencial për subvencionim;</li> <li>• Ndarja e granteve për subvencionimi i fermerëve me serra, bletë, bagëti të imta etj.</li> </ul>

#### 6.2.11. Sektorët Tjerë

Në kuadër të aktiviteteve tjera me rëndësi që mund të përfshihen në procesin e planifikimit për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike mund të përfshihen edhe aktivitetet që ndërlidhen me edukimin dhe ndërgjegjësimin e grupeve të ndryshme të interesit për rëndësinë e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe zhvillim të qëndrueshëm.

Tabela 79. Edukimi dhe informimi për ndryshime klimatike dhe zhvillim të qëndrueshëm

Numri rendor i masës	33
Përfshirja në listën prioritare të projekteve	JO
Emërtimi i masës	Edukimi dhe informimi për ndryshime klimatike dhe zhvillim të

	qëndrueshëm
Bartësi i zbatimit	Komuna e Istogut/Drejtoria e Arsimit
Partneri në zbatim	MMPHI
Palët tjera të përfshira	Organizatrat e Shoqërisë Civile
Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)	2025-2028
Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)	200,000.00
Burimi i financimit	Komuna e Istogut
Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi	<p>Kjo masë përfshinë aktivitet për zhvillimin e materialeve edukative për publikun e gjerë dhe grupet e interesit. Masa mundë të shërbëjë si masë sinergjike edhe për masat tjera të propozuara në plan.</p> <p>Në kuadër të aktiviteteve për zbatimin e kësaj mase përfshihen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Krijimi i një platforme për edukim dhe informim për përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike dhe zhvillim të qëndrueshëm,</li> <li>• Ofrimin e informacionit për gjendjen e parametrave klimatikë dhe kushteve ekstreme klimatike duke sinjalizuar vendndodhjen e shfaqjes së ngjarjeve ekstreme klimatike;</li> <li>• Përgatitjen e hartave digjitale të kushteve klimatike dhe ngjarjeve ekstreme;</li> <li>• Dhënien e paralajmërimeve dhe parashkikimeve për kushtet ekstreme të motit.</li> </ul>

### 6.3. Varfëria energjetike

Tabela 80. Plani i veprimit për luftimin e varfërisë energjetike në Komunën e Istogut

<b>Numri rendor i masës</b>	1
<b>Emërtimi i masës</b>	Plani i veprimit për luftimin e varfërisë energjetike në Komunën e Istogut
<b>Bartësi i zbatimit</b>	Komuna e Istogut
<b>Partneri në zbatim</b>	Qeveria e Kosovës Donatorët
<b>Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)</b>	2025-2027
<b>Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)</b>	
<b>Burimi i financimit</b>	Buxheti komunal, Donatorët

<b>Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi</b>	Masa përfshinë zhvillimin e kritereve të varfërisë energjetike për komunën e Istogut. Këto kritere përcaktojnë cilat amvisëri (familje) hynë në kategorinë e varfërisë energjetike dhe cilat masa janë planifikuar të zbatohen. Plani përcakton mënyrën e verifikimit të statutit të amvisërisë (familjes) si dhe metodologjinë e monitorimit dhe formën e raportimit.
---	--

Tabela 81. Mbështetja e komunës familjeve në nevojë për pagesën e faturave të energjisë elektrike

<b>Numri rendor i masës</b>	2
<b>Emërtimi i masës</b>	Mbështetja e komunës familjeve në nevojë për pagesën e faturave të energjisë elektrike (një pjesë deri në një sasi të caktuar të energjisë elektrike të shpenzuar)
<b>Bartësi i zbatimit</b>	Komuna e Istogut
<b>Partneri në zbatim</b>	Qeveria e Kosovës KEDS Donatorët
<b>Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)</b>	2024-2030
<b>Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)</b>	
<b>Burimi i financimit</b>	Buxheti komunal Donatorët
<b>Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi</b>	<p>Masat për mbështetjen e familjeve në nevojë për pagesën e faturave të energjisë elektrike në Komunën e Istogut janë një hap i rëndësishëm drejt përballjes së varfërisë energjetike dhe ofrojnë një ndihmë të domosdoshme për ata qytetarë që përballen me sfida ekonomike dhe që kanë vështirësi për të paguar furnizimin me energji elektrike. Në kuadër të kësaj mase, Komuna e Istogut mbështet me ndihmë financiare familjet në nevojë për të paguar një pjesë të faturave të energjisë elektrike.</p> <p>Kjo iniciativë reflekton përkushtimin e komunës për të siguruar që askush të mos jetë lënë pas dore dhe për të promovuar një shoqëri më të drejtë dhe më të barabartë për të gjithë banorët.</p>

Tabela 82. Mbështetja e familjeve në nevojë për sigurimin e lëndës djegëse (dru zjarri) për ngrohje

<b>Numri rendor i masës</b>	3
<b>Emërtimi i masës</b>	Mbështetja e familjeve në nevojë për sigurimin e lëndës djegëse

	(dru zjarri) për ngrohje
<b>Bartësi i zbatimit</b>	Komuna e Istogut
<b>Partneri në zbatim</b>	Qeveria e Kosovës Donatorët
<b>Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)</b>	2024-2030
<b>Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)</b>	-
<b>Burimi i financimit</b>	Buxheti komunal Donatorët
<b>Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi</b>	Masat për përballjen me varfërinë energjetike në Komunën e Istogut, duke mbështetur sigurimin e lëndës djegëse për familjet në nevojë për ngrohje, ofrojnë një ndihmë jetësore dhe ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së jetës për komunitetin. Kjo iniciativë shpreh përkushtimin e komunës ndaj mirëqenies së banorëve të saj dhe tregon solidaritet për të ndihmuar ata që kanë më shumë nevojë në kohët e ftohta.

Tabela 83. Subvencionimi për zbatimin e masave për efikasitet të energjisë në shtëpitë e banimit të familjeve në nevojë

<b>Numri rendor i masës</b>	4
<b>Emërtimi i masës</b>	Subvencionimi për zbatimin e masave për efikasitet të energjisë në shtëpitë e banimit të familjeve në nevojë
<b>Bartësi i zbatimit</b>	Komuna e Istogut
<b>Partneri në zbatim</b>	ME, Fondi i Kosovës për Efikasitet të Energjisë (FKEE) Donatorët
<b>Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)</b>	2024-2030
<b>Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)</b>	
<b>Burimi i financimit</b>	Buxheti komunal ME, Fondi i Kosovës për Efikasitet të Energjisë (FKEE) Donatorët
<b>Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi</b>	Masat për përballjen me varfërinë energjetike në Komunën e Istogut përfshijnë një program subvencionimi për zbatimin e masave për efikasitet të energjisë në ndërtesat e familjeve në



	<p>nevojë. Ky program ofron ndihmë financiare për familjet për të ndërmarrë veprime për të ulur konsumin e energjisë dhe për të përmirësuar eficiencën energjetike të ndërtesave të tyre. Këto masa përfshijnë ndërtime-rinovime si: izolimi termik i mureve të jashtme, izolimi termik i tavanit të ndërtesave, zëvendësimi i dritareve dhe dyerve të jashtme me të reja që kanë efikasitet të lartë të energjisë, si dhe instalimi i sistemeve me efikasitet të lartë për ngrohje të hapsirës. Kjo ndihmë financiare është një hap i rëndësishëm drejt zvogëlimit të varfërisë energjetike të familjeve në nevojë dhe reduktimit të kostove të energjisë në nivel lokal.</p> <p>(Kjo masë është e ndërlidhur me të njëjtën masë të veprimet për zbatim ndaj ndryshimeve klimatike).</p>
--	---

Tabela 84. Subvencionimi për përmirësimin e efikasitetit të sistemeve për ngrohjen e hapsirës dhe përdorimi i burimeve të ripërtëritshme të energjisë në shtëpitë e banimit të familjeve në nevojë

<b>Numri rendor i masës</b>	5
<b>Emërtimi i masës</b>	Subvencionimi për përmirësimin e efikasitetit të sistemeve për ngrohjen e hapsirës dhe përdorimi i burimeve të ripërtëritshme të energjisë në shtëpitë e banimit të familjeve në nevojë
<b>Bartësi i zbatimit</b>	Komuna e Istogut
<b>Partneri në zbatim</b>	ME, Fondi i Kosovës për Efikasitet të Energjisë (FKEE) Donatorët
<b>Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)</b>	2024-2030
<b>Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)</b>	
<b>Burimi i financimit</b>	Buxheti komunal ME Fondi i Kosovës për Efikasitet të Energjisë (FKEE) Donatorët
<b>Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi</b>	<p>Kjo masë ka për qëllim mbështetjen e familjeve në nevojë përmes subvencionimit për përmirësimin ose zëvendësimin e sistemeve të ngrohjes së hapsirës në shtëpitë e banimit.</p> <p>Në kuadër të kësaj mase do të mbështeten veprimet për përmirësimin e efikasitetit të sistemeve të ngrohjes së hapsirës dhe zëvendësimi i lëndëve djegëse nga ekzistueset në burime energjetike më të favorshme në aspektin mjedisor dhe financiar, sidomos do të mbështeten sistemet që përdorin burime të</p>

	ripërtëritshme të energjisë.  (Kjo masë është e ndërlidhur me të njëjtën masë të veprimet për zbatim ndaj ndryshimeve klimatike)
--	--

Tabela 85. Përmirësimi i rrjetit për furnizim me energji elektrike në territorin e komunës së Istogut

<b>Numri rendor i masës</b>	6
<b>Emërtimi i masës</b>	Përmirësimi i rrjetit për furnizim me energji elektrike në territorin e komunës së Istogut
<b>Bartësi i zbatimit</b>	Komuna e Istogut
<b>Partneri në zbatim</b>	ME, KEDS, Donatorët
<b>Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)</b>	2024-2030
<b>Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)</b>	
<b>Burimi i financimit</b>	KEDS, ME, Buxheti komunal Donatorë
<b>Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi</b>	Masat për përballje me varfërinë energjetike në Komunën e Istogut përveç tjerash përfshijnë përmirësimin e rrjetit për furnizim me energji elektrike në territorin e komunës. Kjo përfshin investime dhe ndërhyrje për të rritur efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e rrjetit, duke përdorur teknologji të përparuara dhe duke kryer rregullime të nevojshme infrastrukturore. Kjo masë synon të sigurojë një furnizim më të qëndrueshëm dhe më të përshtatshëm me energji për banorët dhe bizneset në territorin e komunës së Istogut, duke kontribuar në uljen e varfërisë energjetike dhe në përdorimin më eficient të energjisë elektrike.

Tabela 86. Formimi i qendrës informuese komunale për varfëri energjetike

<b>Numri rendor i masës</b>	7
<b>Emërtimi i masës</b>	Formimi i qendrës informuese komunale për varfëri energjetike
<b>Bartësi i zbatimit</b>	Komuna e Istogut
<b>Partneri në zbatim</b>	ME, Fondi i Kosovës për Efikasitet të Energjisë (FKEE)

	Donatorët
<b>Periudha e fillimit/përfundimit (vitet)</b>	2027-2029
<b>Investimi i përgjithshëm i vlerësuar (€)</b>	
<b>Burimi i financimit</b>	Buxheti komunal, ME, Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE) Donatorët
<b>Përshkrimi i shkurtë i masës/komentimi</b>	Masat për përballjen me varfërinë energjetike në Komunën e Istogut përfshijnë themelimin e një qendre informuese komunale për varfërinë energjetike. Ky program synon të krijojë një burim informacioni dhe këshillimi për banorët dhe bizneset lokale në lidhje me strategjitë dhe masat për kursimin e energjisë. Qendra informuese do të ofrojë këshillim teknik për përdorimin e energjisë së eficientë, informacion mbi programe dhe shërbime subvencionuese, si dhe trajnime për të rritur ndërgjegjësimin rreth rëndësisë së përdorimit të qëndrueshëm të energjisë. Kjo ndërhyrje synon të përmirësojë vetëdijen dhe kapacitetet e komunitetit për të vepruar në mënyrë të përgjegjshme ndaj energjisë, duke kontribuar në zvogëlimin e varfërisë energjetike dhe në përmirësimin e gjendjes së mjedisit lokal.

## 7. VLERËSIMI I ZVOGËLIMIT TË GAZRAVE SERRË NGA MASAT E PROPOZUARA DERI NË VITIN 2030

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>6</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>7</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.



## Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

### Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>6</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>7</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



**Komuna e Istogut**  
Opština Istok  
Istog Municipality

---

## ZYRA E KRYETARIT

### PLANI I VEPRIMIT PËRZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TE DHENA NGA ZYRA KOMBETARE E AUDITIMIT PER PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË ISTOGUT PËR VITIN 2023

Rekomandimet e paraqitura me poshtë, synojnë të përmirësojnë kontrollin e brendshëm në lidhje me menaxhimin dhe kontrollin financiar, duke respektuar autoritetin që lidhet me menaxhimin e fondeve në sektorin publik. Planin ynë është të rishikojmë dhe të ndjekim këto rekomandime nga Zyra Kombëtare e Auditimit me qëllim të përmirësimit të kontrollit të brendshëm. Raporti ynë ka rezultuar me nëntë (9) rekomandime prej tyre tri (3) janë rekomandime të reja, pesë (5) të përsëritura dhe një (1) pjesërisht i përsëritur për përmirësimin e këtyre aspekteve të menaxhimit financiar dhe kontrolleve.

<u>Nr.</u>	Komponenta e auditimit (kapitulli)	Të gjeturat/çështja	Rekomandimet	Veprimet e planifikuara për realizimin e rekomandimeve	Bartësit/Drejtorit, Zyrtarët përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit	Komentet
<u>1</u>	Çështja A1 - Mosrespektim i hapave për procedimin e pagesave	Sipas Rregulles financiare nr. 01/2013 per shpenzimin e parase publike, neni 22 Shpenzimi i parave publike, percakton hapat per procedimin e pagesave, ku fillimisht behet Kerkesa per blerje, leshohet Urdher blerja, behet pranimi i mallit/sherbimit, pastaj Operatori Ekonomik sjelle faturen per pagese.	<b>Rekomandimi A1:</b> Kryetari duhet te siguroje se respektohen hapat e percaktuar me rregullat ne fuqi per procedimin e pagesave nga zyrtaret pergjegjes, ne menyre qe fillimisht te behet zotimi i mjeteve, te nxjerret urdher blerja dhe me pas pranimi i mallrave/puneve.	Caktimi i zyrtarëve autorizues - përgjegjës brenda njësive të autorizuar për shpenzim të programeve dhe nën programeve buxhetore.	<u>Njësit kërkuese dhe autorizuese në kuadër të drejtorieve që kanë shpenzime nga kategoritë ekonomike e rekomanduar nga ZKA-ja</u>	<u>01.07.2024</u>	
<u>2</u>	Çështja A2 - Mos raportim dhe shfrytëzimi i subvencionit	Ndermarrja Publike Lokale "Stacioni i	<b>Rekomandimi A2:</b> Kryetari duhet te siguroje forcimin e kontroleve ne	Caktimi i personit monitorues te shpenzimeve	<u>Drejtoria për Shërbime Publike dhe Bordi i</u>	30.07.2024	

	<p><b>jo në përputhje me qëllimin e dhënë</b></p>	<p>Autobuseve", e cila është në pronesi të komunes me 100% të aksioneve, ka bërë kerkese me 14.10.2022 në komune për ndarjen e fondeve buxhetore për qellime të funksionalizimit të ndermarrjes. Me vendim të kryetarit, komuna me datë 16.06.2023 ka ndarë mjete buxhetore në vlerë prej 50,000C. Pika 3 e vendimit përcakton se Ndermarrja Publike është e obliguar të bëjë raportim për shpenzimin e fondeve financiare në mënyrë që të vërtetohet se ato janë shpenzuar</p>	<p>fushën e dhenies dhe monitorimit të subvencioneve, në mënyrë që mjetet fondet e dhëna nga komuna të shfrytëzohen vetëm për qëllimet e subvencionuara. Nëse përfituesit nuk arrijnë të arsyetojnë shfrytëzimin e mjeteve fondeve në përputhje me qëllimin e dhënë, të merren masa për kthimin e mjeteve fondeve nga përfituesit</p>	<p><b>nga Bordi i aksionareve</b></p>	<p><u><b>aksionareve</b></u></p>		
--	---	---	---	---------------------------------------	----------------------------------	--	--

		sipas qellimit per te cilin jane dhene.					
<u>3</u>	<b>Çështja B1 - Mos regjistrim i pasurive nën 1,000€ në programin e e-pasurisë</b>	Rregullorja MF-NR. 02/2013 per menaxhimin e pasurise jo financiare ne organizatat Rregullorja MF-NR. 02/2013 per menaxhimin e pasurise jo financiare ne organizatat buxhetore, Neni 6.1. percakton se, "<do organizate buxhetore duhet te krijoje dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare qe i ka ne menaxhimin e saj. Regjistri duhet te mbahet ndaras per <do pasuri dhe ne forme te agreguar sipas kategorive te klasifikuara ne baze te planit kontabel. Po ashtu neni 6.3. percakton se, Pasuria kapitale duhet te	<b>Rekomandimi B1:</b> Kryetari duhet te shtoje kontrollet e brendshme per tu siguruar se zyrtaret e pasurive do ta regjistrojne pasurine jo kapitale ne regjistra kontabel perkatesisht ne sistemin e-pasurise.	<b>Raportimi në baza mujre mbi procesin e regjistrimit të pasurive nën 1000 euro, nga Arsimi, Shëndetësia dhe Administrata</b>	<b>Drejtoria për Administratë, Arsim dhe Shëndetësi.</b>	<b>20.07.2024</b>	

		<p>regjistrohet ne SIMFK ndersa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet te regjistrohet ne sistemin "e-pasuria".</p> <p>Nga testimi i mostrave kemi verejtur se pasuria jo kapitale ne vlere 81,440€ e blere gjate vitit 2023 nuk ishte regjistruar e tera ne sistemin "e-pasua".</p> <p>Pasurite e blera dhe te paregjistruara kane te bejne me inventare, kamera, mobilje, pajisje trafiku, drita dekorative etj. per sektorin e administrates dhe arsimit. Megjithese keto pasuri nuk jane regjistruar ne sistemin "e-pasuria", komuna i ka evidentuar ato gjate procesit te</p>					
--	--	--	--	--	--	--	--



		inventarizimit dhe i ka prezantuar ne PVF.					
<u>4</u>	<b>Çështja B2 - Vonesa në pagesat e faturave të pranuar</b>	Ligji Nr.03/L-048 per MFPP, nenin 39.1, percakton qe "ZKF i organizates buxhetore eshte pergjegjes per te siguruar qe <do fature e vlefshme dhe kerkese per pagim per mallra dhe sherbimet e furnizuara dhe/ose punet e realizuara per organizaten buxhetore te paguhen brenda tridhjete (30) diteve kalendarike pas pranimit te fatures ose kerkeses per pagim nga organizata perkatese buxhetore. Gjate trajtimit te detyrimeve kemi verejtur se pese (5) fatura, ne vlere prej 13,601C	<b>Rekomandimi B2:</b> Kryetari duhet te siguroje nje planifikim me te mire te fondeve buxhetore, si dhe inicimi i procedurave te shpenzimeve te realizohet vetem kur fondet jane ne dispozicion me qellim te eliminimit te vonesave per pagesat e faturave apo te shmangies se padive eventuale nga operatoret ekonomik.	<b>Planifikim më i mirë i planit të shpenzimeve nga menaxhert e kontrat dhe njësit kërkeuse.</b>	<b><u>Njësit kërkuese dhe autorizuese në kuadër të drejtorieve që kanë shpenzime nga kategoritë ekonomike e, duke respektuar afatet e shpenzimeve.</u></b>	<b>01.10.2024</b>	

		nuk ishin paguar brenda afatit 30 ditore, vonesat e pagesave per keto raste jane nga 17 dite deri ne 60 dite.					
<u>5</u>	<b>Çështja A3 - Regjistrat e menaxhimit të kontratave jo përmes platformës së e-prokurimit</b>	Pika 61 e Rregulles dhe Udhezuesit Operativ per Prokurimin Publik parasheh qe te Menaxhimi i Kontrates dhe Vleresimi i performanc es se kontraktues ve te siguroje qe te gjitha regjistrat e	<b>Rekomandimi A3:</b> Kryetari duhet te kerkoje nga te gjithë menaxheret e projekteve per tu siguruar qe menaxhimi i kontratave do te mbahet dhe arkivohet nga sistemi elektronik i prokurimit publik.	Trajnimi i zyrtarëve për menaxhimin dhe regjistrimin e kontratave përmes platformës së e-prokurimit.	<u>Menaxherat e kontratave dhe Drejtorët e Drejtorive të cilët janë mbikëqyrës të drejtpërdrejtë të kontratës.</u>	01.10.2024	

		menaxhimit te kontrates te pergatiten, mbahen dhe arkivohen ne modulin per menaxhim te kontrates ne sistem te prokurimit elektronik					
<u>6</u>	<b>Çështja B3 - Keq klasifikim i shpenzimeve</b>	Sipas Rregulles Financiare Nr. 01/2013/MF "Mbi shpenzimin e parase publike" shpenzimet duhet te kene kodet adekuate, te percaktuara me Udhezimin Administrativ per planin kontabel, po ashtu me planin kontabel te Thesarit jane percaktuar kodet dhe kategorite perkatese te	<b>Rekomandimi B3:</b> Kryetari duhet te siguroje qe shpenzimet te planifikohen ne ndarjet adekuate te buxhetit apo te behet ridestnimi i mjeteve qe pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve me pas te behet sipas kodeve ekonomike adekuate.	<b>Verifikimi shtesë nga Zotuesi i mjeteve bazuar në planin e ri Kontabël.</b>	<b><u>Njësit kërkuese dhe autorizuese në kuadër të drejtorieve që kanë shpenzime nga kategoritë ekonomike e, duke respektuar kategoritë e sakta ekonomike.</u></b>		

		shpenzimeve qe OB duhet te aplikojne. Ne baze te pagesave te testuara, kemi verejtur se jane bere pagesa nga kategorite ekonomike jo adekuate, ne vlere prej 28,394C. Si ne vijim:					
7	<b>Çështja B4 - Dobësi në menaxhimin e Llogarive të Arkëtueshme</b>	Sipas nenit 26 te Ligjit per tatimin ne pronen e paluajtshme 06-L 005,Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente permbaruese kane autoritetin dhe kompetencat per te mbledhur detyrimet tatimore te papaguara qe kalojne shumen e dhjete (10) Eurove dhe neni 27 Nese nje tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotesisht tatimin dhe gjoben	<b>Rekomandimi B4:</b> Kryetari duhet te siguroje forcimin e mekanizmave te kontrollit ne mbledhjen e borxheve nga tatimpaguesit, duke i shfrytezuar te gjitha mjetet ne dispozicion, pa perjashtuar edhe veprimet ligjore.	<b>Shtimi i zyrtarëve në zyrën e tatimit në pronë për mbulimin e tërë territorit të komunës së Istogut, duke lëshuar fletëkujtesa shitesë për rikujtimin e tatimit në pronë, si dhe duke bërë rianketimin e objektev ekzistuese dhe regjistrimin sa më të shpejtë të objekteve të reja.</b>	<b>Zyra e tatimit në pronë</b>	<b>01.09.2024</b>	

		<p>nese ka te ketille, ose detyrimet tatimore te papaguara, ne perputhje me afatet e percaktuara, komuna nxjerr njoftimin perfundimtar me shkrim brenda dhjete (10) diteve pune pas dites se fundit per pagese, ku kerkon pagesen e plote te detyrimeve tatimore te papaguara, jo me vone se dhjete (10) dite kalendarike pas dites qe njoftimi perfundimtar konsiderohet te jete pranuar nga debitori. Pjesa me e madhe e LL/A-ve i takon tatimit ne prone ne vlere 1,245,358C rreth 82%, taksa komunale ne biznes ne vlere 174,831C (borxhe te mbetura nga viti 2012) rreth 12%, shfrytezimi i prones publike ne</p>					
--	--	--	--	--	--	--	--



		<p>vlere 41,019C rreth 3% dhe borxhe te tjera rreth 3%. Llogarite e arketueshme ende mbeten te larta, edhe pse kemi nje zvogelim te tyre per 20% ne vitin 2023 ne krahasim me vitin 2022, sidomos kemi zvogelim te borxhit nga tatimi ne prone, zvogelimin e borxhit nga tatimi ne prone eshte si rrjedhoje e faljes se borxhit qe ka ndodhur ne vitin 2023.</p>					
8	<p><b>Çështja B5 - Mos kompletimi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm</b></p>	<p>Rregulloren QRK - NR 01/2019 per themelimin dhe zbatimin e funksionit te auditimit te brendshem ne subjektin e sektorit public. Neni 5.1.1 percakton qe &lt;do subjekti i sektorit publik me buxhet</p>	<p><b>Rekomandimi B5:</b> Kryetari, duhet te siguroje se per pozitat e kerkuara do te behen planifikimet buxhetore me kohe, dhe qe NjAB te plotesohet me staf te mjaftueshem sipas rregullores per themelimin e saj, e qe njekohsisht do te</p>	<p><b>Shpallja e konkursit për auditor të mbrëmshëm nga Burimet njerëzore.</b></p>	<p><b>Burimet Njerëzore.</b></p>	<p><u>01.09.2024</u></p>	

		<p>mbi shtate (7) milion euro duhet te kete se paku tre auditore. Po ashtu NJAB ne planin vjetor te auditimit per vitin 2023 ka planifikuar kater (4) auditime.</p> <p>Njesia e Auditimit te Brendshem perbehet vetem nga Udheheqesi i Njesise se auditimit. Kjo Njese nuk kishte realizuar asnje auditim nga kater auditimet qe kishte planifikuara per vitin 2023. Shkak i mos permbushjes se planit te auditimit ishte se Udheheqesi i NJAB- se me date 28.05.2023 eshte pensionuar dhe auditori tjeter eshte transferuar ne kete pozite me date 11.10.2023. Pra Komuna nuk ka</p>	<p>rriste dhe forconte kontrollet e brendshme.</p>			
--	--	---	--	--	--	--

		ndermarre veprime te duhura per ta trajtuar <eshtjen e perberjes dhe funksionit te Njesise se Auditimit te brendshem per ta kompletuar me staf te duhur.					
<u>9</u>	<b>Çështja C1 - Komiteti i auditimit funksional</b>	Udhzimit Administrativ MF-NR. 01/ 2019 per themelimin dhe funksionimin e komitetit te auditimit ne subjektin e sektorit publik, Neni 6 Komiteti i Auditimit emerohet nga udheheqesi i subjektit te sektorit publik dhe perbehet nga tre (3) ose pese (5) anetare. Kryesuesi i Komitetit te	<b>Rekomandimi C1:</b> Kryetari, duhet te siguroje funksionimin efektiv te Komitetit te Auditimit, ne menyre qe te rishikojte planet e auditimit te brendshem, per te konfirmuar se ato bazohen ne rrezik dhe t'i ofroje sigurine e kerkuar menaxhmentit per funksionimin e kontrolleve te brendshme	<b>Funksionalizim i imenjehershëm i komitetit të auditimit.</b>	<b>Udhëheqësi i komitetit të auditimit</b>	<b>01.07.2024</b>	



		<p>Auditimit nuk duhet te jete ne poziten udheheqese, dy te tretat (2/3) e anetareve duhet te jene te jashtem, dhe pjesa tjeter nga stafi i brendshem i subjektit te sektorit public Komiteti i Auditimit (KA) te Brendshem nga marsi 2022 ishte pa kuorum (dy prej tyre ishin terhequr nga komiteti i auditimit) deri ne dhjetor te vitit 2022, kur u kompletua me perberje te re, e cila ka vetem dy anetar.Po ashtu komiteti i auditimit nuk i ka mbajtur kater takime qe jane obligative, por vetem dy.</p>					
--	--	---	--	--	--	--	--

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	<b>KRYETARI I KOMUNËS          PREDSIEDNIK OPŠTINE          MUNICIPAL MAYOR</b>		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	01.Nr.586/2024	Datë: 18.07.2024	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 58 pika ( h ) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale; nenin 14 të të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenin 68, pika 8 e Statutit të Komunës 01 Nr. 62/10 të datës 30.11.2010 i :

### Propozon

Kuvendit të Komunës, që në bazë të nenit 11, nenit 12, paragrafi 12.2 pika (d), nenit 14 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3, paragrafi 2 dhe paragrafi 3, nenit 11, paragrafi 1, paragrafi 2, paragrafi 3, nënparagrafi 3.1 dhe 3.2 dhe nenit 13 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 6, nenit 13 dhe nenit 23 paragrafi 1, paragrafi 2 nënparagrafi 2.3 paragrafi 4 nënparagrafi 4.2 dhe nënparagrafi 4.3, paragrafi 6 dhe 7 i Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës; nenit 83 të Statutit të Komunës së Istogut 01 Nr.62/2010 dhe në përputhje me Dokumentet e Planifikimit Hapësinor me qëllim të dhënies në shfrytëzim afatgjatë me negociim pronat e paluajtshme të komunës, Njësia Kadastrale P-70806044-00896-0 me sipërfaqe prej 16942 m<sup>2</sup> investitorit Arber Avdijaj “ Agroproduct “ SHPK me pronar Arber Avdijaj pas negociatave të zhvilluara në mes të Kryetarit të Komunës si përfaqësues i komunës dhe si qiradhënës në njërën anë dhe Arber Avdijaj “ Agroproduct “ SHPK në anën tjetër si qiramarrës, pas shqyrtimit të propozimit të Kryetarit të Komunës, i propozon Kuvendit të Komunës që në mbledhjen e mbajtur më 30.07.2024 të miratojë këtë:

### VENDIM PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË ME NEGOCIM PRONAT E PALUAJTSHME TË KOMUNËS “ AGROPRODUCT “

1. Të **MIRATOHET** propozim-vendimi i Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë me negociim pronën e paluajtshme të Komunës, Njësia Kadastrale P-70806044-00896-0 me sipërfaqe prej 16942 m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale- Sinajë, e cila sipas certifikatës pronësore me numër të referencës 2222/2024 është e evidentuar P.SH. E Mirë e Fshatit e cila i jepet në shfrytëzim afatgjatë me negociim investitorit Arber Avdijaj “ Agroproduct “ SHPK.
2. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim afatgjatë me negociim i pronës së paluajtshme të Komunës të cekur në pikën 1 të këtij vendimi është zhvillimi i aktiviteteve biznesore, ndërtimi i qendres multifunkionale për përpunimin e bimëve medicinale dhe aromatike po ashtu duke përfshirë edhe përpunimin e frutave malore si dhe përpunimin e kërpudhave dhe shumë aktivitete tjera shtesë duke synuar kështu tregun vendor dhe evropian, gjenerimi i vendeve të reja të punës sipas standardeve të përcaktuara me dispozitat ligjore, rritjen e zhvillimit ekonomik të komunës si dhe rritjen e vlerës së pronës së komunës ku vlera e investimit është 1.259.028 euro deri në 1.500.000 euro ( një milion e gjysmë euro) me çka tejkalohet vlera prej 10 % e buxhetit të përgjithshëm për investime kapitale të komunës për vitin paraprak 2023.

3. Afati kohor për dhënien në shfrytëzim afatgjatë me negociim të pronave të paluajtshme të komunës të cekur në pikën 1 të këtij vendimi është në kohëzgjatje prej 40 vite ( katërdhjetë ) vite ku do të jepet në shfrytëzim me kompensim në shumën e qirasë vjetore prej 1.080 euro (njëmijë e tetëdhjetë euro) sipas kushteve tjera të parapara në kontratë.
4. Të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës si qiradhënëse me investitorin " Agro Product " SHPK si qiramarrës do të rregullohen me kontratë të veçantë të nënshkruar nga Kryetari i Komunës si përfaqësues i Komunës dhe investitori i " Agro Product " SHPK " Arber Avdijaj.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis, Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Drejtoria për Inspektion.
4. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike sipas nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

### Arsyetim

Baza ligjore për miratimin e këtij Propozim-Vendimi është përcaktuar me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale; Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Statutit të Komunës së Istogut 01 Nr.62/2010.

Kryetari i Komunës si përfaqësues i komunës, sipas autorizimeve ligjore që i ka, duke u bazuar në nenin 11 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe ligjeve tjera përkatëse në fuqi pas parashtrimit të kërkesës Nr.01-016-19153 me dokumentet përcjellëse ( planin ideor, planin e biznesit, certifikatën e regjistrimit të biznesit etj. ) me datën 04.06.2024 nga investitori Arber Avdijaj "Agroproduct" SHPK për marrjen në shfrytëzim afatgjatë me negociim, pronën e paluajtshme të Komunës, Njësinë Kadastrale P-70806044-00896-0 me sipërfaqe prej 16942 m<sup>2</sup> , Zona Kadastrale- Sinajë, e cila sipas certifikatës pronësore me numër të referencës 2222/2024 është e evidentuar P.SH. E Mirë e Fshatit ka realizuar negociatave për qëllimin e lartcekur.

Sipas projektit ideor-planit të biznesit dhe sipas negociatave investitori planifikon që në pronën e lartcekur të ndërtojë objektin me sipërfaqe prej 1500 m<sup>2</sup> si dhe hapësirën e parkingut, e cila planifikohet të përshtatet në bazë të nevojave të tregu në kuadër të hapësirave ekzistuese. Kohëzgjatja e investimeve deri në përfundimin e saj të plotë do jetë 3 deri në 4 vite pas nënshkrimit të kontratës. Përveç rritjes së vlerës së Pronës së paluajtshme të Komunës sipas projektit ideor do të gjenerohen edhe vende të reja të punës ku pritet të punësohen 30 persona si dhe krijimi i tregut për fermerët vendor për shitjen e produkteve të tyre në këtë qendër të përpunimit.

Me qëllim të realizimit të interesit publik, rritjes së vlerës së pronave të komunës, krijimit të të hyrave vetanake në njërin anë dhe ofrimit të kushteve për krijimin e vendeve të reja të punës në anën tjetër përmes bërjes së politikave të punësimit, propozohet dhënia në shfrytëzim e pronave të paluajtshme të Komunës investitorit të lartcekur siç përcaktohet në nenin 1 të këtij propozim-Vendimi andaj kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

**Udhëheqësja e Zyrës Ligjore**  
**z.Zekije Sutaj**

**Kryetari i Komunës**  
**z. Ilir FERATI**



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut  
Opština Istok  
Istog Municipality

Datë :16.07.2024

## Oferta e Negociuar e Kryetarit të Komunës me investitorin z. Arber Avdijaj "Agro Product "Sh.P.K

Investitori z. Arbër Avdijaj pronar dhe përfaqësues "Agro Produkt" më datë 04.06.2024 ka parashtruar kërkesën Nr. 01-016-19153 ,drejtuar Kryetarit të Komunës z. Ilir Ferati për marrjen në shfrytëzim afatgjatë me negociim pronën e paluajtshme e komunës, Njësinë Kadastrale P-70806044-00896-0 në vendin e quajtur "Rudesh" e cila sipas certifikatës pronësore është e evidentuar pronë E Mirë E Fshatit, Zona Kadastrale - Sinajë K, Istog.

Pas pranimit të kërkesës për marrjen në shfrytëzim me negociim të pronave për njësinë kadastrale të lartcekura u realizuan takime ndërmjet Kryetarit të Komunës z. Ilir Ferati dhe investitorit z. Arber Avdijaj ku të pranishëm kanë qenë edhe Drejtori i Drejtorisë për Kadastër dhe Gjeodezi z.Agon Dreshaj, Drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim Urban dhe Mjedis z.Dukagjin Hoxhaj, Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa si dhe Ekonomi e Zhvillim z.Genc Ademaj dhe Drejtori i Drejtorisë të Inspektionit z.Kushtrim Buleshkaj.

Investitori në këto takime prezantoi planin e biznesit dhe projektin ideor për mënyrën e shfrytëzimit të pronës së komunës me negociim sipas të cilit qëllimi i investimit është ndërtimi i një qendre multifunkionale për përpunimin dhe prodhimin e bimëve medicinale dhe aromatike ,duke përfshirë përpunimin e frutave malore ,pastaj përpunimin e kërpudhave si dhe shumë aktivitete të tjera shitesë në prodhim dhe përpunim, dukë synuar kështu tregun evropian dhe vendor.

Përveç qëllimit të cekur më lartë të këtij investimit pika tjera kryesore të diskutimit për ofertën e negociuar ishin:

- **Investimet në objekt:** Objekti 1500 m<sup>2</sup> dhe hapësira e parkingut si dhe në të ardhmen përshtatja në bazë të nevojave të tregut në hapësirat ekzistuese

- **Objektivat e investitorit** të cilat synohen të arrihen përmes marrjes në shfrytëzim me negociim të pronës së komunës: plotësimi i kërkesave të konsumatorëve sipas të cilit qëllimi i investimit është ndërtimi i një qendre multifunkionale për përpunimin dhe prodhimin e bimëve medicinale dhe aromatike ,duke përfshirë përpunimin e frutave malore, pastaj përpunimin e kërpudhave si

dhe shumë aktivitete të tjera shtesë në prodhim dhe përpunim, duke synuar kështu tregun evropian dhe vendor dhe rajon.

Rritja e qarkullimit dhe shitjes përmes dukë përfshirë këtu përmes plasmanit të mallrave dhe shërbimeve pranimin e produkteve dhe finalizimin e tyre për konsum dhe treg apo edhe për përpunim dhe ripërpunim të produkteve.

- **Vlera dhe qëllimi i investimit** – investimi do të jetë 1.259.028 Euro deri në 1.500.000 Euro, rritja e aftësisë konkurruese dhe pozicionimi më i mirë i biznesit përmes shfrytëzimit optimal të kapaciteteve dhe të gjitha resurseve dhe pozicionit duke rritur kështu duke rritur në mënyrë të fuqishme qarkullimin, të hyrat dhe profitin; hapja e 30 (tridhjetë) vendeve të reja të punës, interaktiviteti dhe lidhja me fermerët vendor, nevoja e komunitetit në raport me afërsinë e nevojave të tyre, rritja e imazhit të lokacionit, investime në objekt dhe infrastrukturë.

- **Kohëzgjatja e investimeve:** 3 - 4 vjet nga nënshkrimi i kontratës.

Pas prezantimit të planit ideor dhe atij të biznesit u arrit pajtimi që ndërmerren të gjitha veprimet e nevojshme ligjore të përcaktuara në Ligjin për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores për përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës me qëllim të dhënies në shfrytëzim afatgjatë me negociim pronat e paluajtshme të komunës të cekura më lartë.

Sipas negociatave komisioni vendosi që shuma e qirasë për investitorin lidhur me shfrytëzimin afatgjatë me negociim të pronave të paluajtshme të komunës të jetë 1080 € ( njëmijetëdhjetë ) euro në vit dhe të jepet në kohëzgjatje prej 40 vite.

Për Komunën e Istogut:

Kryetari, z. Ilir Ferati


Më: 16/07/2024

Për "Agro Product":

Investitori, z. Arber Avdijaj

Më: 16/07/2024





**Për : Kryetarin e Komunës z. Ilir Ferati**

**Nga : "Agro Produkt" Sh.P.K. me përfaqësuar nga Arbër Avdijaj nga fshati Sinajë K, Istog/**

**Tema : Kërkesë për Negocim - Direkt .**

**Datë : 21.05.2024**

## **K Ë R K E S Ë**

I nderuar kryetar FERATI

Kompania "Agro Produkt" Sh.P.K me nr,unik të biznesit 811223924 si veprimtari kryesore ka mbledhjen ,kultivimin ,përpunimin dhe prodhim të bimëve medicinale dhe aromatike ,frutave pyjore dhe këpurdhave.Ne si kompani kemi filluar kultivimin e bimëve medicinale dhe aromatike për herë të parë në Kosovë në vitin 2002.Po ashtu Agro Produkt është eksportuesi i vetëm në tregun evropian nga Kosova që ka nënshkruar kontrata për furnizim afatgjatë me kompani të njohura ndërkombëtarë të përpunimit nga Gjermania, Austria dhe Zvicra.

Më qellim të zhvillimit ekonomik dhe hapjes së vendeve të reja të punës në kompani kërkojmë nga Komuna e Istogut ,Kryetari i Komunës z. Ilir Ferati që në bazë të ligjit Për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës të Paluajtshme të Komunës të na mundësohet që përmes negociimit direkt shfrytëzimi i pjesës së parcelës nga njësia kadastrale me Nr.00896-0 ZK, Sinajë K,Istog.

Në këtë pjesë të parcelës, paraqitur edhe në planin e biznesit ku planifikojmë të investojmë rreth 1.295.028 euro në total duke përfshirë këtu hapjen e vendeve të reja të punës zgjerim infrastrukturor, blerje të makinerisë përpunuese në kuadër të veprimtarisë ekzistuese me të vetmin qellim për rritje të kapaciteteve ekzistuese si dhe zhvillim ekonomik.

Andaj më qellim të kompletimit të dokumentacionit të paraqitur kërkesës ia bashkëngjisim :

- Planin e Biznesit
- Planin Ideor
- Kopjen e Planit për parcelën Nr.00896-0 ZK,Sinajë Istog.
- Certifikatën e Pronësisë.
- Qarkullim bankar
- Vërtetimin e tatimit në pronë.

Istog 2024 .

TEL: 099 504 555







Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije  
Ministry of Trade and Industry

# ARBK

AGJENCIA E REGJISTRIMIT TE BIZNESEVE ME KOSOVE

CERTIFIKATE E REGJISTRIMIT  
CERTIFIKAT O REGISTRACIJI  
CERTIFICATE OF REGISTRATION

## 811223924

Numri Unik Identifikues / Jedinstveni Matični Broj / Unique Identification Number

### AGROPRODUCT SH.P.K.

Emri biznesit / Naziv biznisa / Name of business

///

Emri tregtar / Trgovačko ime / Commercial name

Lloji biznesit: Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara  
Poslovni tip: Društva sa ograničenom odgovornošću  
Business type: Limited Liabilities Companies

Adresa: Kryesore  
Adresa: Sinajë  
Address: Istog

Data e regjistrimit: 09/10/2012  
Datum registracije:  
Date of registration:

15/03/2019

Data / Date / Datum

Nr. ser. / Ser. br. / Ser. No.: 10008463



  
Nënshkrimi / Signature / Potpis







## Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /

Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

### CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70806044-00896-0

Numeri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:

2222/2024

Data dhe koha e lehtërit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:

11.07.2024 - 15:10

Komuna / Opština / Municipality:

ISTOG / ISTOK / ISTOG

Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:

Sinjaj / Sinaj / Sinaj

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:

ISTOG / ISTOK / ISTOG

#### A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numeri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit No.	Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70806044-00896-0	PARCELE / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Rural	16942	1-2004, 1-2004-23/2014,2/2015,2021	10.03.2015	19.05.2021

#### A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
RUDESHT			10.03.2015	19.05.2021

**A.2 LLOJJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE**

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcelë Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcelë Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja Površina Area (m <sup>2</sup> ) (m <sup>2</sup> )
1	Bujqësore/Polljoprivredno/Agriculture	Kulllosat/Pashujac/pasture	Kulllosë E Klasës 4/Pasnjak 4 Klasse/4th Class Pasture	16942

**B. PRONAR/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR**

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licenc broj ID. No.	Vendbanimi Prebivahiste Resident	Kodi postar Postanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednostni adrese Address details	Pjesa e prurës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuaruar Aznařano Updated
Poseidim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	P.SH. E MIRË E FSHATIT	KCID0807495	SINE / SINE / SINE /		SINE	1/1	1-2004	10.03.2015






REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA  
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS  
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE  
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY  
KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : ISTOG  
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Sinajë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m <sup>2</sup>
P-70806044-00896-0	Parcelë / Parcela / Parcel	16942



Shkalla/Razmera/Scale: 1:1521

Punoi/Obradio/Created: Naim Demaj

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:



Data/ Data/Date: 17.05.2024

Koha/ Vreme/ Time: 10:09:08

## PROJEKTI



**INVESTOTOR : ARBËR AVDIJAJ**

**VENDI I NDERTIMIT : SINAJE - ISTOG**

**MAJ 2024**

## PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Agroproduct është kompania lider në Kosovë për mbledhjen, kultivimin, përpunimin dhe prodhimin të bimëve medicinale dhe aromatike, frutave pyjorë dhe kërpudhave. Kompania ka filluar kultivimin e bimëve medicinale dhe aromatike për herë të parë në Kosovë në 2002 dhe është bërë sot e Kosovës udhëheqës në këtë fushë me 18 specie të kultivuara dhe 55 specie të mbledhura me vërtetim organik për të dy produkte të mbledhura dhe të kultivuara.

Agroproduct është eksportuesi i vetëm në tregun evropian në Kosovë që ka nënshkruar furnizimin afatgjatë kontrata me kompani të njohura, ndërkombëtare të përpunimit nga Gjermania, Austri dhe Zvicra.

Mbi të gjitha, gati 95 përqind e produkteve shiten jashtë vendit, gjegjësisht në tregun e BE-së. Si rezultat i përmirësime dhe përmirësime të vazhdueshme në prodhim, përpunim dhe rrjete në zhvillim, kompania ka krijuar veten si një partner strategjik për disa kompani të mëdha evropiane në një treg me një cilësi dhe sasi të lartë e kërkesës së produkteve të saj. Agroproduct madje ka lidhur kontrata në lidhje me kultivimi i specieve të caktuara bimore, përveç kontratave të furnizimit. Kompania vizitohet rregullisht nga ndërmarrjet e huaja për të vlerësuar kapacitetet e saj.

Kompania posedon pajisje moderne për përpunimin e produkteve në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe një infrastrukturë e shkëlqyer, duke përfshirë një ndërtesë objektesh 1.200 m<sup>2</sup>, tharëse moderne me një sipërfaqe tharje 100 m<sup>2</sup> si dhe dhoma ftohëse me sipërfaqe 200 m<sup>2</sup>. Gjatë tre viteve të fundit, xhiroja e kompanisë ka pësuar një rritje mesatare prej 30% duke udhëhequr një të ardhme shumë premtuese për zhvillimin e kompanisë. Për më tepër, kompania ka bërë investimet për të siguruar cilësi të lartë. Agroproduct po planifikon gjithashtu të bëjë investime të mëtejshme të cilat përfshijnë investime në makineri dhe pajisje, zgjerim të mëtejshëm të ambienteve të depove, tokës dhe automjetet. Ky investim do të ndikojë drejtpërdrejt në kapacitetin e prodhimit siç paraqitet në detaje në këtë plan biznesi. Kapaciteti i rritur i prodhimit do t'i mundësojë kompanisë të përmbushë kërkesën për këtë kontratat ekzistuese me ndërmarrjet e huaja dhe megjithatë rritin qarkullimin me mbi 60%.

Totali investimet e parapara me këtë plan biznesi arrijnë në 1,295,028 Euro. Shuma totale e investimeve pritet të financohet pjesërisht nga grantet nga Bashkimi Evropian dhe Ministria e Bujqësisë, gjithsej shuma e grantit prej 524,019 Euro dhe përmes kredive në vlerë prej 770,000 Euro. Investimet janë pritet të realizohet gjatë tremujorit të katërt të vitit 2016.

Për shkak të sezonalitetit të prodhimit, kompania kërkon gjithashtu financim për kapitalin qarkullues gjatë dy tremujorët e parë të vitit në mënyrë që ta përpunojnë atë në kohë dhe në gjendje ta shesin atë gjatë të tretit tremujori i vitit, më tej, kompania do të jetë në gjendje të kthejë financimin e saj për kapitalin qarkullues gjatë tremujori i katërt i vitit. Analiza financiare në këtë plan biznesi zbulon se kërkesat e financimit për kapitalin qarkullues duhet të kufizojë deri në 700,000 Euro. Kjo do t'i lejojë kompanisë të blejë të papërpunuara materiale në kohë dhe të jenë në gjendje të plotësojnë kërkesat për klientët ndërkombëtarë dhe vendas. Me të saj financimi për të punuar në kapital kompani do të jetë në gjendje të rrisë shitjet pothuajse menjëherë. modeli financiar ofron analizën e hollësishme për shitjet, cogs, kostot operacionale dhe të personelit për kompaninë përgjatë periudhës së parashikuar të vitit 2016-2022. Modeli gjeneron pasqyrat financiare që tregojnë një diferencë mesatare EBITDA prej 25.7% dhe një marzh mesatar i fitimit neto prej 19.4% për periudhën e parashikuar 2016-2022. Rezultatet nga metodat e përdorura për të vlerësuar propozimin për investime (NPV, IRR / MIRR dhe Periudha e zbritur e Pagesës) janë pozitive dhe në favor të investimit të propozuar kapital. Një NPV e më shumë sesa 2.042,000 Euro, një normë e brendshme e modifikuar e kthimit prej 22% dhe periudha e zbritjes së pagës prej 3.00 vitet janë shifra të rëndësishme që tregojnë se investimi i propozuar është shumë tërheqës.

PARAQITJA E KOMPANISË / PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

---

## Pershkrimi I pergjithshem I Kompanise

### Përshkrim i kompanisë "AGROPRODUCT" SH.P.K

#### 1. Organizimi

Kompania Agroproduct Sh.p.k është themeluar në vitin **2012** me pronarë Halit Avdijaj dhe është pasardhëse dhe trashëguese e kompanisë Agroprodukt Syne. Agroproduct Sh.p.k ndodhet në të njëjtin lokacion dhe ushtron të njëjtën veprimtari të Agroprodukt Syne.

Aktiviteti i kompanisë ushtrohet në kultivimin e bimëve aromatike dhe erëzave për ushqim, mbledhjen spontane nga natyra dhe përpunimin e tyre.

#### 1. Përshkrimi i aktivitetit të mbledhjes spontane

Kompania "Agroproduct" Shpk që nga viti 2002 zhvillon aktivitetin e mbledhjes së bimëve mjekuese spontane dhe frutave malor nga natyra, në ndërkohë është duke bërë edhe kultivimin e një numri të caktuar të bimëve të cekura.

Që nga themelimi e deri më sot kjo kompani ka shënuar një transformim dhe zhvillim sa i përket sasive të vjelura si dhe zbatimit të praktikave dhe standardeve të nevojshme me qëllim të sigurimit të një vjelje të qëndrueshme dhe në kontiunitet. Sot kjo kompani ka në zbatim standardin e prodhimitarisë organike të BE 837/2008, standard ky i cili domosdoshmërisht kërkon zbatimin e një sërë masave.

Ky standard ka imponuar që në Kosovë të kemi fillimisht një studim të zonave të mbledhjes së produkteve dhe me pastaj inventarizimin komplet të bimëve mjekësore dhe frutave malor në Kosovë.

#### Informacion bazë dhe përshkrim i zonave të MS

Kompania me qëllim të zhvillimit sa më të suksesshëm të këtij aktiviteti dhe shtrirjes së aktivitetit në tërë territorin e Kosovës, zonat e rritjes së këtyre produkteve i ka ndarë në 5 zona, ku të njëjtat janë çertifikuar nga trupa certifikuese "Albinspekt"

---

Ndarja e zonave sipas aktivitetit te kompanisë

Zonimi dhe veprimet e menaxhimit janë bërë në përputhje me kuadrin ligjor dhe vendimet e mëhershme te kompanisë për zonimin e zonave të vjeljes spontane, ku është formuluar një propozim për ndarje te këtij territori ne 5 zona. Në formulimin e këtij propozimi zonimi janë marrë parasysh edhe veçoritë specifike të zonave dhe mundësia e qasjes ne këto zona.

Nr.	Zona	Sipërfaqja ha	Sipërfaqja jo mbledhëse brenda zonës (rrugë, banim, parcela te kultivuara)	Sipërfaqja neto e vjeljes
1	I - Istogu	35.000	2,300	32,700
2.	II- Shala	55,000	3,600	51,400
3.	III - Lipë-Gjakovë/ Alpe 2	62,488	3,788	58,700
4.	IV - Sharri	110.000	16,400	93.400
5	V - Gollaku 1/2 (Novobërdë, Gjilan, Viti, Kamenicë)	130.000	31,300	98.700

Aktiviteti i kompanisë ne këto zona është i intensifikuar qe përpos vjeljes tek vjelësit dhe pikat e grumbullimit te përcjell njohurit e domosdoshme për vjelje te qëndrueshme përmes trajnimeve dhe shpërndarjes se fletëpalosjeve me qëllmë te e mbrojtjes dhe ruajtjes së habitateve dhe biodiversitetit dhe arritjes se objektivave:

1. Të sigurohet që diversiteti i specieve dhe proceseve të ekosistemeve të mos ndikohet negativisht nga aktivitetet njerëzore i vjeljes.
2. Promovimi i mbajtjes së cilësisë së lartë ne vjeljen e bimëve për të siguruar qëndrueshmërinë e habitateve dhe për te parandaluar degradimin dhe dëmtimin e ekosistemeve te , habitateve tokësore, pyjeve dhe tokave barishtore.
3. Nxitja gjerësisht e kujdesit nga vetë komuniteti dhe angazhimit për ruajtjen e specieve bimore
4. Sigurimi që vjelja të mos ketë impakt negativ në vlerat e trashëgimisë ekologjike dhe kulturore të zonës së mbledhjes.
5. Sigurimi që zhvillimi i mbledhjes të realizohet në mënyrë ekologjike të qëndrueshme përmes promovimit te menaxhimit të shëndoshë ekologjik dhe ekonomik i të gjitha zonave.

## Sistemi i zinxhirit Vjelës- Njësitë furnizuese te Agroproductit

Me qëllim te funksionalizimit te këtij aktiviteti dhe për te ofruar me afër shërbimin e tharjes dhe grumbullimit operatori ka te kontraktuar blerjen e produkteve nga këto njësi ne këto zona. Këta operatorë tashmë janë të certifikuar si njësi në vete për aktivitetin që realizojnë. Krahas produkteve nga mbledhja spontane, operatori tashmë ka edhe furnizues të tjerë që merren me kultivimin e këtij grupi të bimëve e që po ashtu janë të certifikuara si njësi në vete.

### Rrjedhja e produktit

#### 1. Vjelësit e bimëve

Bimët mbledhen në natyrë nga persona të zonës që quhen mbledhës apo vjelës. Jo çdo person mund të jetë mbledhës i bimëve spontane mjekësore e aromatike. Pikat e grumbullimit me udhëzimet e marruara nga Agroproduct Shpk ka vendosur kriteret e caktuara se kush mund te jetë vjelës i bimëve.

- Vjelësit kanë një kontratë 10 vjeçare te nënshkruar me pikat e grumbullimit për vjelje te bimëve, duke u identifikuar me një kod (kodi i mbledhësit)
- Vjelësit duhet te kenë gjendje te mirë fizike e shëndetësore përgatitjen e kualifikimin teknik. Në aspektin e sigurisë, personat e procesit të mbledhjes e përpunimit duhet të përzgjidhen:
- Të mos përfshihen në këto procese me risk, fëmijët, nënët shtatzëna dhe të sëmurët me alergji, me plagë, etj. përjashtohen personat me sëmundje ngjitëse infektive, të cilët mund të jenë përhapës të sëmundjes, prandaj ata nuk duhet të jenë në kontakt me materialet bimore.
- Vjelësit para fillimit të vjeljes trajnohen nga stafi i operatorit. Vetëm kur ata të kenë trajnimin e nevojshëm dhe të kenë eksperiencë për të përmbushur kërkesat e standardit, futen në procesin e mbledhjes, ku marrin njohurit e duhura mbi teknikat e parimet e mbledhjes për ruajtjen e biodiversitetit të qëndrueshëm, për mbrojtjen e mjedisit, për ruajtjen e pastër nga ana higjienike, apo ndotës dhe për procedurat e dokumentimit.
- Mbledhja apo vjelja e bimëve apo organeve të bimëve bëhet:
  - Mbledhja me dore: Për të mbledhur lulet, frutat, gjethet, etj.
  - Mbledhja me mjete: Për të mbledhur pjesët nëntokësore, si rrënjë, zhardhokë e rizoma, përdoret shati, beli, capa, etj. Për pjesët e rëndësishme mbitokësore, si konuset e rritjes, kërcëj, degë e lulesa, përdoren gërshërë, thika, drapër, krëhëra, etj, për prerjen me kujdes të tyre. Për të ruajtur prodhimin e ardhshëm mbledhja të bëhet individualisht (një nga një) për çdo bimë, nuk bëhet shkullje e plotë e bimës.



## 2. Procesi i mbledhjes

Për të siguruar cilësinë e produktit që mbliidhet ndiqen rregullat e mëposhtme:

- Mblidhen produkte të pastra plotësisht pa ndotësa të ndryshëm fizikë e kimikë. Mbledhja kryhet në zona të pandotura ose në largësi të caktuar nga burimet e ndotjes (që janë rrugët, industria përpunuese apo prodhuese, vendbanimet, zonat e depozitimit të plehrave apo ndotësve të ndryshëm, zonat bujqësore të ndotura.).
- Nuk mblidhen pjesët e dëmtuara mekanikisht, apo të prekura nga sëmundjet, bimët ruhen të mos lëndohen, shtypen, a vriten gjatë vjeljes, sidomos lulet dhe gjethet që janë shumë delikate.
- Pjesët e mbledhura të bimës nuk lihen në kontakt të drejtpërdrejtë me tokën.
- Materialet e grumbulluara depozitohen në thasë, arka, shporta, etj të pastra, ku mundësisht thasët të jenë të rinj.
- Produkti i vjelë e i grumbulluar gjatë ditës nuk lihet në diell, por në hije deri sa të çohen tek vendi i pikës së grumbullimit

## 3. Transporti mbas vjeljes

- Pjesët e mbledhura duke qenë se janë shkëputur nga trupi i bimës dhe janë të njoma kërkojnë përkujdesje mbas vjeljes sepse dëmtohen lehtë. Shumë e rëndësishme kjo, sidomos për lulet apo pjesë të tjera delikate të bimës. Për këtë produkti i vjelë, transportohet menjëherë brenda ditës në vendin e përpunimit.
- Transportohet në kushte të thata e të pastra, nuk ngjshet e nuk vendoset në shtresa të larta, me qëllim që të mos dëmtohet gjatë transportit. Kur nuk është i mundur transporti i shpejtë, lihen në hije në shtresa të holla, që të mos shtypen apo të mos ndizen nga proceset e kalbjes, si produkte të freskëta bimore sepse ato përmbajnë shumë ujë.

## 4. Përpunimi paraprak pas vjeljes

Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of  
Komuna e ISTOG / Opština ISTOK / Municipality ISTOG



Bazuar në nenin 18 të ligjit 03/L-204 për tatimin në pronë, si dhe udhëzimit administrativ nr. 7/2011 të lëshuar nga MF, i cili ka të bëjë me urdhëresat e ndalimit të shërbimeve komunale për detyrim të pagesës së tatimit në

Na osnovu člana 18, zakona 03/L-204 za poreza na imovinu i administrativne uredbе MF br. 7/2011, u vezi zabrane opštinskih usluga za prinudu uplate poreza na imovinu, izdaje se ova:

Based on the article 18 of LAW 03/L-204 on property tax and administrative instruction MF no. 7/2011 on termination of services for enforcement of the municipal property tax, the municipal Property Tax Office

Nr / Br / No

2061144

16/05/2024

## VËRTETIM POTVRDA CERTIFICATE

Me të cilin vërtetohet se tatimpaguesi  
Kojim se potvrđuje da je poreznik  
that certifies that taxpayer

JETON KABASHI

ISTOG

Komuna / Opština / Municipality

ISTOG GURRAKOC

adresa / adresa / address

I ka kryer pjesërisht / plotësisht obligimet e tatimit në pronë  
Delimično/ izveršio uplatu poreskih obaveza  
has partially / fulfilled obligations on property tax

TE MILI SHPK

Vërtetimi lëshohet në bazë të kërkesës së / Potvrda se izdaje na zahtev / Certificate is issued by

Për nevoja personale

dhe shërben për / i služi za / and is used for

AFATI:30.09.2024

Shënime shtesë / Druge podatke / Additional info

Nenshkrimi / Potpis / Signature







**D.P.T. “Të Shija “**

**PLAN BIZNESI**

**NDERTIMI I OBJEKTIT AFARIST**

Adresa; Gjurakoc, Komuna e Istog

Tel; 044 221 860

Istog, Qershor 2024

Përmbajtja;

Përmbledhja e Planit për Biznes .....	3
Përshkrimi i kompanisë.....	6
Menaxhmenti -organo gram i kompanisë.....	8
Produkti ose shërbimi.....	9
Plani i marketingut .....	13
Rekomandime.....	15
Plani financiar.....	17

## 1. Përmbledhja e Planit për Biznes

Plani i biznesit është një prej hapave të parë dhe më të rëndësishme gjatë fillimit të një investimi të ri, është një mjet i cili shërben për të krahasuar idetë, për të caktuar objektivat, për të planifikuar të ardhmen e ndërmarrjes dhe për të vlerësuar realizimin dhe zbatueshme rinë e idesë. Përveç kësaj, plani i biznesit është një mjet thelbësor për tërheqjen e fondeve dhe është një dokument dinamik i cili kërkon rishikim të vazhdueshëm për të asistuar në monitorimin, matjen e performancës së biznesit dhe rrjedhimisht në mbarëvajtjen e tij.

Nëse plani do të jetë në përdorim të investitorëve apo huadhënësit, është thelbësore të kuptoni objektivat e tyre dhe t'i adresoni këto në plan, në mënyrë që ky i fundit të përmbushë kriteret e tyre të veçanta të investimit ose kreditimit.

Plani i biznesit duhet të jetë lehtësisht i lexueshëm, gjithëpërfshirës, konciz dhe jo kontradiktor.

Është me rëndësi të identifikohet sa më herët se çfarë duhet të dijë një investitor i ardhshëm për biznesin dhe personat të cilët e drejtojnë atë. Arsyeimi i vendimeve të marra, qartësia dhe kredibiliteti janë jetike në një plan biznesi.

Plani duhet të jetë i zbatueshëm dhe duhet të bindë investitorët mbi suksesin e biznesit.

Plani gjithashtu duhet të tregojë se biznesi do të jetë në gjendje të mbështesë sipërmarrësit si dhe çdo kërkesë huamarrje që ata mund të kenë.

Hartimi i një Plani Biznesi ndihmon në:

- Sjelljen e ideve të reja dhe hulumtimin e tyre në një format të strukturuar;
- Vendosjen nëse/ose kur biznesi do të jetë komercialisht i zbatueshëm;
- Qartësimin e qëllimit të biznesit dhe prezantimin e tij me partnerë apo investitorë potencial;
- Parashikimin e pengesave dhe adresimin paraprak të tyre;
- Parashikimi i strategjisë së marketingut;
- Vendosjen e objektivave efektive dhe planeve duke përfshirë shitjet dhe objektivat financiare në mënyrë që performanca e biznesit të jetë vazhdimisht e monitorueshme.

Në rrethanat e ekonomisë së tregut dhe konkurrencës së lirë, plani i biznesit është element qenësor në arritjen e suksesit dhe përmbushjes së objektivave biznesore. Në shumicën e rasteve plani i biznesit shërben si mjet komunikues për zgjerimin e kapaciteteve ekzistuese, shërben për rritje të numrit të vendeve të punës, shërben për orientimin e duhur të mjeteve financiare në dispozicion, shërben për orientimin e duhur të kapaciteteve njerëzore në drejtim të shfrytëzimit sa më efikas të burimeve të ndryshme financiare dhe njerëzore. Edhe në rastin konkret, D.P.T. "Shija" në Gurrakoc të komunës së Istogut krahas shfrytëzimit për zgjerimin e aktiviteteve afariste me këtë plan biznesi do të mund të drejtohet edhe për shfrytëzimin sa më adekuat të rritjes së numrit të punësuarve, të rritjes së bashkëpunimit afarist me partnerët afarist me qëllim të përmbushjes së planit strategjik të saj si dhe me qëllim të rritjes së kontributit social në rrethinë.

Bazuar në faktin se institucionet financiare ofrojnë mundësi të diferencuara për mjetet e tyre financiare ato përcaktojnë kushtet dhe mundësitë e shfrytëzimit të këtyre mjeteve nga operator ekonomik të sektorëve të ndryshme të cilët përmes planeve të biznesit

prezantojnë mundësit dhe arsyetojnë storien e suksesit të tyre që presin. Plani ynë i Biznesit, përshkruan dhe arsyeton storien tonë të suksesit dhe rritjes të pritur të biznesit të D.P.T. “Shija “ në fazat e zhvillimit të këtij Plani të Biznesit. Analiza e bërë nga ekipi i përbashkët, nga manaxhmenti dhe kompania e konsulencës profesionale kemi identifikuar pikat e forta dhe të dobëta në të gjitha aspektet relevante dhe kemi ardhur në përfundim se kompania ka mundësi të mira për të përmbushur objektivat e sajë strategjike në zgjerimin e aktiviteteve afariste si dhe në ndikimin potencial për rrethinën ku planifikohet të shtrihen investimet përmes investimeve të planifikuara.

**Biznesi**

**Emri i Biznesit:** JETON KABASHI B.I / Emri tregtar: D.P.T. “Të Shija “

**Lokacioni i Biznesit:** Gjurakoc, Komuna e Istogut

**Data e themelimit:** 28.03.2006

**Pronari(ët) e biznesit:** Jeton Kabashi

### **1.1 Përvoja e pronarit relevant:**

Pronari ka përvojë 35 vjeçare të marrjes me aktivitetin e ofrimit të shërbimeve në sektorin e gastronomisë dhe aktivitetin e përpunimit të mishit dhe therjes së kafshëve. Këtë aktivitet pronari e ka të trashëguar nga prindi , aktivitet të cilin e ka zhvilluar familja me dekada. Aplikanti gjatë kësaj periudhe ka përmirësuar dhe ngritur aftësitë e tija në menaxhim duke mbajtur një rol aktiv në ushtrimin e një biznesi të qëndrueshme dhe konkurrent në tregun e gastronomisë dhe përpunimit të produkteve nga mishi. Gjatë kësaj periudhe ka qenë i përfshirë aktivisht në një sërë kursesh trajnim me qka ka përmisuar aftësitë e tija dhe përvojën profesionale në të bërit biznes .

### **1.2 Produktet/shërbimet:**

Produkti kryesor i aplikantit është, restoranti ku ofron produkte të ndryshme ushqim dhe pije, aktiviteti tjetër është ,organizim i eventeve të ndryshme dhe gazmendeve familjare si dhe në njësinë e therjes dhe përpunimit të mishit, prodhohen produkte të ndryshme për shitje në njësitë e biznesit por edhe për konsumator të ndryshëm qoftë persona fizik apo juridik.

### **1.3 Tregu shënjestër:**

Personat e ndryshëm nga publiku i gjerë, subjektet e ndryshme juridike dhe personat fizik të tregut lokal dhe atij në nivel të vendit

### **1.4 Strategjia e marketingut:**

Sipas kërkesave dhe pritjeve të konsumatorëve nga tregjet e synuara, kompania do të orientoi edhe programet strategjike të zhvillimit të produktit. Përparësia e kompanisë

qëndron në përkrahjen dhe shfrytëzimin e konsulencës profesionale e cila identifikon përparësitë dhe të metat e konkurrencës dhe sipas trendëve të kërkesës ndihmon në zhvillimin e mirëfilltë të produktit.

E ardhmja

### **1.5 Deklarata e vizionit:**

Qëllimi jonë është që të jemi partnerët më të besueshëm për klientet tanë, të jemi një staf sa më profesional dhe i motivuar si dhe të ruajmë vlerat tona siç janë: integriteti, imazhi si dhe fokusi tek klienti.

### **1.6 Caqet/objektivat:**

Në suazat e Planit të Biznesit të D.P.T. “Shija “ përcaktohen këto objektiva strategjike:

1. Rritja e aftësisë konkurruese dhe pozicionimi më i mirë i kompanisë përmes shfrytëzimit optimal të kapaciteteve dhe të gjitha resurseve në të tri repartet: gastronomi,ne organizimin e eventeve te ndryshme prodhimin e produkteve te mishit duke rritur në mënyrë të fuqishme qarkullimin, të hyrat dhe profitin;
2. Rritja e qarkullimit dhe shitjes përmes plasmanit të produkteve dhe shërbimeve të gastronomisë, ëmbëlsirave, mishit edhe më fuqishëm në kapacitetet e reja të planifikuara përmes plasmanit më të mirë të mallrave në stoqe dhe qarkullim si dhe të kapaciteteve të gastronomisë dhe njësisë se përpunimit te mishit ;
3. Shfrytëzimi më i mirë i formave të reja të shitjes në tregtinë me shumicë përmes bashkëpunimit më nivelin e shitjes me pakicë dhe klientët e përhershëm;

Përveç këtyre objektivave strategjike në kuadër të planit përcaktohen edhe objektivat specifike:

- a. Ngritja e nivelit organizativ dhe manaxhues të kompanisë,
- b. Definimi i formave adekuate dhe profitabile të plasmanit të mallrave në kuadër të tregtisë si dhe produkteve e shërbimeve në gastronomi konform kërkesës në treg dhe trendëve në shembujt më të mirë në rajon dhe më gjerë;
- c. Identifikimi dhe përcaktimi i instrumenteve më adekuate për tu orientuar kah tregjet dhe segmentet e targëtuara të konsumatorëve;
- d. Identifikimi i konkurrencës dhe ndikimit të tyre në tregun lokal dhe rajonal më ndikim në afarizmin e Kompanisë.

Përmes këtij plani definohet dhe përcaktohet politika adekuate e manaxhimit, organizmit funksional të biznesit, resurset e nevojshme njerëzore, kualifikimi dhe trajnimi i tyre i domosdoshëm, analiza financiare, analiza e tregut dhe e konkurrencës, marketingut dhe shitjes, trajtimi i aspekteve teknike dhe teknologjike, e gjithë kjo me qëllim të orientimit dhe koordinimit të masave zhvillimore, operative, organizative dhe manaxhuese në drejtimin e dëshiruar dhe të objektivave të përcaktuara të D.P.T. “Shija “.

### **1.7 Objektivat Kryesore të Planit të Biznesit**

Objektivat kryesore të këtij plani të biznesit janë definuar mjaftë qartë në kuadër të

përmbajtjes së orientimeve zhvillimore dhe objektivave zhvillimore të kompanisë përmes ngritjes së standardeve dhe efikasitetit të kapaciteteve ekzistuese si dhe zhvillimit të kapaciteteve të reja të produkteve dhe shërbimeve të ndryshme, identifikimit të nevojës për funksionet e manaxhimit profesional, nevojave për resurse humane, organizimit më të mirë dhe funksionalizimit të afarizmit, si dhe gjetjes së segmenteve të reja të konsumatorëve, tregjeve më adekuate, përcjellja e konkurrencës, përcaktimi i strategjive të marketingut dhe shitjes si dhe kalkulimit të mjeteve të nevojshme financiare – Planit Financiar. Të gjitha këto qëllime të përcaktuara qartë do të arrihen përmes shfrytëzimit të përvojave më të mira pozitive dhe angazhimit të konsulencës profesionale, si në fazën e planifikimit, ashtu edhe në fazën e implementimit të objektivave zhvillimore.

## 1.8 Financat

- Sigurimi që investimi në vlerë të planifikuar ,në kohëzgjatje prej dy viteve prej 1,019.490 € investim në objekt dhe mjete themelore, me qëllim të funksionalizimit të këtij plani. Investimi total sipas projektit teknik në periudhën brenda dy viteve

## 2. Përshkrimi i Kompanisë

D.P.T. “Shija “ vazhdon të operoj suksesshëm në hapësirat ekzistuese, tashmë, si dhe planifikon të zgjerohet në fazat fillestare edhe me punëtor të rinjë në kuadër të investimeve të planifikuara në repartin tregtar, në repartin e gastronomisë si dhe në repartin e prodhimit.

Potencialin kryesor të konsumatorëve në qendrën e re të planifikuar investive e përbejnë: banorët e komunës së Istogut, Gurrakocit si dhe një numri të madh të fshatrave të përreth Gurrakocit si dhe një numër i konsiderueshëm i udhëtarëve në transit.

Duke marrë parasysh rajonin e Gurrakocit dhe rrethinës të njohur për agrikulturë, në veçanti për prodhimin e produkteve bujqësore dhe perimeve, një segment i ndërmarrjes mund të orientohet në partneritet me komunitetin dhe bizneset lokale, për të qenë një pikë e shitjes së këtyre prodhimeve, për nevojat e restorantit . Këtu në rend të parë vjen në shprehje partneriteti në grumbullimin, përpunimin dhe plasmanin e produkteve, si të përpunuar për konsumator duke marrë parasysh edhe faktin që në rrethinë e ngushtë dhe të mesëm nuk ka ndonjë konkurrencë të theksuar, pozicionimi i D.P.T. “Shija “ në lokacionin e propozuar do të ketë një potencial të mjaftueshëm dhe në rritje për afarizmin e qendrës.

### 2.1 Deklarata e Vizionit

Qëllimi jonë është që të jemi partnerët më të besueshëm për klientët tanë, të jemi një staf sa më profesional dhe i motivuar si dhe të ruajmë vlerat tona siç janë: integriteti,

imazhi si dhe fokusi tek klienti.

## **2.2 Deklarata e Misionit**

Duke ngritur nivelin dhe kapacitetet shërbyese të tregtisë dhe gastronomisë që u përgjigjen nevojave dhe kërkesave të konsumatorëve kompania do të ndërtoj brendin e saj të bazuar në ofrimin e mallrave dhe shërbimeve më cilësore duke u përpjekur që pozicionin e saj më të volitshëm në treg ta ndërlidhë me përgjegjësinë sociale si dhe me marrëdhënien e zhvillimit ekonomik të rrethinës ku vepron.

## **2.3 Caqet/objektivat e kompanisë**

Objektivat kryesore të D.P.T. “Shija “ janë:

- Fitimi i besimit të klientëve si dhe bashkëpunimi sa më adekuat me rrethinën ku plaifikonë të ndër veproje kompania
- Plotësimi i kërkesave të konsumatorëve në sektorin e tregtisë dhe mysafirëve në sektorin e gastronomisë në përputhje të plotë me nevojat dhe pritjet e tyre në kuptimin e ofrimit të mallrave cilësore dhe në asortiman sa më të gjerë si dhe produkteve dhe shërbimeve të gastronomisë, produkteve ushqimore dhe shërbimeve ne nivel te knaqëshmeris.
- Përpjekjet për shfrytëzimin optimal të gjitha kapaciteteve në të dy sektorët:
  - Qarkullimi në sektorin e shitjes në nivelin e 70% të kapaciteteve të ndërtuara, të pajisura dhe të furnizuara me kujdes;
  - Shfrytëzimi i kapaciteteve të ndërtuara, të pajisura dhe të funksionalizuara të gastronomisë, në rreth 45% gjatë vitit dhe rreth 70% gjatë sezonit të pranverës/verës, në një shkallë prej 55% në nivel të vitit të parë , me tendenca të rritjes së ndjeshme në vitet në vazhdim.
  - Organizimi adekuat në të gjitha nivelet në përputhje me kërkesat e një biznesi bashkëkohor dhe cilësor.
  - Sigurimi i stafit të kualifikuar dhe trajnimi i tyre në të gjitha nivelet.

## **2.4 Plani fillues investimet fillestare**

Duke pasur parasysh kompleksitetin e çdo ndërmarrje investive si dhe ndjeshmërinë nga shumë faktor të brendshëm dhe të jashtëm si dhe nevojën e ngritjes së nivelit dhe përmbajtjes së biznesit ekzistues investitori ka bërë analizat paraprake përkrahur nga konsulenca profesionale dhe ka vendosur të planifikoi me investimet zhvillimore. Sigurimi i mjeteve investive do të behet nga operacionet aktuale biznesore, nga kapitali vetanak i pronarit si dhe nga marrja e huave nga bankat aktuale që operojnë në Kosovë.



Qëllimi i këtij plani të biznesit është që ti shërbej investitorit si bazë e mirë e shtrimit të parametrave të besueshëm ekonomik në raport me kërkesat e investitorëve potencial si dhe në raport me institucionet financiare dhe ato qeveritare. Në fillim, në zgjerimin e veprimtarisë ekzistuese të punëve në ndërtimin e objektit afarist D.P.T. “Shija “ si dhe në periudhën e funksionimit të kapaciteteve të para kompania llogaritet në rezultate dhe të hyra të shtuara si dhe në akumulim më të madh të mjeteve investive nga profiti dhe mjetet e amortizimit. Në fazën e parë deri të arritja e kufirit të rentabilitetit kompania do të shfrytëzojë dhe mbështetet në mjete të konsideruara të vetëfinancimit si dhe në huazimet e mundshme më të volitshme nga partnerët dhe bankat përkrahëse por edhe nga kreditë më të mëdha nga bankat. Gjithsesi do të bëhen përpjekje të vazhdueshme të mbështetjes së zhvillimit të kapaciteteve të reja duke hulumtuar dhe shfrytëzuar kredi nga institucionet financiare ndërkombëtare që funksionojnë në Kosovë.

## 2.5 Rëndësia e lokacionit për ndërtimin e kapaciteteve të reja

Të motivuar nga rezultatet pozitive të biznesit aktual ndonëse në rrethana mjaft konkurruese në rajonin më të gjerë duke krijuar një përvojë dhe reputacion mjaftë pozitiv porse duke shfrytëzuar boshllëkun konkurrues në afërsi relative investitori ka vendosur të ndërtoj kapacitetet e reja afariste dhe të gastronomisë në një lokacion mjaftë atraktiv dhe frekuentues në Gurrakoc-Istog.

Pozicioni i planifikimit të investimeve të D.P.T. “Shija “ mundëson bashkëpunim dhe partneritet të rëndësishëm me komunitetin dhe prodhuesit lokal gjë që ndikon në ngritjen e interesit të dyanshëm të shfrytëzimit më të madh të produkteve lokale dhe vendore.

Definimi i njësive funksionale dhe kapaciteteve të reja të D.P.T. “Shija “

1. Sipërfaqja bruto afarizëm -restorant 678 m<sup>2</sup>
2. Sipërfaqja, bruto afarizëm dhe administrata 981 m<sup>2</sup>
3. Sipërfaqja e njësisë së përpunimit të mishit 300 m<sup>2</sup>

jate kalimit të kohës përshtatja e objektit mund të bëhet në bazë të nevojave të tregut.

## 4. Menaxhmenti -organo gram i kompanisë

### Skema e organizimit



## **4 Produkti**

### **Faktorët e Jashtëm dhe Ndikimi i tyre në afarizmin Tregtar dhe të Gastronomisë**

Ekonomia e Kosovës aktualisht ka një ritëm të rritjes graduale dhe inflacion të ultë, të cilat janë një prej parakushteve që motivojnë investimet në themelimin dhe zhvillimin e bizneseve. Aktualisht përpjekjet dhe kujdesi ndaj rritjes së cilësisë së shërbimeve dhe kujdesi ndaj konsumatorit krahas rritjes së kënaqësisë së tyre është çështja të cilës duhet ti përkushtohet vëmendje e posaçme në vendin tonë.

Operatori ekonomik D.P.T. "Shija" synon që me investimin e planifikuar në zgjerimin e kapaciteteve afariste të forcoj akoma më shumë pozicionin e tij në treg me një gamë të zgjeruar të shërbimeve dhe produkteve të përcaktuara në objektivat e tij strategjike. Krahas ofrimit të shërbimeve tregtrare dhe gastronomisë është planifikuar që të hyra financiare të ketë edhe nga programi i përpunimit të mishit dhe produkteve të tija.

Situata politike e tanishme e vendit vështruar në nivelin vendi, rajoni dhe me gjërë tregon se në të ardhmen e afërt do të ketë rritje të investimëve dhe të zhvillimit ekonomik. Komuniteti ndërkombëtar përmes granteve, dhe formave tjera financiare kanë rritur interesimin e tyre për të investuar në sektor të caktuar të ekonomisë kosovare. Po ashtu edhe interesimi i investitorëve potencial në Kosovë është i vazhdueshëm, për depërtimin në tregjet e reja, përfshirë edhe tregun e shërbimeve dhe produkteve të cilat synon ti zhvilloi D.P.T. "Shija"

#### **4.1 Pozita Gjeografike dhe Vlerat e Lokacionit**

Aktivitetet afariste, të cilat është duke i zhvilluar D.P.T. "Shija" aktualisht në Gjurakoc, rruga Istog- Pejë si dhe zgjerimin e kapaciteteve për të cilat po planifikohen nga kompania kanë pozicion mjaftë të përshtatshëm vështruar nga aspekti gjeografik. Projekti i ri i planifikuar, është në Gurrakoc të Istogut e cila pozitë lidh qytete të ndryshme si: Istogu, Klina, Peja dhe Mitrovica.

#### **4.2 Faktorët Politik dhe Juridik**

Për të ndikuar në faktorët Juridik dhe Politik si dhe për tu përshtatur rrethanave të ekonomisë së tregut, gjithsesi duhet të hartohen dhe zbatohen ligje të favorshme që mundësojnë zhvillimin ekonomik të vendit. Kosova në mbështetje edhe të faktorit ndërkombëtar ka avancuar në aprovimin e legjislacionit më të favorshëm për bizneset, të harmonizuara me përvojat pozitive të legjislacionit Evropian.

D.P.T. "Shija" do të ndërtojë dhe funksionalizojë kapacitetet e reja afariste duke respektuar në përpikëri infrastrukturën ligjore, duke plotësuar të gjithë dokumentacionin e nevojshme, në harmoni të plotë me rregullat ligjore. Për të afaruar suksesshëm dhe konform ligjeve në fuqi, paraprakisht duhet të sigurohen lejet dhe licencat e caktuara që plotësojnë standardet e duhura për sektor të caktuar, të produkteve dhe shërbimeve që

### **4.3 Inkorporimi dhe Bashkëpunimi me Komunitetin Lokal**

Përmes objektivave strategjike të përpiluara nga D.P.T. "Shija" janë identifikuar mundësitë e krijimit të bashkëpunimit me komunitetin lokal në pikat ku gërshetohen interesat e përbashkëta afariste.

- Në sektor të konsumit të gjerë menaxhmenti i D.P.T. "Shija" ka identifikuar mundësitë e bashkëpunimit me komunitetin lokal për produktet të cilat komuniteti ka mundësi dhe gatishmëri të prodhojë, ndërsa biznesi i kompanisë do të blejë, përpunojë për të shitur pastaj në lokalet e gastronomisë dhe pikën e shitjes së mishit të planifikuar përmes këtij plani biznesi.
- Në sektorin e gastronomisë në hapësirat e objektit afarist është planifikuar edhe hapësira e nevojshme për sektorin e gastronomisë që do të ofroj shërbimet e ushqimit dhe pijeve, e komuniteti lokal do të ketë mundësinë që për kërkesat e konsumatorëve për këto shërbime të gastronomisë, të furnizoi D.P.T. "Shija" me produkte të caktuara për të plotësuar kërkesat e konsumatorëve.
- Në sektorin e përpunimit të mishit në hapësirat e objektit afarist është planifikuar përpunimi i mishit të gjedhit dhe përmes kësaj diversifikimi dhe plasimi në treg i shumë produkteve të reja.

### **4.4 Ambienti teknologjik**

Zhvillimi dhe avancimi i teknologjisë informative dhe programet adekuate kompjuterike, ofrojnë lehtësira të shumta për menaxhimin dhe zhvillimin e biznesit D.P.T. "Shija" duke shfrytëzuar programe të avancuara teknologjike, do të menaxhoi në mënyrë të sigurtë të hyrat dhe shpenzimet e aktiviteteve afariste. Paketat softërike, që janë në dispozicion për aktivitetet afariste, të përcaktuara përmes objektivave strategjike të biznesit në fjalë, duke përfshirë menaxhimin e objektit, bazës së të dhënave, kontrollin e inventarit, menaxhimin financiar etj. D.P.T. "Shija" do të aplikoi programet teknologjike, që përveç cash-it, të përdoret edhe programi i kredit kartelave, nga institucionet bankare vendore dhe ndërkombëtare. Këjo teknologji do të ndihmoi në menaxhimin dhe kontrollin e të hyrave, kostove të materialit harxhues dhe shpenzimeve tjera, si dhe maksimizimin e fitimit.

### **4.5 Pozicionimi afarist i konkurrencës**

D.P.T. "Shija" aktivitetet afariste do të zhvillojë në komunën e Istogut në një konkurrencë të theksuar lokale ku afrojnë qendra tregtare të njohura të karakterit nacional e lokal, e biznese individuale të tregtisë në nivel lokal. Mirëpo, objektivat strategjike të definuara të D.P.T. "Shija" për bashkëpunim me komunitetin lokal si dhe programet e përcaktuara i krijojnë mundësinë që të ketë vende të caktuara në treg, rritje të qarkullimit financiar dhe rritje të fitimit. Në mungesë të definimit të produktit dhe shërbimeve të diversifikuara ku

të gjithë kopjojnë njëri tjetrin si për nga shërbimet ashtu edhe çmimet duke aplikuar konkurrencë të padenjë dhe injorim të rregullave dhe standardëve profesionale, këtu qëndron përparësia D.P.T. “Shija “ me kusht të rrjedhjes normale të proceseve të planifikuara.

#### **4.6 Hulumtimi i tregut të kërkesës**

Tregu vendor akoma është i varur nga produktet e importit për plotësimin e kërkesave të konsumatorëve si në nivel lokal ashtu edhe atë nacional. Andaj, programet e definuara dhe objektivat e përcaktuara nga D.P.T. “Shija “ janë mjaft atraktive për plotësimin e një pjese të caktuar të kërkesës së tregut me produkte vendore. Andaj, gradualisht do të stimulohet prodhuesi vendor që disa nga produktet vendore të jenë sa më shumë prezent në treg e që zëvendësojnë produktet që vijnë nga importi.

Kërkesat e tregut për produktet dhe shërbimet e përcaktuara nga kompania në fjalë pothuajse janë të vazhdueshme, andaj menaxhmenti i kompanisë do të jetë i fokusuar që konsumatorëve aktual të ju plotësoi kërkesat e tyre dhe të fokusohet kah konsumatorët potencial të Istogut, Klinës, Pejës e më gjërë.

#### **4.7 Segmentimi i Tregut të Kërkesës**

Në Komunën e Istogut funksionojnë 700 biznese, prej tyre janë 10% biznese me veprimtari prodhuese. Pjesa më e madhe e bizneseve janë biznese me fushë veprimtari tregtare. Në sipërfaqen e vetë territoriale, Istogu është i ndarë në 50 fshatra dhe në dy qendra ndërrurbane, si Gurrakoc dhe Banja.

Njëra nga qendrat ndërrurbane Gurrakoci, është edhe lokacioni i përcaktuar për zgjerimin e aktiviteteve afariste të biznesit aktual D.P.T. “Shija “

Krahas lokacionit të përshtatshëm që ka në Gurrakoc D.P.T. “Shija “ për zgjerimin e biznesit të vetë, është edhe treguesi tjetër mjaft i qëndrueshëm, që tregon për qëndrueshmërinë e biznesit, siç janë numri i banorëve dhe familjeve, si dhe frekuentimi i tyre në magjistralen Mitrovicë Pejë si dhe ardhja e konsumatorëve jo rezident (siç janë turistët).

#### **4.8 Pozicionimi i konkurrencës**

Kompanitë konkurrencte në rrethinën e theksuar biznesore kanë bërë shumë pak në organizimin dhe ngritjen e standardeve të tyre profesionale e posaçërisht në krijimin e rrjetëzimit me komunitetin lokal si dhe në favorizimin e produkteve vendore të prodhuara nga prodhues individual të ekonomive rurale. Në këto rrethana as për së afërmi nuk janë shfrytëzuar përparësitë që mund të kenë nga bashkëpunimi me komunitetin lokal. Me qëllim të mbajtjes së tregut aktual dhe orientimit kah tregu potencial, D.P.T. “Shija “ do të fokusohet në realizimin e investimeve të planifikuara dhe përmes marketingut kreativ do të arrij që një pjesë të tregut potencial të mbuloj me produkte e shërbime të definuara.

Në komunën e Istogut për disa produkte të konsumit të gjerë krahas konkurrentëve që ofrojnë këto shërbime, aktivitetet afariste i zhvillojnë edhe qendrat e tjera të gastronomisë ku në sektorin e gastronomisë ekziston konkurrencë aktuale, por realizimi i aktiviteteve

të planifikuara përmes këtij plani të biznesit do ti mundësojnë D.P.T. “Shija “, që të zgjerohet në treg, lokal.

#### 4.9 Lista e tre (ose më shumë) konkurrentëve

Lista e konkurrentëve specifik, përfshirë forcat dhe dobësitë e tyre.

Emri i Konkurenit	Forcat	Dobesit
1. Restorant Podguri	Hapsir dhe infrastrukturë te mirë	Ky konkurrent ndodhet ne një lokacion jashtë qendrës se Grrakocit dhe produkt primar ka organizimin e ahengjeve familjare
2. Kafiteria Relaxi	Ne dukje ka klientel dhe shërben si kafiteri,	Pozicioni i saj ne një lokacion te favorshëm
3.Restorant-Kafiteri Te Sheshi	Ndodhet ne një lokacion te mirë, ne qendrën e Gjurakocit	Por klientela dhe shërbimi kryesor është kafiteri

#### 4.10 Strategjia e marketingut dhe implementimi

Një përmbledhje përshkruese e fokusimit në tregun në shënjestër (produkti/shërbimi) dhe elemente të tjera të miks marketingut (pozicionimi, Çmimi, promovimi, distribuimi).

#### 4.11 Deklarata e Pozicionimit

Sipas kërkesave dhe pritjeve të konsumatorëve nga tregjet e synuara, kompania do të orientoi edhe programet strategjike të zhvillimit të produktit. Përparësia e kompanisë qëndron në përkrahjen dhe shfrytëzimin e konsulencës profesionale e cila identifikon përparësitë dhe të metat e konkurrencës dhe sipas trendëve të kërkesës ndihmon në zhvillimin e mirëfilltë të produktit.

#### 4.12 Strategjia e Çmimeve

D.P.T. “Shija “, me strategjinë e marketingut synon në menaxhimin e çmimeve të pranueshme për konsumatorin bazuar në metodën e shpenzimeve dhe të konkurrencës.

Çmimet e produkteve dhe shërbimeve të kësaj kompanie, do të jenë konkurruese në treg pasi që shpenzimet janë më të ulëta në krahasim me konkurrencën. Duke u bazuar në përvojën e stafit profesional, në numrin optimal të punëtorëve dhe hapësirat e mjaftueshme dhe funksionale për ofrimin e produkteve dhe shërbimeve në bashkëpunimin me komunitetin lokal dhe furnizimin e një numri të konsiderueshme të produkteve nga komuniteti lokal, produkti dhe shërbimet do të kenë një kosto më të ultë

#### **4.13 Strategjia e Promovimit**

Komunikimi me konsumatorët do të realizohet në formë direkte duke ju ofruar shërbimet e profesionale dhe në mënyrë indirekte, përmes materialeve vizuale dhe të shkruara siç janë ueb faqja, interneti, etj. Me qëllim të promovimit të shërbimeve të veta dhe realizimit të komunikimit të drejtpërdrejtë me konsumator potencial kompania do të merr pjesë në panairët dhe ngjarje të ndryshme vendore e ndërkombëtar, ku do të realizohen kontakte të rëndësishme afariste. Ndërmarrja do të komunikoi me konsumatorët duke prezantuar prodhimet e saja në panairët që organizohen në Kosovë dhe më gjerë. Një vëmendje të veçantë në këtë kontekst do ti kushtohet disejnimit të ueb faqes dhe materialeve promotive të printuara si dhe atyre elektronike.

#### **4.14 Strategjia e Distribuimit**

Strategjia e distribuimit e kompanisë mbështetet në shitjen e produkteve dhe shërbimeve konsumatorëve aktual dhe shtrirja e shitjeve edhe të konsumatorëve potencial. Deri me tani kompania me veprimtarinë e tij afariste është e njohur si për konsumatorët lokal, por edhe me gjerë. Politika e distribuimit është e orientuar në shtimin e konsumatorëve të ri në për produktet dhe shërbimet e kompanisë nëpërmjet sektorit të marketingut dhe shitjes.

### **5 Plani i Marketingut**

Në kushtet e ekonomisë bashkohore, zhvillimi dhe funksionimi i afarizmit biznesor pothuajse është i pa mundur pa një plan të mirëfilltë të marketingut si pjesë përbërëse e planit të biznesit i cili merret me analizën dhe programimin e aktiviteteve të shitjes së produkteve dhe shërbimeve të ndërmarrjes në treg. Pikënisjet e planit të marketingut janë përcaktimet e ndërmarrjes në fushën e shitjes, kanalet distribuimit dhe shitjes.

Plani i marketingut do të vlerësojë aftësinë konkurruese të D.P.T. "Shija " në plotësimin e nevojave të konsumatorëve potencial. Nga kjo mund të thuhet se plani i Marketingut përcakton pozitën dhe mundësitë e kompanisë në plotësimin e kërkesave të tregut aktual dhe kërkesave për tregun potencial me produkte e shërbime në raport me konkurrencën.

#### **5.1 Programet e animimit të Konsumatorëve dhe Stimulimit të Shitjes**

Aktivitete tjera të plan marketingut të D.P.T. "Shija " duhet të përgatiten programe favorizuese për konsumator të caktuar dhe animimin e konsumatorëve të rregullt. Po ashtu duhet të ofrohen programe favorizuese për konsumator potencial me rastin e festave kombëtare, lokale, ngjarjeve të ndryshme në nivel lokal, rajonal dhe me gjerë.

D.P.T. "Shija " pos programeve favorizuese të rastit do të hartoi programe favorizuese:

- Për konsumatorët e rregullt me zbritje të çmimeve me përqindje të caktuar;
- Për biznese të caktuara, që janë të rregullt në konsumimin e produkteve dhe shërbimeve të D.P.T. "Shija "
- Programe me rastin e ngjarjeve të ndryshme;

- Programe me rastin e ngjarjeve të ndryshme;
- Programe tërheqëse me rastin e festave, etj.

## 5.2 Reklamimi dhe strategjia e promovimit

D.P.T. “Shija “do ti kushtoi rëndësi të veçantë bashkëpunimit me media të shkruara dhe elektronike që mundëson komunikimin me publikun ku do të prezanton produktet dhe shërbimet vetanake për konsumatorët aktual dhe potencial. Mjetet që duhet të përdorë janë:

Lloji promovimit/reklamimit të planifikuar	Përmirësimet e pritura të biznesit	Data e caktuar
Printo reklamimin në media, reklamim online, dërgesa, reklama në duar, pamfleta ose ngjarje.	Permisim i imazhit te ndërmarrjes	Dhjetor -Janar
Media të shkruara dhe elektronike	Rritja e aftësisë konkurruese	Mars -Prill
Ueb faqja, interneti, telefoni;		Ne vazhdimësi
Materialet e botuara promocionale;	Informacioni tek klientët për produktet	Maj-Qershor
Kontaktet e drejtpërdrejta me konsumatorët;	Rritja e shitjes dhe te hyrave financiare	Janar-Dhjetor
Panaire dhe ngjarjet tjera të ngjashme etj.	Permisim i imazhit ne treg	Korrik-Gusht

## 5.3 Plani i veprimit (masat) ne implementim te projektit

Lista e detajuar e të gjitha aktiviteteve që mund të maten duke përfshirë datën e fillimit, datën e përfundimit te investimeve.

Masat	Data e pritur e përfundimit	Personi përgjegjës
1. Kryerja e procedurave te marrjes ne shfrytëzim te pronës ku planifikohet	Shtator 2024	Pronari i biznesit

investimi		
2. Përgatitja e dokumentacionit investivo teknik	Tetor-dhjetor 2024	Pronari i biznesit
3. Marrja e lejeve te ndërtimit nga institucionet kompetente	Janar 2025	Pronari i biznesit- komuna
4. Kontraktimi i punkryesit dhe sigurimi I fondeve	Janar 2025	Institucionet financiare dhe investitori
5. Fillimi i ndërtimit dhe shitja e produktit	Mars 2025	Pronari i biznesit
6. Fillimi i kthimit te investimeve	Qershor 2025	Pronari i biznesit
7. Përfundimi ii investimeve	Dhjetor 2026	Pronari i biznesit
8. Fillimi i kthimit te investimeve	Qershor 2025	Pronari i biznesit

### Analiza S.W.O.T.

Forcat	Dobësitë
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pozita dhe lokacioni i D.P.T. “Shija “Ambienti rrethues i biznesit</li> <li>• Përvoja e gjatë në ofrimin e shërbimeve e produkteve të përcaktuara</li> <li>• Kërkesat e vazhdueshme për produktet dhe shërbimet e identifikuar</li> <li>• Kërkesat e tregut për produkte dhe shërbime e përcaktuara .</li> <li>• Mundësit për zëvendësimin e produkteve të caktuara që vinë nga importi.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kapacitetet e pakompletuara për objektivat strategjike</li> <li>• Investimet ende të papërfunduara</li> <li>• Mos krijimi i brendit të biznesit</li> <li>• Mungesa e marketing promocionit</li> <li>• Vonesa në krijimin e rrjetëzimit me komunitetin lokal.</li> <li>• Vonesa në</li> </ul>
Mundësitë	Kërcënimet
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Diversifikimi i produktit dhe shërbimeve</li> <li>• Ofrimi i shërbimeve më kosto më të ultë se konkurrenca,</li> <li>• Zgjerimi i tregut për konsumatorët aktual dhe potencial</li> <li>• Krijimi i rrjetëzimit me komunitetin lokal</li> <li>• Rritja e kualitetit të shërbimeve</li> <li>• Ofrimi i shërbimeve për plotësimin e kërkesave të konsumatorëve me produkte vendore</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Diversifikimi i produktit dhe shërbimeve</li> <li>• Ofrimi i shërbimeve më kosto më të ultë se konkurrenca,</li> <li>• Zgjerimi i tregut për konsumatorët aktual dhe potencial</li> <li>• Krijimi i rrjetëzimit me komunitetin lokal</li> <li>• Rritja e kualitetit të shërbimeve</li> <li>• Ofrimi i shërbimeve për plotësimin e kërkesave të konsumatorëve me produkte vendore</li> </ul>



## 6 REKOMANDIMET

### Analiza e ndryshimit të investimeve

Çdo investim në periudhën e tij reale ekonomike të eksploatimit i nënshtrohet ndikimeve dhe ndryshimeve të ndryshme. Nga këto shkaqe është e nevojshme që për çdo projekt investiv të bëhet edhe analiza e ndryshimit të tij ndaj ndryshimeve të caktuara. Analiza e sensitivitetit paraqet një pjesë mjaftë të rëndësishme të vlerësimit të ashtuquajturës idesë biznesore në kuadër të Planit të biznesit, e cila duhet të konsistoi në shkallen e ndikimeve eventuale në ndryshimet e vlerave të parametrave të caktuar nga Plani i biznesit në rentabilitet (profitabilitet), gjegjësisht në pranueshmërinë e planit të biznesit. Sikurse vlerësimi komplet financiar i Planit të biznesit, ashtu edhe vlerësimi i ndryshimit të biznes planit mund të shprehet në variantin statike dhe dinamike. Në praktikë, si analiza statike të ndryshimit të projektit investiv më së shpeshti aplikohen vlerësimet, gjegjësisht analizat e mëposhtme:

#### 4.1. Analiza e ndryshimit të vëllimit të produkteve dhe shërbimeve

Me rastin e projekcionit të Hyrave, janë marrë për bazë parametra mjaftë objektiv, baza nga Pasqyrat reale të prezantuara në ATK për vitin 2022-2023 (niveli mesatar i shfrytëzimit të kapaciteteve dhe të hyrat mesatare për njësi). Gjatë zhvillimeve të mëtutjeshme pozitive në lokacion dhe rajon, si dhe për shkak të rritjes së kërkesës për produkte dhe shërbime në objektin e planifikuar, objektivisht do të shfrytëzohen më mirë kapacitetet e ndërtuara, ndërsa në nivel më modest kapacitetet e mëparshme në raport me ato të projektuara (në bazë të vlerësimeve mesatarisht rreth 6 – 10% më shumë për çdo vjet). Rritje paksa më e ndryshme pritet në sektorin e shërbimeve dhe produkteve të gastronomisë (mesatarja 15-18% mesatarisht në vit).

#### 4.2. Analiza e ndryshimeve të çmimeve shitëse

Falë përdorimit të Valutës Evropiane (Euro), në afat të mesëm nuk parashihen efekte negative dhe ndonjë aktivitet i ndryshëm valutë, kështu që edhe gjatë projeksioneve të Hyrave janë marrë parasysh çmimet e pandryshuara statike. Nga ky aspekt, nuk priten ndikime negative në kostot e furnizimit dhe shitjes së mallrave dhe shërbimeve të gastronomisë.

#### 4.3. Analiza e ndryshimeve tek çmimet e furnizimit të mallrave dhe energjisë

Falë tregut të hapur dhe të lirë të furnizimit me mallra tregtare, materiale dhe inventarit të imtë, si dhe konkurrencës mjaftë të lartë të furnizimit me shumicë nuk ka ndonjë rrezik i dukshëm lidhur me ndryshimet e çmimeve të tyre që do kishin efekt në nivelin e të hyrave dhe cilësinë e të ardhurave. Në sektorin e energjisë do të kushtohet rëndësi kursimeve dhe qajes me panele diellore.

#### 4.4. Analiza e mundësisë së ndryshimit të vëllimit të investimeve

Për shkak të zhvillimit fazor, krahas rritjes së të hyrave nga kapacitetet ekzistuese si dhe karakterit të ciklusit relativisht të shpejtë të efektimit të hyrave nga investimet, përshpejtimi i fazave investuese dhe operacionalizimi i tyre relativisht i shpejtë e mundëson qarkullimin e shpejtë të parasë si dhe re investimin e një pjese të mirë të

Rreziku	Niveli	INdiki mi	Strategjia
Mosdhënia ne shfrytëzim afat gjatë te pronës nga titullari ne afatin e planifikuar me planin e veprimit	I lartë	I lartë	Përmbushja e kriterëve ligjore te parapara sipas kornizës ligjore për marrjen ne shfrytëzim te pronës komunale
Vonesat ne përgatitjen e dokumentacionit tekniko inventiv	I mesëm	I mesëm	Përzgjedhja dhe kontraktimi i kompanive projektuese profesionale dhe qe kanë kapacitete
Rreziku financiar-sigurimi i mjeteve te investimit	I mesëm	I mesëm	Planifikimi dhe kontraktimit me kohë i bankave komerciale për huadhënie
Ramje e fuqisë blerës	I ultë	I ultë	Permisimi I marketingut dhe promovim i produkteve

mjeteve vetanake si në tregti ashtu edhe në gastronomi. Pjesa e dytë e periudhës afatmesme investive dhe zhvillimore pas përfundimit të investimeve dhe operacionalizimit të kapaciteteve të projektuara mundëson një periudhë të efikasitetit optimal të investimeve dhe kthimit të tyre më të relaksuar, si dhe mjete të mjaftueshme qarkulluese.

4.5. Konsiderimi i rrezikut dhe menaxhmenti  
Rreziqet potenciale më të rëndësishme që do mund të ndikonin në mos implementimin e këtij projekti

## 7. Plani Financiar

Objektivat kyçe

### PËRMBLEDHJA E INVESTIMEVE DHE PËRFITIMEVE

Më poshtë në mënyrë të përmbledhur do jepen investimet dhe përfitimet nga ky investim i planifikuar:

- **Investimi në objekt dhe mjete themelore: 1,219.490.00 €** ku të gjitha investimet e planifikuara dhe blerjet investive do bëhen nga firmat lokale përveq në ato raste kur mungon oferta. Në këtë mënyrë do të krijohej një multiplikim i parasë dhe në këtë mënyrë do të rritej qarkullimi i parasë në formë multiplikimi në lokalitetin përkatës.

Investimi në panele solare : I rekomandohet investitorit qe ne fazën e mëvonshme te investimit ,për efektet mjedisore dhe me qellim te uljes se kosos se afarizmit te bej montim se paku te 10 KW kapacitete për prodhimin e energjisë nga burimet e ripërtritshme ku përfitimet do të ishin shumëdimensionale duke nisur nga: mbrojtja e

mjedisit, çmimet e larta të furnizimit me energji elektrike, ruajtja e burimeve të tokës si dhe nga trendët ndërkombëtare për një sistem të qëndrueshëm energjetik me bazë diellore.

**Rrjetëzimi me fermerët lokal:** në kuadër të blerjes mallrave hyn edhe kategoria e blerjes nga fermerët. Në këtë investim parashihet që të bëhet rrjetëzim më i madh dhe më efikas ndërmjet kompanisë dhe fermerëve lokal në formë të shitblerjes së mallrave dhe shërbimeve.

**Imazhi i lokacionit:** në lokacionin përkatës do jepet mundësia që komuniteti të afrohet më afër me nevojat e tyre, do rritet imazhi i lokacionit ku do të nder veprojë kompania si dhe komuniteti do ketë hapësirat e nevojshme argëtimi dhe rekreacioni.

**Objektivat financiarë** (Rendit objektivat kyçe financiare. Kjo mund të jetë në formë të shitjes ose të profiteve që synon. Po ashtu mund ti renditni edhe synimet financiare menagjeriale siç janë synimet e reduktimit të kostove.)

#### **Financat e duhura**

Sa para ju duhet për të filluar? Ku do ti gjeni fondet? Çfarë pjese do të kërkonti nga huatë, investitorët, partnerët e biznesit, miqtë ose të afërmit, kapitalit të projektit ose fondeve qeveritare? Me çfarë shume nga paratë tuaja do të kontribuoni për biznesin?)

#### **Supozimet**

Tabelat financiare në faqet pasuese janë bazuar në supozimet e renditura më poshtë:



- (Renditni supozimet tuaja financiare. Këto përfshijnë përshtatjet sezonale, shkallën e dyshimeve ose interesave etj.)

#### **Shtojcat**

Të ngjitura janë shtojcat e mia, dokumentacioni në lidhje me këtë plan biznesi.

Dokumentet e ngjitura përfshijnë:

- Projekti teknik
- Paramasa me përshkrim teknik të punimeve
- Skicat e objekteve
- Fleta poseduese me kopje plani
- Certifikata e biznesit të OE

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	<b>KRYETARI I KOMUNËS          PRESEDNIK OPŠTINE          MUNICIPAL MAYOR</b>	 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	01.Nr.585/2024	Datë: 18.07.2024

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 58 pika ( h ) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale; nenin 14 të të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenin 68, pika 8 e Statutit të Komunës 01 Nr. 62/10 të datës 30.11.2010 i :

### Propozon

Kuvendit të Komunës, që në bazë të nenit 11, nenit 12, paragrafi 12.2 pika (d), nenit 14 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3, paragrafi 2 dhe paragrafi 3, nenit 11, paragrafi 1, paragrafi 2, paragrafi 3, nënparagrafi 3.1 dhe 3.2 dhe nenit 13 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 6, nenit 13 dhe nenit 23 paragrafi 1, paragrafi 4, nënparagrafi 4.1 i Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës; nenit 83 të Statutit të Komunës së Istogut 01 Nr.62/2010 dhe në përputhje me Dokumentet e Planifikimit Hapësinor me qëllim të dhënies në shfrytëzim afatgjatë me negociim pronën e paluajtshme të Komunës, Njësia Kadastrale P-70806044-00213-4 me sipërfaqe prej 4858 m<sup>2</sup> , investitorit Abedin Haxhijaj, “Dritoni Plast” SHPK me pronar Abedin Haxhijaj, pas negociatave të zhvilluara në mes të Kryetarit të Komunës si përfaqësues i komunës dhe si qiradhënës në njërën anë dhe investitorit Abedin Haxhijaj, “Dritoni Plast” SHPK në anën tjetër si qiramarrës, pas shqyrtimit të propozimit të Kryetarit të Komunës, i propozon Kuvendit të Komunës që në mbledhjen e mbajtur më 30.07.2024 të miratojë këtë:

### VENDIM PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË ME NEGOCIM PRONAT E PALUAJTSHME TË KOMUNËS “ DRITONI PLAST ”

1. Të **MIRATOHET** propozim-vendimi i Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë me negociim pronën paluajtshme të komunës, Njësia Kadastrale P-70806044-00213-4 me sipërfaqe prej 4858 m<sup>2</sup>, në vendin e quajtur “ Rudesh ” Zona Kadastrale-Sinajë, Komuna Istog, e cila sipas certifikatës pronësore me numër të referencës 2210/2024 është e evidentuar P.SH. e mirë e fshatit të cilat i jepen në shfrytëzim afatgjatë me negociim investitorit Abedin Haxhijaj “Dritoni Plast”, me seli në Sinajë, Komuna e Istogut.
2. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim afatgjatë me negociim i pronës së paluajtshme të komunës është zhvillimi i aktiviteteve biznesore, ndërtimi i një objekti për prodhimin e dritareve dhe dyerve si dhe përpunimin e xhamit me qëllim të rritjes së kapacitetit duke përfshirë këtu edhe blerjen e makinerisë përpunuese dhe prodhuese, gjenerimi i vendeve të reja të punës sipas standardeve të përcaktuara me dispozitat ligjore, rritjen e zhvillimit ekonomik të komunës si dhe rritjen e vlerës së pronës së komunës ku vlera e investimit është 1.469.370.42 me çka tejkalohet vlera prej 10 % e buxhetit të përgjithshëm për investime kapitale të komunës për vitin paraprak.

3. Afati kohor për dhënien në shfrytëzim afatgjatë me negocim të pronave të paluajtshme të komunës të cekur në pikën 1 të këtij vendimi është në kohëzgjatje prej 30 vite ( tridhjetë ) vite ku do të jepet në shfrytëzim me kompensim në shumën e qirasë vjetore prej 600 euro ( gjashtëqind euro ) sipas kushteve tjera të parapara në kontratë.
4. Të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës si qiradhënëse me investitorin Abedin Haxhijaj, "Dritoni Plast" si qiramarrës do të rregullohen me kontratë të veçantë të nënshkruar nga Kryetari i Komunës si përfaqësues i Komunës dhe investitori Abedin Haxhijaj "Dritoni Plast" SHPK.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis, Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Drejtoria për Inspektion.
4. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike sipas nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

### Arsyetim

Baza ligjore për miratimin e këtij Propozim-Vendimi është përcaktuar me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale; Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Statutit të Komunës së Istogut 01 Nr.62/2010.

Kryetari i Komunës si përfaqësues i komunës, sipas autorizimeve ligjore që i ka, duke u bazuar në nenin 11 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe ligjeve tjera përkatëse në fuqi pas parashtrimit të kërkesës Nr.01-016-24159 me dokumentet përcjellëse ( planin ideor, planin e biznesit, certifikatën e regjistrimit të biznesit etj. ) me datën 11.07.2024 nga investitori Abedin Haxhijaj, "Dritoni Plast" për marrjen në shfrytëzim afatgjatë me negocim, pronën paluajtshme të komunës, Njësia Kadastrale P-70806044-00213-4 me sipërfaqe prej 4858 m<sup>2</sup>, në vendin e quajtur " Rudesh " Zona Kadastrale-Sinajë, Komuna Istog, e cila sipas certifikatës pronësore me numër të referencës 2210/2024 është e evidentuar P.SH. e mirë e fshatit

Sipas projektit ideor-planit të biznesit dhe sipas negociatave investitori planifikon që në pronën e lartcekur të bëhet ndërtimi i një objekti për prodhimin e dritareve dhe dyerve si dhe përpunimin e xhamit me qëllim të rritjes së kapacitetit duke përfshirë këtu edhe blerjen e makinerisë përpunuese dhe prodhuese, gjenerimi e 20 vendeve të reja të punës sipas standardeve të përcaktuara me dispozitat ligjore, rritjen e zhvillimit ekonomik të komunës si dhe rritjen e vlerës së pronës së komunës ku vlera e investimit është 1.469.370.42 euro.

Me qëllim të realizimit të interesit publik, rritjes së vlerës së pronave të komunës, krijimit të të hyrave vetanake në njërën anë dhe ofrimit të kushteve për krijimin e vendeve të reja të punës në anën tjetër përmes bërjes së politikave të punësimit, propozohet dhënia në shfrytëzim e pronave të paluajtshme të Komunës investitorit të lartcekur siç përcaktohet në nenin 1 të këtij propozim-Vendimi andaj kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

**Udhëheqësja e Zyrës Ligjore**  
**z.Zekije Sutaj**

**Kryetari i Komunës**  
**z. Ilir FERATI**



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut  
Opština Istok  
Municipal of Istog

Datë :16.07.2024

## Oferta e Negociuar e Kryetarit të Komunës me investitorin z. Abedin Haxhijaj "Dritoni Plast" Sh.P.K

Investitori z. Abedin Haxhijaj pronar dhe përfaqësues "Dritoni Plast" Sh.P.K më datë 11.07.2024 ka parashtruar kërkesën Nr.01-016.24159 ,drejtuar Kryetarit të Komunës z. Ilir Ferati për marrjen në shfrytëzim afatgjatë me negociim pronën e paluajtshme e komunës, Njësinë Kadastrale P-70806044 - 00213 - 4 në vendin e quajtur "Rudesh" e cila sipas certifikatës pronësore është e evidentuar pronë P.SH."E Mirë E Fshatit" Komuna Istog , Zona Kadastrale -Sinajë K, Istog.

Pas pranimit të kërkesës për marrjen në shfrytëzim me negociim të pronës njësinë kadastrale të lartcekur u realizuan takime ndërmjet Kryetarit të Komunës z. Ilir Ferati dhe investitorit z. Abedin Haxhijaj ku të pranishëm kanë qenë edhe Drejtori i Drejtorisë për Kadastër dhe Gjeodezi z.Agon Dreshaj, Drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim Urban dhe Mjedis z.Dukagjin Hoxhaj, Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa si dhe Ekonomi e Zhvillim z.Genc Ademaj dhe Drejtori i Drejtorisë të Inspektionit z.Kushtrim Buleshkaj.

Investitori në këto takime prezantoi planin e biznesit dhe projektin ideor për mënyrën e shfrytëzimit të pronës së komunës me negociim sipas të cilit qëllimi i investimit është ndërtimi i një objekti për prodhimin e dritareve dhe dyerve nga plastika si dhe përpunim e gjamit më qëllim të rritjes së kapacitetit të prodhimit duke përfshirë këtu edhe blerjen e makinerisë përpunuese dhe prodhuese.

Përveç qëllimit të cekur më lartë të këtij investimit pika tjera kryesore të diskutimit për ofertën e negociuar ishin:

- **Investimet në objekt:** Objekti 1200 m<sup>2</sup> dhe hapësira e parkingut si dhe në të ardhmen përshtatja në bazë të nevojave të tregut në hapësirat ekzistuese

- **Objektivat e investitorit** të cilat synohen të arrihen përmes marrjes në shfrytëzim me negociim të pronës së komunës: plotësimi i kërkesave të konsumatorëve me qëllim të investimit është ndërtimi i një objekti për prodhimin e dritareve dhe dyerve nga plastika si dhe përpunim e gjamit më qëllim të rritjes së kapacitetit të prodhimit duke përfshirë këtu edhe blerjen e makinerisë përpunuese dhe prodhuese si dhe hapjen e vendeve të reja të punës.

Rritja e qarkullimit dhe shitjes përmes investimit parashihet në periudhën 3 - 4 vjeçare ashtu si është përcaktuar edhe në planin e biznesit si dhe planin ideor prezantuar në shkresat e lëndës bashkangjitur kërkesën e paraqitur.

- **Vlera dhe qëllimi i investimit** – investimi do të jetë 1.469.370.42 deri të rritja e aftësisë konkurruese dhe pozicionimi më i mirë i biznesit përmes shfrytëzimit optimal të kapaciteteve dhe të gjitha resurseve dhe pozicionit duke rritur kështu në mënyrë të fuqishme qarkullimin, të hyrat dhe profitin; hapja e rreth 20 (njëzetë) vendeve e të reja të punës, interaktiviteti dhe lidhja me klientët vendor, nevoja e komunitetit në raport me afërsinë e nevojave të tyre, rritja e imazhit të lokacionit, investime në objekt dhe infrastrukturë.

- **Kohëzgjatja e investimeve:** 3 - 4 vjet nga nënshkrimi i kontratës

Pas prezantimit të planit ideor dhe atij të biznesit u arrit pajtimi që ndërmerren të gjitha veprimet e nevojshme ligjore të përcaktuara në Ligjin për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores për përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës me qëllim të dhënies në shfrytëzim afatgjatë me negociim pronat e paluajtshme të komunës të cekura më lartë.

Sipas negociatave komisioni vendosi që shuma e qirasë për investitorin lidhur me shfrytëzimin afatgjatë me negociim të pronave të paluajtshme të komunës të jetë 600 € (gjashtëqind ) euro dhe të jepet në kohëzgjatje prej 30 vite.

Për Komunën e Istogut:

Kryetari, z. Ilir Ferati




Më: 16/07/2024

Për " Dritoni Plast " Sh.P.K

Investitori z. Abedin Haxhijaj



Më: 16/07/2024



**Për :Kryetarin e Komunës z.Illir Ferati**

**Nga : “Dritoni Plast “ SH.P.K të cilën e përfaqëson z.Abedin Haxhijaj, pronar adresa rruga “Rudina” 101 Sinajë Komuna Istog**

**Tema : Kërkesë për Negocim - Direkt .**

**Datë :11.07.2024.**

## **K Ë R K E S Ë**

**I nderuar kryetar FERATI**

Ne si kompani kemi një kohë të gjatë qe jemi duke operuar në tregun e Kosovës me sukses. Fabrika “Dritoni Plast” është themeluar në vitin 2002 dhe njëjta vazhdon të punojë me adresë në fshatin Sinajë të Komunës së Istogut me një cilësi dhe standard të lartë për prodhimin e dymve dhe dritareve nga plastika si dhe shërbimeve të tjera duke përfshi këtu edhe shërbime të montimit dhe zëvendësimit të produkteve tona.

Më qellim të zhvillimit ekonomik dhe hapjes së vendeve të reja të punës në biznes kërkojmë nga Komuna e Istogut ,Kryetari i Komunës z. Ilir FERATI që në bazë të ligjit ,Për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës të Paluajtshme të Komunës të na mundësohet që përmes negocimit direkt shfrytëzimi i njesisë kadastrale me .nr.P-70806044 –002013 - 4 ZK Sinajë Komuna, Istog.

Në këtë pjesë të parcelës, paraqitur edhe në planin e biznesit ku planifikojmë të investojmë rreth 1.469.370.42 euro në total duke përfshirë këtu hapjen e vendeve të reja të punës zgjerim infrastrukturor, blerje të makinerisë përpunuese në kuadër të veprimtarisë ekzistuese me të vetmin qellim për rritje të kapaciteteve ekzistuese si dhe zhvillim ekonomik.

**Andaj më qellim të kompletimit të dokumentacionit të paraqitur kërkesës ia bashkëngjisim :**

- Planin e Biznesit
- Planin Ideor
- Kopjen e Planit të parcelës.
- Certifikatën e Pronësisë.
- Qarkullim bankar
- Vërtetimin e tatimit në pronë.

**Istog 2024 .**







Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Tregëtisë, Industrisë, Mineshtrisë dhe Tregëtisë  
Ministry of Trade and Industry

# ARBK

AG. ENCIA E REGJISTRIMIT TËR ZHËSËVE NË KOSOVË  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA REGISTRACIJE BIZNISA  
KOSOVA BUSINESS REGISTRATION AGENCY

## CERTIFIKATË E REGJISTRIMIT CERTIFIKAT O REGISTRACIJI CERTIFICATE OF REGISTRATION

### 811223875

Numri Unik Identifikues / Jedinstveni Matični Broj / Unique Identification Number

### Dritoni Plast SH.P.K.

Emri biznesit / Naziv biznisa / Name of business

///

Emri tregtar / Trgovačko ime / Commercial name

Lloji biznesit:  
Poslovni tip:  
Business type:

**Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara  
Društva sa ograničenom odgovornošću  
Limited Liabilities Companies**

Adresa:  
Adresa:  
Address:

**Zona Industriale  
Istog**

Data e regjistrimit:  
Datum registracije:  
Date of registration:

**27/04/2012**

**06/05/2019**

Data / Date / Datum

  
Nënshkrimi / Signature / Potpis

Nr. ser. / Ser. br. / Ser. No.: **10024640**





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of  
Komuna e ISTOG / Opština ISTOK / Municipality ISTOG



Bazuar në nenin 18 të ligjit 03/L-204 për tatimin në pronë, si dhe udhëzimit administrativ nr. 7/2011 të lëshuar nga MF, i cili ka të bëjë me urdhëresat e ndalimit të shërbimeve komunale për detyrim të pagesës së tatimit në

Na osnovu člana 18, zakona 03/L-204 za poreza na imovinu i administrativne uredbe MF br. 7/2011, u vezi zabrane opštinskih usluga za prinudu uplate poreza na imovinu, izdaje se ova:

Based on the article 18 of LAW 03/L-204 on property tax and administrative instruction MF no. 7/2011 on termination of services for enforcement of the municipal property tax, the municipal Property Tax Office

Nr / Br / No

24/05/2024

93335350982

## VËRTETIM POTVRDA CERTIFICATE

Me të cilin vërtetohet se tatimpaguesi  
Kojim se potvrđuje da je poreznik  
that certifies that taxpayer

"DRITONI PLAST " SHPK

ISTOG

Komuna / Opština / Municipality

ISTOG RUDINA NR 101

adresa / adresa / address

I ka kryer pjesërisht / plotësisht obligimet e tatimit në pronë  
Delimično/ izveršio uplatu poreskih obaveza  
has partially / fulfilled obligations on property tax

"DRITONI PLAST " SHPK

Vërtetimi lëshohet në bazë të kërkesës së / Potvrda se izdaje na zahtev / Certificate is issued by

Për nevoja personale

dhe shërben për / i služi za / and is used for

AFATI:30.12.2024

Shënime shtesë / Druge podatke / Additional info

Nenshkrimi / Potpis / Signature





Republika e Kosovës  
Republica Kosovo-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësiror dhe Infrastrukturës / Ministerstvo Životte Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure  
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70806044-00213-4

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:

2210/2024

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme Izdavanja / Date and time of submission:

11.07.2024 - 09:40

Komuna / Opština / Municipality:

ISTOG / ISTOK / ISTOG

Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:

Sinjale / Sinajle / Sinaj

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: ISTOG / ISTOK / ISTOG

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta Imovine Property Type	Zona U/R GIS U/R	Sipërfaqja Površina Area (m <sup>2</sup> )	Pershkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
P-70806044-00213-4	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shtetërore / Drushtivena Imovina / Socially owned Land	Rural	4858	2-2004-23/2014,2021	13.11.2014	19.05.2021

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
RUDESH			13.11.2014	19.05.2021

**A.2 LLOJIT I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE**

Numri Bregj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcelle Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcelle Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kualiteti i klasës Quality Class	Sipërfaqja Površina Area (m <sup>2</sup> )
1	Bujqësore/Pojëqorrëdhno/Agriculture	Kullosar/Pashnjaci/pasture	Kullosë E Klasës 4/Pashnjak 4 Klasse/4th Class Pasture	4858

**B. PRONAR/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR**

Të drejtat Prava Rights	Emri i Imer Name	Nr. personal Lokal broji ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postar Postanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednostni adrese Address details	Pjesa e pronës Dio imovine Share quota	Përshkrimi Opis Description	Azhuaruar Ažurirano Updated
Posejdim individual / Individualna Drazavina / Single possessor	P.SH. E MIRË E FSHATIT	KCID0807495	SINE / SINE / SINE /		SINE	1/1	2-2004	13.11.2014





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS  
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE  
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

**KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN**

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : ISTOG

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Sinajë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m <sup>2</sup>
P-70806044-00213-4	Parcelë / Parcela / Parcel	4858



Shkalla/Razmera/Scale: 1:697

Punoi/Obradio/Created: Meriton Ahmetaj

Nënshkrimi/Potpis/Signature: \_\_\_\_\_

Shënim/Beleška/Note:



Data/ Data/Date: 11.07.2024

Koha/ Vreme/ Time: 09:57:52

Lista e shtresës Ndihma


- Ortofoto
- Ortophoto2018Rural
- Ortophoto2018Majore
- Ortophoto2018Urban
- Ortofoto 2015 UAV
- Ortofoto 2012
- Ortofoto 2009
- Ortofoto 2004
- Hana Topografike
- Hana Topografike 1:250000
- Hana Topografike 1:25000 (2015)
- Nomenklatura
- Modeli Dixhital i Terrenit
- Modeli Dixhital i Terrenit Rëvizimi
- Indeksi i Ortofotove 2018
- Rrjet Rrugor
- Autostradë
- Rrugë Nacionale
- Rrugë Rajonale
- Njësia Administrative
- Kufiri Shetëror
- Kufiri dhe Etnari e Komunave
- Zone urbane
- Njesite Kadestrale
- Zonat Kadestrale
- Parcelat
- Numri parcelës
- Ndertesat
- Numri ndertesës
- Shteti i Adresave
- Rrugët
- Etnari e rrugëve

1 : 1000

Auto

Shtesa e Shërbimit

Kë-9.0



KosovaReD1

Pozita: 7460524.49



**(Dritoni Plast SH.P.K)**

# Biznes Plan

**E përgatitur (04.2024)**



**Emri i veprimtarisë :** Prodhimi i dyerve dhe dritareve nga Plastika

**Pronarë:** Abedin Haxhijaj

**Adresa:** Istog-Sinajë, rr. Rudina nr 101

**Lokacioni:** Istog-Sinajë

**Tel.:** 044/180509

**Nr. i biznesit:** 811223875

**Struktura organizative:** Shoqëri me përgjithësi të kufizuara (SHPK)

## Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive.....	5
1.1. Historiku.....	6
1.2. Vizioni.....	6
1.3. Misioni.....	6
1.4. Objektivat.....	6
1.5. Lokacioni.....	7
2. Tregu.....	7
2.1. Tregu Shënjestër.....	7
2.2. Strategjia e Ndërmarrjes.....	7
2.3. Çelsat e Suksesit.....	8
2.4. Produktet.....	8
2.5. Pozita e veçantë e shitjes.....	11
2.6. Kërkesa e paraparë.....	12
2.7. Strategjia e çmimit.....	12
2.8. Analiza e tregut.....	12
3. Analiza S.W.O.T.....	13
3.1. Buxheti për veprim.....	13
3.2. Stafit teknik.....	14
3.3. Pagat e stafit teknik.....	14
3.4. Personeli Administrativ.....	14
3.5. Makinerit.....	15
3.6. Përshkrimi i makinerive.....	16
3.7. Kërkimet shkencore.....	17
4. Plani financiar.....	18
4.1. Bilanci i gjendjes.....	19
4.2. Bilanci i suksesit.....	20
4.3. Rrjedha e parasë.....	21

## 1.Përmbledhje ekzekutive

Ky plan biznesi është hartuar në kuadër të iniciativës ndërmarrëse individuale për themelimin e një sektori të prodhimit e dyerve dhe dritareve nga plastika. Selia dhe veprimtaria e biznesit është përqendruar në Istog pasi që këtu kemi edhe biznesin egzistues.

Ne kemi një traditë të gjatë për prodhimin e dyerve dhe dritareve nga plastika dhe andaj jemi përcaktuar që të zgjerojmë kapacitetet tona prodhuese.

Me këtë zgjerim synojmë të tërheqim konsumatorët në territorin e Kosovës dhe rrethinës si dhe të tregut ndërkombëtar. Vendimi për themelimin e kësaj veprimtarie për investimin e kemi marrë pas kemi konstatuar se në tregun tonë ka hapësirë për zgjerimin dhe rritjen e kapaciteteve tona për të cilat ka kërkes dhe kështu, kemi marrë vendim për hartimin e këtij plani për t'iu përgjigjur kërkesave të tilla. Gjersa na janë të njohura kërkesat për këtë veprimtari, ne si biznes i përcaktuar qëllimet tona se çka duam të arrijmë se cila është leverdia jonë, të cilat i kemi përmbledhur në tri grupe kryesoret: 1) për t'u bërë ndërmarrës duke krijuar vende pune për realizimin e të ardhurave; 2) të ofrojmë produkt kualitativ me standarde të larta ndërkombetare; 3) të bëhemi shëmbull i mirë në nivel të Kosovës se si mund të ofrohen disa lloje të produkteve të mira për një pjesë të madhe të popullsisë. Ne kemi bërë disa hulumtimin e tregut dhe kemi konstatuar se hapësira e madhe në tregun e Kosovës për produkte cilësore të standardeve të agjensionit për energji dhe efqencë në tregun tonë plotësojnë vetëm disa kompani të cilat janë të certifikuara, po të cilat nuk kanë kapacitet për mbulimin e kërkesave të tregut vendor dhe rajonal dhe për këtë arsye zgjërimi i aktivitetit tonë prodhues na mundëson që të jemi pjesë e kësaj hapësire.

Për ta realizuar me sukses synimin dhe qëllimet e përcaktuara, kemi në dispozicion pajisjet ekzistuese të biznesit tonë si dhe linjën e re e cila do të realizohet brenda vitit 2024 .

## **1.1 Historiku i kompanisë**

Ne si kompani kemi një kohë të gjatë që jemi duke operuar në tregun e Kosovës me sukses ku në fillim kemi pasur disa sfida të cilat i kemi kaluar me sukses. Fabrika Dritoni Plast është themeluar në vitin 2002 dhe vazhdon të punoi në Sinajë të Istogut me cilësi dhe standard të lartë të dyerve dhe dritarëve nga plastika, si dhe shërbimeve të montimit dhe zëvendësimit në shtëpitë tuaja.

## **1.2. Vizioni**

Dritoni Plast SH.P.K synon të bëhet shëmbull i diversifikimit të veprimtarisë së të dyerve dhe dritareve nga plastika duke ofruar Produkte me kualitetit evropian në tregun e Kosovës dhe të rajonit, dhe të bëhem shëmbull në këtë sektor të industrisë.

## **1.3. Misioni**

Misioni i biznesit tonë është që me programe gjithëpërfshirëse të gjejmë mënyrat më të përshtatshme që të mbështesim kërkesat e klientëve dhe të zhvillojmë produktet e me standarte ndërkombëtare.

## **1.4. Objektivat**

Pasi kemi zgjedhur tregun shënjestër dhe kemi bërë identifikimin e nevojave të klientëve, në mbështetje të vizionit dhe misionit të biznesit, kemi përcaktuar objektivat kryesore që duhet të arrihen, dhe ato janë:

- Investimi dhe zgjerimi ,përmirësimi i vazhdueshëm i objekteve në kuadër të kësaj veprimtarie;
- Ofrimi i produkteve kualitative në tregun tonë;
- Bashkëpunimi me brokerët e tregut Evropian për eksportine produkteve tona;
- Rekrutimi dhe zgjedhja e një menaxhmenti profesional dhe të përgjegjshëm që të udhëheq biznesin kur të filloj rritja dhe zhvillimi;
- Njoftimi dhe përzgjedhja e e personelit të kualifikuar për për proceset e sektorve përkatëse të veprimtaris sonë;

## **1.5.Lokacioni dhe mjetet e kompanisë**

Veprimtarin e ushtrijmë në lokalin prej 1200m<sup>2</sup>,ku jemi te vendosur komplet me stafin e kompanis ku objekti i prodhimit është i ndarë me pjesën e Administratës .

## **2.Tregu**

Tregu i veprimtarisë sonë është Kosova, Raojna dhe shtetet e Bashkimit Evropian, por në afat të gjatë pasi të rritemi, zhvillohemi dhe konsolidohemi synojmë të ofrojmë produkte dhe shërbime edhe në tregjet ndërkombëtare pasi qe ka një hapësirë shumë të madhe duke u bazuar në analizen e të dhënave sekondare nga analiza e tregjeve potenciale. Për këtë do të kërkohet një rishqyrtim i planit aktual të biznesit, ose hartimi i një plani strategjik për nevoja afatgjate dhe kërkesave të klientëve, por fillimisht kemi vendosur të shkojmë në hapa pak më sigurt dhe të shohim se si i kemi gjasat për sukses në tregun shënjestër.

### **2.1.Tregu shënjestër**

Tregu shënjestër i kompanisë sonë është tregu i Kosovës dhe shtetet e Bashkimit Evropian. Këtë treg e kemi zgjedhur pas vështrimit tonë se në Kosovë për shkak të standardeve të reja si dhe hapësirës dhe kërkesës së madhe në vendët e ndryshme të Bashkimit Evropian mbetet tregu shënjestër i yni. Ky ishte një sinjal i mirë për neve rreth tregut shënjestër, dhe menjëherë filluam të mendojmë se çfarë strategjie duhet ta përdorim që t'i përgjigjemi nevojave dhe kërkesave të tilla.

### **2.2Strategjia e Ndërmarrjes**

Në botën e sotme, elementi më kritik i shumicës së veprimtarive njerëzore, prandaj edhe i biznesit, është informimi.Ne paraprakisht kemi siguruar shumicën e informatave të mjaftueshme për diagnozën e sektorit të prodhimit të dyerve dhe dritareve nga Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë. Strategjia e marketingut që do ta përdorim është ajo nëpërmjet promocionit për të tërhequr më shpejtë dhe në mënyrë më efikase klientët, që do të përfshijë:

- Reklamimet nëpër mjetet e komunikimit masiv si televizione dhe radio;
- Hapja e një faqe interneti për projektin që është në zbatim e sipër;

- Shpërndarja e mjeteve reprezentuese (broshura, fletushka, dhe gjësende me markën tonë;
- Komunikimin e drejtpërdrejtë me klientët; dhe
- Inkurajimi i klientëve në referencën dhe rekomandimin e klientëve tjerë dhe angazhimi i një kompanie për zbatimin e strategjisë së marketingut.

Strategjia e marketingut do të jetë në përputhje me planin e marketingut i cili në vija të trasha hyn në kuadër të këtij plani të biznesit.

### **2.3.Çelësat e suksesit**

Suksesi i biznesit tonë do të bazohet në një numër përparësish si në vijim:

- Duke ofruar shërbime dhe produkte dukshëm më të mira dhe më të organizuara të cilësisë ndërkombëtare;
- Kushtet më të mira dhe shërbimet me cilësi të lartë janë nxitës i tërheqjes së klientëve;
- Lokacioni i përshtatshëm Regjioni i Dukagjinit, arrihet lehtë nga klientët e qytetit por edhe të rajoneve përreth;
- Zbatimi i një politike të marketingut për t'i joshur sa më shumë njerëz që të bëhen klientë tanë; dhe
- Publiciteti dhe marrëdhëniet me publikun si formë e promovimit intern.

### **2.4.Produktet**


Produktet tona të derve dhe dritarëve të plastikës do të jenë të ndara për konsumatorët e ndryshëm qofshinë ata konsumatorët industrial apo konsumatorët individual.

Ne do të prodhojmë me tri lloje të produkteve të ndryshme me standarde të ndryshme:


- Prodimi i Dritareve nga Plastika;
- Prodhimi i Dyerve nga Plastika;

- Roleta nga plastika dhe alumini.

**Prodimi i Dritareve nga Plastika**, ka karakteristika të jashtëzakonshme të performancës, si një vlerë e izolimit termik të shkallës së parë UF prej 0,932/m<sup>2</sup>k dhe një theçësi të profilit të ulët prej 76mm garanton, fleksibilitet maksimal në ndërtesat dhe rinovimet e reja, me material të riciklueshëm.




**Prodhimi i Dyerve nga Plastika**, dyert e përparme janë karta e vizitës së shtëpisë tuaj dhe i japin hijeshi dhe stil zonës së hyrjes. Me sistemin e ri të dyerve të përparme S 9000, GEALAN ofron zgjidhjen e duhur për çdo shije. Ju mund të zgjidhni midis versionit klasik dhe atij që mbulon krahët. Dhe falë skemës fleksibël të ngjyrave të fletëve të shumta dekorative, ju keni mundësinë të përshtatni derën tuaj të re të hyrjes me pamjen e përgjithshme të ndërtesës suaj.





Roleta nga plastika dhe alumini, roletat tona të montuara përpara janë sisteme të pavarura që mund të montohen gjithashtu në dritare. Në varësi të dizajnit të fasadës, ju mund të zgjidhni midis kutive të roletave në formë katrore ose të rumbullakët. Duke ofruar një llojshmëri në ngjyra dhe forma të ndryshme sipas kërkesës së tregut.



## **2.5.Pozita e veçantë e shitjes**

Përparësi e madhe për kompaninë tonë është lokacioni. Ofrimi i transportit falas për konsumatorët tanë, është element kyç dhe strategji e kompanisë, me të cilën mendojmë se do të arrijmë të mundim konkurrencën. Kur mendojmë për transportin, mendojmë për klientët kryesisht në regjionet e Kosovës dhe shtet e ndryshme të Bashkimit Evropian.

Ne si kompani ekzistuese e kemi një pozit shumë të mirë të shitjes pasi jemi të njohur ne rajonin e pejes për shërbime të shkelqyshme të të sakta sipas marrëveshjes.

## **2.6.Kërkesa e paraparë**

Meqenëse jemi biznes ekzistues kërkesat do të matet nga disa këndvështrime dhe burime. Së pari, është vlerësimi ynë në terren për një numër të konsumatorë regjinal dhe atyre ndërkombëtar, e të cilët kanë shprehur interesim për t'i përdorur produktet tona që jenë në dispozicion.

Kërkesën e lartpërmëndur e kemi hulumtuar shumë dhe aq saktë, ndonëse e kemi identifikuar shumë mirë. Nga grupi i parë kemi identifikuar 25 biznese shqiptare Evropiane si dhe klientët tanë besnik që janë më shumë se 20 vite.

## **2.7.Strategjia e çmimit**

Duke u bazuar në çmimet e konkurrencës jemi futur ne treg me një strategji jo shumë e perdorur ne vendin tonë ku çmimi i produkteve tona do të jetë me i ultë se sa i konkurrencës ku prodhimi ynë do të jetë i kualitetit më të lartë sesa ai konkurrues falë avantazhit tonë të ri teknologjik.

## **2.8.Analiza e tregut**

Nëse bazohemi ne vitet e kaluara, shohim se industria e prodhimit të dymit dhe dritareve nga platika ka pasur trend të rritjes.

Edhe ne bazë të analizës të tregut të Kosoves , nuk realizohen nevojat e vendit me prodhimit e produktit vendor as 70%, dhe për këtë arsye ka një hapësirë të madhe për plasimine e produkteve tona në vendin tonë dhe shtet e ndryshme të Bashkimit Evropian.

Duke ju referuar përqindjes dhe kërkesave të klientëve për këto lloje të produkteve kemi analizuar dhe vlersuar seky projekt është me vlerë të madhe pasi që ka një kërkes për këtë lloje të produkteve në vendin ton ku shumica e produkteve ekzistuese nepër filialet tona jan krysisht të importuara nga vendet e ndryshe të raioneve si maqedonia,shqipëria dhe fqinjët për rreth po edhe produkte të ndryshme ndërkombëtare qe vin nga larg.

Ne do të tentojmë se me inovacione të shtojmë vlerën e shërbimeve, në mënyrë që të fitojmë klient lojalë dhe t'i bëjmë ata konsumator të rregullt të cilet do të vedisohen më shume për produktet vendore.

### 3.Analiza S.W.O.T.

<b>Forcat</b>	<b>Dobësitë</b>
Lokacioni , Objekti ekzistues, Lënda e parë,	Mungesa e furnizimit me rrymë të çendrushme,

<b>Mundësitë</b>	<b>Kërcënimet</b>
Zgjerim i vazhdueshëm i llinjave të prodhimit Distribulim të shpejtë dhe efikas. Vedlismi i qytetarve për produktet vendore.	Konkurrenca nga Inporti, Ndryshimet teknologjike. Politika Fiskale

#### 3.1.Buxheti për veprim

**Pagat e personelit vendimmarrës** ku janë të përfshira sigurimet shëndetsore+trusti pensional.

Këto paga i arsyetojmë më rëndesin e përgjegjësive të këti personeli duke e pasur parasyshtë se ky personel ka rol kyqë në vendimmarrje dhe zhvillim të biznesit.

<b>PAGAT E PERSONELI VENDIMARRËS (TË PËRFSHIRA SIGURIMET DHE TRUSTI PENSIONAL)</b>			
<b>PËRSONELI</b>	<b>Çmimi</b>	<b>Nr. Puntorët</b>	<b>Gjithësej</b>
<b>Menaxheri</b>	950€	1	950€
<b>Mbikëqyrësi i prodhimit</b>	750€	2	750€
<b>Gjithësej</b>			<b>2270€</b>

### 3.2 Staf i teknik

Stafi teknik ka një rëndësi të madhe në sektorin e prodhimit se pa një staf të kualifikuar teknik nuk mund të funksionoj procesi i prodhimit .

Në staf teknikë bëjnë pjesë një numer i caktuar i personelit të cilet bëjnë të mundur procesin e prodhimit që të shkojë në hapat e planifikuar të prodhimit.

Secili puntor i kësaj kompanie e ka detyrën e caktuar brenda orarit të paraparë në kontrat me ligj, si brenda kompanis ashtu edhe jashtë sajë. Orari i këtyre punëtorve do të jetë në përputhshmëri me ligjin e punës në fuqi ku orari është tetë orësh me mundësi të marrveshjës për të punuar jashtë orari me pages shtesë

### 3.3. PAGAT E STAFIT TEKNIK

Emërtimi	Çmimi	Nr. Puntorve	Gjithësej
Inxhinieri i makineris	1150€	1	1150€
Inxhinieri i elektros	900€	1	900€
Pranuesi i porosive	700€	1	700€
Përgjegjes i paketimit	680€	1	680€
Puntorët e sektorit të prodhimit	650€	11	7150€
Puntorët e ambalazhimit	600€	4	2400€
Depoisti	580€	1	580€
Pastrues	450€	1	450€
Puntorët e sigurimit	480€	1	480€
Gjithësej		22	14490.00€

### 3.4.

#### Përsonei Administrativ

Përsonei administrativ ka një përgjegjësi sa i përket problemeve juridike për hartimin e kontratave në mes të paleve kontraktuese lidhur me kompaninë, puntorëve me kompanin dhe ndonjë problem juridik që mund ta këtë kompania.

Po ashtu edhe kontabilisti ka një pjesë të përgjegjësis sa i përket deklarimit të pashqyrave financiare të kompanisë, pagesave të obligimeve të kompanisë ku bëjnë pjesë: tatimet e kompanisë obligimet ndaj shtetit, pagesat e pagave të puntorëve të cilat bëhen përmes sistemit bankarë.

IT përkujdeset për mirmbajtjen e e paisjeve kompjuterike të kompanisë.

<b>PAGAT E PERSONELI ADMINISTRATIV (TË PËRFSHIRA SIGURIMET DHE TRUSTI PENSIONAL)</b>			
<b>PERSONELI</b>	<b>Çmimi</b>	<b>Nr. Puntorët</b>	<b>Gjithësej</b>
Juristi	680€	1	680€
Kontabilisti	680€	1	680€
Administratore	550€	1	550€
IT	200€	1	200€
<b>Gjithësej</b>		<b>4</b>	<b>2110</b>

### **3.5.Makinerit**

Pka kryesore e këtij projekti janë makinerit për prodhimin e e dyerve dhe dritareve nga plastika këto makineri janë të një standardi evropian e cila teknologji perdoret edhe ne shtetet e bashkimit evropian.

Ne jemi fokusuar kryesisht në shtetin e gjermanis sa i përket blerjes së makineris për prodhimin e produkteve tona këtu janë të përfshira të gjitha makinerit e nevojshme për nje proces të kompletuar të përpunimit dhe prodhimit të produkteve duke përfshirë edhe ambalazhimin.

Për realizimin e veprimtarisë të prodhimit jemi bazuar në teknologjin e fundit bashkohore të cilat garantojnë përpunimin, pastrimin , prerjen, dhe ambalazhimin e produkteve tona.

### 3.6.Lista e aseteve për prodhimin e dyerve dhe dritareve nga plastika.

<b>LLOJET E MAKINERIVE</b>	<b>TVOE/BRAND</b>	<b>NR.REF/SER.</b>
SHARRE DVKOKESHE PER PVC	ELUMATEC	0799232997
SHARRE PER HEKUR	ELUMATEC	-
SHPUARESE PER HEKUR	REXON	19915
FREZUES PER SHTVLLA	ELUMATEC	2210020664
FREZUES PER VRIMA	ELUMATEC	0760020357
SALDUESE NIEKOKESHE	ELUMATEC	ES710/60
SALDUESE DYKOKESHE	ELUMATEC	7200020320
QENDRA PER PASTRIMIN E SALDIMIT	ELUMATEC	8340020091
SHARRE PER ALU	ELUMATEC	-
MAKINA PER PRERIEIN E LLAISNEVE	ELUMATEC	1920021012
TAVOLINE PER PERPUNIMIN E	ELUMATEC	-
MAKINA PER PASTRIMIN E XHAMIT	ELUMATEC	LV 1600
MAKINA PER IZOLIMIN E XHAMIT	SZILANK	22000032/09
MAKINA PER IZOLIMIN E LLajsNEVE	ELUMATEC	-
GENERATOR 100KW	MANN	-
TRAFOSTACIONIELEKTRIK	-	-
GJENERATOR 25 KW	HONDA	-
KOMPRESOR AIRI		-
MAKINE PER PASTRIMIN E GOMES	KABAN	0106
MAKINE PER SHERAFA	ELUMATEC	-
KAMIONET 408D	MERCEDES	03 458 - BG
TAVOLINE PUNE	ELUMATEC	25001030020005
TAVOLINE PUNE	ELUMATEC	2505009002001 5
TAVOLINE PUNE	ELUMATEC	25001030020002
SB 3011 PVC PROFILE PROCESSING AND CUTTING CENTER	KABAN	0194
TD 3020 PVC WELDING AND CLEANING CENTER	KABAN	0298
MAKINE PER PRERJEN E HEKURIT	MIMAKSAN	HD 200 CW
MAKINA PER VRIMAT E DOREZES	ELUMATEC	1710020518

### 3.7.Kërkimet e të dhënave

Planifikimi i këtij projekti është i bazuar në kërkimet shkencore dhe ato profesionale duke i kategorizuar në mbledhjet e të dhënave:



- Sekundare
- Primare

Përmes kërkimeve sekundare kemi kalkuluar shumat për stafin e punës, ku kemi përdorur disa revista dhe kryesisht internetin duke kontaktuar me firmat për produktet dhe materialet e nevojshme për realizimin e hapave të projektit. Po ashtu kemi arritur që të gjejmë teknologjinë bashkohore për realizimin e biznesit të ri që ka të bëjë me përpunimin dhe prodhimin e dyerve dhe dritareve nga plastika.

Dhe gjithashtu kemi analizuar dhe krahasuar disa burime ekzistuese më lidhëshmëri me këtë projekt ku i kemi klasifikuar dhe verifikuar informacionet ekzistuese të cilat kanë qënë shumë të rëndësishme për ne.

Ndërsa realizimi i mbledhjes së të dhënave primare e kemi bërë në teren duke analizuar dhe krahasuar çmimet për makinerit dhe paisjet duke u takuar me personat përkatës të lamive të ndryshme.

Ku kemi arritur deri të çmimet reale dhe të sakta të makinerive dhe të gjitha paisjeve të tjera si brenda vendit ashtu edhe jashtë kemi takuar përsoa të përfaqësive të ndryshme dhe pastaj kemi marrur vendimin për zgjedhjen e atyre paisjeve dhe makinerive.

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	01.Nr.587/2024	Datë: 18.07.2024	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 58 pika ( h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale; nenin 14 të të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenin 68, pika 8 e Statutit të Komunës 01 Nr. 62/10 të datës 30.11.2010 i :

### Propozon

Kuvendit të Komunës, që në bazë të nenit 11, nenit 12, paragrafi 12.2 pika (d), nenit 14 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3, paragrafi 2 dhe 3, nenit 11, paragrafi 1, paragrafi 2, paragrafi 3, nënparagrafi 3.1 dhe nenit 13 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 6, nenit 13 dhe nenit 23, paragrafi 1, paragrafi 2, nënparagrafi 2.3, paragrafi 4, nënparagrafi 4.3, paragrafi 6 dhe 7 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës; nenit 83 të Statutit të Komunës së Istogut 01 Nr.62/2010 dhe në përputhje me Dokumentet e Planifikimit Hapësinor me qëllim të dhënies në shfrytëzim afatgjatë me negociim pronat e paluajtshme të komunës, Njësia Kadastrale P-70806016-00067-1 sipërfaqen prej 3650 m<sup>2</sup> nga sipërfaqja e përgjithshme prej 17404 m<sup>2</sup> dhe Njësia Kadastrale P-70806016-00069-1 sipërfaqen prej 350 m<sup>2</sup> nga sipërfaqja e përgjithshme prej 42060 m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale- Gjurakoc, investitorit Mehmet Imeraj, "RINA COMERC" SHPK me pronar Mehmet Imeraj, pas negociatave të zhvilluara në mes të Kryetarit të Komunës si përfaqësues i komunës dhe si qiradhënës në njërën anë dhe investitorit Mehmet Imeraj "RINA COMERC" SHPK në anën tjetër si qiramarrës, pas shqyrtimit të propozimit të Kryetarit të Komunës, i propozon Kuvendit të Komunës që në mbledhjen e mbajtur më 30/07/2024 të miratojë këtë:

### VENDIM PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË ME NEGOCIM PRONAT E PALUAJTSHME TË KOMUNËS " RINA COMERC"

1. Të **MIRATOHET** propozim-vendimi i Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë me negociim pronat e paluajtshme e komunës, Njësia Kadastrale P-70806016-00067-1, me sipërfaqe prej 3650 m<sup>2</sup> nga sipërfaqja e përgjithshme prej 17404 m<sup>2</sup>, në vendin e quajtur "Terezi" Zona Kadastrale-Gjurakoc e cila sipas certifikatës pronësore është e evidentuar Komuna e Istogut dhe Njësia Kadastrale P-70806016-00069-1 sipërfaqe prej 350 m<sup>2</sup> nga sipërfaqja e përgjithshme prej 42060 m<sup>2</sup>, në vendin e quajtur "Terezi" Zona Kadastrale-Gjurakoc e cila sipas certifikatës pronësore është e evidentuar Komuna e Istogut, Zona Kadastrale-Gjurakoc, të cilat i jepen në shfrytëzim afatgjatë me negociim investitorit Mehmet Imeraj "RINA COMERC" SHPK, me seli në Gjurakoc, Komuna e Istogut.
2. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim afatgjatë me negociim të pronave të paluajtshme të Komunës të cekur në pikën 1 të këtij vendimi është zhvillimi i aktiviteteve biznesore, ndërtimi i qendres multifunkionale ku do të shërbehen mallra dhe asortiment të të gjitha kategorive, përpunimi i mishit, prodhimi i ëmbëlsirave të ndryshme, prodhim i pjekurinave, shërbime gastronomie gjenerimi i vendeve të reja të punës sipas standardeve të përcaktuara me dispozitat ligjore,



rritjen e zhvillimit ekonomik të komunës si dhe rritjen e vlerës së pronës së komunës ku vlera e investimit është 2.000.000,00 deri në 2.100.000,00 ( dy milion deri në dy milion e njëqindmijë euro) me çka tejkalohet vlera prej 10 % e buxhetit të përgjithshëm për investime kapitale të komunës për vitin paraprak 2023.

3. Afati kohor për dhënien në shfrytëzim afatgjatë me negociim të pronave të paluajtshme të komunës të cekur në pikën 1 të këtij vendimi është në kohëzgjatje prej 40 vite ( katërdhjetë ) vite ku do të jepet në shfrytëzim me kompensim në shumën e qirasë vjetore prej 1800 euro ( njëmijë e tetëqind euro ) sipas kushteve tjera të parapara në kontratë.
4. Të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës si qiradhënëse me investitorin " Rina Comerc " SHPK si qiramarrës do të rregullohen me kontratë të veçantë të nënshkruar nga Kryetari i Komunës si përfaqësues i Komunës dhe investitori i " Rina Comerc " SHPK " Mehmet Imeraj.
- 3 Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis, Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Drejtoria për Inspektion.
4. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike sipas nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

### Arsyetim

Baza ligjore për miratimin e këtij Propozim-Vendimi është përcaktuar me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale; Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Statutit të Komunës së Istogut 01 Nr.62/2010.

Kryetari i Komunës si përfaqësues i komunës, sipas autorizimeve ligjore që i ka, duke u bazuar në nenin 11 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe ligjeve tjera përkatëse në fuqi pas parashtrimit të kërkesës Nr.01.016-16493 me dokumentet përcjellëse ( planin ideor, planin e biznesit, certifikatën e regjistrimit të biznesit etj.) me datën 15.05.2024 nga investitori Mehmet Imeraj "RINA COMERC" SHPK për marrjen në shfrytëzim afatgjatë me negociim, pronat e paluajtshme e komunës, nga Njësia Kadastrale P-70806016-00067-1, me sipërfaqe prej 3650 m<sup>2</sup> nga sipërfaqja e përgjithshme prej 17404 m<sup>2</sup>, në vendin e quajtur "Terezi" Zona Kadastrale-Gjurakoc e cila sipas certifikatës pronësore është e evidentuar Komuna e Istogut dhe Njësia Kadastrale P-70806016-00069-1 sipërfaqe prej 350 m<sup>2</sup> nga sipërfaqja e përgjithshme prej 42060 m<sup>2</sup>, në vendin e quajtur "Terezi" Zona Kadastrale-Gjurakoc e cila sipas certifikatës pronësore është e evidentuar Komuna e Istogut, Zona Kadastrale-Gjurakoc, të cilat i jepen në shfrytëzim afatgjatë me negociim investitorit Mehmet Imeraj "RINA COMERC" SHPK, me seli në Gjurakoc, Komuna e Istogut

Sipas projektit ideor-planit të biznesit dhe sipas negociatave investitori planifikon që në pronat e lartcekura të ndërtojë një qendër multifunkionale, përkatësisht një objekt me sipërfaqe prej 3100 m<sup>2</sup>, hapësira të parkingut në të cilin do të shërbehen mallra dhe asortimentet e të gjitha kategorive, përpunimi i mishit, prodhimi i ëmbëlsirave të ndryshme, prodhim i pjekurinave, shërbime gastronomie, me qëllim të plotësimit të kërkesave dhe nevojave të qytetarëve përmes ofrimit me çmime më të lira të tregut. Kohëzgjatja e investimeve deri në përfundimin e saj të plotë do jetë 3 deri në 4 vite pas nënshkrimit të kontratës. Përveç rritjes së vlerës së Pronës së paluajtshme të Komunës sipas

projektit ideor do të gjenerohen edhe vende të reja të punës ku pritet të punësohen 80 persona si dhe krijimi i tregut për fermerët vendor për shitjen e produkteve të tyre në këtë qendër tregtare

Me qëllim të realizimit të interesit publik, rritjes së vlerës së pronave të komunës, krijimit të të hyrave vetanake në një rën anë dhe ofrimit të kushteve për krijimin e vendeve të reja të punës në anën tjetër përmes bërjes së politikave të punësimit, propozohet dhënia në shfrytëzim e pronave të paluajtshme të Komunës investitorit të lartcekur siç përcaktohet në nenin 1 të këtij propozim-Vendimi andaj kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

**Kryetari i Komunës  
z. Ilir FERATI**





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut  
Opština Istok  
Municipal of Istog

Datë :17.07.2024

## Oferta e Negociuar e Kryetarit të Komunës me investitorin Mehmet Imeraj “ Rina Comerc”

Investitori Mehmet Imeraj pronar dhe përfaqësues i “ Rina Comerc “ SHPK, më datë ka parashtruar kërkesën Nr. 01-016-16403 e datës 15.05.2024 drejtuar Kryetarit të Komunës z. Ilir Ferati për marrjen në shfrytëzim afatgjatë me negociim pronat e paluajtshme e komunës, Njësia Kadastrale P-70806016-00067-1, sipërfaqen prej 3650 m<sup>2</sup> nga sipërfaqja e përgjithshme prej 17404 m<sup>2</sup>, në vendin e quajtur “Terezi” Zona Kadastrale-Gjurakoc e cila sipas certifikatës pronësore është e evidentuar Komuna e Istogut dhe nga Njësia Kadastrale P-70806016-00069-1 sipërfaqen prej 350 m<sup>2</sup> nga sipërfaqja e përgjithshme prej 42060 m<sup>2</sup>, në vendin e quajtur “Terezi” Zona Kadastrale-Gjurakoc e cila sipas certifikatës pronësore është e evidentuar Komuna e Istogut, Zona Kadastrale-Gjurakoc.

Pas pranimit të kërkesës për marrjen në shfrytëzim me negociim të pronave për njësitë kadastrale të lartcekura u realizuan takime ndërmjet Kryetarit të Komunës z. Ilir Ferati dhe investitorit z. Mehmet Imeraj, ku të pranishëm kanë qenë edhe Drejtori i Drejtorisë për Kadastër dhe Gjeodezi z. Agon Dreshaj, Drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim Urban dhe Mjedis z. Dukagjin Hoxhaj, Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa si dhe Ekonomi e Zhvillim z. Genc Ademaj dhe Drejtori i Drejtorisë të Inspektionit z. Kushtrim Buleshkaj.

Investitori në këto takime prezantoi planin e biznesit dhe projektin ideor për mënyrën e shfrytëzimit të pronës së komunës me negociim sipas të cilit qëllimi i investimit është ndërtimi i një qendre multifunkionale ku do të shërbehen mallra dhe asortiment të te gjitha kategorive, përpunimi i mishit, prodhimi i ëmbëlsirave të ndryshme, prodhim i pjekurinave dhe shërbime të ndryshme gastronomie.

Përveç qëllimit të cekur më lartë të këtij investimit pika tjera kryesore të diskutimit për ofertën e negociuar ishin:

- **Investimet në objekt:** Objekti 3100 m<sup>2</sup> dhe hapësira e parkingut si dhe në të ardhmen përshtatja në bazë të nevojave të tregut në hapësirat ekzistuese
- **Objektivat e investitorit** të cilat synohen të arrihen përmes marrjes në shfrytëzim me negociim të pronës së komunës: plotësimi i kërkesave të konsumatorëve në sektorin e tregtisë dhe mysafirëve në sektorin e gastronomisë në përputhje të plotë me nevojat dhe pritjet e tyre në kuptimin e ofrimit të mallrave cilësore dhe në asortiman sa më të gjerë si dhe produkteve dhe shërbimeve të gastronomisë, produkteve ushqimore dhe shërbimeve të restoranteve si dhe kateringut.

Rritja e qarkullimit dhe shitjes përmes plasmanit të mallrave tregtare, të produkteve dhe shërbimeve të gastronomisë, ëmbëlsirave, mishit dhe furrës edhe më fuqishëm në kapacitetet e reja të planifikuara përmes plasmanit më të mirë të mallrave në stoqe dhe qarkullim si dhe të kapaciteteve të gastronomisë dhe furrës;

Shfrytëzimi më i mirë i formave të reja të shitjes në tregtinë me shumicë përmes bashkëpunimit më nivelin e shitjes me pakicë dhe klientët përhershëm.

- **Vlera dhe qëllimi i investimit** – investimi do të jetë 2.000.000,00 deri në 2.100.000,00. Rritja e aftësisë konkurruese dhe pozicionimi më i mirë i kompanisë përmes shfrytëzimit optimal të kapaciteteve dhe të gjitha resurseve në të tri repartet: në tregti, gastronomi, prodhimin e bukës dhe pjekurinave, prodhimin e ëmbëlsirave si dhe përpunimin e mishit duke rritur në mënyrë të fuqishme qarkullimin, të hyrat dhe profitin; hapja e mbi 80 vendeve të reja të punës, interaktiviteti dhe lidhja me fermerët vendor, nevoja e komunitetit në raport me afërsinë e nevojave të tyre, rritja e imazhit të lokacionit, investime në energji të gjelbër.

- **Kohëzgjatja e investimeve:** 3-4 vjet nga nënshkrimi i kontratës

Pas prezantimit të planit ideor dhe atij të biznesit u arrit pajtimi që ndërmerren të gjitha veprimet e nevojshme ligjore të përcaktuara në Ligjin për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores për përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës me qëllim të dhënies në shfrytëzim afatgjatë me negociim pronat e paluajtshme të komunës të cekura më lartë.

Sipas negociatave komisioni vendosi që shuma e qirasë për investitorin lidhur me shfrytëzimin afatgjatë me negociim të pronave të paluajtshme të komunës të jetë 1800 € ( një mijë e tetëqind ) euro në vit dhe të jepet në kohëzgjatje prej 40 vite.

Për Komunën e Istogut:

Kryetari, z. **Ilir Ferati**

Më: 17/07/2024

Për "Rina Comerc" SHPK:

Investitori, z. **Mehmet Imeraj**

Më: 17/07/2024

Për: Kryetarin e komunes z. Ilir Ferati

Nga: 'RINA COMERC', shpk, 810034330, Mehmet Imeraj

Datë: 14.05.2024



## KËRKESË

I nderuari kryetar

Kompania 'RINA COMERC' SHPK me numër të biznesit veprimtari kryesore ka:

Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara, ku mbizotëron ushqimi, pijet dhe duhani, restourantet dhe aktivitetet tjera shërbyese lëvizëse të ushqimit

Me qëllim të zhvillimit ekonomik të palëve të interesit dhe hapjes së reja të vendeve të punes ne si kompani kërkojm nga komuna e Istogut-Kryetari i komunës që të na mundësohet dhënia në shfrytëzim për periudhë afatgjatë e pronës së komunes me negociim direkt, parcela P-70806016-00067-1 me sipërfaqe prej 3650 m2 si dhe pjesen e sipërfaqes, parcela P-70806016-00069-1 me sipërfaqe prej 350 m2 në Zonën Kadastrale të Gurrakocit ashtu siç e parasheh Ligji për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

Në këtë parcelë ne si kompani kemi planifikuar të bëjmë ndërtimin e objektit dhe infrastrukturës përcjellëse për realizimin e aktivitetit afarist biznesor për të cilin më teper detale janë të paraqitura në planin biznesor dhe në planin ideor.

Vlera e investimit do të jetë rreth 2,000.000.00 euro dhe fillimisht pritet të punësohen rreth 80 punetore dhe gjithmonë duke u rritur numri i të punësuarve në të ardhmen.

Kërkeses i bashkëngjisim:

**Planin ideor**

**Planin e biznesit**

**Çertifikatën dhe informatat e regjistrimit të biznesit**

**Fletat poseduese për parcelat 67-1 dhe 69-1**

**Kopjet e planit për parcelat 67-1 dhe 69-1**

**Situacionin për njësitë kadastrale 67-1 dhe 69-1**

**Qarkullimin bankar**

**Vërtetimin e obligimeve komunale**

TEL: 048505050





Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë  
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

ARBK

AGENCIA E REGJISTRIMIT TË BIZNESIT NË KOSOVË  
KOSOVARSKA AGENCIJA ZA REGISTRACIJE BIZNISA  
KOSOVA BUSINESS REGISTRATION AGENCY

CERTIFIKATË E REGJISTRIMIT  
CERTIFIKAT O REGISTRACIJI  
CERTIFICATE OF REGISTRATION

810034330

Numri Unik Identifikues / Jedinstveni Matični Broj / Unique Identification Number

Rina Comerc SH.P.K.

Emri biznesit / Naziv biznisa / Name of business

///

Emri tregtar / Trgovačko ime / Commercial name

Lloji biznesit:  
Poslovni tip:  
Business type:

Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar  
Društvo sa ograničenom odgovornošću  
Limited Liabilities Companies

Adresa:  
Adresa:  
Address:

Rruga Bardh Isufi, pn  
Banjë  
Istog

Data e regjistrimit:  
Datum registracije:  
Date of registration:

19/06/2017

07/03/2022

Data / Date / Datum





Nënshkrimi / Signature / Potpis

Nr. ser. / Ser. br. / Ser. No.: 10133720





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of  
Komuna e ISTOG / Opština ISTOK / Municipality ISTOG



Bazuar në nenin 18 të ligjit 03/L-204 për tatimin në pronë, si dhe udhëzimit administrativ nr. 7/2011 të lëshuar nga MF, i cili ka të bëjë me urdhëresat e ndalimit të shërbimeve komunale për detyrim të pagesës së tatimit në

Na osnovu člana 18, zakona 03/L-204 za poreza na imovinu i administrativne uredbe MF br. 7/2011, u vezi zabrane opštinskih usluga za prinudu uplate poreza na imovinu, izdaje se ova:

Based on the article 18 of LAW 03/L-204 on property tax and administrative instruction MF no. 7/2011 on termination of services for enforcement of the municipal property tax, the municipal Property Tax Office

Nr / Br / No

91213852373

13/05/2024

## VËRTETIM POTVRDA CERTIFICATE

Me të cilin vërtetohet se tatimpaguesi  
Kojim se potvrđuje da je poreznik  
that certifies that taxpayer

MEHMET IMERAJ

ISTOG

Komuna / Opština / Municipality

ISTOG RINA COMERC SHPK

adresa / adresa / address

I ka kryer pjesërisht / plotësisht obligimet e tatimit në pronë  
Delimično/ izvršio uplatu poreskih obaveza  
has partially / fulfilled obligations on property tax

MEHMET IMERAJ RINA COMERC

Vërtetimi lëshohet në bazë të kërkesës së / Potvrda se izdaje na zahtev / Certificate is issued by

Për nevoja personale

dhe shërben për / i služi za / and is used for

AFATI:30.12.2024

Shënime shtesë / Druge podatke / Additional info

Nenshkrimi / Potpis / Signature





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government



Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministerstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure  
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

## CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70806016-00069-1

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:

1579/2024

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:

13.05.2024 - 13:55

Komuna / Opština / Municipality:

ISTOG / ISTOK / ISTOG

Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:

Gjurakoc / Đurakovac / Gjurakoc

Zyrtar Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:

ISTOG / ISTOK / ISTOG

### A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R GIS U/R	Sipërfaqja Površina Area (m <sup>2</sup> )	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70806016-00069-1	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land		42060			

### A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
TEREZI				



**A.2 LLOJTI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE**

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcelë Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcelë Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kualiteti Klasse Quality Class	Sipërfaqja (m <sup>2</sup> ) Površina (m <sup>2</sup> ) Area
1	Bujqësore/Pojipori/vredho/Agriculture	Kullosë/Pashnjaci/pasture	Kullosë E Klasës 2/Pashnjak 2 Klasse/2nd Class Pasture	41958
2	Tokë Ndërtimore/Građevnisko zemljište/Construction land	Shëqepi-Ndërtues/Kuca-Zgrada/House-Building		102

**B. PRONARI/POSEDEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR**

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licenç broj ID. No.	Vendbanimi Prethvaliste Resident	Kodi postel Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Azurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	Komuna e Istogut	680413629	ISTOG / ISTOK / ISTOG /		FADIL FERATI	1/1		17.12.2018





Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government



Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësior dhe Infrastrukturës / Ministerstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure  
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70806016-00067-1

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:

1579/2024

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:

13.05.2024 - 13:55

Komuna / Opština / Municipality:

ISTOG / ISTOK / ISTOG

Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:

Gjurakoc / Đurakovac / Gurrakoc

Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:

ISTOG / ISTOK / ISTOG

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit No.	Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m <sup>2</sup> )	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan	Azhuruar Azurirano Updated
P-70806016-00067-1	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land		17404			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
TEREZI				



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVES / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MUESIT, PLANIFIKIMIT HAPESINOR DHE INFRASTRUKTURES  
MINISTARSTVO ZIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE


MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGENCIA KADASTRALE E KOSOVES / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / CADASTRAL AGENCY

**KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN**

Zyra Kadastre Komune/ Opštinska Katarstarka Kancelarija / Municipal Cadstral Office : ISTOG  
Zona Kadastre / Katarstarka Zona / Cadstral Zone: Gjurakoc


Njësia/Jednica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Površina/Area m²
P-70806016-00069-1	Parcelë / Parcela / Parcel	42080
P-70806016-00067-1	Parcelë / Parcela / Parcel	17404



Puno/Obradio/Created: Naim Demaj  
Nënshkrimi/Potpis/Signature:  
Shënim/Beleshka/Note:



Data/Data/Date: 13.05.2024  
Koha/Vreme/Time: 02:00:49



**TITULLI**

Situacion Terreni

**LEGJENDA**

Pjesë nga parcela me nr. 67-1 me sip=3778m dhe Pjesë nga parcela nr. 69-1 me sip=350m ne Z.K. Gurrakoc, Rrugë - gjendje faktike

Parcelë

**Objekt - Bashkësa e Ujrave**

(Sipërfaqe e përcaktuar ne terren sipas kërkesës së shtyrëzuesit: Rina Markel)

**Lokacioni**

Komuna: Istog  
Zona kadastrale: Gurrakoc  
Parcela nr: 67-1 dhe 69-1

Sistemi koordinativ: KosovareF01

**Punoj**

inxh. Zeke Ibrahimaj Lic. nr.: 50

Data e rievimit: 29.11.2023

Shkalla: 1:750

**KONTAKT**


— 044 276 506  
— zekibrahimaj@hotmail.com





TITULLI	
Situacion Terreni	
LEGJENDA	
<input type="checkbox"/>	Pjesë nga parcela me nr. 67-1me sip=3778m dhe pjes nga Parcela nr.69-1 me sip=350mme ZK Gurrakoc
<input type="checkbox"/>	Rrugë - gjendje faktike
<input checked="" type="checkbox"/>	Parcelë
<input type="checkbox"/>	Objekt - Bashkia e Ujave
(Sipërfaqe e përcaktuar në terren sipas kërkesës së shtyftëzuesit: Rina Markel)	
Lokacioni	
Komuna: Istog	
Zona kadastrale: Gurrakoc	
Parcela nr: 67-1,69-1	
Sistemi koordinativ: Kosovaref01	
Pardhi	
inxh. Zeke Ibrahimaj, Lic. nr.: 50	
Data e hartimit	29.11.2023
Shtet	V.V
1:750	
CONTACT	
— 044 276 506	
— zekibr Ibrahimaj@hotmail.com	

Situacioni me paraqitje horizontale per pjeset e njesive kadastrale nr. 67-1 dhe 69-1 -  
Lokacioni ish Bashksia e Ujrave ne Gurrakoc



Istog  
me 25.09.2020

E Punoi  
Inxh. Zeke Ibrahimaj  
gjeodet i licencuar

RINA COMERC SHPK

# PLAN BIZNESI



Kosovë, Istog-Gurrakoc

E-mail: [info@rinamarket-ks.com](mailto:info@rinamarket-ks.com)

tel: 048505050

## Qëllimi i Planit të Biznesit

### Hyrje

Në rrethanat e ekonomisë së tregut dhe konkurrencës së lirë, plani i biznesit është element qenësor në arritjen e suksesit dhe përmbushjes së objektivave biznesore. Në shumicën e rasteve plani i biznesit shërben si mjet komunikues për zgjerimin e kapaciteteve ekzistuese, shërben për rritje të numrit të vendeve të punës, shërben për orientimin e duhur të mjeteve financiare në dispozicion, shërben për orientimin e duhur të kapacitetve njerëzore në drejtim të shfrytëzimit sa më efikas të burimeve të ndryshme financiare dhe njerëzore. Edhe në rastin konkret, "RINA COMERC" shpk në Gurrakoc të komunës së Istogut krahas shfrytëzimit për zgjerimin e aktiviteteve afariste me këtë plan biznesi do të mund të drejtohet edhe për shfrytëzimin sa më adekuat të rritjes së numrit të punësuarve, të rritjes së bashkëpunimit afarist me partnerët afarist bujq me qëllim të përmbushjes së planit strategjik të saj si dhe me qëllim të rritjes së kontributit social në rrethinë.

Bazuar në faktin se institucionet financiare ofrojnë mundësi të diferencuara për mjetet e tyre financiare ato përcaktojnë kushtet dhe mundësitë e shfrytëzimit të këtyre mjeteve nga operator ekonomik të sektorëve të ndryshme të cilët përmes planeve të biznesit prezantojnë mundësitë dhe arsyetojnë storien e suksesit të tyre që presin. Plani ynë i Biznesit, përshkruan dhe arsyeton storien tonë të suksesit dhe rritjes të pritur të biznesit të "RINA COMERC" shpk në fazat e zhvillimit të këtij Plani të Biznesit. Analiza e bërë nga ekipi i përbashkët, nga manaxhmenti dhe kompania e konsulencës profesionale kemi identifikuar pikat e forta dhe të dobëta në të gjitha aspektet relevante dhe kemi ardhur në përfundim se kompania ka mundësi të mira për të përmbushur objektivat e sajë strategjike në zgjerimin e aktiviteteve afariste si dhe në ndikimin potencial për rrethinën ku planifikohet të shtrihen investimet përmes investimeve të planifikuara.



## Objektivat Strategjike dhe metoda e përdorur

Në suazat e Planit të Biznesit të "RINA COMERC" shpk përcaktohen këto objektiva strategjike:

1. Rritja e aftësisë konkurruese dhe pozicionimi më i mirë i kompanisë përmes shfrytëzimit optimal të kapaciteteve dhe të gjitha resurseve në të tri repartet: në tregti, gastronomi, prodhimin e bukës dhe pjekurinave, prodhimin e ëmbëlsirave si dhe përpunimin e mishit duke rritur në mënyrë të fuqishme qarkullimin, të hyrat dhe profitin;
2. Rritja e qarkullimit dhe shitjes përmes plasmanit të mallrave tregtare, të produkteve dhe shërbimeve të gastronomisë, ëmbëlsirave, mishit dhe furrës edhe më fuqishëm në kapacitetet e reja të planifikuara përmes plasmanit më të mirë të mallrave në stoqe dhe qarkullim si dhe të kapaciteteve të gastronomisë dhe furrës;
3. Shfrytëzimi më i mirë i formave të reja të shitjes në tregtinë me shumicë përmes bashkëpunimit më nivelin e shitjes me pakicë dhe klientete përhershëm;

Përveç këtyre objektivave strategjike në kuadër të planit përcaktohen edhe objektivat specifike:

- a. Ngritja e nivelit organizativ dhe manaxhues të kompanisë,
- b. Definimi i formave adekuate dhe profitabile të plasmanit të mallrave në kaudër të tregtisë si dhe produkteve e shërbimeve në gastronomi konform kërkesës në treg dhe trendeve në shembujt më të mirë në rajon dhe më gjerë;
- c. Identifikimi dhe përcaktimi i instrumenteve më adekuate për tu orientuar kah tregjet dhe segmentët e targetuara të konsumatorëve;
- d. Identifikimi i konkurrencës dhe ndikimit të tyre në tregun lokal dhe rajonal më ndikim në afarizmin e Kompanisë.

Përmes këtij plani definohet dhe përcaktohet politika adekuate e manaxhimit, organizmit funksional të biznesit, resurset e nevojshme njerëzore, kualifikimi dhe trajnimi i tyre i domosdoshëm, analiza financiare, analiza e tregut dhe e konkurrencës, marketingut dhe shitjes, trajtimi i aspekteve teknike dhe teknologjike, e gjithë kjo me qëllim të orientimit dhe koordinimit të masave zhvillimore, operative, organizative dhe manaxhuese në drejtimin e dëshiruar dhe të objektivave të përcaktuara të "RINA COMERC" shpk.

## Objektivat Kryesore të Planit të Biznesit

Objektivat kryesore të këtij plani të biznesit janë definuar mjaftë qartë në kuadër të përmbajtjes së orientimeve zhvillimore dhe objektivave zhvillimore të kompanisë përmes ngritjes së standardeve dhe efikasitetit të kapaciteteve ekzistuese si dhe zhvillimit të kapaciteteve të reja të produkteve dhe shërbimeve të ndryshme, identifikimit të nevojës për funksionet e manaxhimit profesional, nevojave për resurse humane, organizimit më të mirë dhe funksionalizimit të afarizmit, si dhe gjetjes së segmenteve të reja të konsumatorëve, tregjeve më adekuate, përcjellja e konkurrencës, përcaktimi i strategjive të marketingut dhe shitjes si dhe kalkulimit të mjeteve të nevojshme financiare – Planit Financiar. Të gjitha këto qëllime të përcaktuara qartë do të arrihen përmes shfrytëzimit të përvojave më të mira pozitive dhe angazhimit të konsulencës profesionale, si në fazën e planifikimit, ashtu edhe në fazën e implementimit të objektivave zhvillimore.

## Objektivat Kryesore të kompanisë “RINA COMERC” shpk

Objektivat kryesore të “RINA COMERC” shpk janë:

- Fitimi i besimit të klienteve si dhe bashkëpunimi sa më adekuat me rrethinen ku plaifikojë të nderveprojë kompania
- Plotësimi i kërkesave të konsumatorëve në sektorin e tregtisë dhe mysafirëve në sektorin e gastronomisë në përputhje të plotë me nevojat dhe pritjet e tyre në kuptimin e ofrimit të mallrave cilësore dhe në asortiman sa më të gjerë si dhe produkteve dhe shërbimeve të gastronomisë, produkteve ushqimore dhe shërbimeve të restorantërisë si dhe kateringut.
- Përpjekjet për shfrytëzimin optimal të gjitha kapaciteteve në të dy sektorët:
  - Qarkullimi në sektorin e tregtisë në nivelin e 70% të kapaciteteve të ndërtuara, të pajisura dhe të furnizuara me kujdes;
  - Shfrytëzimi i kapaciteteve të ndërtuara, të pajisura dhe të funksionalizuara të gastronomisë, në rreth 45% gjatë vitit dhe rreth 70% gjatë sezonit të pranverës/verës, në një shkallë prej 55% në nivel të vitit të parë , me tendenca të rritjes së ndjeshme në vitet në vazhdim.
- Organizimi adekuat në të gjitha nivelet në përputhje me kërkesat e një biznesi bashkëkohor dhe cilësor.
- Sigurimi i stafit të kualifikuar dhe trajnimi i tyre në të gjitha nivelet.

## Burimi i kapitalit dhe investimet fillestare

Duke pasur parasysh kompleksitetin e çdo ndërmarrje investive si dhe ndjeshmërinë nga shumë faktor të brendshëm dhe të jashtëm si dhe nevojën e ngritjes së nivelit dhe përmbajtjes së biznesit ekzistues investitori ka bërë analizat paraprake përkrahur nga konsulenca profesionale dhe ka vendosur të planifikoi me investimet zhvillimore. Sigurimi i mjeteve investive do të bëhet nga operacionet aktuale biznese, nga kapitali vetanak i pronarit si dhe nga marrja e huave nga bankat aktuale që operojnë në Kosovë.

Qëllimi i këtij plani të biznesit është që ti shërbej investitorit si bazë e mirë e shtrimit të parametrave të besueshëm ekonomik në raport me kërkesat e investitorëve potencial si dhe në raport me institucionet financiare dhe ato qeveritare. Në fillim, në zgjerimin e veprimtarisë ekzistuese të punëve në ndërtimin e Qendrës së re “RINA COMERC” shpk si dhe në periudhën e funksionimit të kapaciteteve të para kompania llogaritë në rezultate dhe të hyra të shtuara si dhe në akumulim më të madh të mjeteve investive nga profiti dhe mjetet e amortizimit. Në fazën e parë deri të arritja e kufirit të rentabilitetit kompania do të shfrytëzoi dhe mbështetët në mjete të konsideruara të vetëfinancimit si dhe në huazimet e mundshme më të volitshme nga partnerët dhe bankat përkrahëse por edhe nga kreditë më të mëdha nga bankat. Gjithsesi do të bëhen përpjekje të vazhdueshme të mbështetjes së zhvillimit të kapaciteteve të reja duke hulumtuar dhe shfrytëzuar kredi nga institucionet financiare ndërkombëtare që funksionojnë në Kosovë.

### **Rëndësia e lokacionit për ndërtimin e kapaciteteve të reja**

Të motivuar nga rezultatet pozitive të biznesit ndonëse në rrethana mjaftë konkurruese në rajonin më të gjerë duke krijuar një përvojë dhe reputacion mjaftë pozitiv porse duke shfrytëzuar boshllëkun konkurrues në afërsi relative investitori ka vendosur të ndërtoi kapacitetet e reja tregtare dhe të gastronomisë në një lokacion mjaftë atraktiv dhe frekuentues në Gurrakoc-Istog.

Pozicioni i planifikimit të investimeve të “RINA COMERC” shpk mundëson bashkëpunim dhe partneritet të rëndësishëm me komunitetin dhe prodhuesit lokal gjë që ndikon në ngritjen e interesit të dyanshëm të shfrytëzimit më të madh të produkteve lokale dhe vendore.

### **Misioni i Kompanisë**

Duke ngritur nivelin dhe kapacitetet shërbyese të tregtisë dhe gastronomisë që u përgjigjen nevojave dhe kërkesave të konsumatorëve kompania do të ndërtoi brendin e saj të bazuar në ofrimin e mallrave dhe shërbimeve më cilësore duke u përpjekur që pozicionin e saj më të volitshëm në treg ta ndërlihdë me përgjegjësinë sociale si dhe me mirëenienë e zhvillimit ekonomik të rrethines ku vepron.

### **Vizioni i Kompanisë**

Qëllimi jonë është që të jemi partnerët më të besueshem për klientet tanë, të jemi një staf sa më profesional dhe i motivuar si dhe të ruajmë vlerat tona siq janë: integriteti, imazhi si dhe fokusi tek klienti.

## **Caqet zhvillimore të Biznes Planit për kompaninë**

Përmes këtij biznes plani dhe orientimeve zhvillimore qëllimi është që në mënyrë analitike të prezantohen kahet dhe orientimet, për të arritur qëllimet e përcaktuara strategjike dhe të tjera të kompanisë duke u mbështetur fillimisht në burimet vetanake për investimet parainvesticionale

duke pasur për objektiv animimin dhe përkrahjen e partnerëve, institucioneve financiare ndërkombëtare dhe bankave partnere vendore si dhe duke marrë përkrahjen ose mirëkuptimin e institucioneve lokale dhe qendrore. Kështu, përmes këtij plani, janë prezantuar këto objektiva themelore të kompanisë RINA COMERC shpk,:

- Harmonizimi i zhvillimit të kompanisë me kahet zhvillimore efëiente lokale, rajonale dhe vendore duke pasur parasysh trendët e interesave dhe kërkesave të konsumatorëve, aktualisht dhe në periudhën afatmesme zhvillimore;
- Identifikimi i kaheve aktuale dhe afatmesme zhvillimore përmes konceptimit dhe aplikimit të formave optimale zhvillimore duke ecur në rrugën e drejtë vetanake për dallim nga stereotipet e konkurrencës;
- Sigurimi që investimi në vlerë të planifikuar në kohëzgjatje prej dy viteve prej **1.497.997,40€ investim në objekt dhe mjete themelore, 150.000,00 në panele solare dhe 500.000,00 investim në mallra** të jetë i orientuar sa më në mënyrë efëiente në funksion të harmonizimit të duhur të këtij plani biznesi ;
- Përmes përvojave vetanake dhe shërbimeve të konsulencës, kompania do të siguroj:
  - Identifikimin dhe përcaktimin e qëllimeve dhe objektivave zhvillimore,
  - Harmonizimin e zhvillimit me kërkesat dhe trendët në treg gjithsesi edhe me qëllimet zhvillimore në rajon dhe nivel të vendit;
  - Kontrolli dhe përcjellja e zhvillimit të Kompanisë, drejtimi i rrjedhave zhvillimore në bazë të formave më efikase të afarizmit – rritës së të hyrave dhe profitit në të gjitha kapacitetet ekzistuese dhe ato që do të zhvillohen në kontekst të këtij plani;
- Aplikimi i standardëve të larta në formësimin dhe plasmanin e mallrave, produkteve dhe shërbimeve duke shfrytëzuar përvojat pozitive në rajonet e ngjashme në nivel të lakmuar zhvillimor.

Përveç shërbimeve të furnizimit me asortiman të kërkuar të mallrave, “RINA COMERC” shpk planifikon që të ofrojë zgjedhje më të gjerë të asortimanit të mallrave tregtare si dhe nivel të lartë të produkteve dhe shërbimeve të gastronomisë cilësore, relaksimit dhe kënaqjes së fëmijëve në këndin e lodrave gjithsesi edhe me mundësi më të mëdha të trajnimit të stafit të sektorëve të afarizmit si dhe mundësinë e hapjes së bizneseve të reja familjare nga palët e tjera në kuader të lokacionit të planifikuar. Në bazë të këtij plani në kuadër të “RINA COMERC” shpk, porse edhe në kuadër të kapaciteteve ekzistuese përmes fuqizimit dhe profesionalizimit të nivelit organizativ dhe manaxhues, pranimit të stafit të ri të trajnuar dhe profilizuar, atraktivitetit dhe vlerave të lokacionit dhe ambientit përreth, asortimani dhe cilësia e mallrave, shërbimeve dhe produkteve, konform standardëve të njohura të tregtimit dhe gastronomisë, do të mundësoi diferencimin pozitiv të biznesit, si atij tregtar ashtu edhe atij të gastronomisë. Kjo do mundësoi pozicionim më të favorshëm përballë trendëve të gjertanishme të zhvillimit të bizneseve konkurrenente të vendosura dhe të zhvilluara pa analiza paraprake dhe koncepte të bazuara kryesisht duke kopjuar nga bizneset stereotipe ndonësë mjaftë prezentë në nivel rajonal. Edhe në kushte të tilla dhe gjithsesi të konkurrencës kompania do të respektoi çdo formë të konkurrencës së ndershme si dhe do të përcjellë ecuritë e zhvillimit të biznesit të tyre në favor dhe kënaqësi të biznesit dhe rrethines ku kompania vepron.

## **Menaxhimi dhe Organizimi i funksioneve dhe resurseve**

Përmes skemës organizative bëhet identifikimi dhe lidhja e komunikimit të roleve, përgjegjësi, dhe linjave të autoritetit organizativ dhe veprues në “RINA COMERC” shpk me qëllim të përmbushjes të qëllimeve strategjike të kompanisë.

### **KONCEPTI PLANIT ZHVILLIMOR TË “RINA COMERC” shpk**

“RINA COMERC” shpk vazhdon të operoj sukseshem në hapsirat ekzistuese, tashmë, “RINA COMERC” shpk numëron 200 punëtor si dhe planifikon të zgjerohet në fazat fillestare edhe me 80 punëtor të rinjë në kuader të investimeve të planifikuara në repartin tregtar, në repartin e gastronomisë si dhe në repartin e prodhimit.

Potencialin kryesor të konsumatorëve në qendren e re të planifikuar investive e përbëjnë: banorët e komunës së Istogut, Gurrakocit si dhe një numri të madh të fshatrave të përreth Gurrakocit si dhe një numer i konsiderueshem i udhëtarëve në transit.

Duke marrë parasysh rajonin e Gurrakocit dhe rrethines të njohur për agrikulturë, në veçanti për prodhimin e pemëve dhe perimeve si dhe pasurisë së madhe të bjeshkëve përreth me fruta malore, një segment i Qendrës mund të orientohet në partneritet me komunitetin dhe bizneset lokale. Këtu në rend të parë vjen në shprehje partneriteti në grumbullimin, përpunimin dhe plasmanin e produkteve bujqësore dhe frutave malore.

Pra, duke marrë parasysh edhe faktin së në rrethin e ngushtë dhe të mesëm nuk ka ndonjë konkurrencë të theksuar, pozicionimi i “RINA COMERC” shpk në lokacionin e propozuar do të ketë një potencial të mjaftueshëm dhe në rritje për afarizmin e qendrës.

## **Definimi i njësive funksionale dhe kapaciteteve të reja të “RINA COMERC” shpk**

- 1. Sipërfaqja e hapësirës së Furrës së bukës dhe pjekurinave 150m<sup>2</sup>**
- 2. Sipërfaqja e kuzhinës 30 m<sup>2</sup>**
- 3. Sipërfaqja e Restorantit dhe terasave 300m<sup>2</sup>**
- 4. Sipërfaqja e përpunimit të mishit 200 m<sup>2</sup>**
- 5. Sipërfaqja e grumbullimit të pemëve dhe perimeve nga bujqit 100 m<sup>2</sup>**
- 6. Lokalet Afariste 222 m<sup>2</sup>**
- 7. Sipërfaqja e tërësishme e Marketit me depon dhe hapësirat përreth**
  - 7.1. Sipërfaqja e hapësirave shitëse të gjitha mallrave 2070m<sup>2</sup>**
  - 7.2. Sipërfaqja e hapësirave të depove ushqimore dhe jo-ushqimore 100m<sup>2</sup>**

## **Definimi i njësive funksionale dhe kapaciteteve të reja të biznesit të planifikuar**

- 1. Sipërfaqja e tërësishme e lokacionit 4000m<sup>2</sup>**
- 2. Sipërfaqja e parkingut të Qendrës 900 m<sup>2</sup>**


**Gjate kalimit të kohës përshtatja e objektit mund të bëhet në bazë të nevojave të tregut.**

## Përmbajtja e Skemës Organizative të Kompanisë

### Definimi i njësive operative dhe projekcioni i resurseve njerëzore

- Projekcioni i Strukturës Manaxhuese dhe Koordinative
- Projekcioni i Strukturës Operative

#### Struktura organizative e “RINA COMERC” shpk



## **ANALIZA E TREGUT**

### **Faktorët e Jashtëm dhe Ndikimi i tyre në afarizmin Tregtar dhe të Gastronomisë**

Ekonomia e Kosovës aktualisht ka një ritëm të rritjes graduale dhe inflacion të ultë, të cilat janë një prej parakushteve që motivojnë investimet në themelimin dhe zhvillimin e bizneseve. Aktualisht përpjekjet dhe kujdesi ndaj rritjes së cilësisë së shërbimeve dhe kujdesi ndaj konsumatorit krahas rritjes së knaqësisë së tyre është çështja të cilës duhet ti përkushtohet vëmendje e posaçme në vendin tonë.

Operatori ekonomik "RINA COMERC" shpk synon që me investimin e planifikuar në zgjerimin e kapaciteteve afariste të forcoj akoma më shume pozicionin e tij në treg me një gamë të zgjëruar të shërbimeve dhe produkteve të përcaktuara në objektivat e tij strategjike. Krahas ofrimit të shërbimeve tregtrare dhe gastronomisë është planifikuar që të hyra financiare të ketë edhe nga programi i përpunimit dhe konservimit të frutave bujqësore.

Situata politike e tanishme e vendit vështruar në nivelin vendi, rajoni dhe me gjërë tregon se në të ardhmën e afërt do të ketë rritje të investimeve dhe të zhvillimit ekonomik. Komuniteti nderkombëtar përmes granteve, dhe formave tjera financiare kanë rritur interesimin e tyre për të investuar në sektor të caktuar të ekonomisë kosovare. Po ashtu edhe interesimi i investitoreve potencial në Kosovë është i vazhdueshëm, për depërtimin në tregjet e reja, përfshirë edhe tregun e shërbimeve dhe produkteve të cilat synon ti zhvilloi "RINA COMERC" shpk.

#### **Pozita Gjeografike dhe Vlerat e Lokacionit**

Aktivitetet afariste, të cilat është duke i zhvilluar "RINA COMERC" shpk aktualisht ( në Zallq), rruga Klinë-Istog si dhe zgjerimin e kapaciteteve për të cilat po planifikohen nga kompania kanë pozicion mjaftë të përshtatshëm vështruar nga aspekti gjeografik. Projekti i ri i planifikuar, është në Gurrakoc të Istogut e cila pozitë lidh qytete të ndryshme si: Istogu, Klina, Peja dhe Mitrovica.

#### **Faktorët Politik dhe Juridik**

Për të ndikuar në faktoret Juridik dhe Politik si dhe për tu përshtatur rrethanave të ekonomisë së tregut, gjithësesi duhet të hartohen dhe zbatohen ligje të favorshme që mundësojnë zhvillimin ekonomik të vendit. Kosova në mbështetje edhe të faktorit nderkombëtar ka avansuar në aprovimin e legjislacionit më të favorshëm për bizneset, të harmonizuara me përvojat pozitive të legjislacionit Evropian.

"RINA COMERC" shpk do të ndërtoi dhe funksionalizoi kapacitetet e reja afariste duke respektuar në përpikëri infrastrukturen ligjore, duke plotësuar të gjithë dokumentacionin e nevojshme, në harmoni të plotë me rregullativen ligjore. Për të afaruar susesshem dhe konform ligjeve në fuqi, paraprakisht duhet të sigurohen lejet dhe liçencat e caktuara që plotësojnë standardet e duhura për sektor të caktuar, të produkteve dhe shërbimeve që ofron "RINA COMERC" shpk



## **Inkorporimi dhe Bashkëpunimi me Komunitetin Lokal**

Përmes objektivave strategjike të përpiluara nga “RINA COMERC” shpk janë identifikuar mundësitë e krijimit të bashkëpunimit me komunitetin lokal në pikat ku gërshetohen interesat e përbashkëta afariste.

- Në sektor të konsumit të gjerë manaxhmenti i “RINA COMERC shpk ka identifikuar mundësitë e bashkëpunimit me komunitetin lokal për produktet të cilat komuniteti ka mundësi dhe gatishmëri të prodhojë, ndërsa biznesi i kompanisë do të blejë për të shitur pastaj në pikat e shitjes ekzistuese dhe të planifikuar përmes këtij plani biznesi.
- Në sektorin e përpunimit dhe konservimit të frutave, komuna e Istogut është e njohur me një diversitet të frutave të malit dhe atyre që i kultivon komuniteti, kështu që programi i “RINA COMERC” shpk për përpunim dhe konservim të frutave do të jetë mjaft tërheqës për komunitetin si dhe do të mundësojë krijimin e rrjetëzimit me komunitetin në këtë program.
- Në sektorin e gastronomisë në hapësirat e objektit afarist është planifikuar edhe hapësira e nevojshme për sektorin e gastronomisë që do të ofroj shërbimet e ushqimit dhe pijeve, e komuniteti lokal do të ketë mundësinë që për kërkesat e konsumatorëve për këto shërbime të gastronomisë, të furnizoi “RINA COMERC” shpk me produkte të caktuara për të plotësuar kërkesat e konsumatorëve.
- Në sektorin e përpunimit të mishit në hapësirat e objektit afarist është planifikuar përpunimi i mishit të gjedhit dhe përmes kësaj diversifikimi dhe plasimi në treg i shumë produkteve të reja.

### **Ambienti Teknologjik**

Zhvillimi dhe avancimi i teknologjisë informative dhe programet adekuate kompjuterike, ofrojnë lehtësira të shumta për menaxhimin dhe zhvillimin e biznesit “RINA COMERC” shpk duke shfrytëzuar programe të avancuara teknologjike, do të menaxhojë në mënyrë të sigurtë të hyrat dhe shpenzimet e aktiviteteve afariste. Paketat softërike, që janë në dispozicion për aktivitetet afariste, të përcaktuara përmes objektivave strategjike të biznesit në fjalë, duke përfshirë menaxhimin e objektit, bazës së të dhënave, kontrollin e inventarit, menaxhimin financiar etj. “RINA COMERC” shpk do të aplikoi programet teknologjike, që përveç cash-it, të përdoret edhe programi i kredit kartelave, nga institucionet bankare vendore dhe ndërkombëtare. Këjo teknologji do të ndihmoi në menaxhimin dhe kontrollin e të hyrave, kostove të materialit harxhues dhe shpenzimeve tjera, si dhe maksimizimin e fitimit.

## Pozicionimi Afarist i Konkurrencës

### Biznesi i Tregtisë me mallra Ushqimor (kapacitetet, çmimet, pozicionimi)

“RINA COMERC” shpk aktivitetet afariste do i zhvillon në komunën e Istogut në një konkurrencë të theksuar lokale ku afarojnë qendra tregtare të njohura të karakterit nacional e lokal si ETC, Viva Fresh, Banane, e biznese individuale të tregtisë në nivel lokal. Mirëpo, objektivat strategjike të definuara të “RINA COMERC” shpk për bashkëpunim me komunitetin lokal si dhe programet e përcaktuara i krijojnë mundësinë që të ketë vende të caktuar në treg, rritje të qarkullimit financiar dhe rritje të fitimit. Në mungesë të definimit të produktit dhe shërbimeve të diversifikuara ku të gjithë kopjojnë njëri tjetrin si për nga shërbimet ashtu edhe çmimet duke aplikuar konkurrencë të padenjë dhe injorim të rregullave dhe standardëve profesionale, këtu qëndron përparësia “RINA COMERC” shpk me kusht të rrjedhjes normale të proceseve të planifikuara.

## Hulumtimi i Tregut të Kërkesës

### Hulumtimi i Tregut të Kërkesës

Tregu vendor akoma është i varur nga produktet e importit për plotësimin e kërkesave të konsumatorëve si në nivel lokal ashtu edhe atë nacional. Andaj, programet e definuara dhe objektivat e përcaktuara nga “RINA COMERC” shpk janë mjaft atraktive për plotësimin e një pjese të caktuar të kërkesës së tregut me produkte vendore. Andaj, gradualisht do të stimulohet prodhuesi vendor që disa nga produktet vendore të jenë sa më shumë prezent në treg e që zëvendësojnë produktet që vijnë nga importi.

Kërkesat e tregut për produktet dhe shërbimet e përcaktuara nga kompania në fjalë pothuajse janë të vazhdueshme, andaj menaxhmeti i kompanisë do të jetë i fokusuar që konsumatorëve aktual të ju plotësoi kërkesat e tyre dhe të fokusohet kah konsumatorët potencial të Istogut, Klina, Pejë e më gjërë.

### Segmentimi i Tregut të Kërkesës

Në Komunën e Istogut funksionojnë 654 biznese, prej tyre janë 64 biznese me veprimtari prodhuese. Pjesa më e madhe e bizneseve janë biznese me fushë veprimtari tregtare. Në sipërfaqen e vetë territoriale, Istogu është i ndarë në 50 fshatra dhe në dy qendra ndërrurbane, si Gurrakoc dhe Banja.

Njëra nga qendrat ndërrurbane Gurrakoci, është edhe lokacioni i përcaktuar për zgjerimin e aktiviteteve afariste të biznesit aktual „RINA COMERC” shpk.

Krahas lokacionit të përshtatshëm që ka në Gurrakoc “RINA COMERC” shpk për zgjerimin e biznesit të vetë, është edhe treguesi tjetër mjaft i qëndrueshëm, që tregon për qëndrueshmërinë e biznesit, siç janë numri i banorëve dhe familjeve, si dhe frekuentimi i tyre në magjistralen Mitrovicë Pejë si dhe ardhja e konsumatorëve jorezident (siç janë turistët).

### **Pozicionimi i konkurrencës**

Kompanitë konkurrenente në rrethinën e theksuar biznesore kanë bërë shumë pak në organizmin dhe ngritjen e standardeve të tyre profesionale e posaçërisht në krijimin e rrjetëzimit me komunitetin lokal si dhe në favorizimin e produkteve vendore të prodhuara nga prodhues individual të ekonomive rurale. Në këto rrethana as për së afërmi nuk janë shfrytëzuar përparësitë që mund të kenë nga bashkëpunimi me komunitetin lokal. Me qëllim të mbajtjes së tregut aktual dhe orientimit kah tregu potencial, “RINA COMERC” shpk do të fokusohet në realizimin e investimeve të planifikuara dhe përmes marketingut kreativ do të arrij që një pjesë të tregut potencial të mbuloj me produkte e shërbime të definuara.

Në komunën e Istogut për disa produkte të konsumit të gjerë krahas konkurrentëve që shesin me pakicë, aktivitetet afariste i zhvillojnë edhe qendrat tregtare, të nivelit kombëtar, siç janë Viva Fresh, ETC, Banana, etj; por edhe në sektorin e gastronomisë ekziston konkurrencë aktuale, por realizimi i aktiviteteve të planifikuara përmes këtij plani të biznesit do ti mundësojnë “RINA COMERC” shpk, që të zgjerohet në treg, fillimisht lokal, e në të ardhmen e afërt edhe më gjerë.

# IMPLEMENTIMI I STRATEGJIVE TË MARKETINGUT

## Strategjitë Marketingut

### Definimi i Produkteve dhe Fushëveprimit të Shërbimeve për Marketim

Sipas kërkesave dhe pritjeve të konsumatorëve nga tregjet e synuara, kompania do të orientoi edhe programet strategjike të zhvillimit të produktit. Përparësia e kompanisë qëndron në përkrahjen dhe shfrytëzimin e konsulencës profesionale e cila identifikon përparësitë dhe të metat e konkurrencës dhe sipas trendëve të kërkesës ndihmon në zhvillimin e mirëfilltë të produktit.

### Strategjia e Çmimeve

“RINA COMERC” shpk, me strategjinë e marketingut synon në menaxhimin e çmimeve të pranueshme për konsumatorin bazuar në metodën e shpenzimeve dhe të konkurrencës.

Çmimet e produkteve dhe shërbimeve të kësaj kompanie, do të jenë konkurruese në treg pasi që shpenzimet janë më të ulëta në krahasim me konkurrencën. Duke u bazuar në përvojën e stafit profesional, në numrin optimal të punëtorëve dhe hapësirat e mjaftueshme dhe funksionale për ofrimin e produkteve dhe shërbimeve në bashkëpunimin me komunitetin lokal dhe furnizimin e një numri të konsiderueshme të produkteve nga komuniteti lokal, produkti dhe shërbimet do të kenë një kosto më të ultë

### Strategjia e Distribuimit dhe Shitjes

Strategjia e distribuimit e kompanisë mbështetet në shitjen e produkteve dhe shërbimeve konsumatorëve aktual dhe shtrirja e shitjeve edhe të konsumatorëve potencial. Deri me tani kompania me veprimtarinë e tij afariste është e njohur si për konsumatorët lokal, por edhe me gjerë. Politika e distribuimit është e orientuar në shtimin e konsumatorëve të rinjë për produktet dhe shërbimet e kompanisë nëpërmjet sektorit të marketingut dhe shitjes.

### Strategjia e Promocionit

Komunikimi me konsumatorët do të realizohet në formë direkte duke ju ofruar shërbimet e profesionale dhe në mënyrë indirekte, përmes materialeve vizuale dhe të shkruara siç janë ueb faja, interneti, etj. Me qëllim të promovimit të shërbimeve të veta dhe realizimit të komunikimit të drejtpërdrejtë me konsumator potencial kompania do të merr pjesë në panairët dhe ngjarje të ndryshme vendore e ndërkombëtar, ku do të realizohen kontakte të rëndësishme afariste. Ndërmarrja do të komunikoi me konsumatorët duke prezantuar prodhimet e saja në panairët që organizohen në Kosovë dhe më gjerë.

Një vëmendje të veçantë në këtë kontekst do ti kushtohet disejnimin të ueb faqes dhe materialeve promotive të printuara si dhe atyre elektronike.

## SWOT ANALIZA

Përparësitë	Dobësitë
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pozita dhe lokacioni i “RINA COMERC” shpk</li> <li>• Ambienti rrethues i biznesit</li> <li>• Përvoja e gjatë në ofrimin e shërbimeve e produkteve të përcaktuara</li> <li>• Kërkesat e vazhdueshme për produktet dhe shërbimet e identifikuar</li> <li>• Kërkesat e tregut për produkte dhe shërbime të përcaktuara .</li> <li>• Mundësit për zëvendësimin e produkteve të caktuara që vinë nga importi.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kapacitetet e pakompletuara për objektivat strategjike</li> <li>• Investimet ende të papërfunduara</li> <li>• Mos krijimi i brendit të biznesit</li> <li>• Mungesa e marketing promocionit</li> <li>• Vonesa në krijimin e rrjetëzimit me komunitetin lokal.</li> <li>• Vonesa në definimin e produkteve që mund të furnizohen nga komuniteti lokal .</li> </ul>
Mundësitë	Kërcënimet
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Diversifikimi i produktit dhe shërbimeve</li> <li>• Ofrimi i shërbimeve më kosto më të ultë se konkurrenca,</li> <li>• Zgjerimi i tregut për konsumatorët aktual dhe potencial</li> <li>• Krijimi i rrjetëzimit me komunitetin lokal</li> <li>• Rritja e kualitetit të shërbimeve</li> <li>• Ofrimi i shërbimeve për plotësimin e kërkesave të konsumatorëve me produkte vendore</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rritja e konkurrencës</li> <li>• Vonesa në zgjerimin e kapaciteteve</li> <li>• Vonesa në kompletimin e infrastrukturës se nevojshme afariste</li> <li>• Konkurrenca jo lojale në treg,</li> <li>• Mungesa e burimeve njerëzore të kualifikuara për segmente të caktuara afariste</li> </ul>

### Plani i Marketingut

Në kushtet e ekonomisë bashkohore, zhvillimi dhe funksionimi i afarizmit biznesor pothuajse është i pamundur pa një plan të mirëfillt të marketingut si pjesë përbërëse e planit të biznesit i cili merret me analizën dhe programimin e aktiviteteve të shitjes së produkteve dhe shërbimeve të ndërmarrjes në treg. Pikënisjet e planit të marketingut janë përcaktimet e ndërmarrjes në fushën e shitjes, kanalet distribuimit dhe shitjes.

Plani i marketingut do të vlerësojë aftësinë konkurruese të “RINA COMERC” shpk në plotësimin e nevojave të konsumatorëve potencial. Nga kjo mund të thuhet se plani i Marketingut përcakton pozitën dhe mundësitë e kompanisë në plotësimin e kërkesave të tregut aktual dhe kërkesave për tregun potencial me produkte të shërbimeve në raport me konkurrencën.

### Programet e animimit të Konsumatorëve dhe Stimulimit të Shitjes

Aktivitete tjera të plan marketingut të “RINA COMERC” shpk duhet të përgatiten programe favorizuese për konsumator të caktuar dhe animimin e konsumatorëve të rregullt. Po ashtu duhet të ofrohen programe favorizuese për konsumator potencial me rastin e festave kombëtare, lokale, ngjarjeve të ndryshme në nivel lokal, rajonal dhe me gjërë.

“RINA COMERC” shpk pos programeve favorizuese të rastit do të hartoi programe favorizuese:

- Për konsumatorët e rregullt me zbritje të çmimeve me përqindje të caktuar;
- Për biznese të caktuara, që janë të rregullt në konsumimin e produkteve dhe shërbimeve të “RINA COMERC” shpk;
- Me rastin e përvjetorit të hapjes së biznesit “RINA COMERC” shpk, si ditët e “RINA COMERC” shpk;
- Programe me rastin e ngjarjeve të ndryshme;
- Programe tërheqëse me rastin e festave, etj.

### **Publikimi në Mediet e Shkruara dhe Elektronike**

“RINA COMERC” shpk do të kushtoi rëndësi të veçantë bashkëpunimit me media të shkruara dhe elektronike që mundëson komunikimin me publikun ku do të prezanton produktet dhe shërbimet vetanake për konsumatorët aktual dhe potencial. Mjetet që duhet të përdorë janë:

- Media të shkruara dhe elektronike;
- Ueb faqja, interneti, telefoni;
- Materialet e botuara promociionale;
- Kontaktet e drejtpërdrejta me konsumatorët;
- Panairë dhe ngjarjet tjera të ngjashme etj.

## REZYMEA DHE REKOMANDIMET

### Analiza e ndryshëmrisë ose senzitivitetit të investimeve

Çdo investim në periudhën e tij reale ekonomike të eksploatimit i nënshtrohet ndikimeve dhe ndryshimeve të ndryshme. Nga këto shkaqe është e nevojshme që për çdo projekt investiv të bëhet edhe analiza e ndryshëmrisë së tij ndaj ndryshimeve të caktuara. Analiza e senzitivitetit paraqet një pjesë mjaftë të rëndësishme të vlerësimit të ashtuquajturës idesë biznesore në kuadër të Planit të biznesit, e cila duhet të konsistoi në shkallen e ndikimeve eventuale në ndryshimet e vlerave të parametrave të caktuar nga Plani i biznesit në rentabilitet (profitabilitet), gjegjësisht në pranueshmerinë e planit të biznesit. Sikurse vlerësimi komplet financiar i Planit të biznesit, ashtu edhe vlerësimi i ndryshëmrisë së biznes planit mund të shprehet në variantin statike dhe dinamike. Në praktikë, si analiza statike të ndryshëmrisë së projektit investiv më së shpeshti aplikohen vlerësimet, gjegjësisht analizat e mëposhtme:

#### a. Analiza e ndryshimit të vëllimit të produkteve dhe shërbimeve

Me rastin e projekcionit të Hyrave, janë marrë për bazë parametra mjaftë objektiv, baza nga Pasqyrat reale të prezantuara në ATK për vitin 2022-2023 (niveli mesatar i shfrytëzimit të kapaciteteve dhe të hyrat mesatare për njësi). Gjatë zhvillimeve të mëtutjeshme pozitive në lokacion dhe rajon, si dhe për shkak të rritjes së kërkesës për produkte dhe shërbime në objektin e planifikuar, objektivisht do të shfrytëzohen më mirë kapacitetet e ndërtuara, ndërsa në nivel më modest kapacitetet e mëparshme në raport me ato të projektuara (në bazë të vlerësimeve mesatarisht rreth 6 – 10% më shumë për çdo vjet). Rritje paksa më e ndryshme pritet në sektorin e shërbimeve dhe produkteve të gastronomisë (mesatarja 15-18% mesatarisht në vit).

#### b. Analiza e ndryshimeve të çmimeve shitëse

Falë përdorimit të Valutës Evropiane (Euro), në afat të mesëm nuk parashihen efekte negative dhe ndonjë fluktuacion i ndryshëm valutor, kështu që edhe gjatë projeksioneve të Hyrave janë marrë parasysh çmimet e pandryshuara statike. Nga ky aspekt, nuk priten ndikime negative në kostot e furnizimit dhe shitjes së mallrave dhe shërbimeve të gastronomisë.

#### c. Analiza e ndryshimeve tek çmimet e furnizimit të mallrave dhe energjisë

Falë tregut të hapur dhe të lirë të furnizimit me mallra tregtare, materiale dhe inventarit të imtë, si dhe konkurrencës mjaftë të lartë të furnizimit me shumicë nuk ka ndonjë rrezik i dukshëm lidhur me ndryshimet e çmimeve të tyre që do kishin efekt në nivelin e të hyrave dhe cilësinë e të ardhurave. Në sektorin e energjisë do të kushtohet rëndësi kursimeve dhe qajes me panele diellore.

#### d. Analiza e mundësisë së ndryshimit të vëllimit të investimeve

Për shkak të zhvillimit fazor, krahas rritjes së të hyrave nga kapacitetet ekzistuese si dhe karakterit të ciklusit relativisht të shpejtë të efektimit të hyrave nga investimet, përsheptimi i fazave investuese dhe operacionalizimi i tyre relativisht i shpejtë e mundëson qarkullimin e shpejtë të parasë si dhe reinvestimin e një pjese të mirë të mjeteve vetanake si në tregti ashtu edhe në gastronomi. Pjesa e dytë e periudhës afatmesme investive dhe zhvillimore pas përfundimit të investimeve dhe operacionalizimit të kapaciteteve të projektuara mundëson një periudhë të efikasitetit optimal të investimeve dhe kthimit të tyre më të relaksuar, si dhe mjete të mjaftueshme qarkulluese.

## PËRMBLEDHJA E INVESTIMEVE DHE PËRFITIMEVE

Më poshtë në mënyrë të përmbledhshme do jepen investimet dhe përfitimet nga ky investim i planifikuar:

**Investimi në objekt dhe mjete themelore: 1.497.997,40€** ku të gjitha investimet e planifikuara dhe blerjet investive do bëhen nga firmat lokale përveq në ato raste kur mungon oferta. Në këtë mënyrë do të krijohej një multiplikim i parësë dhe në këtë mënyrë do të rritej qarkullimi i parësë në formë multiplikimi në lokalitetin përkatës.

**Investimi në panele solare : 150.000,00€** ku përfitimet do të ishin shumëdimensionale duke nisur nga: mbrojtja e mjedisit, çmimet e larta të furnizimit me energji elektrike, ruajtja e burimeve të tokës si dhe nga trendet ndërkombëtare për një sistem të qëndrueshem energjetik me bazë diellore.

**Rrjetëzimi me fermeret lokal:** në kuader të blerjes mallrave hyn edhe kategoria e blerjes nga fermeret. Në këtë investim parashihet që të bëhet rrjetëzim më i madh dhe më efikas ndërmjet kompanisë dhe fërmereve lokal në formë të shitblerjes së mallrave dhe shërbimeve.

**Imazhi i lokacionit:** në lokacionin përkatës do jepet mundësia që komuniteti të afrohet më afër me nevojat e tyre, do rritet imazhi i lokacionit ku do të ndërveprojë kompania si dhe komuniteti do ketë hapësirat e nevojshme argëtimi dhe rekreacioni.





Informata mbi biznesin  
Information about business  
Informacija o biznisu

Numri Unik Identifikues / Jedinstveni Matični Broj / Unique Identification Number  
810034330

Aplikacioni / Application / Aplikacija

Subjekti i regjistrimit:  
Registration subject:  
Subjekt registracije:

Data e plotësimit:  
Filling date: 19/06/2017  
Datum:

Data e pranimit:  
Reception date: 19/06/2017  
Datum primljenje:

Numri i protokollit:  
Protocol number: 0A0000566  
Broj protokola:

Biznesi / Business/ Biznis

Tipi i biznesit  
Business Type  
Tip biznisa  
Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara  
Limited Liabilities Companies  
Društvo sa ograničenom odgovornošću

Emri i biznesit:  
Business name:  
Naziv biznisa:  
Rina Comerc SH.P.K.

Emri tregtar:  
Trgovačko ime:  
Commercial name:  
///

Adresa  
Address  
Adresa  
Rruga Bardh Isufi, pn  
Banjë  
Istog

Data e themelimit:  
Date of establishment: 19/06/2017  
Datum osnivanja:

Kapitali i përgjithshëm:  
Total Capital: € 398,939.18  
Totalni kapital:

Numri i punëtorëve:  
Number of employees: 2  
Broj radnika:



---

Informata mbi biznesin  
Information about business  
Informacija o biznisu

---

**Numri Unik Identifikues / Jedinstveni Matični Broj / Unique Identification Number**  
**810034330**

---

Shënim me rëndësi / Important Note / Vazan podatak

Informata plotësuese / Additional Information Note / Dodatna informacija



Informata mbi biznesin  
Information about business  
Informacija o biznisu

Numri Unik Identifikues / Jedinstveni Matični Broj / Unique Identification Number  
810034330

Veprimtaritë / Activities / Delatnosti

4711	Aktiviteti kryesor i biznesit	Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara, ku mbizotëron ushqimi, pijet dhe duhani Retail sale in non-specialised stores with food, beverages or tobacco predominating Trgovina na malo u nespecializiranim prodavaonicama pretežno hranom, pićima i duvanskim proizvodima
1071	Aktiviteti sekondar	Prodhimi i bukës, simiteve dhe ëmbëlsirave të freskëta Manufacture of bread; manufacture of fresh pastry goods and cakes Proizvodnja hleba; proizvodnja svežih peciva, slastičarskih proizvoda i kolača
1011	Aktivitetet tjera	Përpunimi dhe konservimi i mishit Processing and preserving of meat Prerada i konzerviranje mesa
4721	Aktivitetet tjera	Tregtia me pakicë e frutave dhe perimeve në dyqane të specializuara Retail sale of fruit and vegetables in specialised stores Trgovina na malo voćem i povrćem u specijaliziranim prodavnicama
4722	Aktivitetet tjera	Tregtia me pakicë e mishit dhe produkteve të mishit në dyqane të specializuara Retail sale of meat and meat products in specialised stores Trgovina na malo mesom i mesnim proizvodima u specijaliziranim prodavnicama
4723	Aktivitetet tjera	Tregtia me pakicë të peshkut, krustaceve dhe molusqeve (frutave të detit) në dyqane të specializuara Retail sale of fish, crustaceans and molluscs in specialised stores Trgovina na malo ribama, rakovima i školjkama u specijaliziranim prodavnicama
4724	Aktivitetet tjera	Tregtia me pakicë e bukës, ëmbëlsirave, produkteve prej mielli dhe produkteve prej sheqeri, në dyqane të specializuara Retail sale of bread, cakes, flour confectionery and sugar confectionery in specialised stores Trgovina na malo hlebom, pecivom, kolaćima, testeninama, bombonima i slatkićima u specijaliziranim prodavnicama
4725	Aktivitetet tjera	Tregtia me pakicë e pijeve në dyqane të specializuara Retail sale of beverages in specialised stores Trgovina na malo pićima u specijaliziranim prodavnicama
4751	Aktivitetet tjera	Tregtia me pakicë e tekstileve në dyqane të specializuara Retail sale of textiles in specialised stores Trgovina na malo tekstilom u specijaliziranim prodavnicama
4752	Aktivitetet tjera	Tregtia me pakicë e artikujve elektronikë, ngjyrave dhe xhamit, në dyqane të specializuara Retail sale of hardware, paints and glass in specialised stores Trgovina na malo željeznom robom, bojama i staklom u specijaliziranim prodavnicama
4753	Aktivitetet tjera	Tregtia me pakicë e qilimave, sixhadeve, veshjeve të mureve dhe dyshemeve, në dyqane të specializuara Retail sale of carpets, rugs, wall and floor coverings in specialised stores Trgovina na malo sagovima i prostiraćima za pod, zidnim i podnim oblogama u specijaliziranim prodavnicama
4754	Aktivitetet tjera	Tregtia me pakicë e pajisjeve elektrike në dyqane të specializuara Retail sale of electrical household appliances in specialised stores Trgovina na malo elektrićnim aparatima za domaćinstvo u specijaliziranim prodavnicama



Informata mbi biznesin  
Information about business  
Informacija o biznisu

4761	Aktivitetet tjera	Tregtia me pakicë e librave në dyqane të specializuara Retail sale of books in specialised stores Trgovina na malo knjigama u specijaliziranim prodavnicama
4765	Aktivitetet tjera	Tregtia me pakicë e lojërave dhe lodrave, në dyqane të specializuara Retail sale of games and toys in specialised stores Trgovina na malo igrama i igračkama u specijaliziranim prodavnicama
4771	Aktivitetet tjera	Tregtia me pakicë e veshjeve në dyqane të specializuara Retail sale of clothing in specialised stores Trgovina na malo odjećom u specijaliziranim prodavnicama
4772	Aktivitetet tjera	Tregtia me pakicë e këpucëve dhe artikujve prej lëkure, në dyqane të specializuara Retail sale of footwear and leather goods in specialised stores Trgovina na malo obućom i proizvodima od kože u specijaliziranim prodavnicama
4775	Aktivitetet tjera	Tregtia me pakicë e artikujve kozmetikë dhe të tualetit, në dyqane të specializuara Retail sale of cosmetic and toilet articles in specialised stores Trgovina na malo kozmetičkim i toaletnim proizvodima u specijaliziranim prodavnicama
4776	Aktivitetet tjera	Tregtia me pakicë e luleve, bimëve, farërave, plehrave artificialë, kafshëve përkdhelëse dhe ushqimi i tyre, në dyqane të specializuara Retail sale of flowers, plants, seeds, fertilisers, pet animals and pet food in specialised stores Trgovina na malo cvijećem, sadnicama, sjemenjem, gnojivom, kućnim ljubimcima i hranom za kućne ljubimce u specijaliziranim prodavnicama
4941	Aktivitetet tjera	Transporti rrugor i mallrave Freight transport by road Drumski prevoz robe
5210	Aktivitetet tjera	Magazinimi dhe ruajtja Warehousing and storage Skladištenje robe
5221	Aktivitetet tjera	Aktivitetet shërbyese të rastit për transportin tokësor Service activities incidental to land transportation Uslužne djelatnosti u vezi s kopnenim prevozom
5229	Aktivitetet tjera	Aktivitetet e tjera mbështetëse të transportit Other transportation support activities Ostale prateće djelatnosti u prevozu
5610	Aktivitetet tjera	Restorantet dhe aktivitetet shërbyese lëvizëse të ushqimit Restaurants and mobile food service activities Delatnosti restorana i ostalih objekata za pripremu i usluživanje hrane

Filialet / Branches / Jedince



Informata mbi biznesin  
Information about business  
Informacija o biznisu

Emri: Name: Ime:	RINA VRELLË
Kodi: Code: Kod:	4711
Aktiviteti kryesor: Main activity: Glavna delatnost:	Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuar, ku mbizotëron ushqimi, pijet dhe duhani Retail sale in non-specialised stores with food, beverages or tobacco predominating Trgovina na malo u nespecializiranim prodavaonicama pretežno hranom, pićima i duvanskim proizvodima
Adresa: Address: Adresa:	Rruga Qazim Hakaj, pn Vrellë Istog
Data regjistrimit: Registration date: Datum registracije:	07/03/2022
Emri: Name: Ime:	Rina Banjë
Kodi: Code: Kod:	4711
Aktiviteti kryesor: Main activity: Glavna delatnost:	Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuar, ku mbizotëron ushqimi, pijet dhe duhani Retail sale in non-specialised stores with food, beverages or tobacco predominating Trgovina na malo u nespecializiranim prodavaonicama pretežno hranom, pićima i duvanskim proizvodima
Adresa: Address: Adresa:	Bardhe Isufi, p.n Banjë Istog
Data regjistrimit: Registration date: Datum registracije:	02/03/2020
Emri: Name: Ime:	Restaurant RINA
Kodi: Code: Kod:	5610
Aktiviteti kryesor: Main activity: Glavna delatnost:	Restorantet dhe aktivitetet shërbyese lëvizëse të ushqimit Restaurants and mobile food service activities Delatnosti restorana i ostalih objekata za pripremu i usluživanje hrane
Adresa: Address: Adresa:	Motrat Qiriaz Zallq Istog
Data regjistrimit: Registration date: Datum registracije:	19/03/2015



Informata mbi biznesin  
Information about business  
Informacija o biznisu

Emri: Name: Ime:	Njësia 2 GURRAKOC
Kodi: Code: Kod:	4711
Aktiviteti kryesor: Main activity: Glavna delatnost:	Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuar, ku mbizotëron ushqimi, pijet dhe duhani Retail sale in non-specialised stores with food, beverages or tobacco predominating Trgovina na malo u nespecializiranim prodavaonicama pretežno hranom, pićima i duvanskim proizvodima
Adresa: Address: Adresa:	Pn Gurrakoc Istog
Data regjistrimit: Registration date: Datum registracije:	26/03/2014
Emri: Name: Ime:	Rina - Zallç
Kodi: Code: Kod:	4711
Aktiviteti kryesor: Main activity: Glavna delatnost:	Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuar, ku mbizotëron ushqimi, pijet dhe duhani Retail sale in non-specialised stores with food, beverages or tobacco predominating Trgovina na malo u nespecializiranim prodavaonicama pretežno hranom, pićima i duvanskim proizvodima
Adresa: Address: Adresa:	Kryesore Zallq Istog
Data regjistrimit: Registration date: Datum registracije:	30/08/2013
Bordi drejtorëve / Board of Directors / Upravni odbor	



Informata mbi biznesin  
Information about business  
Informacija o biznisu

**Pronarët / Owners / Vlasnici**

Person fizik

Emri:  
Name: Mehmet Imeraj  
Ime:

ID Personale:  
Personal ID: 2002583537  
Licni ID:

Adresa:  
Address: Isa Boletini  
Adresa: Zallç  
Istog, Kosova

Përgjegjësia:  
Liability:  
Odgovornost:

Pjesa në pronë:  
Owned part: 398,939.18€  
Deo o vlasnistvu:

Data:  
Date: 18/01/1953  
Datum:

Aksionar / Shareholder / Akcionarsko  Aksionar i privilegjuar / Privileged shareholder/ Privilegovani akcionar

**Personat e autorizuar / Authorized participants / Ovlaścene lice**

Emri:  
Name: Valon Imeraj  
Ime:

ID Personale:  
Personal ID: 1500552731  
Licni ID:

Pozita e punës:  
Job position: Drejtor menaxhues  
Radno mesto:

Adresa:  
Address: Drejë  
Adresa: Drejë  
Istog, Kosova

Autorizimet:  
Authorizations: Sipas ligjit dhe statutit.  
Autorizacije:

Lista e shtresave Grupi i zgjedhjes

Hartat bazike

ARIS\_DEV\_ORTO\_LAYER

Orthophoto\_2012

Orthophoto2018Rural

Orthophoto2018Urban

Mosaicu i Imazheve

70806048\_7E16-B5-5g.tif

70806002\_7e16-a5-4.tif

70806051\_7e16-a5-7-1.tif

70806051\_7e16-b5-3.tif

70806016\_7e16-a5-1.tif

70806016\_7e16-b5-2-1.tif

70806013\_7e16-a5-2.tif

70806039\_7e16-a5-1.tif

Njësitë administrative

Komune

Zonë kadastrale

Regjistri i adresave

Shresat e tjerà kadastrale (gjendja e tan

Parcelat dhe Ndërtesat (gjendja e tanish

Pika kufitare e parcelës

Vija kufitare e parcelës

Parcelat

Numri i parcelës

Pika kufitare e ndërtesës

Ndërtesat

Vija kufitare e ndërtesës

Numri i ndërtesës

Vija e kufiut të ndërtesës

Pjesë e ndërtesës

Kati:

